

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

EUROMEDITERRANEAN
(PROCEEDINGS)

Revistë periodike shkencore

6

Janar 2013

Tiranë, Janar 2013

© UMSH PRESS

EUROMEDITERRANEAN

Revistë shkencore

Botim i UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Nën Drejtimin e Akad.Asoc. Prof. Dr Anastas ANGJELI

Bordi i Nderit

Prof.Dr.Arben Puto
Prof.Dr.Artistotel Pano
Prof.Dr.Sabah Hilmija
Prof.Dr.Ilia Kristo
Prof.Dr.Emin Riza
Prof.Dr.Vasil Tole

Bordi Drejtues-Shkencor -Editorial

Kryetar
Prof.Dr.ANASTAS ANGJELI
Akademik i Asoc.

Anëtarë

Prof.Dr.Kosta Bajraba
Prof.Dr Ilia Kristo
Prof.Dr. Esmeralda Uruçi
Prof.Dr. Stefan Çapaliku
MA. Ben Blushi
Prof.Asoc. Mimoza Manxhari
Prof.Dr.Orfea Dhuci
Dr. Hysen Çela
Dr. Altin Hoti
Dr. Fatos Ibrahim
Dr.Skender Demaliaj
MA. Gjergj Teneqexhi
MA. Ardian Petollari
MA. Nevila Rama
MA Jona MARASHI
MA. Ilir Aliaj
MA.Besnik Leskaj
MA. Kriton Kuci
MA. Etleva Vertopi
MA.Merita Myftari
MA. Emilio Cika

Kryeredaktor

MA. Ilir HEBOVIJA

Redaktorë Shkencore

MA.Nevila RAMA
MA.Kriton KUÇI

Kopertina Quick Advertise

Faqosja: Dafina Stojko

© UMSH PRESS

Shtypyr: GEER, 2013

Scientific Committee:

Professor Justin Yifu LIN- (former World Bank Vice President) University of Beijing, China, Chair
Professor Anastas ANGJELI – Mediterranean University of Albania, Albania
M.A. Greta ANGJELI - Mediterranean University of Albania, Albania
Volker TREICHEL – The World Bank, USA
Professor Nabil AYAD – Rector of London Academy of Diplomacy, United Kingdom
Professor Kosta BARJABA – Mediterranean University of Albania, Albania
Professor Vincenzo SCOTTI – President Link Campus University, Italy
Professor Vassilis DAGDILELIS – University of Macedonia, Thessaloniki, Greece
Professor Fernando Merino De LUCAS – University of Murcia, Spain
Professor David FARAGGI – University of HAIFFA, Israel
Professor Sulo HADERI – University of Tirana, Albania
MA. Ilir HEBOVIJA – Mediterranean University of Albania, Albania
Professor Erich HOEDL – Vice President of European Academy of Sciences and Arts, Brussels
Professor Natasha HODAJ – Agricultural University of Tirana, Albania
Professor Ilia KRISTO – University of Tirana, Albania
MA Kriton KUCI Mediterranean University of Albania, Albania
Dr. Etleva LESKAJ – University of Tirana, Albania
Professor Joseph MIFSUD – London Academy of Diplomacy, United Kingdom
Professor Aristotel PANO- Mediterranean University of Albania, Albania
D.r.Nevila RAMA- Mediterranean University of Albania, Albania
Dr. Mamica SKENDERI – SEERC- Thessaloniki, Greece
Professor Piergiorgio VALENTE - Link Campus University, Italy

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
SHQIPERIA SFIDAT E RRIJTJES DHE PERBALLJA ME KRIZEN. RENDESIA E RIMARRJES SE MODELIT TE RRIJTJES EKONOMIKE. Akademik, Prof. Dr ANASTAS ANGJELI Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë	9
KRIZA E BORXHEVE, SEKTORI FINANCIAR DHE IMPLIKIMET NE ZHVILLIMIN EKONOMIK TE SHQIPERISE	
HISTORIA DHE FILOZOFOIA E TATIMIT PROGRESIV, ROLI PËR MAKSIMALIZIMIN DHE GARANTIMIN E DREJTËSISË EKONOMIKE E SOCIALE DHE LEHTËSITË PËR TEJKALIMIN E SITUATAVE TE KRIZËS. Anastas Angjeli, Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë	18
THE ALBANIAN FISCAL SUSTAINABILLITY UNDER THE EUROZONE CRISIS Dr. Olta Milova, Dr. Soana Teka-Jaupllari	26
AUDITI I BRENDSTEM. POZICIONI I TIJ NE FINANCAT PUBLIKE Greta ANGJELI, Sulo Haderi.....	41
BORXHI PUBLIK DHE RRIJTJA E EKONOMISE SHQIPTARE Klodian Muco, Lindita Rova, Alketa Bejko	59
KRIZA FINANCIARE NË RAJON SITUATA FINANCIARE NË SHQIPËRI Armen Kadriu, Nazmije Merko Zabzun	73

TATIMI PROGRESIV DHE PËR PJESTIMOR- NJË VËSHTRIM KRAHASIMOR	
Luan Shahollari	97
THE IMPACT OF GLOBAL RECESSION ON INTERNATIONAL TRADE	
Biljana Ciglovska, Ramis Merko	122
EDUKIMI DHE KULTURA FISKALE SI SHENJË SOLIDARITETI DHE PËRGJEGJËSIE PËR NJË VEND MË TË MIRË	
Artur Papajani	136
PUBLIC DEBT IN ALBANIA	
Edlira Kalaja, Arjeta Abazi	146
ROLI I SHËRBIMEVE TË AUDITIMIT NË REDUKTIMIN E KORRUPSIONIT	
Greta ANGJELL, Gjon Ndreja	156
EFEKTI I POLITIKAVE MONETARE NË EKONOMI PËRGJATE RECESIONIT GLOBAL 2008-2011	
Alqi Naqellari, Terida Mëhilli	177
NDIKIMI I KRIZËS EKONOMIKE NË TREGUN E SIGURIMEVE DHE KOMPANITË NË RAJONIN TONË	
Zhanina Dapi, Jovan Stojanoski, Klime Poposki, Liljana Elmazi	200
DISA PROBLEME MBI RITMET E RRITJES DHE MODELET E ZHVILLIMIT EKONOMIK	
Hysen Xhaja, Alban Beqaj	205
TIPARET E TRANZICIONIT EKONOMIK NË SHQIPËRI	
Leontiev Çuçi	221
ZHVILLIMI I EKONOMISE REALE, REFORMAT STRUKTURE DHE SEKTORET PRIORITARE	
EKONOMIKSI I MIREQENIES - NJË DISKUTIM I MUNGUAR GJATE TRAJEKTORES SONË TË ZHVILLIMIT	
Gjergj Filipi, Elena Polo	232

INDUSTRIA E ENERGJETIKËS (NAFTËS) DHE EKUILIBRI I SISTEMIT TATIMOR Vladimir Mici	248
MENAXHIMI I RISQEVE BANKARE NË SHQIPËRI NË KUADRIN E KRIZËS GLOBALE FINANCIARE Erisa Xhaxho	259
LIRIA EKONOMIKE DHE KULTURA SI NËXTËS TË ZHVILLIMIT EKONOMIK Rudina Ramaj, Ilirjan Lipi, Etleva Leskaj	278
IMPAKTI I KRIZES EKONOMIKE FINANCIARE NE NIVEL LOKAL - RAJONI I GJIROKASTRES Lindita Rova, Klodian Muço, Daniela Qiqi.....	297
GJIROKASTRA DHE ZHVILLIMI I TURIZMIT TE QENDRUESHEM Daniela Qiqi, Alketa Bejko	311
TFP AND ECONOMIC GROWTH: THE CASE OF ALBANIA Altin Gjini	327

HYRJE

Ky numër i ri i revistës shkencore EUROMEDITERRANEAN përmbledh punimet shkencore të prezantuara në katër sesionet tematike të Konferencës Ndërkombëtare Shkencore “Albania and the crisis. What’s next? Revisiting the growth model” të organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në datat 15-16 dhjetor 2012.

Dita e parë e konferencës konsistonte në Sesionin plenar ku merrnin pjesë akademikë, politikanë, profesorë vendas dhe të huaj, studiues, studentë dhe të ftuar të tjerë. Në këtë session plenar mbajtën referate, mbi çështjet thelbësore të konferencës, Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Angjeli, Profesor Justin Yifu Lin, ish zv. President i Bankës Botërore, Z. Edmond Haxhinasto, Ministër i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë, Dr. Volker Treichel, Drejtor për Afrikën në Bankën Botërore, z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Erich Hoedl, Zv. President i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, Profesor Vincenzo Scotti, President i Link Campus University në Itali, Profesor Piergiorgio Valente i Link Campus University, Profesor Nabil Ayad dhe Joseph Mifsud nga London Academy of Diplomacy, Profesor David Faraggi, rektor i Universitetit të Haiffas në Izrael, Profesor Fernando Merino de Lucas nga Universiteti i Murcias në Spanjë dhe Profesor Vasilis Dagdilelis nga Universiteti i Maqedonisë në Selanik të Greqisë.

Në ditën e dytë të konferencës u organizuar 4 sesione tematike ku referuan mbi 70 profesorë vendas dhe të huaj.

SHQIPERIA SFIDAT E RRITJES DHE PERBAL- LJA ME KRIZEN. RENDESIA E RIMARRJES SE MODELIT TE RRITJES EKONOMIKE

Akademik, Prof. Dr ANASTAS ANGJELI
Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

Të nderuar miq kolegë dhe të ftuar

Ju uroj mirëseardhjen në Seancën plenare të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Albania and the crisis. What's next? Revisiting the growth model".

Nevoja për debat publik shkencor, akademik dhe profesional, sidomos rreth zhvillimeve ekonomike të një vendi, nuk është një çështje vullneti personal, por domosdoshmëri dhe nevojë e zhvillimit dhe e progresit. Recetat për një model të rritjes ekonomike dhe rekomandimet për to nuk mund të jenë më zgjidhje e një grupi njerëzish. Ato duhet të jenë produkt i studimeve të thella, përllogaritjeve të sakta, strategjive e vizioneve qartësisht të konturuara.

Kjo sepse sot jo vetëm zhvillimet ekonomike, por edhe ato politike dhe sociale të një vendi, nuk mund të shihen të shkëputura nga zhvillimet rajonale dhe globale. Për këtë arsye, as Shqipëria nuk mund dhe nuk duhet të jetë e shkëputur nga debatet që zhvillohen në nivel akademik, shkencor, profesional dhe politik në Evropë dhe më gjerë. Në këtë debat janë përfshirë duke u vënë përballë, jo vetëm lider politike dhe institucione ndërkombëtare, por edhe ekspertë të njohur të fushës së ekonomisë dhe financave, përfaqësues të jetës akademike e universitare, përfaqësues të shkollave dhe rrymave të ndryshme ekonomike, kejnsoniane, neokejnsoniane, neoklasike ,etj etj. nobelistë, përfaqësues të komunitetit të biznesit e më gjerë. Dhe debatet, propozimet, problematikat dhe dilemat në Evropë sot janë të shumta.

“Buzëqeshja” e Presidentit Holande, apo “ashpërsia” e Kancelares Merkel? Masa shtrënguese, apo zhvillim? Kursim i tejskajshëm, apo stimul për zhvillim të qëndrueshëm e solidar? A ka nevojë ekonomia e eurozonës për një shtysë të re, apo do të vazhdohet me masa shtrënguese? A janë këto masa efektive? A duhen dënuar përjetë kombet që kanë bërë aq shumë sakrifica nëse qytetarët vlerësojnë se këto sakrifica nuk japin rezultat? A është sot kërcënim vetëm deficitit dhe borxhi, apo edhe recesioni e papunësia? Apo duhet të gjejmë pikërisht një kompromis ndërmjet mbështetësve të masave shtrënguese dhe kursimit me mbështetësit e zhvillimit? A duhet që vetëm në emër të rritjes ekonomike të lihen pas dore të drejtat sociale të qytetarëve? Si do të garantojmë një harmonizim të rritjes ekonomike, zhvillimit ekonomik, punesimit zhvillimit social dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së popullsisë?

Por, dilemat shtrohen edhe në nivel rajonal dhe kombëtar për zhvillimet e pritshme në vendet në zhvillim, që janë në fund të tranzicionit, por që përballen me pasojat e krizës në eurozonë. E tillë është edhe ekonomia shqiptare. Dhe ne duhet të japim përgjigje nëse duhet që Shqipëria të rimarrë modelin e rritjes ekonomike përmes një strukture të re ekonomike, duke riprioritizuar drejtimit e zhvillimit konkurrues dhe me rritje të punësimit, apo duhet t’i qëndrojmë “besnike” modelit të ndjekur këto 22 vite tranzicion? Sa të kujdesshëm duhet të jemi kundrejt rritjes së borxhit publik? A lejon më mundësi dhe hapësira zhvillimi rritja e mëtejshme e borxhit?! Si duhet të veprojmë për të rritur aftësitë paguese të borxhit? Çfarë ekonomie do të zhvillojmë? Si do t’i identifikojmë mundësitë e rritjes së mëtejshme ekonomike? Në cilat drejtime, sektorë, produkte do të orientohet zhvillimi i ardhshëm ekonomik i vendit në 10-15 vitet që vijnë? Cili është modeli ekonomik dhe burimet e resurset që duhen shfrytëzuar dhe produktet, industritë, sektorët që garantojnë avantazhe krahasuese dhe zëvendësuese? Si duhen identifikuar dhe zhvilluar në mënyrë që të sigurohet rritja e qëndrueshme dhe konkurruese nga njëra anë, por edhe të minimizohen problemet e papunesisë dhe ato sociale, nga ana tjetër ?

Profesor Justin Yifu Lin, keynote speaker, me përvojën dhe karrierën e tij do të na ofrojë për diskutim një recete për modelin e rritjes të suksesshëm për identifikimin e mundësive të rritjes ekonomike, pra të sektorëve që duhet të kenë përparësi, si dhe lehtësimin e rritjes ekonomike. Thelbi i modelit strukturor të ri ekonomik qëndron tek aplikimi i teorisë neoklasike ekonomike ku studiohen pjesët përbërëse të strukturës ekonomike dhe evolucionit në procesin e zhvillimit, të cilat përbëjnë natyrën e zhvillimit ekonomik modern. Hipoteza kryesore e modelit të ri të rritjes ekonomike është që struktura industriale përbëhet si pasojë e faktorëve të prodhimit, në një moment të caktuar dhe me mundësi ndryshimi me kalimin e kohës.

Sot ne do të kemi prej tij sugjerimin e një guide te rëndësishme, me vlerë jo vetëm akademike por edhe praktike, për qeverite e vendeve në zhvillim. Në funksion të përmbushjes së objektivave të rritjes ekonomike qeveritë do të duhet të adoptojnë politikat e duhura në mënyrë që të lehtësojë zhvillimin e sektorit privat në një linjë me avantazhet krahasuese të vendit dhe të perfitojë nga avantazhet hyrëse në tregjet e ndryshme.

Ne besojmë se mënyra më efektive që pyetjet dhe dilemat që citova më sipër të gjejnë përgjigje dhe të shërbejnë si katalizatorë për zhvillimin e një dialogu shkencor, është nëpërmjet forumeve dhe konferencave shkencore të hapura dhe gjithëpërfshirëse. Këtë karakter u përpoqëm t'i japim edhe Konferencës Shkencore "Albania and the crisis: What's next? Revisiting the growth model", e cila gjatë kësaj seance plenare që po zhvillohet sot si dhe gjatë katër seancave tematike që do të zhvillohen nesër para dite ne Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, do të trajtojnë situatën ekonomike, financiare e sociale të Shqipërisë në kushtet e krizës globale në përgjithësi dhe të eurozonës në veçanti dhe perspektivën e zhvillimit të saj në këndvështrimet e reja ekonomike, duke pasur parasysh:

Së pari, identifikimin e faktorëve dhe prioritetëve të rritjes ekonomike, që shoqërohet me gjenerim të punësimit dhe kushteve-kuadër të masave lehtësuese për të. **Së dyti**, marrjen në konsideratë e të gjithë faktorëve të mësipërm, por, në veçanti, ata që ndikojnë më shumë, të cilët janë një kompozim relativ i resurseve natyrore, punës, kapitalit human dhe kapacitetit fizik, që në faza të ndryshme të zhvillimit janë të ndryshme. **Së treti**, mbajtjen në qendër të vëmendjes se sistemi i nxitjes së rritjes ekonomike (rritja ekonomike moderne) është një proces i vazhdimit të novacionit teknologjik, rritjes dhe diversifikimit industrial dhe përmirësimit të tipave të ndryshëm (infrastrukturë, rregullimet institucionale, kushtet për zhvillimin e një biznesi të suksesshëm).

Kjo konferencë shkencore ndërkombëtare është bazuar jo vetëm në faktet e theksuara më sipër, por edhe ne ate qe...

Së pari, ajo vjen si vazhdim dhe reflektim i konferencës ndërkombëtare me temë "Për një model të ri ekonomik", zhvilluar dy vjet më parë. Kjo konferencë dhe mendimet e diskutuara në të u bënë pjesë e një debati të gjerë për dy vjet rresht.

Së dyti, rreth idese dhe recetes për rimarrjen e modelit të rritjes ekonomike, me mbeshtetjen e partnerit mediatik, gazetes "Panorama" për të cilin gjej rastin ta falënderoj, ne zhvilluam një debat të hapur-publik ku mbi dyzete artikuj transmetuan në mënyrë transparente në publik opinione dhe mendime shumë të vlefshme. Më lejoni të falënderoj gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit në këtë debat të hapur :

Se treti, sepse kriza globale, dhe veçanërisht ajo e eurozones, gjatë këtyre tri viteve, është thelluar, pavarësisht masave të mara dhe reformave të kryera, duke u shoqëruar me një sërë fenomenesh, problematikash dhe zhvillimesh.

Së katërti, kriza globale me pasojat e saj është më e dukshme edhe nga perspektiva e ekonomisë shqiptare. Se si do të vazhdojmë të reagojmë ndaj krizës, duke kombinuar rezistencën ndaj pasojave me shfrytëzimin e oportuniteteve, kjo do të varet nga Shqipëria. Dhe qëndrimi në këtë rast duhet të jetë jo i politizuar, por realist, profesional dhe i mbështetur nga argumente ekonomike dhe shkencore. Shqipëria, me zhvillimet dhe frenimet, me anët pozitive dhe negative, me përfitimet dhe kostot, risqet dhe humbjet, pavarësisht nga shkalla e hapjes, është pjesë e këtyre zhvillimeve. Kësisoj, ajo nuk mund të mos ndikohet nga pasojat negative të kësaj krize të madhe të ekonomisë globale dhe veçanërisht nga kriza në eurozonë. Kjo pasi kriza në vendet fqinje, Greqi dhe Itali, implikon dhe ekonominë, financat dhe çështjet sociale të vendit tonë. Natyrisht që ndikimet janë shumëdimensionale. Për kuptimin e natyrës dhe të përmasave të ndikimit të kësaj krize në ekonominë tonë duhet, që ne radhe te pare, të merren në konsideratë karakteristikat e kësaj krize të tejzgjatur globale dhe konkreteisht.

a- Kushtet e një ekonomie kapitaliste të globalizuar me ndërlikime dhe ndërvarësi ndikojnë në përhapjen globale të saj.

b- Ashpërsimi i konkurrencës në të gjitha tregjet globale nga futja në to e fuqive të reja ekonomike të globit.

c- Kriza aktuale po zhvillohet në epokën e ekonomisë së financiarizuar, dhe jo në atë të ekonomisë industriale ose postindustriale. Sot pjesa e kapitaleve, e vendosur në sferën financiare e bankare dhe roli e madhësia e transaksioneve të zhvilluara në këtë sferë, ka marrë përmasa të mëdha dhe rëndësi të paimagjinuara më parë për ecurinë ekonomike globale. Ky sektor, siç kanë vënë në dukje personalitete dhe ekspertë të njohur të ekonomisë dhe financave botërore, po zë një vend gjithnjë e më të madh në modelin ekonomik në kontekstin global, duke iu imponuar, duhet thënë në mënyrë të ekzagjeruar, sektorëve të tjerë të ekonomisë. Gjithashtu, për të njohur dhe ekzaminuar ndikimin e kësaj krize në ekonominë tonë, duhen marrë në konsideratë edhe karakteristikat e ekonomisë sonë, sidomos në këtë fazë të zhvillimit të saj.

a- Stadi i zhvillimit dhe struktura e ekonomisë sonë. Ekonomia shqiptare është në një stad relativisht të ulët zhvillimi me një sistem bankar e financiar më pak të "stërholluar". Megjithëse në tregun tonë bankar veprojnë një seri banka të huaja dhe vendase, akoma nuk ka filluar përdorimi i gjerë i të gjitha instrumenteve financiare të tregjeve të zhvilluara, as funksionimi i të gjitha

llojeve të transaksioneve financiare. Kjo do të thotë se integrimi i tregut tonë bankar në atë global është disi më i vogël se vendet e tjera të prekura nga kriza dhe si klientët, ashtu edhe bankat, janë më pak të ekspozuara ndaj luhatjeve negative të tregjeve të ndryshme globale.

b- Përmasat dhe struktura e ekonomisë sonë, megjithëse janë më pak të prekshme (në krahasim me vendet e tjera) nga luhatjet e ekonomisë globale, goditjet e krizës së eurozonës tashmë janë prezente dhe pasojat pritet të rriten. Rreth 55% e PBB përbëhet nga shërbime që, ndonëse janë më pak të prekshme nga luhatjet e ekonomisë globale, do të përkeqësohen nëse nuk zhvillohen më tej. Ndërsa rreth 20% e PBB përbëhet nga produktet e degës së bujqësisë, e cila edhe ajo, në kushtet e sotme, vuan jo vetëm prej nga kriza (në ato përmasa që ndikohet ky sektor), por sidomos nga mungesa e vizionit dhe politikave zhvilluese të tij.

c- Sektori që ka njohur më shumë zhvillim në vitet e fundit në vendin tonë dhe që u godit më fort nga ndikimi i krizës globale dhe asaj të eurozonës, është ai i ndërtimit që në vitet e fundit ka pasiguruar rreth 15-17 % të PBB dhe me të cilin janë të lidhur rreth 160 industri (biznese) të tjera. Ky sektor dhe rrjeti i biznesit i lidhur me të konsiderohet i zhytur në krizë, ku borxhi dhe kleringu po e asfiksojnë atë maksimalisht.

d- Përsa i përket prodhimit tonë industrial, vitet e fundit ai ka siguruar rreth 8% të PBB dhe përbëhet në pjesën më të madhe nga prodhimi i energjisë (që varet vetëm nga kushtet natyrore për efekt të hidrocentraleve), nga prodhimi i disa mineraleve për eksport dhe nga prodhimet e veshmbathjes (me material të porositësit-fason), që në një masë të madhe eksportohen). Pra, vështirësitë e eksportit të mineraleve ose ulja e çmimeve të tyre dhe vështirësitë e eksportit të produkteve të industrisë tekstile (që zënë rreth 48% të eksporteve) kanë ndikuar negativisht në ritmet tona të rritjes ekonomike, në punësimin, në uljen e fuqisë blerëse të konsumatorëve.

e- Çështja më delikate e ekonomisë sonë janë remitancat, madhësia e të ardhurave nga emigrantët që përfaqësojnë një nga burimet më të rëndësishme si të fuqisë blerëse të vendit, ashtu dhe të ndikimit në kurset e monedhës sonë me valutat e tjera. Kriza në dy vendet fqinje (Itali dhe Greqi), ku punon pjesa më e madhe e emigranteve tanë, ka ndikuar dhe do të vazhdojë të ndikojë në të ardhurat e emigranteve dhe të dërgesave të tyre në Shqipëri.

f- Pasiguria e krizës ka ndikuar drejtpërdrejt në kufizimin e investimeve private në ekonomi, vendase dhe të huaja, dhe ato të financuara nga buxheti i shtetit.

g- Një aspekt më vete përbën niveli i konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe sfidat para të cilave e vendosi këtë tregues kriza globale.

Të nderuar kolegë,

Gjatë këtyre dy ditëve të Konferencës “Albania and the crisis: What’s next? Revisiting the growth model”, në funksion të recetës për një rritje ekonomike, do të trajtohen edhe rastet dhe përvoja nga kriza në Greqi, Spanjë, Itali dhe do të parashtrohen ide për rivlerësimin e modelit të rritjes ekonomike dhe rritjes së konkurrencës së ekonomisë shqiptare, duke adresuar sinergjinë midis modelit ekonomik me rritje ekonomike dhe zhvillimit shoqëror e punësimin. Do të analizohen probleme të fluksit dhe kapitaleve të migrimit të shqiptarëve gjatë tranzicionit, mbështetur në dukuritë e reja që ka prodhuar kriza globale, dhe veçanërisht ajo e eurozonës, veçoritë e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, rritja e pakontrolluar e borxhit të jashtëm dhe implikimet e mundshme të saj në financat publike dhe zhvillimin ekonomik perspektiv të vendit, duke u fokusuar në idenë se rritja e borxhit nuk është shoqëruar nga niveli i pritshëm i rritjes ekonomike dhe ka rënduar dhe po kercenon gjendjen e financave publike, dhe vete stabilitetin financiar të vendit. Gjithashtu, do të analizohet gjendja e sistemit bankar dhe jobankar (shoqëritë e sigurimit etj), infektimi nga kriza në eurozonë, pasojat, masat parandaluese dhe kuruese, si dhe lidhja midis sistemit bankar dhe ekonomisë reale, në çfarë mase sistemi bankar ka kontribuar për zhvillimin ekonomik dhe në çfarë mase për shëndoshjen e vetvetes, duke e vënë theksin në politikat e reja fiskale e të taksave, ato bankare, monetare, interesit, ndryshimin e kredidhënies, produktet e reja financiare e jofinanciare etj. Do të diskutohet për përmasat aktuale të lirisë ekonomike në vend, problematikat ekzistuese dhe mundësitë e zgjerimit të lirisë ekonomike në kushtet e reja të zhvillimit të ekonomisë, përmes thellimit të reformave rregullatore dhe rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, me qëllim që biznesit shqiptar dhe të huaj t’i zgjerohet liria ekonomike për t’u zhvilluar, dhe jo për t’u frenuar.

Të nderuar pjesëmarrës!

Me lejon t’ju njoh shkurtimisht me miqtë tanë të ftuar në panelin e sotëm të kësaj seance plenare në Konferencën Shkencore “Albania and the crisis: What’s next? Revisiting the growth model”

Profesor Justin Yifu Lin, ish zv. President i Bankës Botërore, doktoruar në Universitetin e Cikagos dhe profesor në Universitetin e Pekinit dhe Yale. Një personalitet i shquar ndërkombëtar në fushën e ekonomisë.

Z. Edmond Haxhinasto, Ministër i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë për të na dhënë mendimin e tij të vyer për tematikën kryesore të Konferencës nisur nga këndvështrimi i ekonomisë shqiptare,

Ne panelin tonë, sot vjen edhe një mik i Shqipërisë, me të cilin

kemi bashkëpunuar shumë për realizimin e reformave të rëndësishme makroekonomike, financiare-buxhetore dhe ristrukturuese në ekonominë tonë, kur ai mbante rolin e përfaqësuesit rezident të FMN në Tiranë, një bashkëpunor i ngushtë i Prof. Lin dhe aktualisht Drejtor për Afrikën në Bankën Botërore, **Dr. Volker Treichel**.

Fqinjët dhe bashkëkombasit tanë përfaqësohen nga personalitetet të shquara, **z. Besim Beqaj**, Ministër i Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës dhe **z. Ramiz Merko Kryetar** i Bashkisë së Strugës- Maqedoni për të na dhënë një këndvështrim rajonal, nga pozitat e zhvillimeve ekonomike të vendeve të tyre.

Prof. Dr. Erich Hoedl, Zv. President i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, njohës dhe studiues shumë i mirë i çështjeve monetare. **Profesor Vincenzo Scotti**, President i Link Campus University në Itali, disa herë ministër në qeveritë italiane dhe deputet dhe senator i parlamentit dhe senatit italian dhe **Profesor Piergiorgio Valente** i Link Campus University do të na japë mendimin e tyre të cmuar në lidhje me ndikimin e krizës në ekonominë e Italisë dhe efektet që kjo sjell për ekonominë shqiptare si dhe evolucionin e pritshëm të sistemit të taksave ndërkombëtare në nivel evropian, ndërsa nga miqtë e mi të nderuar **Profesor Nabil Ayad dhe Joseph Mifsud** nga London Academy of Diplomacy do të mirëpresim opinionet e tyre në lidhje me çështje të rëndësishme si roli i ri i diplomacisë ekonomike, ai i edukimit, teknologjive të reja dhe novacionit në rritjen ekonomike.

Me ne sot gjithashtu është dhe Profeshori i nderuar **David Faraggi**, rektor i Universitetit të Haiffas në Izrael do të kontribuojë në këtë konferencë me diskutimin e tij, në lidhje me zhvillimin e sektorëve të bujqësisë dhe turizmit në Izrael dhe benefitet e vendit tonë nga kjo eksperiencë. Më në fund (por jo nga rëndësia) **Z. Nikolin Jaka**, Kryetar i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë së Tiranës do të referojë në vazhdim. Profesorët e nderuar **Fernando Merino de Lucas** nga Universiteti i Murcias në Spanjë dhe **Vasilis Dagdilelis** nga Universiteti i Maqedonisë në Selanik të Greqisë do të na sjellin eksperiencat e dy vendeve të tyre, më të goditurat nga kriza e eurozones dhe reformat strukturore që këto vende kanë ndërmarrë për të përballuar krizës.

Konferenca në këtë sesion plenar do të mirëpresë diskutime dhe ndërhyrje nga ju të pranishëm që na nderuat sot me pjesëmarrjen tuaj në këtë konferencë dhe do të jetë e hapur për pyetje të ndryshme nga të pranishmit dhe përfaqësuesit e medias.

**KRIZA E BORXHEVE,
SEKTORI FINANCIAR DHE
IMPLIKIMET NE ZHVILLIMIN
EKONOMIK TE SHQIPERISE**

HISTORIA DHE FILOZOFIA E TATIMIT PROGRESIV, ROLI PËR MAKSIMALIZIMIN DHE GARANTIMIN E DREJTËSISË EKONOMIKE E SOCIALE DHE LEHTËSITË PËR TEJKALIMIN E SITUATAVE TE KRIZËS

Anastas Angjeli

Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

rector@umsh.edu.al

ABSTRACT

The main purpose of this paper is to analyze the progressive taxation through a philosophical approach of the history of its implementation. According to the economic history and scholars, tax policies and various types of taxes were born simultaneously with the birth of the state. They are rooted in ancient times, first in Egypt, then in ancient Greece, the Roman Empire, and later with the development of capitalism in England, in France and in other European countries and in America. Regarding the progressive tax ideological affiliation this paper highlights that the theory of progressive taxation was born and has been applied for the first time about 500 years ago in England and in France in the fourteenth century long before that Marx and Engels developed their own theories. In addition the paper takes into account the characteristics of the progressive taxation by examining the advantages of implementing it in the context of the global economic crisis.

Keywords: progressive taxation, philosophy, theory, global economic crisis, Karl Marx,

Hyrje

Kohët e fundit, jo vetëm në shtypin e përditshëm, por edhe në debatin politik (kryesisht midis opozitës dhe maxhorancës) dhe atë profesional dhe mes komunitetit të biznesit, është ushtruar një kritikë (prej maxhorancës dhe mbështetësve të saj), lidhur me mundësinë e zëvendësimit të taksës së sheshtë me taksën progresive, duke ngritur alibinë se “tatimi progresiv është një instrument marksist i politikës tatimore”?! “Grackë”, në të cilën, përveç disa politikanëve, kanë rënë dhe ekspertë e media të veçanta. Përtej keqardhjes, në rastin më të mirë, kjo kritikë e disa ithtarëve të së djathtës tregon se ose ata nuk e njohin historinë botërore të politikës tatimore, ose nuk njohin mirë qëllimin e përdorimit në veprat e Marksit dhe të Engelsit të tatimit progresiv. Për më tepër, teoria e tatimit progresiv ka lindur dhe është aplikuar për herë të parë rreth 500 vjet më parë në Angli e në Francë që në shekullin XIV, e ndërsa Marksi e ka shkruar veprën e tij në shekullin XIX. Akoma më tej...

Prëzimi i alibisë “tatimi progresiv – instrument marksist”?!

Argumentet e mëposhtme janë te bazuara në fakte historike dhe shkencore, të cilat e rrëzojnë pretendimin e mjegullt mbi marksizmin e taksimit progresiv.

ARGUMENTI I PARË: Po t’i referohemi historisë ekonomike dhe tatimore dhe studiuesve të këtyre politikave, para lindjes së marksizmit, është e qartë se në përgjithësi politika tatimore dhe llojet e ndryshme të tatimeve (dhe vetë financat) kanë lindur njëherësh me lindjen e shtetit. Ato e kanë zanafillën që në lashtësi, fillimisht në Egjipt, pastaj ëe Greqinë e lashtë, në Perandorinë Romake, për t’u përsosur më vonë me zhvillimin e kapitalizmit në Angli e në Francë dhe në shtetet e tjera të Europës dhe në Amerikë. Dhe kjo është e vërtetueshme mjaft lehtë. Mjafton të kthehemi shumë shkurt, pas në kohë, në këtë histori. Kështu, në mënyrë më specifike, tarifatat e tatimit progresiv, për të cilat ka lindur ky debat, janë përdorur në Angli e në Francë që në shekullin XIV (në kohën e luftës 100-vjeçare franko-angleze në vitet 1337-1453). Më vonë, në Amerikën koloniale, në vitet 1764-1775. Gjithë politika tatimore është përpunuar e përsosur më tej nëpërmjet “British Tax Act” të vitit 1792 (në një kohë që Marksi nuk kishte lindur – ai lindi në vitin 1818!), që vendosi tarifën progresive të tatimit mbi të ardhura që fillonte me 0,8% për të ardhura 60 paund dhe arrinte 10% për të ardhura mbi 200 paund. Dhe besoj se nuk është e rastit që parimet e politikës tatimore (parimet e tatimit) janë formuluar nga themeluesi i shkencës

ekonomike, Adam Smithi. Për më tepër njohuri historike për tarifën progresive të tatimit, sidomos mbi të ardhurat, veçanërisht gjatë zhvillimit të ekonomisë kapitaliste, mund të gjenden lehtë nga kushdo, mjafton t'i drejtohet bibliotekës apo internetit. Atje do të gjejnë shumë botime për këtë çështje, ndër të cilat përmendim "Tax World: A History of Taxation" ose "History of the Income taxation in the United States" ose "Modern History of Modern Taxation" etj. Ndërsa, nëse duhet t'i referoheni kësaj takse (progresive) dhe përdorimit të saj para çlirimit në Shqipëri (në regjimin e Zogut dhe më parë), mund t'i adresohemi te një nga veprat e përkryera historiko-shkencore të financave të Shqipërisë, pikërisht librit "Financat e Shqipërisë" 1839-1934 (p.sh. Kap.11. f252-258, Tatimi mbi të ardhura - autor: Haxhi Shkoza, Inspektor i përgjithshëm i oborrit mbretner). Nuk e besoj që Haxhi Shkoza dhe vetë mbreti Zog të kenë qenë marksistë!

ARGUMENTI I DYTË: Marksi dhe Engelsi, ashtu sikurse edhe shkollat e tjera ekonomike, e kanë përmendur, i janë referuar dhe kanë përdorur teorinë e tatimeve në përgjithësi dhe atë progresive apo proporcionale në veçanti në funksion të teorive dhe sipas interesave të tyre. Kështu mjafton të lexohen punimet e botuara në shqip, konkretisht: veprat "Thirrja e KQ drejtuar lidhjes së komunistëve mars 1850 (faqe 111), "Lufta e klasave në Francë" faqe 138, 170-171, 177-178, 212-213, 215, 220 ose "Rreth Çështjes së Banësive" (faqe 597-598 , 607) dhe veprat e zgjedhura vëll. II "Kritika e Programit të Gotes" (faqe 25-26) ose "Origjina e familjes..." (faqe 340) për të kuptuar më mirë pikëpamjet e Marksit dhe të Engelsit mbi tatimin progresiv. Marksi dhe Engelsi e kanë trajtuar problemin e tatimit progresiv për dy arsye (qëllime): Së pari, për të kritikuar (sipas tyre) të ashtuquajturit ideologë të borgjezisë, që pretendonin se thelbi i sistemit kapitalist mund të ndryshojë nëpërmjet politikës tatimore. Por për Marksit asnjë ndryshim i sistemit tatimor (pra dhe instrumentit për llojin e tatimit mbi të ardhurat) nuk përfaqësonte mjetin për kalimin nga kapitalizmi në socializëm. Kjo sepse në thelb të teorisë së tij kishte shpronësimin total të pronarëve (mohonin pronën private). Së dyti, Marksi dhe Engelsi, ndonëse nuk e mohonin se tatimi progresiv mbi të ardhurat ishte më i drejtë se ai proporcional, ashtu si realisht, për periudhën që ata i referoheshin (kjo lloj tarife tatimi progresiv), mund të rëndonte disi më shumë shtresat e pasura. Por, për ta, jo vetëm që kjo nuk sillte asnjë lloj socializmi, po ashtu siç kanë bërë shumë shkolla ekonomike, para dhe pas tyre, i kanë përdorur në analizat e tyre të gjitha llojet e tatimeve. Madje, Marksi dhe Engelsi kanë përdorur jo më pak edhe taksën proporcionale (të sheshtë). Ndërkohë që është e provuar se teoria mbi parimet dhe elementet e tatimeve

mbajnë vulën e A.Smithit (në veprën “Hulumtime mbi natyrën dhe shkaqet e pasurisë së kombeve” (1776) dhe A.Wagner-it, ndërsa në vite para dhe pas lindjes së Marksit, teoritë mbi financat u janë referuar (tatimet, taksat) edhe Th.Men.W.Petty (shek. XVII-XVIII), Malchus dhe Rau K.H,D.Rikardo dhe G.Zheze e me radhë, Stein, Sax, Pantaleoni, Davidi de Marco, Graziani etj. etj.

Tatimi progresiv, më shumë drejtësi sociale dhe zhvillim ekonomik.

Në shekullin e kaluar dhe në këto vite të këtij shekulli, sidomos në kushtet e globalizimit të ekonomisë, politika tatimore ka një rol dhe rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut. Ajo është trajtuar dhe përmirësuar në vazhdimësi. Kështu, sot sistemin progresiv e përdorin vendet e BE, ShBA, Kina, Japonia, Brazili, Australia etj., kurse tatimin përpjesëtimor Vendet Balltike, Rusia, ish-republikat sovjetike, vendet ish-komuniste të Europës Lindore dhe Qendrore etj. Në funksion të kushteve të krijuara (kriza globale dhe ajo në eurozonë), reformat dhe ndryshimet fiskale që po bëhen në shumë vende të BE (Francë, Gjermani, Itali, Spanjë) e në SHBA po prirën drejt progresivitetit. Kjo përjasje, për më shumë drejtësi sociale nëpërmjet një taksimi progresiv, vjen edhe nga SHBA. Presidenti Obama që në mandatin e tij të parë ishte fokusuar fort për ndryshime në mënyrën e vendosjes së taksave, duke u bazuar te parimi se ata që fitojnë më shumë duhet të kontribuojnë edhe më shumë.

Një përjasje që u mbështet nga populli amerikan në fushatën për rizgjedhjen e tij, duke i dhënë besimin Obamës për katër vjet të tjera. Jo më kot që në fjalimin e parë, pas rizgjedhjes së tij, Obama përsëriti atë që kishte deklaruar edhe gjatë fushatës elektorale: “Nqs duam të ulim deficitin, atëherë duhet të kombinojmë uljen e shpenzimeve me rritjen e të ardhurave – që do të thotë të kërkojmë nga amerikanët e pasur të paguajnë pak më shumë taksë”, deklaroi ai. Gjithashtu, me gjithë kritikën që i janë bërë Presidentit francez Françoise Hollande, gjatë këtyre dy muajve të fundit, kritika si nga e djathta por edhe nga e majta, ai u qëndron konsekuent premtimeve të bëra gjatë fushatës elektorale. Dhe një nga këto premtime ishte pikërisht një taksim progresiv më i lartë, për dy vitet e ardhshme, për fitimet mbi 1 milion euro. Dhe parimi ishte pikërisht arritja e një drejtësie sociale dhe, nëpërmjet saj, një zhvillimi ekonomik për vendin. Gjatë intervistës së dhënë me 13 nëntor të këtij viti, Presidenti francez mbrojti politikën e tij (përfshirë atë fiskale), duke kërkuar nga populli francez që ta vlerësojnë në fund të mandatit

të tij, dhe se në fund të pesë viteve të rinjtë do të jetojnë më mirë se sot. Edhe sistemi fiskal shqiptar, në këto 22 vite tranzicion, ka pësuar evoluimin e vet. Ai ka ndryshuar dhe është zhvilluar në varësi të fazave, ndryshimeve, transformimeve dhe zhvillimeve që ekonomia e tregut ka pësuar në vendin tonë dhe natyrisht të ndryshimeve politike dhe qeverisëse, në përputhje dhe në funksion të programeve të tyre. Këtu nuk mund të mos shtojmë dhe të vlerësojmë dhe asistencën teknike të huaj e këshillat e dhëna nga institucionet financiare ndërkombëtare apo misione specifike të BE-së. Për rastin konkret, lidhur me debatin tatim progresiv apo proporcional, mund të themi se deri më 2007-n është përdorur sistemi i tatimit progresiv, kurse prej vitit 2008 – sistemi përpjesëtimor. Në sistemin progresiv, të ardhurat për efekt tatimi ishin ndarë në pesë grupe, përkatësisht: 1%; 3.6%; 7.1%; 5.6 % dhe 13.2 %. Sipas sistemit përpjesëtimor, shumat mbi 10 mijë lekë në muaj, me ndonjë veçori, tatonen të gjitha me 10%. Në kuadrin e këtij sistemi, edhe tatimi mbi fitimin u ul nga 20% në 10%. Ndonëse koha e përdorimit të sistemit përpjesëtimor është e shkurtër, të dhënat tregojnë se të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe mbi fitimin kundrejt PBB më 2011 kanë rënë 0.1%, kundrejt vitit 2007. Prandaj dhe gjykimi (për avantazhet dhe disavantazhet mes tyre) bëhet kur sistemet provohen për një kohë, në një ambient të caktuar ekonomik (fazë zhvillimi) dhe të ndikimit të faktorëve të tjerë ekonomikë dhe financiarë të brendshëm (politikat e zhvillimit që zbaton apo programon të zbatosh) dhe faktorë të zhvillimeve të jashtme dhe të ndikimit të tyre në ekonominë e brendshme (p.sh., në këtë moment kriza në eurozonë). Pra, përveç diferencave klasike mes sistemeve, vlerësimi i ndryshimeve bëhet në momentin dhe terrenin ekonomik të caktuar. Kështu, nëse taksa e sheshtë në fillim të zbatimit të saj la përshtypjen e përfshirjes më të gjerë të tatimpaguesve (zgjerim i bazës tatimore) dhe “krijoi lehtësi në llogaritje dhe mbledhje të të ardhurave (thjeshtëzim) nga organet fiskale, ajo rëndon më shumë, padrejtësisht këdo që ka të ardhura të vogla (shumicën) individë apo biznese të vegjël, apo të mesëm, në raport me të ardhurat (rentabilitetin, fitimin), duke u kufizuar atyre nevojat jetike apo mundësinë e zhvillimit të biznesit të tyre. Dhe, nga ana tjetër, lejon më shumë mundësi përfitimi të pamërituara për grupime të veçanta, monopoleve apo oligopoleve, duke pakësuar të ardhurat e buxhetit të shtetit në raport me GDP dhe mundësinë e rikthimit të tyre ndaj gjithë vendit dhe popullsisë në formën e shpenzimeve për shërbime të ndryshme, në përputhje me funksionet e shtetit. Përkundrazi, një sistem progresiv i mirëstudiuar dhe i konsultuar me ekspertët më të mirë, botën akademike dhe komunitetin e biznesit, i diferencuar për të ardhurat personale, nga ajo mbi biznesin e vogël, fitimin apo dividendin mbi biznesin e mesëm nga

ai i madh veçanërisht monopolet, i garanton vazhdimin e zgjerimit të bazës tatimore dhe jep më shumë drejtësi sociale e ekonomike dhe liri zhvillimi. Në funksion të këtij qëllimi, në kushtet aktuale, sidomos në kushtet e krizës globale, asaj të eurozonës e të ndikimit të saj edhe në ekonominë tonë, reflektimet mbi sistemin tatimor duhet të bëhen për të përmirësuar e siguruar konkretisht:

a) një drejtësi më të madhe shoqërore (ai që përfiton dhe ka më shumë duhet të kontribuojë, pra të paguajë më shumë)

b) një politikë ekonomike që siguron jo vetëm rishpërndarjen e të ardhurave, por dhe zhvillimin më të mirë të ekonomisë duke kombinuar të gjitha llojet e tatimeve direkte dhe indirekte. Pa këto instrumente nuk mund të zbatohet një politikë sociale e të ardhurave për zbutjen e pabarazive të mëdha sociale që mund të krijohen në shoqëri.

c) një politikë tatimore që merr mirë parasysh burimin e krijimit të të ardhurave (nga kapitali, nga puna, nga llojet e ndryshme të veprimtarisë etj) dhe të shkallës së rentabilitetit (fitimit).

Po përse përdorimi i tarifës progresive tatimore të shkallëzuar siguron një drejtësi më të madhe shoqërore dhe një zhvillim më të madh ekonomik? Gjykimi duhet mbështetur në atë që, nëse për efekte tatimore a duhet trajtuar njësoj fitimi i superkompanive (monopoleve etj) me të ardhurat e një biznesi të vogël, apo një fermeri të thjeshtë, apo një punëtori të zakonshëm? Mendoj se jo. Më tej, për një politikë tatimore më efikase, kërkohet një trajtim i veçantë i të ardhurave të ndryshme sipas burimit të krijimit të tyre. A mund të tatonen njësoj të ardhurat e punës me ato të trashëgimisë së pasurisë ose të ardhurat e lojërave të fatit me ato të fermerëve të vegjël? Përsëri mendoj se jo. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh se burimi kryesor i të ardhurave buxhetore përbëhen nga tatimet indirekte, tarifatat e të cilave mund që të konsiderohen tarifa proporcionale, sepse nuk marrin fare parasysh nivelin e të ardhurave të blerësit të mallrave dhe të shërbimeve në të cilat përfshihet tatimi indirekt (përballë shitësit të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, çdo blerës edhe ai me të ardhura të mëdha dhe ai me të vogla trajtohen - goditen nga taksat indirekte njësoj). Është kjo një arsye më shumë që përdorimi i tarifës progresive tatimore të shkallëzuar siguron një drejtësi më të madhe shoqërore. Gjithashtu, politika e re tatimore sot kërkon një trajtim më të drejtë lidhur me tarifatat proporcionale e progresive të tatimeve në kuadrin e një politike më të plotë të të ardhurave që ndihmojnë shtresat me të ardhura të ulëta dhe evitojnë pabarazitë e thella që krijojnë reagime të forta shoqërore. Është kjo një arsye më shumë, që në kohën e sotme, në vendet ku vihet re një thellim i

mëtejshëm i pabarazisë ekonomike (në shumicën e këtyre vendeve), përdoret tarifa progresive e tatimit të të ardhurave dhe të pasurisë. Kështu, duke qenë se tatimi progresiv favorizon njerëzit me të ardhura të pakta, atëherë arrihet në konkluzionin se ky lloj tatimi nxit më shumë përpjekjet ekonomike të shtresave të varfra për përmirësimin e ekonomisë dhe të gjendjes sociale të tyre, duke i motivuar më tepër për zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë (Shiko. Richard A.Easterlin "Diminishing Marginal Utility of Income"). Prandaj, aplikimi i taksës progresive, i mirëstudiuar dhe mirëbalancuar, që konsideron drejt të ardhurat personale, fitimet, rentabilitetin (i cili mund të synojë që përveç monopoleve dhe super të ardhurave personale që do të kenë një shkallë më të lartë, pavarësisht nga shkalla e tarifës së progresivitetit, apo dhe vendosje e taksës negative për disa raste, duke filluar nga tarifa zero, si mesatare të mos e kalojë 10%) është më pozitive, prandaj nuk duhet të frikësojë askënd, asnjë lloj biznesi. Përkundrazi, aplikimi i saj ofron më shumë drejtësi ekonomike dhe sociale, më shumë liri për zhvillim dhe kontribut më të drejtë në buxhet duke e shndërruar në përfitim për zhvillim të të gjithë vendit dhe të gjithë qytetarëve, duke ngushtuar pabarazinë e thellë sociale, bashkërenduar me një program masash modernizimi të administratës fiskale dhe një sjellje ndryshe (nga gjrobat e korrupsioni) dhe bazuar në respektimin e ligjit, në luftë kundër informalitetit, prurja e këtij sistemi do të jetë shumë më i drejtë dhe më pozitive

Më në fund, dua të theksoj se debati mbi sistemin e taksave është një debat me shumë vlera, jo vetëm për rolin që politika tatimore ka për të ardhmen e zhvillimit ekonomik të vendit e për më shumë drejtësi sociale, por edhe për më shumë transparencë e ndërgjegjësim të taksapaguesve shqiptarë. Vlerat e këtij debati shtohen kur opinionit publik i transmetohen njëherësh edhe masat dhe programi për llojin e ekonomisë që do të zhvillojmë në 10-15 vitet e ardhshme, se si dhe se përmes çfarë prioritetesh do të mund të rimarrim një model të rritjes ekonomike, kaq të nevojshëm e të domosdoshëm, tashmë që ekonomia shqiptare po shkon drejt zeros, në një ngrirje të plotë. Në një kohe kur rreziku i destabilitetit makroekonomik është evident dhe qëndrueshmëria fiskale po kërcënohet.

Çdo politikë e re tatimesh do të zbatohet mbi një ekonomi reale, që është burim i të ardhurave. Sistemi që zgjedh të përdorësh, i maksimizon dhe garanton ose jo drejtësinë ekonomike e sociale dhe zgjedh rrugën që lehtëson tejkalimin e situatave të krizës.

Bibliografia

1. Richard L. Doernberg, *International taxation in a nutshell*. West Publishing Co, USA, 2009
2. Charles Adams, *For Good and Evil: The Impact of Taxes on the Course of Civilization*, Madison Books, Maryland, 2001
3. Bernard Salanie, *The economics of taxation*, MIT, Cambridge, 2003
4. Louis Kaplow, *The theory of taxation and public economics*, Princeton University Press, New Jersey, 2008
5. Joseph Jacobs Thorndike (ed) Dennis J., Jr. Ventry (ed) *Tax Justice: The Ongoing Debate*, Book News, Inc., Portland, OR, 2003
6. John W. Diamond (ed), George R. Zodrow (ed), *Fundamental Tax Reform: Issues, Choices, and Implications*, MIT, Cambridge, 2008
7. Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipnisë" 1839-1934*
8. *Vepra te Karl Marks*
 - *Thirrja e KQ drejtuar lidhjes së komunistëve mars 1850*
 - *"Lufta e klasave në Francë"*
 - *"Rreth Çështjes së Banesave"*
 - *"Kritika e Programit të Gotes"*
 - *"Origjina e familjes"*

THE ALBANIAN FISCAL SUSTAINABILITY UNDER THE EUROZONE CRISIS

Dr. Olta Milova

Faculty of Economy/University of Tirana
oltamilova@hotmail.com

Dr. Soana Teka-Jaupllari

Faculty of Economy/University of Tirana
soanateka@yahoo.com

ABSTRACT

The Eurozone countries crisis which began as a financial crisis and then was converted into a debt crisis is one of the most discussed issues among economists nowadays. Some countries like Italy and Greece are currently in crisis and other countries are at a potential risk. Although our country has been protected from the financial crisis seems that the eurozone debt crisis apparently threatens Albania. The reductions of trade flows, foreign investment, remittances and lending reduced by the banking system are not the only negative effects reflected in our economy as a result of the crisis that our neighboring countries are passing through. Public finances are also threatened. High levels of public debt, the repeated underperformance of the budget in recent years (large cuts in middle year budget review), the low level of tax revenues, which have narrowed more and more the space of public spending, the need for a restructuring of the tax system to facilitate business development and increase budget revenues (fiscal evasion and management) are all important indicators, which will be on the focus of the paper "The Albanian fiscal sustainability under the Eurozone crisis". This paper aims to show how sustainable

our country's public finances are and how much are they exposed to the crisis. Which are the main problems inherited over the years and what is actually done to improve fiscal consolidation. The paper will end with some conclusions.

Keywords: Fiscal sustainability, government spending, tax revenues, public debt. Budget deficit

1. Introduction

The Eurozone countries crisis which began as a financial crisis and then was converted into a debt crisis is one of the most discussed issues among economists nowadays. Some countries like Italy and Greece are currently in crisis and other countries are at a potential risk. Although our country has been protected from the financial crisis seems that the eurozone debt crisis apparently threatens Albania. The reductions of trade flows, foreign investment, remittances and lending reduced by the banking system are not the only negative effects reflected in our economy as a result of the crisis that our neighboring countries are passing through. Are we exposed to the crisis? In fact, the stability of the macroeconomic variables is an important indicator of the economic performance and affordability of the crisis. Although the private sector is the most affected by the crisis public sector may be under a potential risk. Fiscal sustainability is very important to show that a state has the capacity to stimulate private sector in crisis conditions without prejudice to fiscal performance. Some of the possible reasons of the debt crisis are also high costs and loans granted by governments to the private sector for a rebound to them. So if public finances are not consolidated they may be threatened by any crisis. The aim of this paper is to show the fiscal situation in Albania, which is not as prominent as it is declared. High levels of public debt, the repeated underperformance of the budget in recent years (large cuts in middle year budget review), the low level of tax revenues, which have narrowed more and more the space of public spending, the need for a restructuring of the tax system to facilitate business development and increase budget revenues (fiscal evasion and management) are all important indicators, which will be on the focus of the paper **"The Albanian fiscal sustainability under the Eurozone crisis"**.

2. Debt crisis in Eurozone

The European sovereign debt crisis known also as Eurozone crisis is an ongoing financial crisis that has made it difficult or impossible for some countries in the euro area to repay or re-finance their government debt without the assistance of third parties. From late 2009, fears of a debt crisis developed among investors as a result of the rising private and government debt levels around the world together with a wave of downgrading of government debt in some European states. As the crisis advanced leading Europe's finance ministers approved a rescue package worth €750 billion aimed at ensuring financial stability across Europe by creating the European Financial Stability Facility (EFSF). To restore confidence in Europe, the focus across all EU member states has been gradually to implement austerity measures. EU leaders agreed on adopting the Euro Plus Pact, consisting of political reforms to improve fiscal strength and competitiveness, as well as the Fiscal Compact, including the commitment of each participating country to introduce a balanced budget amendment as part of their national law/constitution. It is hoped that these measures will decrease current account imbalances among Eurozone member states and gradually lead to an end of the crisis. Many economists however, have criticized the extent of austerity measures for their negative impact on economic growth. In October 2012 also the International Monetary Fund (IMF) found that tax hikes and spending cuts have been doing more damage than expected. Already a few months earlier, several European countries have called for a new growth strategy based on additional public investments, financed by growth-friendly taxes on property, land, wealth, and financial institutions. In June 2012, EU leaders agreed to moderately increase the funds of the European Investment Bank to kick-start infrastructure projects and increase loans to the private sector.

AB ne procesin e vet te pershtatjes me standartete nderkombetare duhet te kete tashme si objektiv kryesor perpos kontrollit tradicional, keshillimin e menaxherëve në lidhje me përshtatshmërinë e sistemeve, rigorozitetin e ndjekjes se tyre dhe të masave të ndërmarra për menaxhimin e riskut. *Tashme AB ka të bëjë me arritjen e objektivave dhe matjen e 'efiçencës dhe efektivitetit'.*

Sipas nje studimi me baze anketimin veme re disa aspekte pozitive në zhvillimin e AB:

1. Përmirësimi i veprimtarisë së Njesise se AB e cila ka kaluare nga faza e vlerësimit te sistemeve nga identifikimi i hallkave më të dobëta, tek ofrimi i këshillave dhe rekomandimeve që kanë si qëllim përfundimtar t'i shtojnë vlerë organizatave të tyre.

2. Forcimi dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së funksionit të AB si kusht i domosdoshëm për arritjen e objektivave që synon strategjia antikorrupsion e Qeverisë.

3. Kryerja e auditimeve specifike me kërkesë të menaxhimit të lartë, të cilat kanë kërkuar vlerësimin për sisteme të veçanta dhe që janë kosideruar me riskun më të lartë.

4. Ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, që siguron informacion jo vetëm për vlefshmërinë dhe dobishmërinë e auditimeve, por mundëson dhe vlerësimin e cilësisës të punës së audituesve.

5. Përmirësimi i nivelit të aftësive dhe kapaciteteve profesionale të stafit të strukturave të AB, si rezultat i zbatimit të procesit të trajnimit për titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik".

Zbatimi i rekomandimeve për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2011

TOTALI REKOMAN-DIMEVE	REKOMAN-DIME TË ZBATUARA	LLOJET E REKOMANDIMEVE SIPAS PRIORITETEVE					
		PRIORITET I LARTË		PRIORITET I MESËM		PRIORITET I ULËT	
5524	3494	1857	1033	2052	1482	1615	979

(Burimi Min Financave , NJHKB raporti i vitit 2011)

Por ne te njeften kohe veme re edhe mangesite e meposhteme:

1. Niveli aktual i formimit profesional dhe aftësive të punonjësve të strukturave të AB mbetet ende larg standardeve të kërkuara, gjë që ndikon ndjeshëm dhe në cilësinë e auditimit.

2. Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga AB. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë sporadike dhe jo praktika të zakonshme të punës audituese.

3. Rastet e shkeljeve të pavarësisë së veprimtarisë së auditimit janë të shumta dhe krijojnë një ambjent jo të përshtatshëm për ushtrimin e këtij funksioni në përputhje me kërkesat e standardeve.

4. Niveli relativisht i ulët i ndërgjegjësimit të menaxhimit të lartë ndaj rolit të AB-së.

5. Gjatë vitit 2011 vihet re një ulje në numrin e NJAB (10 më pak se në vitin 2010). Kjo nuk mund të konsiderohet si negative sepse ka të beje me riorganizimin e këtij shërbimi sipas manualeve të reja, të cilat kanë diktuar nevojën e rritjes dhe funksionimit të Njësive të AB mbi bazën e standardeve të miratuara dhe praktikave më të mira të fushës. Keto standarte të reja ligjore kërkojnë jo më pak se tre auditues në NJAB , riorganizim i cili ka sjellë si pasojë mbylljen e disa prej Njesive të AB që kanë më pak se tre persona.

STRUKTURAT	VITI 2009	Viti 2010	Viti 2011
Institucione Qendrore	14	14	14
Institucione të Vartësisë	51	55	52
Institucione të Pavarura	4	8	8
Pushteti Vendor	50	55	49
Gjithsej	119	133	123

Ecuria e krijimit të strukturave të auditimit në tre vitet e fundit

6.Problematike paraqitet situata në organet e pushtetit vendor, ku shpesh kufizimet e kuadrit ligjor apo dhe keqinterpretimet e tij bëhen shkak për mosmarrëveshje midis Njësive të AB, apo akuza të ndërsjella për ndërhyrje në objektet e auditimit. Megjithatë NJQH/AB ka intensifikuar përpjekjet e saj për koordinimin e veprimtarive, trajnimin e stafit dhe mbështetjen për përmirësimin e cilësisë së punës së tyre. Më konkretisht tabela e mëposhtme jep një informacion më të saktë lidhur me strukturat e AB të ngritura në njësitë e qeverisjes lokale:

Pushteti Vendor		Struktura
1	Këshilla Qarqesh	5
2	Bashki	37
3	Komuna	5
4	Ndërmarrje Bashkie	2
Shuma		49

Njesite e AB të ngritura në Njësitë e Qeverisjes Vendore

Per permiresimin e punes vemendja duhet perqendruar:

I. Ne maredheniet nderistitucionale dhe perceptimin

A. Perceptimi dhe qeveria

Perceptimi eshte nje nga detyrat baze qe duhet planifikuar e punuar sipas nje plani afat-gjate sepse vetem ne momentin qe ky profesion do te perceprohet per vleren e vet pozirive ne rritjen e efektivitetit te mireqeverisjes , ai do te harrje te luaj plotesisht rolin e tij. Perceptimi si ceshtje psikologjike kerkon strategji te ndertuarr e zbatuar ne menyren me korrekte te mundeshme. Nuk mjaftojne per kete qellim vetem ndryshimet në kuadrin ligjor por keto duhet të shoqërohen me aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e saktë të rolit të AB si mbështetje dhe ndihmë për menaxhimin në përmbushjen e

objektivave.

Drejtuesit e qeverisjeve duhet te behen me te ditur ne ate se cfare AB mund te ofroje ne ndihme te tyre, ndersa Auditi duhet te integrohet ne strukturen e organizates nepermjet kompetences profesionale dhe fokusimit ne objektivat e organizates . Vetem duke qene i tille mund ta asistojte drejtuesin ne punen e tij duke marre e kryer rol pro-aktiv. Krijimi i nje ekipi te ngritur profesionalisht i cili do komunikojte me publikun ne vazhdimesi do rrishte perceptimin mbi rolin e funksionin e tij

- AB duhet te shihet si vlere e shtuar per menaxhimin e jo te behet sherbyes i tij
- AB duhet te kete vision pozitiv duke synuar ne kontribute per te ardhmen ne menaxhimin e riskut me qellim mireperdorimin e fondeve publike
- AB duhet te jene ne rritjet profesionale te vazhdueshme per te realizuar kontrollin e riskut, analizat financiare, duke perdorur teknologjine e informacionit etj. Keto njohuri duhet te jene te certifikuara.
- AB duhet te krroje nje klime solide etike, sepse pa nje klime te tille ligjet kurre nuk do te zbatohen dhe struktura organizative nuk do te funksionojte sic duhet.
- Ndryshimet e AB kerkojne kohe sepse kane te bejne me ndryshime kulturore, ndryshime ne procedurat e AB, perceptime etj.
- Perzgjedhja e drejtuesve te AB eshte vitale per zhvillimet ne kete profesion.

Organizimi dhe struktura e qeverisjes.

Funksionet e AB kryhen me me efektivitet kur ata organizohen ne struktura te mireformuara qe japin siguri ne vazhdimesine e punes se tyre.

Vlersimi numerik i rezultateve :

AB duhet te konsiderojte cilesine e rishikimit te eficiences duke marre ne konsiderate perfshirjen ne vleresime e publikime te vlerave numerike (perfitimi per 1,000 lek psh) fakt qe do te permiresojte sherbimin e dhene nga AB duke rritur ne te njejten kohe kuptimshmerine per vleren e shtuar te punes se tij.

Percaktimi i planeve

Eshte ne vartesi te aftesive individuale e kombinimit te tyre ne ekipi, duke perfshire hartimin, ndjekjen, afatet, rekomandimet, rezultatet numerike.

Vleresimi i drejte i risqeve

Bashke me drejtuesin duhet punuar per te gjetur pikat e dobeta per te harritur te ndertojne profilin e risqeve.

Siguri ne kontroll e cila harrihet nepermjet aftesive te larta profesionale **Raportimi i ceshtjeve kyce dhe rekomandim** per parandalimin ose minimizimin e risqeve te gjetura per ti paradale efekteve negative ne te ardhmen.

B. Ne pikpamjen organizative

Per te ushtruar sa me mire funksionet e tij AB duhet te jete:

- Realisht i pamvarur
- Te kete nje kuptim te mire te organizates, struktures, detyres, organizimiz e ceshtjeve kyce me te cilat ballafaqohet organizata aktualisht.
- Te jete fleksibel ne kryerjen e detyres duke ju pergjigjur nevojave te drejtuesve
- Te jete i afte te vleresoje, keshilloje dhe siguroje drejtuesin per risqet kyce me te cilat ballafaqohet organizata
- Te kontribuojte ne permiresimin e performances
- Te jete proaktiv ne komunikim me drejtuesin
- Te jape rekomandime dhe te ndihmoje ne zbatimin e tyre
- Te jete i afte te mase aftesite ekzistuese dhe te kete mundesine te plotesoje nevojat me stafin e duhur
- Te perdore teknologjine ne dizpozicion dhe te punoje ne menyre te zgjuar.

C. Ne pikpamjen legjislative

Sic permendem tashme ekziston nje rrjet ligjesh qe e ka kornizuar kete profesion ne Shqiperi. Pershtatja me standartet nderkombetare duhet te jete detyre e vazhdueshme duke njohur e pranuar ne kete proces dhe realitetin tone. Duhet te forcohen kerkesat ligjore per drejtuesin e AB dhe profesionalizmin e specialisteve te AB.

Ne kete pikpamje nje ceshtje teper e ndjeshme eshte pavaresi e AB ne kryerjen e funksioneve te tij sepse ende eshte e veshtire kjo pavaresi per Auditoret e jashtem per te qene te pavarur nga ekzekutivi. (Megjithese ligjerisht varen nga Parlamenti e jo nga Qeveria). Per kete duhet:

1. Zhvillimi, përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor e rregullator për AB.
2. Mbajtja në nivele të standardeve dhe praktikave ndërkombëtare të të gjithë kuadrit teorik e praktik për auditimin, për të siguruar një bazë të fortë për zhvillimin e zbatimit e një funksioni efektiv të auditimit të brendshëm.

3. Përcaktimi i plote dhe i qarte i kritereve për ngritjen dhe funksionimin e Njesive të AB me akte normative .

Ne Shqipëri AUDITI I BRENDESTEM është në vartësi të qeverisë dhe është një profesion shumë i ri në kundërshtim me eksperiencën e shumë vendeve të zhvilluara ku ky institucion varet nga parlamenti. Në këtë kuptim pavaresia e tij duhet të jetë ligjrisht shumë e qarte dhe siguria e funksionimit të kësaj strukture në vazhdimësi duhet të gjejë mbështetje ligjore për qëndrueshmëri e vazhdimësi duke u rritur sidomos kërkesat profesionale për përfitimin e këtij titulli.

D. Në kërkesat për nivelet e kerkuara profesionale

Profesioni i AB kërkon që rinovim njohurish në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të dallosh midis kolegësh e profesionistëve të jashtëm për nivelin e shërbimeve të kualifikuara që jep, nivel i cili fitohet me shumë punë..

Në këtë kuptim duhet siguar një harmonizim sa më i mirë midis 2 kërkesave e pozicionimeve kontradiktore. Nga njëra anë AB duhet të kenë statusin e shërbimit civil të dhënë pavaresi e siguri përfundimtare me pagë konkurruese por nga ana tjetër edhe të kërkojë rritje e vazhdueshme profesionale për të bërë të mundur realizimin e funksioneve të tyre kryesore. Teste e provime duhen kryer në vazhdimësi në këtë profesion.

Duke qenë se AB në përzierjen e shërbimit civil AB shihet si kosto, overhead, dhe si jo kontribues në dënimin e shërbimeve , duhet synuar në gjetjen e profesionistëve të vertetë që me pak shpenzime të marrim rezultatet që kërkojnë.

Në këtë pikë rëndësi merr vërtetimi për këtë profesion duke mos e parë atë si të meritshëm dhe represiv, por duke e gjykuar veten si shumë të respektuar dhe të nevojshëm. AB është i respektuar globalisht dhe të qenit në këtë grup është një arsye me tepër për të qenë kërenar.

Për këtë qëllim duhet :

- Ngritja dhe mbajtja e një programi për sigurimin e cilësisë të punës së strukturave të AB, që konsiston si në zhvillimin e kuadrit rregullator ekzistues, teorik dhe praktik, si dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të AB.
- Zbatimi i një plani efektiv trajnimi në përshtatje me nevojat për trajnim të audituesve me qëllim rritjen e mëtejshme profesionale të audituesve.
- Prezantimi tek audituesit i zhvillimit praktik të metodave dhe strategjive mbi bazë risku për vlerësimin e subjekteve publike.

E. Burimet

Burimet janë një pikë e rëndësishme për pavaresinë dhe mirefunksionimin e këtij profesioni. Tek në rëndësi merr hartimi i plan-veprimit për të mbajtur profesionistët në këtë profesion, duke gjykuar që vendit i nevojiten këta profesionistë. Kujdes duhet patur në mosdiskriminimin financiar të këtij sektori duke e mbështetur me shumë se të tjerët në fazën aktuale të krijimit sa me të mirë të bazës së këtij profesioni që jep efekte pozitive në vazhdimësi për qeverisjen.

Nga analiza e përbërjes profesionale të stafit auditues vërejmë që numrin më të madh e zënë specialistë të fushave ekonomike 85% , 10% juristë dhe vetëm 5% i përkasin specialiteteve të tjera teknike. Duke marrë në konsideratë zhvillimet e jashtëzakonshme që nderlidhen me punën e subjekteve të veçanta si Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, si dhe ente të tjera shtetërore si ato të telekomunikacionit, energjisë, KKRT, frekuencat etj thekson problemin që në strukturën e AB në njësitë perkatese duhet të ketë një harmonizim me të mirë midis profesioneve baze tradicionale dhe profesionisteve të fushave të mesiperme, për të përmbushur misionin e tyre në raport me veprimtarinë që zhvillojnë.

Numri i Punonj. planifik.	Numri i Punonj. faktik	Arsimimi			Vitet si AB		Zhvillimi Profesional		
		Të ndarë sipas specializimit:			Studim të thell.	deri 5 vjet	mbi 5 vjet	Çertifikimi	
		Ekonomist	Juristë	Të Tjerë				Të çert.	në proces
403	392	335	38	19	55	166	227	320	29

KONKLuzionet dhe Objektivat

Zhvillimi i modelit të ri të kontrollit të brendshëm financiar publik në Shqipëri kërkon prej pjesëmarrësve kryesorë në proces ndërmarrjen e veprimeve efektive në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e tyre. Vetëm zbatimi i duhur i kuadrit të ri ligjor dhe përpjekjet nga ana e të gjitha palëve të interesuara mund të çojë në arritjen e qëllimit – krijimin e një sistemi modern,

të besueshëm dhe funksional të kontrollit të brendshëm financiar publik. Në këtë drejtim Ministria e Financave ka miratuar planin 5 vjeçar të zbatimit të një sistemi modern të MFK-së dhe tashmë ka filluar zbatimin e tij, në fazën fillestare me mbështetjen e SIGMA-s dhe në vijim me mbështetjen e SIDA-s dhe BE nëpërmjet instrumentit të IPA 2012.

Funksionimi eficient i menaxhimit financiar dhe kontrollit është shumë më tepër se një reformë teknike, duke synuar vendosjen e një regjimi të ri të kontrollit financiar. Menaxhimi Financiar sot duhet të bazohet mbi idenë e përgjegjshmërisë menaxheriale e cila i ka rrënjët në konceptin e menaxhimit efektiv. Menaxhimi efektiv kërkon mbështetjen e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe e kontrollit sepse menaxhimi nuk ndodh në një vakum financiar, i gjithë aktiviteti i menaxhimit është subjekt i shtrëngesave/detyrimeve financiare. Dhe meqë presioni mbi burimet publike është gjithmonë për të ofruar më shumë me të njëjtat (ose më pak) burime, duhet të merren në konsideratë efienca dhe efektiviteti. AB është projektuar për të siguruar këtë mbështetje thelbësore financiare për menaxherët.

Parashikimi i përgjegjshmërisë menaxheriale ka edhe rrjedhime të rëndësishme për formën e kontrolleve të ushtruara AB, proces i cili për shpenzimet publike nuk reduktohet, por bëhet më i mprehtë duke u fokusuar në mënyrën si përdoren paratë publike dhe çfarë efekti është harritur. Menaxhimi financiar dhe AB janë parakusht thelbësor për zhvillimet që kanë ndodhur tashmë në programimin buxhetor dhe në zhvillimin e buxhetimit afatmesëm.

NjQH/AB duhet të vazhdojë përpjekjet në përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë nepermjet hartimit të manualeve specifike për të gjitha njësitë e AB në sektorin publik, duke e konsideruar këtë si sfiden e radhës në fushën e përmirësimit të kuadrit rregullator për veprimtarinë e AB.

Si një nga “tre shtyllat” e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, AB duhet zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht në mënyrë që të fitojë rolin e tij modern si vlerësues dhe këshilltar për sistemet dhe kontribues në arritjen e objektivave strategjike dhe operationale të qeverisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

Referime

¹ Association of Certified Fraud Examiners, 2004 Report to the Nation on Occupational Fraud and Abuse, ACFE, 2004

² The American Securities and Exchange Commission is one of the strictest in the world and still could not prevent these scandals.

Grafiket nga materiali “ Plani 5 vjeçar për implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit në RSH – maj 2011” (MF)

Bibliografia

1. Managerial Accounting for Managers - second edition Noreen-Brewer-Garrison
2. Managerial Accounting - McGraw-Hill Irwin
3. The role of Internal Audit in Government Financial Management - Jack Diamond(IMF)
4. KPMG Evolution of Risk and Control
5. How Internal Audit Adds value to the governance process - Carmen Rossiter
6. Ligji Nr. 9720 date 23.04.2007 "Per Auditimin e Brendeshem ne Sektorin Publik"
7. Ligji Nr.10296 date 8.7.2010 " Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"
8. Ligji 10294, date 01.07.2010 " Per inspektimin financiar publik"
9. Ligji 10091, datë 5.3.2009 "Per Auditimin Ligjor,Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar"
10. Metodika e Auditimit Financiar
11. Manuali i procedurave te auditimit te brendeshme
12. Manuali per menaxhimin financiar dhe kontrollin
13. Plani vjetor dhe strategjik 2010-2013 (MF)
14. Raporti vjetor per veprimtarine e AB dhe analiza e zhvillimit te sistemit 2009 (MF)
15. Raporti vjetor mbi Funksonimin e Sistemit te KBFP ne njesite e Qeversijes Vendore per periudhen 1 janar - 31 Dhjetor 2011.
16. Internal Audit *Finding Its Place in Public Finance Management* - Cecil Auditi i Brendeshem Nordin Van Gansberghe

BORXHI PUBLIK DHE RRTIJA E EKONOMISE SHQIPTARE

Klodian Muco

Universiteti Egerem Cabej
klodianmuco@hotmail.com

Lindita Rova

Universiteti Egerem Cabej
lindita_rova@yahoo.com

Alketa Bejko

Universiteti Egerem Cabej
alketabejko@yahoo.com

ABSTRACT

State can be seen as a public company that manages an impressive property to fulfill requirements and needs of citizens by offering goods and services. The optimal situation is achieved only when the state satisfies its objectives keeping the financial and economic balance in equilibrium. Public revenues should cover all the public expenditures. But public resources are limited and insufficient to cover all the public expenditures and to stimulate economic growth. In developed and developing countries public debt is used every fiscal year to cover the increasing differences between revenues and expenditures. The aim of this paper is to demonstrate how the public debt of Albania affects the economic growth of the country. The effects and relation between public debts with the fiscal system will be on the focus.

Keywords: public growth, public expenditure, economic crisis, tax revenues.

Hyrje

Shteti mund të shihet si një shoqëri publike që administron një prone mbreselenese për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e qytetarëve duke ofruar të mira dhe shërbime. Situata optimale arrihet vetëm atëherë kur shteti plotëson të gjitha objektivat e veta duke mbajtur balancën financiare dhe ekonomike në ekuilibër. Të ardhurat publike duhet të mbulojnë shpenzimet publike, por burimet publike janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme të mbulojnë të gjitha shpenzimet publike dhe njëkohësisht të stimulojnë zhvillimin ekonomik. Në shtetet e zhvilluara dhe në zhvillim borxhi publik përdoret çdo vit fiskal të mbulojë diferencat në rritje midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Me konkretisht është e pamundur që një shtet mos të hyjë në borxh duke pasur burime të ardhurash të limituara, nderkohe që kohe pas kohe ai me siguri do gjendet përballë situatash anormale (si psh. lufte apo katastrofa natyrore) dhe për këtë motiv do mbylli bilanc negativ (në deficit) e duhet të debitohet. Në të kaluarën ekzistonin dy linja mendimesh politike shumë të ndara: konservatorët dhe progresistët. Të parët dëshironin të ulnin borxhin e shtetit ose me saktë donin të arrinin të barazonin llogaritë publike me qëllim për të mbajtur në "rregull" buxhetin e shtetit, shpenzimet publike dhe rolin e shtetit në ekonomi. Ndërsa të dytët ishin të disponueshëm të pranonin borxhin publik struktural, duke u mjaftuar që në fund të mbeshetëj kërkesa agregate, dmth që të mundesohej zhvillimi ekonomik.

Sot në Shqipëri sikundër edhe në shumë vende të industrializuara, është e vështirë të njihen pozicionet e ndryshme politike për sa i përket vullnetit për të mbyllur në barazim apo deficit llogaritë publike. Në vecanti pozicionet që krijohen nga idetë keynesianiste që i atribuojnë shtetit detyrën që të mbeshetë, derisa të jete e nevojshme, kërkesen për të mira dhe shërbime me anë të shpenzimeve publike në kushte deficiti.

Perberja e shpenzimeve publike⁴CP është konsumi publik dhe përbehet si nga oferta e të mirave publike të disponueshme për shoqërinë (psh gjykata, mbrojtja, rendi publik) si shërbimet që ofron shteti qytetarëve për të mira sociale dhe për të ulur diferencat ndërmjet grupeve të ndryshme sociale (si psh shkollimi, sistemi shëndetsor)⁵.

Zakonisht në Shqipëri konsumi publik përfaqëson rreth 20% të shpenzimeve publike, dhe është një tregues me rritje kostante: $Y=CP+TR+CC$

TR janë transferimet publike (pjesa më e madhe përbehet nga shpenzimet

4 O.J. Blanchard, Scoprire la macroeconomia / Quello che non si può non sapere, il mulino, Bologna, 2002

5 C.M. Reinhart, K.S. Rogoff, Growth in a Time of Debt, American Economic Review, 2010

per pensionet dhe asistencen).

CC jane shpenzimet ne llogarine kapitale, te cilat ndahen ne investime publike dhe ne trasferime ne llogarine kapitale, te cilat rrisin kapitalin fiks ne administraten publike e prodhojne infrastrukture dhe vepra publike.

1.1 BORXHI PUBLIK

Nga 1990 borxhi publik mund te percaktohet si borxhi total i akumuluar ne vite nga shteti ne konfront me subjektet qe mbajne obligacionet te cilat financojne nevojat shtetere per likuiditet. Nje borxh publik mund te jete i klasifikuar ne baze te kohes qe kalon nga momenti i emetimit deri ne kohën kur ky borxh rimburohet. Kemi borxh te konsoliduar ku shteti ka per detyrim vec te japi interesa dhe jo te ktheje kapital, borxh fluktuant i cili permbledh borxhet e periudhes afatshkurter, kur shteti ka nevojë per likuiditet urgent si dhe borxhe afatgjate. Nga pikepamja e tregut ne te cilin borxhi eshte emetuar ai ndahet ne borxh te brendshem dhe borxh te jashtem⁶.

Borxhet e brendshme implikojne trasferimet e burimeve brenda shtetit, likuiditeti kalon nga sektori privat ne sektorin publik. Ndersa borxhi i jashtem, perben vleren totale qe shteti duhet te derdhi me skadence qe eshte vendosur paraprakisht nga operatoret e shteteve te huaja.

Aktualisht borxhet e jashtem⁷ te dhena nga istitucione si IMF (International Monetary Fund), WB (World Bank), BERS (European Bank for Reconstruction and Development) kane zene nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin e vendit. Ne prezencen e nje borxhi fillestar (Bo) shuma e borxhit publik ne nje periudhe kohore t (Bt) eshte baraz me shumen algjebrike dhe suficitet apo deficitet buxhetore⁸.

$Bt = \text{deficitet (ose suficitet)} Z + B0$ ku $z=0$

Deficitet buxhetore ne sektorin publik jane te perbera nga dy komponente: e para, komponentet primar qe llogariten nga diferenca ndermjet hyrjeve dhe daljeve, ndersa, e dyta, eshte komponenti financiar, i cili jepet nga shuma e interesit pasiv mbi borxhin ekzistues. Keto dy komponente jane te influencuara nga faktore te ndryshem: ajo primare eshte e influencuar nga elementet

6 A.Schclarek ,Debito e crescita economica nei paesi in via di sviluppo e industriale, Lund University, Dipartimento di Economia, 2004

7 Per vende ne zhvillim si Shqiperia, nje ulje e borxhit te jashtem shoqerohet me nje rritje ekonomike shume te larta.

8 O.J. Blanchard, Scoprire la macroeconomia / Quello che non si può non sapere, il mulino, Bologna, 2002

e brendshem te qeverise ne sektorin publik dhe nga kontrolli i kryer nga autoritetet tatimore e nga vijueshmeria e shpenzimeve, ndersa, ato financiare varen nga komponenti i pare, nga menyra si financohet deficitit buxhetor si dhe nga niveli i normes se interesit.

1.2 LIDHJA NDERMJET BORXHIT PUBLIK DHE RRRITJES EKONOMIKE

Lidhja ndermjet borxhit publik dhe rritjes ekonomike eshte nje problem aktual dhe i prekur nga literatura financiare. Ky problem trajtohet nga dy dege mendimesh: nga teoria Rikardiane, qe mbeshtetet shume edhe nga Barro⁹ i cili perjashton prezencen dhe efektet ne periudhen afatgjate te ketyre dy parametrave, ndersa teoria konvencionale afirmon ekzistencen e nje lidhjeje ndermjet borxhit dhe rritjes ekonomike me ane te akumulimit te kapitalit.

Debatet mbi efektet e borxhit publik kane nje rendesi te vecante edhe ne kontekstin e percaktimit te politikave fiskale te nje vendi: borxhi publik nga shume studies shihet si nje strument me te cilin financohen shpenzimet publike pa marre masa jo populllore si rritja e taksave.

Borxhi publik zakonisht merret ne konsiderate ne raport me GDP, per te vene ne nje lidhje deficitin buxhetor me kapacitetin per te prodhuar "pasuri". Ky raport njekohesisht vlereson aftesine e nje shteti per te paguar borxhin qe akumulohet per efekt te prezences se shume borxheve.

GDP eshte e perbere nga te mira dhe sherbime te prodhuara nga nje shtet, pavaresisht nga kombesia e prodhuesve; ajo mat pasurine e prodhuar nga nje vend ne nje periudhe te caktuar kohore.

Sipas Keynes¹⁰, GDP jepet nga vlera totale e shpezes se familjeve dhe nga firmat per investime. $Y=C+I+G+(X-M)$ Ku

$Y=GDP$

C Konsumi,

I Investimet,

G Shpenzimet publike,

X Eksport

M Import

Nje variacion pozitiv ne kohe i ketyre zerave, pervec importit, influencon

9 R.J.Barro, On the Determination of the Public Debt, *Journal of Political Economy*, University of Chicago Press, 1979.

10 J.M.Keynes, Teoria generale dell'occupazione, dell'interesse e della moneta, Utet, Torino, 2006

pozitivisht rritjen ekonomike. Rimbursimi i kapitalit dhe interesave, per shkak te rritjes se shpenzimeve qe cohen per keto te fundit, mund te coje ne rrenim te situates ekonomike te vendit¹¹. Nese nuk merren masa shpesh here per limitimin e hyrjes gjithmone e me teper ne borxh, shpenzimet per interesat pasive mund te arrijne te behen te pa perballueshme.

Shtetet mund te bejne ne menyre autonome politiken e tyre monetare, mund te emetojne monedhe, manover kjo me efekte inflacionistike. Nje rezultat i tille arrihet edhe kur kemi nje rritje te taksave, por rritja e cmimeve i prek te gjitha dhe vendos ne veshtiresi ato persona qe kane te ardhura modese. Inflacioni ka kapacitetin te ule normen e interesit real, dhe nese eshte me i larte se inflacioni mund te ule borxhin real, po jo ne vlere zyrtare. Borxhi publik matet ne terma relative, pra, ne raport me GDP sepse kjo varet nga popullsia¹² e nje vendi dhe nga pasuria e vet. Ky raport sherben edhe per te vleresuar veshtiresite e hedhjes ne treg te titujve te borxhit publik. Nese ky raport qendron konstant edhe veshtiresia per te hedhur ne treg keta tituj mbetet te njejta. Nje rritje apo zbritje te ketij raporti mund te nenkuptohet edhe si nje rritje apo ulje veshtiresie te hedhjes ne treg te ketyre titujve.

Me ane te kesaj mund te kuptojme edhe limitin e ketij raporti ne Shqiperi qe eshte 60% te GDP dhe ky limit ekziston duke marre ne konsiderate nje rritje te qendrushme ekonomike, pasi nese rritja ekonomike reale do te ulej ateher ky limit do ish i pa perballueshme per Shqiperine.

$$\text{Kemi } B_t - B_{t-1} = rB_{t-1} + G_t - T_t$$

Ecuria e raportit borxh/GDP mund te jete e dhene me ane te ketij ekuacioni¹³:

$$(B/Y)_t - (B/Y)_{t-1} = (r-g) * (B/Y)_{t-1} + [(T-G)/Y]_t$$

Ne te cilin:

B eshte stoku i borxhit

Y eshte GDP bruto

T jane hyrjet, te marra me ane te taksave

G shpeza publike

$[(T-G)/Y]$ Eshte rezultati primar i GDP

t treguesi kohe

r norma e interesit real

g eshte rritja reale e GDP

11 A.Greiner, B.Fincke, Public debt and economic growth, Springer, 2009.

12 Ne Shqiperi kemi shpesh nje ulje fiktive te nr te popullsisë, kjo vihet re edhe ne regjistrimin e fundit te popullsisë te bere ne vend. Kjo per arsye se nje ulje e popullsisë ben nje rritje fiktive te GDP per person e ben te mundur kolokimin e borxhit publik ne treg.

13 O.J. Blanchard, Scoprire la macroeconomia / Quello che non si può non sapere, il mulino, Bologna, 2002

Nese shenojme ne n normen e rritjes se popullsisë dhe Y_{t-1}/Y_t mund te shkruhet si $1/(1+n)$.

$(B/Y)_t - (B_{t-1}/Y_t) \cdot (1/(1+n)) = r/(1+n) \cdot (B_{t-1}/Y_{t-1}) + [(G - T)/Y]_t$ me thjeshte mund ta shkruajme si: $b_t - b_{t-1} \cdot (1/(1+n)) = r/(1+n) \cdot b_{t-1} + g - \tau$

b_t eshte perqindja qe ndikon borxhi publik ne GDP ne te njejtin vit t .

b_{t-1} tregon te njejten gje po nje vit me pare

g tregon perqindjen e speses publike ne GDP

τ tregon perqindjen e ndikimit te taksave ne GDP ne vitin korrent.

Me ane te ketyre ekuacioneve kuptojme diferencen ndermjet r e n ; nese norma e interesit real eshte me e larte apo me e ulet se norma e rritjen se GDP reale, ky faktor tregon dhe nje rritje apo ulje te raportit borxh/GDP. Nese n eshte me e madhe se r , raporti borxh/GDP do vije duke u ulur nga viti ne vit dhe anasjelltas.

1.3 EFEKTET EKONOMIKE TE BORXHIT PUBLIK DHE LIDHJA ME SISTEMIN FISKAL

Literatura ekonomike mbi efektet e borxhit publik eshte e ndare ne dy dege kryesore: teoria e neutralitetit te borxhit dhe teoria konvencionale¹⁴. Teoria e neutralitetit te borxhit eshte e bazuar ne ekuivalencen Rikardiane dhe thote se borxhi publik nuk ka efekte te periudhen afatgjate mbi kerkesen agregate: ka nje impakt direkt mbi kursimet dhe mbi akumulimin e kapitalit.

Ne shekullin XIX sipas David Ricardo¹⁵ i cili propozoi nje teori sipas se ciles, shpenzimet publike si nga taksat apo nga borxhi do ishte indiferente mbi efektet e kerkeses agregate: konsumatorët jane koshiente ndaj mbajtjes se bilancit brenda normave, dhe perceptojne akumulimin e borxhit si nje parapagese taksash, per ti bere balle nje rritje te barres fiskale ne te ardhmen ata rrisin kursimin. Ky arsyetim eshte i vlefshem dyke marre parasysh perfeksionimin e tregut te kapitalit si dhe faktin qe cdo familje mund te kurseje ose te marre borxh me nje norme interesi te njejte per te gjithë. Shuma e shpenzimeve publike ndjek nje seri te njohur, pra dihet se rritja ne te ardhmen e taksave (si rrjedhoje e rritjes se borxhit publik) mund te vije shume vjet perpara se te kemi nje lidhje intra-gjeneratash, derisa gjeneratat aktuale nuk kane asnje avantazh nga nje ulje te taksave e cila do peshoje me vone te femijet e tyre.

14 D.W. Elmendorf; N.G. Mankiw, Government Debt, National Bureau of Economic Research, IDEAS, 1998

15 D.Ricardo, Essay On the Funding System, *The Works of David Ricardo. With a Notice of the Life and Writings of the Author*, by J.R. McCulloch, London: John Murray, 1888.

Ekivalenca rikardiane eshte e bazuar ne dy ide baze: obligimi nderkohor i qeverise dhe hipotezat e te ardhurave konstante dhe te perhershme. Obligimi i bilancit te qeverise eshte i shprehur nga nje forme barazie ndermjet hyrjeve dhe daljeve:

$$Gt + rDt_{j1} = Tt + (Dt ; Dt_{j1})$$

ku Gt shpreh nivelin e shpenzimeve publike ne kohen t ,

r eshte norma e interesit,

Dt eshte stoku i borxhit publik ne kohe

Tt eshte eshte niveli i taksave.

Eshte evidente qe nese niveli i shpenzimeve nuk ulet, nje ulje e taksave aktuale shkakton nje rritje te peshes fiskale ne te ardhmen, por vlera aktuale e shumes komplekse te taksave ne te ardhmen eshte e pa ndryshueshme.

Hipoteza e te ardhurave konstante ne kohe parashikon qe familjet planifikojne konsumin e tyre dhe kursimet e tyre ne baze te vlerave aktuale dhe te ardhurave aktuale dhe ato ne te ardhmen. Bashkimi i ketyre dy kushteve ben te mundur qe nje modifikim i barres fiskale ndermjet periudhave ne ndryshme qe nuk alternon vleren aktuale nuk ka efekte mbi kerkesen agregate. Borxhi publik sipas idese rikardiane eshte pare si nje transferim i taksave ne kohe. Eshte e rendesishme te theksohet se ekuivalenca rikardiane nuk privohet nga efikasiteti i politikave fiskale: nese qeveria ul presionin fiskal, dhe nese nga kjo ulje kemi nje pritje te uljes se shpenzimeve publike atehere te ardhurat e qendrueshme te familjeve do te rriten dhe ka si efekt stimulimin e konsumit. Eshte e rendesishme te verehet qe nuk eshte ulja e taksave qe sjell kete efekt ekspansiv po nje rrjedhoje e uljes se shpenzimeve publike, pastaj eshte kjo qe con ne rritjen e qendrueshme te te ardhurave te familjeve. Problemi i modelit rikardian eshte se tregjet e kapitalit nuk jane perfekte. Po edhe kalimi gjeneracional: borxhi publik mund te krijoje nje rishperndarje te pasurise ndermjet gjeneratash te ndryshme, nje taksim i lart ne te ardhmen mund mos te jete eficient.

2. IMPAKTI I BORXHIT PUBLIK NE RRRITJEN EKONOMIKE TE VENDIT, BORXHI I JASHEM.

Nje numer i konsiderueshem ekonomistesh kane mbeshtetur se nje rritje e nivelit te borxhit mund te influencoje ne ekonomine e nje vendi ne menyre jo standarte. Nje rritje e borxhit publik sipas tyre ndikon tek investitoret, duke i bere ate me te kujdesshem per arsye se nje komb me borxh publik te larte

mund te mos jete ne gjendje t'u ktheje borxhet kreditorëve¹⁶. Si rrjedhoje do kete nje largim te investitoreve ndaj ketyre borxheve e cila do shkaktoje nje norme interesi shume te larte¹⁷, turbullira ne tregun financiare dhe do demtoje rritjen ekonomike.

Nje fakt tjetër eshte se kriza fianciare aktuale eshte shkaktuar nga nje rritje e larte e borxhit, dhe kjo ka krijuar kosto ekonomike shume te larta ne shume vende si psh Italia, Spanja, Greqia etj.

Nje rritje e borxhit publik duhet te jete e shoqeruar me nje rritje ekonomike ose me sakte me nje rritje te suficiteve primare te qeverise per te garantuar tregun financiar. Per vendet e varfëra lidhja ndermjet borxhit publik dhe rritjes ekonomike eshte edhe me delikate, nje borxh publik i larte mund te shkaterroje ekonomine e nje vendi duke e cuar ate deri ne faliment. Nga nje ane, rritja e financimit direkt dhe politikat e sakta mund te rrisin kapacitetin e nje vendi per te arritur objektivat e veta te zhvillimit. Nga ana tjetër borxhi i larte mund te jete jo produktiv per objektivat e zhvillimit¹⁸. Per vendet ne zhvillim si Shqiperia, problem nuk eshte borxhi publik ne pergjithesi por borxhi i jashtem pasi shoqerohet me norma interesi me te larta, dhe kjo lidhje negative merr per baze borxhin publik te jashtem dhe jo borxhin qe subjektet privatemarrin borxh nga vende te tjera. Ne studimet empirike¹⁹, te kryera deri me sot, veme re se, marredheniet midis borxhit publik dhe rritjes ekonomike jane te dobëta. Literatura gjithashtu tregon se nje rritje e borxhit publik ka nje impakt negativ ne rritjen ekonomike. Evidencat empirike jane perqendruar kryesisht mbi borxhin e jashtem dhe rritjen ekonomike ne vendet ne zhvillim. Sipas nje modeli empirik te hartuar nga Banka Qendrore Europiane²⁰ ku jane marre per baze 12 vende anetare te bashkimit monetar dhe vendoset ne relacion borxhi mesatar ne raport me GDP dhe borxhi per fryme duke filluar nga 1970. Nga ky model veme re qe nje rritje negative e GDP shkakton nje barre me te larte te borxhit per person pra nje relacion jo linear ndermjet borxhit dhe rritjes se GDP. Ne kete raport vihet re se niveli kritik i borxhit publik ne raport me GDP eshte 90%.

16 R.E.Rubin, P.R.Orszag, A.Sinai, Sustained Budget Deficits: Longer-Run U.S. Economic Performance and the Risk of Financial and Fiscal Disarray, National Economic and Financial Policies for Growth and Stability, 2004

17 L.Ball, G.N.Mankiw, Relative-Price Changes as Aggregate Supply Shocks, Ideas, 1995

18 P. Chuhan, M. Thomas, Economia globale: gli aiuti allo sviluppo e la riduzione del debito, 2007

19 Permendim ketu studimim e M.C. Reinhart, ., and K.S. Rogoff. 2009a. "The Aftermath of Financial Crises." American Economic Review, Vol. 99, No. 2: 466-472

20 C. Checherita, P.Rother, The impact of high and growing government debt on economic growth an empirical investigation for the euro area, 2010

Gjithsesi nese rritja ekonomike eshte e ulet nis nje rreth vicioz ku edhe ky raport eshte i paperballueshem. Sipas Tanzi dhe Schuknecht (1997) *per te marre ne konsiderate nje raport limit te borxhit publik eshte e rendesishme prespektiva ekonomike dhe strategjite per rritjen ekonomike.*


Edhe ekonomistet neoklasike si Modigliani(1961) Buchanan(1958) apo Meade(1958) thone se *“borxhi publik eshte nje barre per brezat e ardhshem” e cila vjen nga ulja e fluksit te te ardhurave te kapitalit privat.*

Krugman²¹ i cili eshte fokusuar ne ndikimin negativ te borxhit te jashtem mbi ekonomine shpjegon termin *“dalja e borxhit”* si nje situatë ne te cilen nje vend humbet aftesine e ripagimit te borxhit te jashtem, kur bie nen vleren e borxhit kontraktual. Pra akumulimi i borxhit te huaj mund te nxise investimet deri ne nje fare pike pastaj pertej ketij kufiri borxhi do te beje nje presion negativ mbi gadishmerine e investitoreve te huaj.

3. PROBLEMET E BORXHIT PUBLIK NE SHQIPERI

Ekonomia shqiptare pas renies se komunizmit dhe pas nje periudhe veshtiresie te krijuar nga tranzicioni ekonomik arriti me ne fund te kishte norma te larta te rritjes ekonomike sidomos vitet e fundit. Nje pjese e rritjes se madhe ekonomike ishte e bazuar mbi borxhin publik. Rritja e kufirit te borxhit nga qeveria shqiptare se fundmi natyrshem sjell pyetjen: a do te arrije dot Shqiperia ta perballoje kete borxh publik? Nje qeveri qe nuk ka shume sovranitet dhe eksperience te mirefillte ne politiken ekonomike per te rritur masen monetare e per te luftuar inflacionin, riskon qe te mos jete me ne gjendje te paguaj borxhet e akumuluar dhe te deklaroj *faliment*. Ne vitin 2011 borxhi publik ka qene rreth 772 milionë lekë (58.76% i PBB-së) ose 8% më i lartë sesa një vit më parë. Stoku i borxhit publik të brendshëm për vitin 2011 është 439 milionë lekë ose rreth 7.66% më shumë se në vitin 2010, ndërkohë stoku i borxhit publik të jashtëm është 334 milionë lekë ose 8.37% më shumë krahasuar me një vit më parë. Niveli i borxhit të brendshëm është ende i lartë dhe zë rreth 33,36% të prodhimit të brendshëm bruto (GDP-së) gjatë vitit 2011 krahasur më nivelin e borxhit të jashtëm që përbën 25.39% të GDP-së.


21 P.Krugman, Financing vs. Forgiving a Debt Overhang Journal of Development Economics, Vol. 29, pp. 253-268, 1988.




Burimi: Ministria e financave, 2011

Normalisht ky borxh ka edhe kosto e cila financohet nga buxheti. Sic e permendem edhe me lart një tregues shumë i rëndësishëm për të gjykuar mbi borxhin dhe aftësinë e shlyerjes së koston së tij nga ana e shtetit huamarrës është edhe kostoja e borxhit për frymë. Ai llogaritet si raport i shumës së interesave që duhen shlyer në një vit të caktuar me popullsinë e po atij viti.

Ja evolucioni i koston se borxhit per fryme:



Burimi: Open data Albania




Burimi: Open data Albania

Ne periudhen ne fjale ritmet e ndryshimit te popullsise ishin relativisht te uleta per mos te thene kostante. Por veme re qe pervec periudhes '98-'01 ku kosto e borxhit per fryme ka nje renie pra rreth 34% qe nga 2001 ne vazhdim kemi nje rritje te vazhdueshme te kosos se borxhit per fryme. Veme re gjithashtu qe ne vitin 2008 dhe 2009 kemi nje rritje shume te larte te borxhit ne kete periudhe filloi te ndjehet kriza financiare boterore dhe ekonomia shqiptare pesoi nje turrje edhe pse kishte nje rritje pozitive. Aktualisht interesat per borxhin publik jane mesatarisht 6 per qind²². Rreth 15 per qind e te gjithë të ardhurave të buxhetit shkojnë për pagesat e interesave të borxhit. Në rast se ekonomia nuk rritet me 4-6 për qind në terma reale, do jete shume e veshtire per te paguar kete borxh. Ne 2011 kemi pasur Censusin i cili ka zvogeluar ne menyre fiktive numrin e popullsise nese i referohemi te dhenava te meparshme te INSTAT, pra nje popullsi me e vogel ne krahasim me nje vit me pare ka ndikuar ne nje rritje shume te larte te kosos se borxhit per fryme sic vihet re edhe nga grafiku per vitin 2011. Nje problem tjetër i borxhit publik te Shqiperise eshte se pjesa me e madhe eshte borxh i jashtem pra 57% ndersa borxhi i brendshem eshte 43%²³. Borxhi i jashtem eshte shume i demshem per venden ne zhvillim. Borxhi i jashtëm ne Shqiperi konsiston kryesisht në borxh të përfituar përmes marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të financimit nga ana e institucione financiare nderkombëtare si EBRD, IMF, WB dhe qeveri te ndryshme, te cilat kane ndihmuar Shqiperine ne shume projekte.

²² Raporti i Bankes se Shqiperise, 2011


²³ Raporti i Bankes se Shqiperise 2011



Burimi: Ministria e financave

Nga analiza vihet re që, euro është monedha kryesore në të cilën qeveria shqiptare aktualisht merr borxh të huaj, me rreth 59% të totalit të stokut të borxhit të huaj²⁴. Vihet re që WB është kreditori kryesor i shtetit shqiptar.

Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë rritja ekonomike e Shqipërisë për 2011 është rreth 3.6% për shkak të krizës ndërkombëtare, të rënies së remitançave e si pasojë kemi një rritje të përqindjes të borxhit publik në raport me GDP dhe kosto e borxhit bëhet gjithmone e më e lartë.



Burimi: Ministria e financave, 2010

24 Open data Albania, Mbajtësit e Borxhit të Jashtëm gjatë vitit 2011, <http://open.data.al>, maj 2012

Shqipëria ka borxhin publik me të lartë në krahasim me vendet e Ballkanit. Sipas ministrisë së financave borxhi publik është rreth 5 miliardë euro për vitin 2010 i cili në fund të vitit 2011 do kap shifrën e 5.8 miliardë euro, ndërsa GDP për 2010 arriti 8.7 miliardë euro. Një problem tjetër i borxhit publik shqiptar është se pjesa më e madhe është borxh afatshkurter pra qeveria ka nevojë të vazhdueshme për likuiditet. Mjafton të permendim faktin që për të dhënë kështu e për të borxhit të marrë për ndërtimin e rruges Durrës- Kukes qeveria u detyrua të marrë borxh 30 milionë dollar për të paguar këtë kështu.

Si përfundim mund të themi se borxhi publik është një e hyrë shtetërore e cila duhet menaxhuar me kujdes në mënyrë që të mos gjendemi për situatave të njohura mirë vitet e fundit të shteteve si Greqia, Irlanda apo Spanja. Rritja e kufirit të borxhit publik në 62.6% sidomos në prag të vitit elektoral tregon keq menaxhim të borxhit publik në Shqipëri. Rritja e stokut të borxhit publik e shoqëruar me rritjen e kostove të borxhit publik në një situatë kur rritja ekonomike e vendit është e ulët ve në rrezik pagesat e ardhme të kështeve.

Bibliografia

1. A.Greiner, B.Fincke, Public debt and economic growth, Springer, 2009.
2. A.Schclarek ,Debito e crescita economica nei paesi in via di sviluppo e industriale, Lund University, Dipartimento di Economia, 2004
3. C. Checherita, P.Rother, The impact of high and growing government debt on economic growth an empirical investigation for the euro area, 2010
4. C.M. Reinhart, K.S. Rogoff, Growth in a Time of Debt, American Economic Review, 2010
5. D.Ricardo, Essay On the Funding System, The Works of David Ricardo. With a Notice of the Life and Writings of the Author, by J.R. McCulloch, London: John Murray, 1888.
6. D.W Elmendorf; N.G. Mankiw , Government Debt, National Bureau of Economic Research, IDEAS, 1998
7. J.M.Keynes, Teoria generale dell'occupazione, dell'interesse e della moneta, Utet, Torino, 2006

8. L. Ball, G.N. Mankiw, Relative-Price Changes as Aggregate Supply Shocks, Ideas, 1995
9. M.C. Reinhart, K.S. Rogoff. 2009a. "The Aftermath of Financial Crises." *American Economic Review*, Vol. 99, No. 2: 466-472
10. O.J. Blanchard, Scoprire la macroeconomia / Quello che non si può non sapere, il mulino, Bologna, 2002
11. Open data Albania, Mbajtësit e Borxhit të Jashtëm gjatë vitit 2011, <http://open.data.al>, maj 2012
12. P. Chuhan, M. Thomas, Economia globale: gli aiuti allo sviluppo e la riduzione del debito, 2007
13. P. Krugman, Financing vs. Forgiving a Debt Overhang *Journal of Development Economics*, Vol. 29, pp. 253-268, 1988.
14. R.E. Rubin, P.R. Orszag, A. Sinai, Sustained Budget Deficits: Longer-Run U.S. Economic Performance and the Risk of Financial and Fiscal Disarray, National Economic and Financial Policies for Growth and Stability, 2004
15. R.J. Barro, On the Determination of the Public Debt, *Journal of Political Economy*, University of Chicago Press, 1979.
16. Raporti i Bankes se Shqipërisë, 2011

KRIZA FINANCIARE NË RAJON SITUATA FINANCIARE NË SHQIPËRI

Armen Kadriu

Universiteti Ndërkombëtar i Strugës
a.kadriu@eust.edu.mk

Nazmije Merko Zabzun

Universiteti Ndërkombëtar i Strugës
n.merko@eust.edu.mk

ABSTRACT

The financial crisis of the states in the region does not allow us to have serious reforms in macroeconomic policy. Serious changes are needed because governments are an accomplice in economic catastrophe. Financial crises always have urged the need for regeneration to the capitalist system, have led to greater economic concentration situations, loss of rights by citizens, the enforcement of laws and measures of civil liberties in the name of a myth called "The great good." The main purpose of this paper is to bring a sense of financial volatility and banking. Politicians and economic policy makers must recognize that it is possible and desirable to use fiscal and monetary policies to fight each recession. The central thesis of this paper is that our financial system is not behaving in accordance with the laws and efficient market.

Keywords: financial crisis, banks, politics, economics, state

Hyrje

Shenjat e para të tensionit financiar filluan të ndjehen në Shtetet e Bashkuara në gjysmën e parë të 2007, kur disa institucione të mëdha financiare të filluan

të reduktojnë ekspozimin e tyre ndaj letrave me vlerë hipotekare veçanërisht të rrezikshme (të ashtuquajturat letra me vlerë subprime).

Turbullirat intensifikohen në verë duke sjellë tregjet ndërbankare në një gjendje mosveprimi në gusht. Që atëherë, kriza thellohet dhe përhapet me shpejtësi në disa muaj në të gjitha tregjet kryesore dhe rajonet, duke u pasqyruar pastaj në kërkesë dhe ofertë që nga 2008. Në tremujorin e dytë të atij viti biznesi fillon të ngadalësohet në të gjitha ekonomitë e mëdha. Tensionet në tregje financiare arrijnë kulmin e tyre në vjeshtë të vitit 2008. Në muajt në vijim tregtia ndërkombëtare ngushtohet, me rreth -16 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2008 dhe të parë të vitit 2009) dhe aktiviteti ekonomik pëson një humbje të fortë në të gjithë botën në mes të vitit 2009.

Kriza financiare që goditi ekonominë globale që nga vera e vitit 2007 është e pa precedent në historinë ekonomike të pasluftës. Edhe pse përmasat dhe saj janë të jashtëzakonshme, kriza ka shumë karakteristika të përbashkëta me recesionet ngjashme stress-financiare të ndodhura në të kaluarën. Kriza ishte e paraprirë nga periudha të gjata të rritjes së shpejtë të kredisë, prime të riskut të ulëta, disponueshmëria e bollshme e likuiditetit, leva financiare forta, çmimet e aseteve larta dhe zhvillimi i “flluskave” në sektorin e pasurive të patundshme.

Megjithatë, këtë herë është ndryshme, nga kriza globale e ngjashme që shkaktoi Depresioni i Madh i1930.

1. Veshtrim i pergjithshem mbi krizen financiare

1.1 Zanafilla e krizës financiare

Thellësia dhe fryma e tanishme krizes globale financiare është e pashembullt në historinë ekonomike të pasluftës Ajo ka disa karakteristika të përbashkëta me krizë të ngjashme financiare të 1930. Ajo u parapri nga periudhë relativisht të gjatë e rritjes së shpejtë të kredisë, primet e ulëta të rizkut, disponueshmëria e bollshme të likuiditetit, të levës së fortë (të levës financiare) , çmimet fluturuese rritëse të pasurisë dhe zhvillimi i “flluskave” në sektorin e pasurive të patundshme, performance e përkeqësuar në kredi dhe trazira në tregjet me shumicë të financimit.

Episode të tilla kanë ndodhur me parë, dhe shembujt janë të bollshme (p.sh. Japoni dhe vendet nordike në vitet 1990, kriza aziatike në mes të viteve 1990).

Por dallimi kryesor midis episodeve të mëparshme dhe krizes aktuale është dimensionin global i saj.

Kur kriza shpërtheu në fund të verës së 2007, u përhapen pasiguri në mesin


e bankave për kredite të homologëve të tyre të zhdukur pasiqë kishin investuar shumë në produkte të errët dhe mbiçmuara financiare. Si rezultat, tregu ndërbankar u mbyll praktikisht dhe primet të rizkut për kredite ndërbankare u rritën. Bankat upërballën me një problem serioz të likuiditetit, Ato hasën vështirësi të mëdha për të përmbysur problemet e borxhit afatshkurtër e tyre.

Në këtë fazë, politikëbërësit ende e perceptonin krizën kryesisht si një problem të likuiditetit. Shqetësimet mbi aftësinë paguese të institucione financiare individuale gjithashtu u shfaqen , por një kolaps I sistemit u vlerësua si i pa mundur.

Gjithashtu besojë gjerësisht se ekonomia evropiane ishte , ndryshe nga ekonomia amerikane, do të ishte kryesisht e imunizuar ndaj turbullirave financiare. Ky besim ishte i ushqyer nga perceptimet që ekonomia reale, edhe pse ngadalësuar, lulëzonte në themele të forta të tilla si rritja eshpejtë e eksportit dhe pozita të shëndosha financiare në familjet dhe bizneset.


Këto perceptime kanë ndryshuar në mënyrë dramatike në Shtator 2008, lidhur me shpëtimin e Fannie Mae dhe Freddy Mac, falimentimi I Lehman Brothers dhe frika e gjigantit të sigurimeve AIG (i cili u përfundimisht shpetoi) duke marrë poshtë institucionet financiare më të mëdha të SHBA dhe BE-në zgjimin e saj. Paniku shpërtheu në tregjet e aksioneve, tregu I vlerësimeve të institucioneve financiare avulloi, investitorët nxituan për strehë te disa investime te sigurta që kishin parë si rrugëdalje (p.sh. obligacione sovraane), dhe shkrirja e plotë të sistemit financiar u bë një kërcënim të vërtetë. Kriza kështu filloi të ushqej vetë veten, me banka të detyruara të frenojnë kredinë, aktiviteti ekonomik precipitoi, librat e huave u përkeqësuan, bankat shkurtuan kredite dhe kështu me radhë.

Rënia në tregjet e aseteve u rrokullis si ortek me shpejtësi në të gjithë botën. Tregtia e kreditë u paksua dhe u shtrenjtua, tregtia botërore ra ndjeshëm dhe firmat industriale pa shitjet e tyre grumbulluan inventaret. Besimi i të dyve, konsumatorëve dhe bizneseve ra në mënyrë të pashembullt.



Grafiku I.1.1: e Rritja parashikuar e PBB për vitin 2009

Graph I.1.27: Real GDP growth,
EU and euro area, semi-annual growth rates



Burimi: Komisioni Evropian, parashikimi i konsensusit

Ky zinxhir i ngjarjeve e vendos skenën si recesioni më i thellë në Evropë që nga viti 1930.

PBB në vitin 2009 u tkurr me rreth 4 për qind në zonën e euros dhe evropë

Situata padyshim do të kishte qenë shumë më serioze, nëse bankat qendrore, qeveritë dhe autoritetet supra-nacionale (disa vendeve), në Evropë dhe gjetkë, nuk do ti përgjigjenin me force. Politikat e normave të interesit u ulën ndjeshëm,

bankat kanë qasje thuajse të pakufizuar në kufirin e huave nga bankat e tyre qendrore, balancat të cilave u zgjeruan masivisht, dhe është dhënë garanci prej qeverive të tyre. Garancitë për depozitat e kursimit janë ngritur, dhe qeveritë dhënë stimul të konsiderueshëm fiskale. Këto veprime japin, megjithatë, kurajo për sfidat e reja, sidomos nevojën për të orkestruar një dalje të koordinuar nga politikat stimujve në vitet e ardhshme, nevojën e bashkpunimit për të krijuar struktura të reja në BE dhe kudo në botë për parandalimin dhe zgjidhjen e krizave financiare dhe menaxhimin e rrezikut sistematik.

Më tej, një sërë hapash janë ndermarrë për ti dhënë formë perspektivës për rritje,

ndërsa zbutja e planifikuar e ambientit global dhe konsolidimi fiskal pritet të kenë një efekt frenimi, sidomos vitin 2011, përmirësime të mëtejshme në kushtet financiare të tregut dhe zgjerimi i përmirësimit pritet që mbështesin aktivitetin në vitin 2011 dhe 2012. Në të vërtetë, me parashikimin në horizont të kërkesës private që gradualisht vjen duke u forcuar, rimëkëmbja është


vendosur të bëhet gjithnjë e më shumë stabile. Zhvillimet e gjithë Shteteve Anëtare mbeten të pabarabartë megjithatë, me avancimin e rimëkëmbjes me një ritëm relativisht të shpejtë në disa, por të ulët në të tjerët. Kjo pasqyron dallimet në shkallën e rregullimit Sfidave ekonomike dhe rebalancimin në vazhdim brenda zonës së BE-së dhe euro.

1.2 *Thellimi i krizës*

Fillimet e krizës financiare mendohet të kenë nisur në 6 mujorin e dytë të 2006-ës me pakësimin e kthimit të huave hipotekare (subprime) në SHBA ku shumë huamarrës nuk mund t'i kthenin borxhet e marra. Kriza transferohet tek bankat kryesore në shkurtin e 2007-ës duke u transferuar në një krizë financiare që përfshiu kreditë hipotekare më të mëdhaja, që prej verës së 2007-ës. Kriza shkaktoi rënie në tregun e bursës në verë të 2007-ës, rënia e tregut të bursës, ishte shumë më e ulët se rënia e thelluar e tregut në bursën e 2008-ës. Autoritetet qeveritare dhe ekspertë financiarë që gjykuan se bëhej fjalë për një mungesë të likuiditetit ndërbankar, ndaj edhe ndërmoren politika ekonomike për të shtuar shumatat monetare në tregjet ndërbankare. Kriza dalëngadalë u transformua në një krizë globale të josolvabilitetit bankar dhe financiar.

Nërkohë në Evropë mendohej se gëzonin imunitet ndaj kësaj krize dhe nuk flitej për mundësinë e përfshirjes në këtë krizë. Shumë banka nxituan në rritjen e kapitalit duke shitur aksionet e veta ose nëpërmjet pjesëmarrjes në investimet e jashtëme veçanërisht aziatike dhe të Gjirit Persik. Kjo vlerë rreth 6-mujorit të dytë të 2007-ës deri 6-mujorin e parë të 2008-ës shkoi në 300 miliard \$ megjithëse ishte vlerë inferiore krahasuar me nevojat reale të kapitalizmit bankar dhe ekuilibrit të strukturës së bilancit të bankës (The New York Times, 2009:3). Në të vërtetë bankat ishin të paafta të vlerësonin vlerën reale të aktiveve të tyre, çdo vlerësim u bë i pasigurtë, i ndryshueshëm, për të përcaktuar vlerën reale. Kjo situatë çoi në rritjen e krizës së likuiditetit ndërbankar, krizë besueshmërie e ndërsjelltë dhe rritje e normave të interesit të huave ndërbankare. Mbi të gjitha solli një klimë mos-besueshmërie ndërbankare, duke hezitur në ofrimin e shërbimeve të këmbimit afatshkurtër të vlerave monetare, bankave partnere, që në kohë normale kryhej me sinjale telefonike. Tani kjo nuk ndodhte më, konsiderohej e rrezikshme, sepse nuk dihej se cila bankë mund të falimentonte dhe të merrte bashkë me të edhe partnerin drejt falimentit. Kriza financiare thellohet në shtator të 2008-ës, ku një numër i madh i institucioneve financiare amerikane u ndodhën në një situatë të dështimit ose u shpëtuan nga ndërhyrja e Fed-it (si psh kompania e sigurimeve AIG, Fannie Mae dhe Freddie Mac), u blenë

me çmime simbolike (si Bear Stearns nga JPMorgan) ose dështuan (si Lehman Brothers). Këto ndodhi shkaktuan turbullira përtej SHBA-se veçanërisht në Europë ku jë numër i madh i institucioneve financiare u ndodhën para dështimit. I tërë sistemi bankar ndërkombëtar ishte i ndërlidhur, veçanërisht me qendrat bankare amerikane. Si pasojë struktura bankare ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë me shpejtësi, ndërsa bursa pësoi një nga rëniet më të thella të historisë së saj, nga janari deri tetor të 2008-ës pësoi një rënie si të




parapë: Doë Jones (SHBA) ra me 36.83 përqind, DAX (Gjermani) me 46.75 përqind, Nikkei (Japonia) me 50.03 përqind, CAC 40 (France) me 43.11 përqind, FTSE 100 (Britani) me 39.86 përqind, Bursa e Moskës qëndroi e mbyllur me javë të tëra si pasojë e frikës së efekteve të bursës. (The Financial Times, 2009:5)

Dy aktorët më të mëdhenj në im ndërmarrjen e politikave ekonomike: qeveria dhe banka qendrore.

- *Bankat qendrore* po reagojnë në zbritjen e përqindjes së interesit të tyre si dhe në marrjen si garant të aktiveve të "infektuara" të bankave në vështirësi. Psh. Në tetor 2008, Fed dyfishoi nivelin e likuiditetit të vënë në dispozicion të bankave duke arritur shumën në 9000 miliard dollarë.

- *Qeveritë* - Qeveria e SHBA ndërmori "Planin Paulson" ky plan i cili parashikonte blerjen e aktiveve të "infektuara" nga bankat e ndryshme në shumën prej 700 miliard dollarë. Francë qeveria blen aktivet e infektuara deri në 320 miliardë \$ dhe u ofron ndihmë bankave për kapitalizmin e tyre deri në 40 miliardë \$. Në gjermani blihen aktivet e infektuara deri në 400 miliard \$ dhe për kapitalizmin e tyre me një vlerë deri 80 miliard \$, në Britani qeveria u garanton bankave në vlerë prej 64 miliard dollarë, Zvicër ndihme për kapitalizmin e bankës prej 6 miliard franga zviceriane dhe blihen aktivet e infektuara deri në 60 miliard franga, në Kinë Ulen përqindjet e interesit.

Dhe pse u ndërmorën një sërë masash stabilizuar dhe për të minimizuar



efektet e krizës, kriza vazhdoi thellimin e saj. Humbjet vetëm të ekonomisë amerikane shkojnë në rreth 3600 miliard \$. (The Financial Times, 2008:3) Shumë analistë mendojnë se shkaqet e kësaj krize pasqyrohen në grafikun në vijim:

(Shumat e huazuara ndaj atyre të kursyera)

Në grafik paraqiten shumat huazuara dhe të kursyera në miliard dollarë nga amerikanët në periudhën 1953-2008. Ku deri në vitet 90 në familjet amerikane kishte një ecuri normale, konsumi pëson një rritje të lartë pas 98. Grafiku pasqyron arsyet e deficitit tregëtar dhe buxhetor si dhe huanë të lartë të jashtëme të qeverisë amerikane. Kriza dalëngadalë po ndryshon formën e saj dhe po paraqitet si krizë e superprodhimit. Industria e automobilëve rrezikon të përfshihet në këtë krizë, nëse kjo sektorët e tjerë do të përfshihen me shpejtësi të madhe. Parashikimet rezultojnë me pakësim të PBB në të gjitha ekonomitë e vëndeve të mëdha dhe në mbarë globin për vitet 2009 - 2013 në (-3) e deri në (-10) % të.

2. Ndikimi i krizës financiare mbi Shqipërinë

2.1 Kriza aktuale në Shqipëri

Kriza aktuale në Shqipëri është e shkaktuar nga disa faktorë të ndryshëm, por së tepërmi nga mungesa e efikasitetit të institucioneve demokratike me një mungesë të thellë të konsensusit politik për bashpunim, kjo gjë shkakton pabarazi korrupsion dhe jostabilitet në shoqëri. Sidomos pas vdekjeve gjatë protestave në janar të 2011, situatë politike është rënduar dhe më shumë.

Për sa i përket recensionit global Shqipëria duket se po e përballon më mirë nga sa pritej dhe parashikohej nga analistë dhe ekonomistë të ndryshëm.

Sipas të dhënave të publikuara nga fondi monetar ndërkombëtar, banka botërore, banka e Shqipërisë dhe entitete ekonomike të tjera, në Shqipëri recesioni u shmang dhe tronditja e rritjes ekonomike ishte pak më e lehtë sesa në Evropë (shih shtojcën) dhe tani stabiliteti ka filluar të përmirësohet, si dhe vendi ishte në gjendje për të vendosur një shumë prej 300.000.000 € Eurobond, në vjeshtën e vitit 2010.

Sistemi financiar mposhti stresin rritur në mënyrë të menjëhershme si pasojë e krizës dhe shmangu një thellim të mëtejshëm të kredisë, dikush e quajti Shqipërinë, duke iu referuar rritjes ekonomike, **“Tigri I Balkanit”**, të cilës, i mungon një stabilitet i fortë politik dhe institucional dhe rregulla të besueshme dhe të qëndrueshme që të lejojnë krijimin të punës dhe investimeve afat-gjata. Që nga viti 2004, kur treguesit ekonomikë shënuan Shqipërinë si shtetin më të varfër në Evropë, në vitin 2008, ku popullsia nën vijën e varfërisë (më pak se \$ 2 ne dite) do të ndalet 12% (në krahasim me rreth 30 % në 2004), duke parë përmirsimin, e njëjta renditje e vendoste atë mes ekonomive më të lulëzuara të Evropës.

Për vite të tëra marka **“Made in Albania”** në eksport ishte zhdukur (për shembull 1 produkt eksportohej dhe 11 importoheshin në sektorin e bujqësisë), remitancat, ndihmat për zhvillim të dhuruara nga disa shtete donatore si dhe rrjedhja e parave në investimet e kapitalit të huaj mbulonin këtë mungesë. Përveç financimit për pagimin e importeve, (kryesisht mallra konsumi), kjo ka kontribuar dhe në rritjen e bumit të ndertimit, sektori kryesor ekonomik.

Nga të dhënat e publikuara nga Fondi Ndërkombëtar Monetar në tetor të 2011 në raportin nr 4 mbi gjëndjen e Shqipërisë, të dhënat mbi indikatorët bazë makroekonomikë janë:

PBB- ka pasur me rreth 7.5 %, në 2009 me 3.3%, në 2010 rritje me 3.5 %, dhe në 2011 rritje me 2.5%. Në bilionë lekë rritje në 2008 me 1,089 , në 2009 rritje prej 1,151, në 2010 me 1,238 dhe 1,322 në 2011.

Kursimet kombëtare – janë rritur me 17.4% në 2008, me rreth 15.5% në 2009, 14.1% në 2010 dhe 14.1% në 2011.

Investimet – janë rritur me 32.5% në 2008, me rreth 29.0% në 2009, me 25.9% në vitin 2010 dhe me rreth 25.0% në vitin 2011.

Të ardhurat dhe grantet – janë rritur me 26.7% në vitin 2008, me rreth 26.0% në vitin 2009, me rreth 25.8% në vitin 2010, dhe me rreth 25.6% në vitin 2011.

Shpenzimet – janë rritur me rreth 32.3% në vitin 2008, me rreth 33.4% në vitin 2009, me rreth 29.6% në vitin 2010, dhe me rreth 29.4% në vitin 2011.

Bilanci i përgjithshëm – ka pësuar rënie më rreth 5.6% në vitin 2008, me rreth 7.4% në vitin 2009, me rreth 3.7% në vitin 2010, dhe me rreth 3.7% në vitin 2011.

Huamarrja e brendshme neto – ka pësuar rritje në 2008 me rreth 1%, në 2009 rritje me 0.9%, në 2010 rritje me 0.5%, dhe në 2011 rritje me 2.3%.

Borxhi publik – ka pësuar rritje në 2008 me rreth 54.7%, në 2009 rritje me 59.3%, në 2010 rritje me 58.3%, dhe në 2011 rritje me 59.4%.

Bilanci i llogarisë korente – ka pësuar rënie më rreth 15.1% në vitin 2008, me rreth 13.5% në vitin 2009, me rreth 11.8% në vitin 2010, dhe me rreth 10.9% në vitin 2011.

Bilanci tregtar – ka pësuar rënie më rreth 26.6% në vitin 2008, me rreth 24.6% në vitin 2009, me rreth 21.0% në vitin 2010, dhe me rreth 19.2% në vitin 2011.

Norma e interesit – ka pësuar rritje në 2008 me rreth 6.3%, në 2009 rritje me 6.3%, në 2010 rritje me 5.3%.

Për periudhën 2002-2010, rritja reale e PBB ishte ndër më të mirat në këtë zone me rreth 5-6% në vit, më mirë se vendet e tjera të rajonit që kanë pasur rritje të paqëndrueshme me një mesatare rreth 3-4%. Inflacioni është mbajtur i parregullt dhe jo më shumë se 2% (me përjashtim në vitin 2002 me rreth 8 % dhe 2003 në 0.5 %, ndërsa stabiliteti i Bankës Qendrore Evropiane duhet të jetë midis 1% dhe 2%). Papunësia në Shqipëri (varion nga 13 % në 16% në periudhën 2002-2010), gjatë vitit 2010 mbeti rreth 13%, më keq se Kroacia (12%), por më e mirë se ajo serbe dhe boshnjake (përkatësisht 18 dhe 27%) . Joefikasiteti është i lidhur me shkallën e lartë të punës së padeklaruar dhe edukimit joformal dhe mungesa e masave që synojnë promovimin dhe rigjenerimin e punësimit në sektorin formal, i cili është i destinuar ndoshta të vazhdojë apo të rritet si rezultat i jostabilitetit politik. E njëjta gjë vlen edhe për politikën makroekonomike të disiplinës fiskale, qasja në financa dhe siguria sociale. Këto janë pikat e spikatura, që ende nuk kualifikohen, por që normalisht do të inkurajonin investitorët e huaj strategjikë dhe bizneset.

2.2 Ndikimi i krizës globale financiare mbi migracionin

Puna emigrantore ka mundësi të fitojë rëndësi përpara faktit të vjetërimit të popullsisë në Europë dhe disa pjesë të ish Bashkimit Sovjetik. Emigrimi në rajon është unik dhe sinjifikant: ECA (Europa dhe Azia qendrore) përbën një të tretën e të gjithë vendeve që kanë të zhvilluara emigrimin dhe Rusia është i dyti vend që ka të zhvilluar emigrimin. Remitancat e emigrantëve si një pjesë e madhe e PBB janë gjithashtu të larta nga standartet në disa vende të rajonit. Motivet ekonomike aktualisht drejtojnë flukset e emigrimit në ECA. Emigrimi në Europën lindore është i lartë krahasuar me standartet ndërkombëtare. Nëse

përrjashtojmë lëvizjet ndërmjet vendeve industriale, ECA përbën më shumë se një të tretën e emigrimit total. Janë 35 milion të huaj të lindur në vendet e ECA.

Renia e komunizmit inkurajoi një rritje masive të migrimit gjeografik në rajonin e Europës dhe Azisë qendrore, duke përfshirë lëvizje të brendshme, flukse dalese nga ECA dhe flukse hyrese nga disa rajone të tjera. Pjesa më e madhe e emigrimit në ECA, ose 42% drejtohet në Europën Perëndimore. Numri i emigrantëve ilegale nga vendet e ECA në Europën Perëndimore është i lartë por ai është i vështirë të përcaktohet saktë. Aktualisht ekzistojnë vlerësime për një numër të mundshëm prej 3 milionë emigrantë ilegale në Europën Perëndimore dhe ndërmjet 3 milion dhe 3.5 milion në Rusi

2.3 Emigrimi

Pavarësisht variacionit të madh në modelet e emigrimit në rajon dhe kombinimeve komplekse të motiveve ekonomike e sociale në rajon për emigrim një numër i motiveve të ngjashme duket se janë arsyet për të emigruar. Emigrimi ndërkombëtar është i shpjeguar nga një model shtytje-dhe tërheqje: kushtet ekonomike, presionet demografike, dhe papunësia (faktorë shtytës) në vendet dërguese, puna e koordinuar me paga më të larta, kërkesa për punë, dhe ribashkimi i familjes (faktorë tërheqës) në vendet pritëse të emigrimit. Emigrimi krijon sfida dhe mundësi për vendet pritëse dhe ato dërguese. Për shumë vende migruese të ardhurat e familjeve dhe outputi kombëtar janë të lidhur ngushtë me të radhurat e emigrantëve që jetojnë dhe punojnë jashtë. Emigrimi gjithashtu i lejon emigrantëve të mësojnë aftësi të reja. Përfitimet e vendeve migruese nga emigracioni dhe remitancat janë të kushtëzuara nga cilësia e kushteve ekonomike, sociale dhe politike dhe problemeve në këto vende. Përmirësimi i kushteve të jetës në vendet dërguese të emigrantëve kanë potencialin të :

- të reduktohet përqindja e emigrimit në këto vende;
- të nxiten emigrantët në diasporë të kthehen në shtëpi;
- të nxisë emigrantët për të përdorur burimet njerëzore dhe kapitale, duke përfshirë remitancat të mbledhura jashtë, të investohen në vendin e origjinës.

2.4 Remitancat e emigrantëve

Në krahasim me PBB remitancat janë sinjifikative në shumë vende të ECA. Në 2004 remitancat e regjistruara në total në rajonin e ECA ishin më shumë se 19 miliardë US\$ duke përbërë 8% të remitancave globale dhe më shumë se 12%

te përfituara në vendet e zhvilluara. Për shumë prej vendeve të ECA, remitancat janë burimi i dytë i rëndësishëm i financimeve të jashtme pas investimeve të huaja direkte. Për shumë nga vendet më të varfëra të rajonit ato janë burimi më i madh i të ardhurave të jashtme. Fondet e emigrantëve përbëjnë më shumë se 20% të PBB në Moldavi dhe Bosnje Hercegovine dhe më shumë se 10% në Shqipëri, Armeni dhe Taxhikistan.

Remitancat e regjistruara në bilancin e pagesave llogarisin transfertat ndërmjet emigranteve dhe familjeve të tyre. Duke iu referuar studimeve me emigrantë të kthyer, ndërmjet një të tretës dhe dy të tretës së emigrantëve, në varësi të vendit të tyre të origjinës, kanë përdorur kanale informale ose metoda jashtë sistemit financiar si transfertat bankare për të dërguar transfertat në destinacionin e tyre. Specifikisht, studimet kanë treguar se një përqindje prej 40% të emigrantëve në ECA kanë raportuar përdorimin e kanaleve informale për të transferuar remitancat si drejtuesit e transportit publik, miqtë, ose familjarët. Remitancat mund të ushtrojnë një impakt pozitiv në rritjen makroekonomike. Gjithashtu, remitancat kanë një impakt pozitiv në reduktimin e varfërisë për familjet e varfëra. Të dhenat në lidhje me buxhetin e familjeve të varfëra konstatojnë se remitancat përbëjnë më shumë se 20% të shpenzimeve në familjet e varfëra. Remitancat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të këmbimit të huaj për shtete të ndryshme të ECA.

Vendet me nivel të lartë të emigrimit përfitojnë nga remitancat më shumë se 10% të shumave të të mirave të eksportuara dhe shërbimeve të sjella.

Në Moldavi dhe Serbi e Mal i Zi, remitancat sjellin në valutën e huaj gjysmën e të ardhurave nga exportet.


Për Shqipërinë dhe Bosnje Hercegovina kontributi i remitancave është pothuajse po aq sa ai i exporteve.

Remitancat e paregjistruara kanë një rëndësi të madhe në shpjegimin e deficitit të lartë të llogarisë në disa vende me nivel të lartë të emigrimit të ECA. Në figuren e mëposhtme paraqiten remitancat si pjesë e PBB. Po të shohim pozicionin e Shqipërisë në këtë figurë shohim se në Shqipëri remitancat përbëjnë nga 10-20% të PBB-se në vitin 2003 dhe kjo përqindje në kohën që flasim është rritur me tej.

2.5 Impakti ekonomik i remitancave

Pasojat ekonomike të remitancave janë të vështira për t'u veçuar, ato mund të ndikojnë në rritje nëpërmjet shumë kanaleve. Remitancat shtojnë të ardhurat kombëtare dhe agregojnë kërkesën si një të tërë. Figura 2.2 sjell vlerësime të të ardhurave të përfituara nga miqtë dhe të afërmit jashtë si një pjesë e të ardhurave kombëtare.

FIGURE 2.2

Remittances as a Portion of GDP in Eastern Europe and the Former Soviet Union, 2004


Source: IMF Balance of Payments Statistics.

Kryesuesit në këtë aspekt janë Moldavia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Taxhikistan, Armenia etj. Ashtu si çdo e ardhur tjetër, remitancat janë të shpenzuara pjesërisht në konsumin familjar dhe pjesërisht të kursyera e të investuara. Nëse ne i referohemi një modeli makroekonomik tradicional, efekti inflacionist i remitancave do të jetë me i madh nëse ato shpenzohen për investime ose të kursyera në sektorin formal financiar. Rezultatet nga studimet me emigrantë të kthyer në ECA tregojnë se pjesa më e madhe e remitancave janë përdorur për konsum ushqimor dhe veshje por gjithashtu një pjesë e mirë e tyre janë përdorur për edukim e kursime(më shumë se 10%). Shuma më të vogla janë shpenzuar në investime biznesi(më pak se 5%). Në figuren e mëposhtme paraqitet pjesa që zënë remitancat në lidhje me totalin e shpenzimeve. Siç e shohim në figurë, Shqipëria zë vendin e tretë në lidhje me pjesë që zënë remitancat përkundrejt shpenzimeve totale. Kjo tregon se remitancat janë një nga financuesit kryesorë të shpenzimeve të tyre rreth 28%.

Shpërndarja e remitancave ndërmjet zonave rurale dhe atyre urbane paraqitet në figuren 2.7. Siç mund të shohim nga figura vende të ndryshme karakterizohen nga karakteristika të ndryshme. Kështu po të shohim grafikun, Shqipëria karakterizohet nga nivel më i lartë remitancash në zonat rurale gati 70%. Gjithashtu shohim se nga grafiku 2.8, përbërja e popullsisë shqiptare është

më shumë më popullsi rurale dhe një pjesë më e vogël me popullsi urbane e cila ndikon në nivelin më të lartë të remitancave drejt popullsise rurale. Ky fenomen ndodh edhe për faktin se familjet në zonat rurale janë ato që kanë nivel më të lartë të varfërisë.


FIGURE 2.7
Distribution of Remittances by Location in 2002
(percent)



Source: Authors' calculations; World Bank, Household Data Archive for Europe and Central Asia.


Note: Data for Tajikistan are for 2003.

FIGURE 2.8
Distribution of Population by Location in 2002
(percent)



Source: Authors' calculations; World Bank, Household Data Archive for Europe and Central Asia.

Note: Data for Tajikistan are for 2003.




Source: National statistical offices and UNICEF, TransMONEE Database.

Në figurën e mësipërme paraqitet përqindja e popullsisë së emigruar në vitet 1989-99 dhe në vitet 2000-03. Siç e shohim në figurë në Shqipëri përqindja e popullsisë së emigruar në vitet 2000-03 është më e ulët, mund të thuhet shumë më e ulët se në vitet 1989-99.

FIGURE 2.1

Leading 20 Remittance-Receiving Countries in the World
(percentage of GDP in 2004)



Source: IMF Balance of Payment Statistics; World Bank.


Note: Received remittances = received compensation of employee + received worker's remittances + received migrants' transfer. Lighter bars in the graph are ECA countries.

Figura e 20 vendeve kryesuese marrëse të remitancave

Në figurën e mësipërme tregohen 20 vendet që kanë nivel më të lartë remitancash në lidhje me PBB-në. Në këtë figurë shihet qartë se Shqipëria ka një nivel të lartë remitancash në krahasim me PBB, rreth 16% te PBB-së. Pra edhe në këtë grafik shihet se Shqipëria është në një pozicion të favorshëm në lidhje me të ardhurat nga emigracioni. Në figurën 2.3 tregohet përqindja e rritjes së remitancave në vitet 1995-98 dhe në vitet 2001-04. Në figurë shihet se rritja e remitancave në vitet 2001-04 ka qenë më e ulët se rritja në vitet 1995-98, kjo si pasojë e faktit se edhe niveli i emigrimit në keto vite ka rënë në krahasim me vitet 1995-98. Megjithatë pavarësisht se rritja është më e ulët në vitet e fundit ajo përsëri është e lartë në krahasim me vendet e tjera.

FIGURE 2.3

Growth Rate of Remittances in ECA: 1995-98, 2001-04
(percent)



Source: IMF Balance of Payments Yearbook.

Note: Remittances defined as the sum of received workers' remittances, compensation of employees, and migrants' transfers.

Figura e përqindjes së rritjes së remitancave në ECA

Pra në të gjithë paraqitjet grafike të mësipërme shihet qartë se Shqipëria është një nga vendet që ndikohet më shumë nga flukset e remitancave dhe për këtë arsye ato duhet të përbëjnë një shtysë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Për këtë motiv një rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe shteti shqiptar.

Per t'u siguruar qe emigracioni te sjelle perfitime per vendet pritese ashtu edhe per ato te origjines, si dhe per vete emigrantet, vendeve u duhet te bashkepunojne per nje koordinim me te ngushte te politikave, ne menyre qe oferta e krahut emigrant te punes te plotesoje kerkesen permes kanaleve ligjore qe respektojne te drejtat e emigranteve dhe qe jane politikisht dhe nga pikepamja sociale te pranueshme per vendet pritese te emigranteve.

Nuk ka zgjidhje te gatshme per politika efektive emigracioni, megjithate nje rruge e mundshme mund te ishte kombinimi i emigracionit afatshkurter me stimuj per emigracionin e perseritur ose afatshkurter jashte shtetit, pa krijuar rritje te emigracionit te perhershem.

Nder perfitimet potenciale te emigracionit ciklik perfshijne:

- Vendet pritese mund te plotesojne mungesat ne krahun e punes, te rrisin te ardhurat dhe te ulin tensionet sociale qe lidhen me emigracionin ilegal;
- Vendet e origjinës do te akumulonin kapital njerezor qe ndryshe mund te shkonte dem; dhe kursime, te ruanin lidhjet me familjet e tyre, te paguanin kosto me te uleta te ardhurash nga emigracioni dhe te krijojne lidhje tregtare/investimesh midis vendeve


2.6 Analize e Remitancave ne 3-mujorin e pare te 2011

Në fakt si pasojë e krizës së fundit globale në vendet si Shqipëria, Bosnja dhe Serbia është ndërë rëniera e mprehtë në madhësinë e remitancave që mbulojnë nga 13 në 20 për qind të PBB-së, dhe është një përqindje më e lartë se e sektorit të eksportit.

a) Karakteristikat demografike të pritësve dhe dërguesve

Dërguesit dërgojnë tek familjet e tyre në të shumën e rasteve ardhura ose mallra, të cilat i ndihmojnë të përmirësojnë jetesën e familjareve të tyre.


Pjesa më e madhe e kryetarëve të familjeve përfituese të dërgesave i takojnë moshës 51-64 vjeç, të ndjekur nga ata 36-50vjeç.




Mesatarisht familja Shqiptare perbehet nga 4,2 anetare, pikërisht dhe pjesa më e madhe e familjeve që përfitojnë të ardhura nga dërgesat nga jashtë janë familjet me numrin e anëtarëve 1-4 persona.

Familjet me 1-4 anëtarë prfitojnë rreth 72.5 % të të dërgësave nga

jashtë. (shih grafiku b). Kryefamiljarët e familjeve përfituese kanë një nivel arsimor në përgjithësi të mesëm, rreth 40.2%, rreth 36 % arsim 8-vjeçar, 10.2 % arsim fillor dhe vetëm 13.5 % rezultojnë me arsim të Lartë.(shih graf c)



grafiku b



grafiku c

Shpërndarja gjeografike e emigrantëve

Nr Vendi i Origjines Përqindja


1 Greqi	41.9	5 Angli	3.1
2 Itali	38.6	6 SHBA	8.5
3 Gjermani	3.8	7 Tjetër	3.4
4 Zvicër	0.7		

Të dhënat e analizës dëshmojnë se përqindja më e madhe e dërgesave të të ardhurave që dërgohen në vend vijnë me së shumti nga vëndet fqinje si Greqia me rreth 41% te totalit, Italia 38.6 %, Gjermania 3.8% etj. Këto të dhëna tregojnë për një ndikim të lartë në ekonominë vëndase nga vëndet fqinje.

b) Dërgesat

Nga të dhënat e analizës rezulton se familjarët janë ata që dërgojnë pjesën më të madhe të parave. Dhe janë më së shumti fëmijët ata që zënë % më të lartë të dërguesëve të të ardhurave në familjet Shqipëtare.

Personi që dërgon të ardhurat




grafiku d

Të dhënat tregojnë se rreth 65,9 % e dërguesve përbëhet nga fëmijët. Ndërohe që burri ose gruaja zënë vetëm 10 % të totalit të dërguesve.

Nga analiza na rezulton se familjet pritëse të përfitonë dërgesa në masën mbi 50%, pra më

shumë se gjysma e tyre kanë të ardhura mujore deri në 30,000 lekë në muaj, pa përfshirë dërgesat. Këto familje e konsiderojnë dërgesën shumë të rëndësishme për jetetën e tyre. Pjesa tjetër ose janë të pa-punë ose në pension, vetëm një pjesë e vogël e përfituesve të dërgesave rezultojnë të punësuar.



grafiku e

Nga raportet e INSTAT rezulton një rënie e vazhdueshme e remitancave që emigrantët dërgojnë praën familjeve të tyre.

Në tremujorin e katërt të 2010 rënia e rmitancave shënon 29.4 % të vlerës, kjo rënie nuk kaloi pa u ndjerë në familjet Shqipëtare në festat e fundvitit.

Në tre-mujorin e parë të 2011 INSTAT raporton për një rënie të remitancave në masën 8.2% gjë e cila bëri që tendenca e qytetarëve drejt kursimeve të rritet ndjeshëm (shih graf f).

Në tremujorin e dytë situatë ekonomike e vëndit duket paksa më e rënduar, me një rënie të remitancave deri në masën 13.2% dhe rritje të prirjes për konsum, bazuar në raportet e INSTAT.


Familjet Shqipëtare kanë marrë këtë vit më pak se një vit më parë, kjo për efekt të krizës që përjetojnë vëndet ku kanë emigruar familjarët e tyre dhe për shkak të papunësisë së shkaktuar nga kjo krizë.

Pra nga të dhënat e siguruara deri tani na rezulton se hopet e krizës financiare ndërbotërore në Shqipëri po ndjehen më së shumti gjatë 2011, duke rënduar jo vetëm tregun vëndas por dhe efektet që sjell percepti e qytetarëve të Shqipërisë duke rritur prirjet për kursim nga frika e krizës. Prirje e cila tregon për një ulje të konsumit.

“Sinjalet e marra nga të dhëna të pjesshme për tremujorin e tretë, janë të paqarta

dhe sugjerojnë për një kontribut të ulët të konsumit në rritjen e kërkesës agregate.

Kështu, në periudhën korrik-gusht 2011, importi në vlerë i mallrave për konsum ra me 0.84% në krahasim me vitin e kaluar” (INSTAT).



grafiku f

Sipas analizave të rezultateve vërehet një situatë ekonomike e rënduar në gjatë 2011. Dhe një rëndësi gjithnjë e në rritje e remitancave në familjet Shqipëtare.

Rreth 73 % e dërgesave të 2011 janë përdorur për nevoja jetësore dhe për ushqim.

Afërsisht 80 % e familjeve e familjeve Shqipëtare mendojnë se dërgesat janë jetësore dhe 39 % e tyre mendojnë se janë tepër të rëndësishme.

Përfundimi

Nevojiten ndryshime strukturore për tu shëruar nga Krizat Strukturore

Duke folur për krizën e rrezikshme financiare të njohur dhe të komentuar tani nga ekonomistë dhe analistë të ndryshëm, arrijmë në përfundimin se Të dyja palët [qeveritë dhe institucionet financiare] dështuan. Ky është një dështim i rëndë i qeverisjes.

Nga titujt më në zë të editorialit “Financial Times”, është titulli tingëllues i këtij artikulli: “Uashingtoni duhet të ndale pozimet dhe të fillojë të qeverisë”. Ndërsa në qoftë se editorialet si kjo mund të benin dicka më shumë se pozimet në emer të “qeverisjes” për çështjen e rëndë në diskutim, do te ishte për borxhin katastrofik të “shtëpisë së pushtetit” të kapitalizimit global, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vetëm borxhi i qeverisë (pa shtuar borxhin e korporatave edhe individeve private) është numëruar tashmë në mbi 14 trilion dollarë I drejtuar

drejt numrave te ndricuar në fasadën e një ndërtese publike të Nju Jorkut që tregon tendencën e papërmbajtshme të borxhit në rritje.

Është e nevojshme që të sqarohen dallimet përkatëse mes llojeve apo modaliteteve te krizës. Kjo nuk është një çështje indiference nëse një krizë në sferën sociale mund të konsiderohet si një krizë periodike , ose diçka shumë më themelore se kaq. Sepse, natyrisht, mënyrat që kanë të bëjnë me një krizë themelore strukturore nuk mund të konceptohen në lidhje me kategoritë e krizave periodike . Dallimi thelbësor midis këtyre dy llojeve të kundërta të krizave është se krizat periodike ndahen dhe janë më shumë ose më pak të zgjidhura me sukses brenda kornizës së përcaktuar, ndërsa kriza themelore ndikon në kuadrin e vetë tërësisë se saj.

Në terma të përgjithshme, ky dallim nuk është thjesht një çështje e ashpërsisë se dukshme e llojeve kundërta te krizave. Për një krizë periodike ose konjunkturale mund të jenë dramatikisht te rënda si “Krizat e Madhe Botërore Ekonomike e 1929-1933” ku ndodhi që të ishte ende e aftë për një zgjidhje brenda parametrave të sistemit të dhënë. Dhe në të njëjtën mënyrë, por në kuptim të kundërt, karakteri “jo-eksploziv” i një krize të zgjatur strukturore, në kontrast me “stuhi të mëdha” (në fjalët e Marksit) përmes të cilës kriza periodike konjunkturale mund të shkarkohe dhe të zgjidhë veten, mund të të çojë në strategjitë fundamentale te pakonceptuara, si rezultat i keqinterpretimit të mungesës së “stuhisë”; sikur mungesa e tyre ishte provë e madhe për stabilitetin e pacaktuar te “kapitalizmit të organizuar” dhe të “integritimit të klasës punëtore”.

Nuk mund të jete mjaft i theksuar fakti se kriza në kohën tonë nuk është e kuptueshme pa iu referuar kuadrin te gjerë të përgjithshëm shoqëror. Kjo do të thotë se në vend qe të sqarojme natyrën e krizës së vazhdueshme dhe të thellimit të gjithë botës e sotme, ne duhet të përqendrojmë vëmendjen në krizën e sistemit të kapitalit në tërësinë e saj. Për krizën qe ne jemi duke përjetuar është një krizë gjithëpërfshirëse strukturore.

Le të shohim karakteristikat përcaktuese të krizës strukturore per të cilat jemi te shqetësuar, te përmbledhura sa me shkurt qe ishte e mundur :

Risia historike e krizës së sotme është manifestuar në disa aspekte kryesore:

- o karakteri i saj është universal, dhe jo i kufizuar në një sferë të veçantë (p.sh., financiar ose tregtar, që ndikojnë në këtë apo atë degë të veçantë të prodhimit, ose duke aplikuar për këtë lloj sesa atë lloj të punës, me gamën e saj të veçantë të aftësive dhe gradave te produktivitetit, etj);
- o Qëllimi i saj është me të vërtetë global (në kuptimin më kërcënues të fjalës), se sa i mbyllur në një grup të veçantë të vendeve (si të gjitha krizat e mëdha kanë qenë në të kaluarën);

- o shkalla e saj kohore eshte e zgjatur,e vazhdueshme:e përhershme, ne vend qe te jete e kufizuar dhe ciklike, si të gjitha krizat e meparshme të kapitalit qe kane ndodhur;

Këtu është e nevojshme të bëjmë disa pika të përgjithshme në lidhje me kriteret e një krize strukturore, si dhe për format në të cilat zgjidhja e saj mund të parashikohet. Për të vënë në terma më të thjeshtë dhe më të përgjithshme, një krizë strukturore ndikon në tërësinë e një kompleksi social, në të gjitha marrëdhëniet e saj me pjesët përbërëse të tij apo nën-komplekset, si dhe me komplekse të tjera me të cilat ajo është lidhur.

Në të kundërt, një krize jo-strukturore prek vetëm disa pjesë të kompleksit në fjalë, dhe kështu pa marrë parasysh sa e rëndë mund të jetë në lidhje me pjesët e prekura, ajo nuk mund të rrezikojë mbijetesën e vazhdueshme të strukturës së përgjithshme. Prandaj, zhvendosja e kontradiktave është e realizueshme vetëm kur kriza është e pjesshme, relative dhe brendesisht e menaxheshme nga sistemi, duke kërkuar jo më shumë se ndryshime, madje edhe ndryshime të mëdha, në kuadër të sistemit relativisht autonom. Me të njëjtën logjikë, një krizë strukturore vë në dyshim ekzistencën e kompleksit të përgjithshëm , duke marre si te mirëqenë përsosmerine e saj dhe zëvendësimin me një farë kompleksi alternativ. I njeiti kotrast mund të shprehet në drejtim të kufijve per çdo kompleks të veçantë social që ndodh në mënyrë të menjëhershme , në çdo kohë të dhënë, në krahasim me ato përtej të cilit ajo nuk mund të mendohet të shkojë.

Për “stuhite” përmes të cilave kriza hipotetike shkarkon vetëveten janë mjaft paradoksale, në kuptimin që në mënyrën e tyre të shpalosur ata jo vetëm shkarkojne (dhe imponojnë), por edhe zgjidhin vetveten , me shkallën në të cilën është e mundshme në ato rrethana. Këtë ato mund ta bëjnë pikërisht për shkak të karakterit të tyre të pjesshëm i cili nuk vë në dyshim kufijtë e fundit të strukturës globale të krijuar . Në të njëjtën kohë, (edhe për të njëjtën arsye), ato vetëm mund të “zgjidhin” problemet strukturore themelore të ngulitura thellë te cilat domosdoshmërisht rikthejne veten vazhdimisht në formën e krizave specifike hipotetike, në mënyrë rigoroze të pjesshme dhe te përkohëshme gjithashtu ne mënyre të kufizuar. Derisa, kriza e ardhshme hipotetike shfaqet në horizontin e shoqërisë.

Në të kundërt, në funksion të natyrës pashmangshmerisht të ndërlikuar dhe të zgjatur të krizës strukturore, e shpalosur në kohë historike në një kuptim epokal dhe jo episodik / i menjëhershëm, ajo është ndërlidhja e akumuluar e tërësise që vendos per këtë çështje, madje edhe nën pamjen false të “normalitetit” . Kjo është sepse në krizën strukturore çdo gjë është në rrezik,

që përfshin limitet e fundit gjithëpërfshirës të rendit të caktuar të cilat ndoshta nuk mund të jenë një rast i veçantë “simbolik / paradigmatic”. Pa i kuptuar lidhjet e përgjithshme sistematike dhe implikimet e ngjarjeve të veçanta dhe zhvillimet në harrojmë ndryshimet e vërteta të rëndësishme dhe levat përkatëse të ndërhyrjes potenciale strategjike që ndikojnë pozitivisht në to, në interes të transformimit sistematik të nevojshëm.

Përgjegjësia jonë sociale bën thirrje për një ndergjegjesim të pakompromentueshem të marrëdhënieve kumulative të zhvillim, në vend që të kërkohe risigurime ngushëlluese në botën e normalitetit të rreme derisa shtëpia të bjere mbi kokën tonë. Është e nevojshme të theksoj këtu se për gati tri dekada pas Luftës së Dytë Botërore zgjerimi i suksesshëm ekonomik në vendet dominuese kapitaliste ka gjeneruar iluzionin edhe në mesin e disa intelektualëve të mëdhenj që faza historike e “kapitalizmit të krizës” i kishte kapërcyer, duke ja lënë vendin e tyre për atë që ata e quajtën “kapitalizmi i organizuar i avancuar”.

Unë dua të ilustroj këtë problem duke cituar disa pasazhe nga puna e një prej intelektualëve më të mëdhenj militante të shekullit të njëzetë, të Jean-Paul Sartre, për të cilin unë kam një konsideratë shumë të lartë. Megjithatë, fakt është se miratimi i nocionit që duke kapërcyer “kapitalizmin e krizës” ku themelimi shndërroi vetveten në “kapitalizmi të avancuar” dhe krijoi disa dilema të mëdha për Sartre. Kjo është e gjitha më e rëndësishmja, sepse askush nuk mund të mohojë kërkimin e plot të kryer prej Sartrit për një zgjidhje praktike emancipuese dhe integritetin e tij të madh personal.

Në lidhje me problemin tonë ne duhet të kujtojmë që në intervistën e rëndësishme që I është dhënë grupit Italian të Manifestit –pasi u përshkrua koncepti i tij rreth implikimeve negative të pakapercyeshme të kategorisë së tij shpjeguese të institucionalizimit dëmtues të pashmangshëm të asaj që ai e quajti “grupe të perziera” në Kritiken e tij të arsyes Dialektike, atij iu desh të arrinte në përfundimin e dhimbshëm se “Ndërsa unë e kuptoj nevojën e një organizate, unë duhet të pranoj se unë nuk shoh se si problemet që e përballin çdo strukture të stabilizuar mund të zgjidhen.”

Këtu vështirësia është se termat e analizës sociale të Sartrit janë ngritur në mënyrë të tillë që faktorë të ndryshëm dhe korrelacionet që në realitet qendrojnë së bashku, përbëjnë aspekte të ndryshme të te njejtit kompleks shoqëror rrenjesisht, janë përshkruar nga ai në formën më problematike ndarëse dhe kundërshtuese, duke gjeneruar dilemme të pazgjidhshme dhe një disfatë të pashmangshme për forcat emancipuese shoqërore. Kjo është treguar qartë nga këmbimi midis grupit të Manifestit dhe Sartri:

Manifesto: Në çfarë bazash të sakta mundet dikush të përgatisë një alternativë revolucionare?

Sartri: Unë përsëris, më shumë duhet te jemi në bazë të “tjetërsimit” sesa në “nevoja”. Me pak fjalë nevoja për rindërtimin e individit dhe lirisë është aq e ngutshme sa që edhe teknikat më të rafinuara të integritit nuk mundën ta paksojnë atë nevojë.

Kështu Sartri në këtë mënyrë, në vlerësimin e tij strategjik se si të kapërcejmë karakterin shtypës të realitetit kapitalist, krijon një opozitë krejtësisht të papërshtatshme midis punëtorëve në lidhje me nocionin e “tjetërsimit” dhe gjoja “nevojat” e tyre të kënaqura, duke e bërë gjithçka më të vështirë për të parashikuar një rezultat pozitiv praktikisht të realizueshëm. Dhe këtu problemi nuk është thjesht se ai i jep kredibilitet më shumë modernes por një shpjegimin sociologjik tejet sipërfaqësor të ashtuquajturave “teknika të rafinuara të integritit” në lidhje me punëtorët. Për fat të keq ajo është shumë më serioze se kaq.

Në fakt problemi me të vërtetë shqetësues në rrezik është vlerësimi i qëndrueshmërisë së “kapitalizmit të avancuar” vetë dhe lidhur me postulatit të klases puntore “integrimin” të cilat Sartri ndodh që i ndanë në atë kohë në një gjerësi të madhe me Herbert Marcuse. Sepse në fakt e vërteta e çështjes është që në kontrast me integrimin e padyshimtë të mundshëm të disa punëtorëve të veçante në rendin kapitalist, klasa puntore antagonistja strukturore e kapitalit, që përfaqëson të vetmen alternativë historikisht të qëndrueshme në sistemin e kapitalit nuk mund të integrohet në kuadër të tjetërsuar dhe shfrytëzues të riprodhimit shoqëror. Çfarë e bën të pamundur është antagonizmi themelor strukturor midis kapitalit dhe punës, që burojnë me një domosdoshmëri të pakapërcyeshme që vjen nga realiteti klasik i dominimit antagonist dhe varësise.

Në kohët e sotme nevoja për ndryshime strukturore është përgjigja ndaj krizës tonë të thellë strukturore, dhe është bërë urgjente jo vetëm në sektorin financiar, për shkak të humbjes së trilionave dollarëve, por kudo. Mediat kryesore kapitaliste financiare ankohen se “Kina është ulur në tre trilionë dollarë të holla”, me dëshirën për të projektuar përsëri zgjidhje si “përdorimi më i mirë i këtyre parave”. Por e vërteta është e hidhur Borxhi i kapitalizmit që shkon deri në dhjetë herë më shumë se sa Kina disponon “dollarë të përdorura.” Përveç kësaj, edhe në qoftë se borxhi i madh i tanishëm mund të eliminohet disi, edhe pse askush nuk mund të thotë se si, pyetja e vërtetë do të mbetet: Si u gjenerua fillimi, dhe si mund të sigurohemi se nuk do të ndodhë përsëri në të ardhmen?

Bibliografia

1. Abadie L., `` La crise financière en 2008 / 2010 : mode d`employ pour la décrypter et l`exploiter``, Collection : VALYS, Editeur : Edouard Valys éditions; Édition : édition 2009.
2. Bertrand J., Vivien L-G., `` Les 100 mots de la crise financière``, Collection: Que sais-je ?, Editeur : Presses Universitaires de France - PUF janvier 2009.
3. Civici. A, Kriza financiare apo globale?, Publisher: UET/Press, 2010, ISBN: 978-99956-39-25-9
4. Financial Times – The Rising Cost of Food : (The global food crisis, Published : April 13 2008; Global recovery threatens food price surge, published november 15, 2009; Food security is G8 chance of relevance, published July 10, 2009).
5. Fullani A., Fjala në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 24 shkurt 2010.
6. Burime nga INSTAT
7. Burime nga “The New York Times”,2008
8. Burime nga “The Financial Times”,2008
9. Burime nga “The economist”

TATIMI PROGRESIV DHE PËR PJESTIMOR- NJË VËSHTRIM KRAHASIMOR

Luan Shahollari

Instituti Shqiptar të Sociologjisë

lshahollari@yahoo.com

ABSTRACT

Tax systems around World are: progressive; proportional and regressive. Taxpayers (individuals or businesses), in a progressive system, are paying more taxes if they earned more incomes. Taxpayers in a proportional system (otherwise, "flat rate tax") are paying the same tax rate, despite of their income level. In the regressive system, the tax rate decreased, when incomes increased, (as, value added tax). The progressive system is using in EU countries, USA, China, Japan, Brazil, Australia, etc., while proportional tax system is using in the Baltic countries, Russia, in some ex-Soviet Union republics, ex-communist countries of the Central and Eastern Europe etc. In Albania, till 2007, was used the proportional tax system, while since 2008 –proportional system. The incomes in the progressive system - subject of taxation- were divided in five groups, respectively: 1 %; 3.6 %; 7.1; 5.6 %, and 13.2 %. While according to proportional system, levels over 10 000 lek per month, in general, are the subject of tax rate by 10 %. In the context of this system, the corporate tax rate was decreased from 20% to 10 %. Though the using of this system is only four years (2008-2011), the data shows that revenues of personal incomes tax and corporate tax toward GDP in 2011 were decreased 0.1 % in comparison with 2007. In order to increase the budget revenues, IMF (2011) has suggested the increase of the proportional tax rate from 10% to 12 or 15 %. In 2007, the revenues from corporate tax reached 58.7 % of the total revenues from this system, but in 2008 the level decreased to 42.5 %. This trend is continuing also after 2008. The increase of tax rate on

personal incomes and the decrease on corporate tax has aggravated the situation of strates with low and middle incomes, therefore, in this analysis we are proposing the study of the opportunity to return back in the progressive tax system, as more fairer and effective system.

Keywords: Progressive tax; Proportional tax; Revenue tax; Corporate tax; Gross domestic product; Fair tax.

Hyrje

Literatura e huaj ofron përkufizime të ndryshme të tatimeve dhe taksave,²⁵ por në thelb të ngjashme midis tyre: ato janë pagesa të detyrueshme nga bizneset apo nga individët, që vendosen nga një nivel qeverisjeje²⁶, me qëllim që të financojnë veprimtaritë qeveritare.²⁷

Legjislacioni shqiptar i përcakton tatimet dhe taksat si pagesa të detyrueshme dhe të pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo të organeve të qeverisjes vendore të vendosura me ligj, me dallimin se tatimi nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara, kurse taksa paguhet nga personat që ushtrojnë të drejta publike apo përfitojnë shërbime publike.²⁸ Dispozitat e ligjit për procedurat tatimore përfshijnë edhe taksat.

Tatimet dhe taksat përbëjnë burimin kryesor të ardhurave të buxhetit. Në vitin 2011 tatimet dhe taksat (në nivel kombëtar dhe vendor, direkte dhe indirekte) zinin rreth 92 për qind të ardhurave të buxhetit, nga të cilat 82 për qind nga tatimet dhe 10 për qind nga taksat.

Peshën më të madhe në të ardhurat në raport me PBB e ze tatimi mbi vlerën e shtuar me 9.2 për qind, pasuar nga akcizat me 3.1 për qind, tatimi mbi të ardhurat personale me 2.1 për qind, taksat nacionale 1.6 për qind, tatimi mbi fitimin 1.5 për qind etj.

Në literaturën financiare botërore njihen tre sisteme tatimi: *progresiv*, *përpjestimor* (*proporcional*) dhe *regresiv*. Në sistemin progresiv, tatimpaguesit (persona apo biznese), paguajnë më shumë tatime kur fitojnë më shumë të

25 Në literaturën e huaj haset më shpesh termi tax apo taxation, i cili nënkupton edhe tatimin.

26 Termi government - qeveri -qeverisje -shpesh nënkupton edhe organet ligjvënëse (parlamentet).

27 <http://www.investopedia.com/terms/t/taxes.asp#axzz2C7tBu3Gq>

28 Neni 5 i ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

ardhura.²⁹ Në një sistem përpjestimor tatimpaguesit i nënshtrohen të njëjtës përqindje tatimi, pavarësisht nga niveli i të ardhurave të tyre. Në sistemin regresiv tatimi ulet, kur të ardhurat rriten, psh tatimi mbi vlerën e shtuar.

Objekt i kësaj teme janë sistemi progresiv dhe përpjestimor. Por më parë po ndalemi në një vështrim të shkurtër mbi parimet, dhe qëllimet e tatimit.

1. Parimet dhe qëllimet e tatimit

Në veprën e tij madhore *Pasuria e kombeve* (1776), Adam Smith, themeluesi i ekonomisë moderne, i ka kushtuar një kapitull të veçantë edhe analizës të taksave. Por, para t'i hyjë kësaj analize ai e gjen të nevojshme të formulojë katër parime për taksimin në tërësi, të cilat konsiderohen ende si piknisja e financave të shëndosha publike. Këto parime janë: i barazisë apo i aftësisë; i sigurisë; i përshtatshmërisë; i ekonomisë.³⁰

- *Parimi i barazisë apo aftësisë.* Subjektet e çdo shteti duhet të kontribuojnë për mbështetjen e qeverisë, sa më ngushtë të jetë e mundur, në përpjestim me mundësitë e tyre përkatëse; pra, në përpjestim me të ardhurat të cilat ata i gëzojnë nën mbrojtjen e shtetit.
- *Parimi i sigurisë.* Taksa e cila çdo individ është i detyruar të paguajë duhet të jetë e sigurtë dhe jo arbitrare. Koha e pagesës dhe mënyra e pagesës, shumat për t'u paguar, duhet të jenë të gjitha të qarta dhe të planizuara për taksapaguesin dhe çdo person tjetër.
- *Parimi i përshtatshmërisë.* Çdo taksë duhet të vendoset në kohën, apo në mënyrën, që është më e përshtatshme për kontribuesin për ta paguar atë.
- *Parimi i ekonomisë.* Çdo taksë duhet të jetë aq e ekonomizuar, sa të nxjerrë dhe të lerë nga xhepat e njerëzve sa më pak të jetë e mundur, veç çfarë çon në thesarin e shtetit.

Me kalimin e kohës, qeverisja erdhi duke u bërë më komplekse, prandaj studjues të financave publike, formuluan edhe katër parime të tjera si:

- *Parimi i produktivitetit.* Vendosja e një takse duhet të sjellë të ardhura të mjaftueshme për qeverinë.
- *Parimi i elasticitetit.* Sistemi taksor duhet të jetë elastik, aq që kur të lindë nevoja për më shumë të ardhura, qeveria t'i rrisë burimet pa kosto shtesë për mbledhjen e tyre.
- *Parimi i thjeshtësisë.* Sistemi i taksimit të jetë sa më i thjeshtë, i qartë dhe i kuptueshëm për taksapaguesin.

29 <http://financial-dictionary.thefreedictionary.com/Progressive+Taxation>.

30 Volume II of "The Wealth of Nations". Book V, Chapter II, part II. 'Of Taxes' (f.676-677).

- *Parimi i llojshmërisë.* Sistemi të përfshijë një numur taksash ekonomike, direkte dhe indirekte, në përputhje me parimin e barazisë, të ardhurave dhe stabilitetit.³¹

Tatimet dhe taksat përdoren nga qeveria për katër qëllime kryesore, të cilat, në anglisht fillojnë me shkronjën R. Po kështu mund të përshtaten me këtë shkronjë edhe në shqip:

a) *Revenue- Rritja e të ardhurave* përbën qëllimin më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë të të taksimit pasi shërben si bazë për financimin e shpenzimeve për mbrojtjen, rendin publik, shkollat, spitalet, sistemin juridik, pagat, pensionet etj.

b) *Redistribution-Rishpërndarja* kupton transferimin e parave nga shtresat e pasura të popullsisë në ato më të varfëra përmes projekteve sociale. Ky funksion është i pranuar në shumicën e demokracive, ndonëse masa e shtrirjes mbetet e diskutueshme.

c) *Re-pricing- Ri-vlerësimi* shërben për të shkurajuar përdorimin e artikujve të caktuar të tillë si psh duhani apo alkooli. Në mënyrë të veçantë, taksimi shërben si mjet për qeverinë për të ndikuar sjelljen e individëve dhe firmave të biznesit.

d) *Representation- Rritja e përfaqësimit* i referohet përgjegjshmërisë të qeverisë ndaj qytetarëve të saj. Studimet kanë treguar se taksimi direkt sjell shkallë më të lartë të përgjegjshmërisë dhe qeverisjes, ndërsa tatimi indirekt priret të ketë efekte më të vogla.³²

Tatimet në vendin tonë shërbejnë: a) Si burim kryesor i të ardhurave për buxhetin e shtetit, duke kontribuar në mbulimin e shpenzimeve të përgjithëshme që bën shteti për mbrojtjen, rendin, arsimin, shëndetësinë, kulturën e shkencën, si dhe për zhvillimin ekonomisë, kryesisht për infrastrukturën; b) Si instrument për rishpërndarjen e të ardhurës kombëtare dhe të pasurisë; c) Si mjet për ndryshimin e çmimeve relative të mallrave dhe shërbimeve, duke ndikuar kështu mbi kërkesën agregate.³³

31 Canons/Principles of Taxation, by Adam Smith. http://economicsconcepts.com/canons_of_taxation.htm

32 <http://www.taxplaza.org/the-four-r's.asp>

33 S.Hilmia, E.Luçi. Fjalor Enciklopedik Shqiptar.Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2009.F. 2661.

2. Tatimi progresiv dhe përpjestimor- historiku dhe dallimet midis tyre

Ndonëse jetoi në shekullin e 18-të, "A. Smith është i njohur dhe i vlerësuar ende për veprën e tij mbi ekonominë e tregut të lirë, përfshirë taksimin."³⁴ Krahas tatimit përpjestimor, ai është i pari që ka mbështetur edhe tatimin progresiv. Duke mbajtur parasysh se kërkesat e jetesës të pasurve ndryshojnë ndaj të varfërve, ai shkruan se: *"Nuk është shumë e paarsyeshme që të pasurit duhet të kontribuojnë për shpenzimet publike, jo vetëm në përpjestim të të ardhurave të tyre, por diçka më shumë se në këtë përpjestim."*³⁵

Fillimi i tatimit mbi të ardhurat në Britani daton më 1799 kur u vendos ajo që në histori ka hyrë si "taksa që mundi Napoleonin", që mbuloi një pjesë të shpenzimeve të luftërave me Francën. Më 1816 u shfuqizua për t'u rivendosur në buxhetin e vitit 1842 fillimisht me një shkallë, por në buxhetin e vitit 1909 u miratua si një "mbitaksë" me disa syresh.³⁶

Kongresi amerikan miratoi ligjin e parë federal të taksës mbi të ardhurat më 1862, për të mbështetur Luftën Civile (1861-1865). Personat që fitonin 600 deri 10,000 usd paguanin një taksë prej 3 për qind në vit, ata me 10,000 usd e më shumë, 5 për qind. Më 1872 kjo taksë u shfuqizua për t'u rivendosur në vitet 1894 - 1895 derisa një vit më vonë Gjykata e Lartë e shfuqizoi si jo-kushtetuese. Por më 1913, Amendamenti 16-të i Kushtetutës e bëri tatimin mbi të ardhurat e individëve dhe bizneseve pjesë të përherëshme të sistemit taksor.³⁷

Tatime mbi të ardhurat vendosën edhe Japonia më 1887, Prusia më 1891 (Gjermania federale, më 1919), Holanda më 1893, Suedia më 1903 etj.

Nga dekada e parë e shekullit të 20-të taksa progresive mbi të ardhurat filloi të bëhej një rregull i përgjithshëm në shumicën e vendeve europiane e më gjerë.

Rritja e shpenzimeve në Luftën I Botërore diktoi rritjen e tatimit mbi të ardhurat, sidomos në grupet me të ardhura të larta. Në Britani niveli më i lartë i tatimit nga 8.3 për qind më 1914 arriti 60 për qind më 1920, në ShBA nga 7 për qind në fillim të luftës në 77 për qind nga fundi, në Kanada nga 21.9 për qind

34 Tom Walton. The Heartland Institute. Adam Smith on Taxes. Nov. 1, 2003.

35 Volume II of "The Wealth of Nations". Book V, Chapter II, part II. 'Of Taxes' F.691.

36 A B Atkinson. Growth, taxation and the long-run evolution of top incomes. Nuffield College, OXFORD. Pavia, Università, 7 - 8 ottobre 2004. www-3.unipv.it/websiep/wp/386.pdf

37 History of the Income Tax in the US. Tax Foundation. <http://www.infoplease.com/ipa/A0005921.html>

më 1917 në 72.5 për qind më 1920, në Francë e vendosur për herë të parë 2 për qind më 1915 arriti në 50 për qind më 1919.³⁸

Deri në vitet 1930-të, tatim mbi të ardhurat paguanin vetëm shumë të pasurit, por në fund të Luftës II Botërore këtë taksë e paguanin mbi 60 për qind e atyre që fitonin të ardhura. Të ardhurat nga taksat në raport me PBB thuajse u dyfishuan në shumicën e vendeve të industrializuara midis viteve 1930 - 1945.³⁹

Pas Luftës II Botërore *sistemi i tatimit progresiv* u bë gati tërësisht mbizotërues në vendet perëndimore. Një ndikim të ndjeshëm pati në këtë periudhë teoria ekonomike e J M Kejnssit, veçanërisht politika e uljes të papunësisë dhe kontrollit të inflacionit përmes ndryshimit të normave të interesit, tarifave të taksimit dhe shpenzimeve publike.

Mbështetësit e *sistemit progresiv* argumentojnë se parimi i drejtësisë kërkon që ata që kanë më shumë të ardhura duhet të paguajnë më shumë tatime apo taksa, pasi shteti shpenzon më shumë për ruajtjen dhe shtimin e pasurisë së tyre. Nga ana tjetër, ky sistem zbut shpërpjestimet në të ardhurat dhe krijon më shumë mundësi për drejtësi dhe barazi sociale.

Mbështetësit e *sistemit përpjestimor* shprehen se kjo mënyrë tatimi i nxit taksapaguesit të fitojnë më shumë dhe se mbledhja e është më e thjeshtë dhe më transparente. Brenda këtij sistemi, në disa vende zbatohet "taksa e sheshtë - përqindje të njëjta pagese për tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale si dhe për disa tatime të tjera.

Debatet për sistemet e tatimit shpesh zbresin edhe në terrenin ideologjik. Mjafton të sjellim në vëmendje zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Francë dhe ShBA. Madje këto debate vazhdojnë ende.⁴⁰

Më 12 prill 2007, në një takim me donatorë të huaj, kryeministri S.Berisha, u shpreh se "në filozofinë fiskale botërore janë dy rryma: rryma marksiste⁴¹ e taksës progresive dhe e kundërta e saj, rryma e taksës së sheshtë" (shqipëria.com).

38 Kenneth Scheve, Yale University. David Stasavage, New York University. *The Conscripton of Wealth: Mass Warfare and the Demand for Progressive Taxation*. July 2009.

39 Sven Steinmo. *The evolution of policy ideas: tax policy in the 20th century*. *British Journal of Politics and International Relations*, Vol. 5, No. 2, May 2003, pp. 206-236.

40 Sarah Palin (R), ish guvernatore e Alaskës, në *Fox News Monday night*, (4.12.2012) u shpreh se duke e rritur borxhin, B.Obama është një socialist, dhe një president që, po e drejton vendin në një marshim të ngadaltë drejt komunizmit. http://www.huffingtonpost.com/2012/12/04/sarah-palin-obama-socialist_n_2237163.html

41 Në programin e Lidhjes së Komunistëve (1848), Marksi dhe Engelsi kanë shkruar për "një tatim të lartë apo të shkallëzuar mbi të ardhurat. (<http://www.gutenberg.org/cache/epub/61/pg61.html>).

Debati u rindez kur PS bëri publik programin e saj të ri (nëntor 2011) ku angazhohet “ta heqë taksën e sheshtë dhe të vendosë drejtësi sociale përmes tatimit progresiv”, që “kush është më i pasur të ketë një barrë më të lartë fiskale se sa një më i varfër.”

Në fakt “sot, janë vendet e industrializuara që përdorin strukturat progresive ndërsa vendet ish-komuniste mbështesin taksat e sheshta” dhe se “për botën perëndimore, kultura e drejtësisë priret të mbizotërojë mbi thjeshtësimin.”⁴²

3. Përdorimi i sistemit të tatimit progresiv

Aktualisht sistemi i tatimit progresiv përdoret në mbi 164 vende të botës, nga 196 gjithsej: në BE, ShBA, Japoni, Brazil, Australi, Kinë, Egjipt... Kosovë, e vende të tjera. Një shtrirje e tillë globale, e në vende me qeverisje të ndryshme politike tregon se motivet për përdorimin e këtij sistemi nuk janë ideologjike, por ekonomike dhe sociale. Ato lidhen me zbutjen e pabarazive horizontale dhe vertikale dhe krijimin e shoqërive sa më harmonike.

Në vijim po sjellim shembuj të sistemeve progresive që përdoren në disa vende.⁴³

Në **Britaninë e Madhe**, vendlindjen e kapitalizmit, tatimi mbi të ardhurat personale është progresiv, me 5 shkallë tarifore. Për vitet 2010-2011 shkallëzimi ndryshon nga 10 % në 50 %. Shumat deri 2,440 paund në vit, apo 203 paund në muaj taten me 10 për qind. Shkalla arrin në 20 për qind kur të ardhurat arrijnë 37,401 paund në vit, 40 për qind midis kësaj shume dhe 150 mijë paund dhe 50 për qind kur kalojnë 150 mijë paund në vit.

Të ardhurat e tatueshme, paund në vit		Tatimi në %
Nga	Deri	
1	2,440	10
1	37,400	20
37,401	150,000	40
150,000	Mbi	50

42 Flat or Flattened? A Review of International Trends in Tax Simplification and Reform. Sandra Hadler, DAI; Christine Moloi, AYSPS; Sally Wallace, AYSPS (Development Alternatives, Inc). Një analizë e kryer në qershor 2006 për USAID. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADH107.pdf.

43 Për këtë analizë kemi shfrytëzuar të dhëna nga portali <http://www.taxrates.cc/index.html> i cili shërben si një guidë për taksat si dhe për tregues të tjerë ekonomikë dhe financiarë në shkallë globale.

Në **Shtetet e Bashkuara** sistemi taksor mbi të ardhurat personale më 2011 ishte progresiv me 6 shkallë tarifore që përfaqësojnë ndarjen e grupeve të ardhurave. Në dallim nga sistemi britanik, këtu shkalla tarifore është jo vetëm në përqindje por edhe në dollarë.

Të ardhurat e tatueshme, usd në vit		Taksa:	
Mbi	Por jo mbi	Usd	Plus
0	8,500	0.00	10 % të shumës mbi 0 usd
8,500	34,500	850	15% të shumës mbi 8,500 usd
34,500	83,600	4,750	25% të shumës mbi 34,500 usd
83,600	174,400	17,025	28% të shumës mbi 83,600 usd
174,400	379,150	42,449	33% të shumës mbi 174,400 usd
379,150	-	110,016	35% të shumës mbi 379,150 usd

Shkalla e parë fillon me 10 për qind tatim të shumës nga 0 deri në 8,500 usd në vit, shkalla e dytë (mbi 8,500 deri 34,500) është 850 usd plus 15 për qind të shumës mbi 8,500 usd, deri tek e gjashta mbi 379,150 usd në vit e cila tatóhet me 110,016 usd dhe 35 për qind të shumës mbi 379,150. Më 2012, shkalla e parë është 8,700 usd dhe e fundit, 388,350 usd.

Në **Gjermani**, ekonomia e të cilit konsiderohet si “lokomotiva” e BE, përdoret një sistem tatimi progresiv për të ardhurat personale i ndarë në 4 shkallë. Të dhënat e vitit 2012 tregojnë se shkalla e parë, deri në 8,004 euro në vit, nuk i nënështróhet tatimit. Një lehtësim i tillë sigurisht shkon në dobi të shtresave me të ardhura më të ulta dhe forcon karakterin social të këtij shteti. Por grupimet e tjera, dhe sidomos e treta dhe e katërta kanë tarifa më larta tatimi, përkatësisht 42 dhe 45 për qind.

Të ardhurat e tatueshme, euro në vit		Tatimi në %
Mbi	Deri në:	
0	8,004	0
8,005	52,881	14
52,882	250,730	42
250,731	Dhe mbi	45

Franca përdor një sistem tatimi progresiv mbi të ardhurat personale me 5 shkallë, ku shkalla e parë, deri në 5,963 euro në vitin 2012 nuk tatóhet,

kurse shkalla e dytë tatohet me një tarifë të ulët-vetëm 5.5 për qind. Tarifat e tatimit vijnë duke u rritur me rritjen e të ardhurave të fituara. Nga viti 2012, në kuadrin e përpjekjeve për të lehtësuar pasojat e krizës financiare botërore, është vendosur një 3 për qind shtesë mbi të ardhurat personale midis 250,000-500,000 euro dhe 4 për qind për të ardhurat që kapërcejnë 500 mijë euro.

Të ardhurat e tatueshme, euro në vit		Tatimi në %
Mbi	Deri në:	
0	5,963	0
5,963	11,896	5,5
11,896	26,420	14
26,420	70,830	30
70,830	Mbi	41

Në **Italinë** fqinjë, ku për vite me radhë kryeministër ka qënë z.S.Berlusconi, një nga kapitalistët më të pasur të Europës, tatimi progresiv ndahet në 5 shkallë që përfaqëson 5 grupe të ardhurash. Referuar të dhënave të vitit 2012, veçori e sistemit Italian, ndryshe nga ai gjerman dhe francez, është tarifa e lartë e shkallës së parë, 23 për qind, tarifa e dytë 27 për qind, kurse tre tarifat e tjera të përafërta midis tyre: 38,41, 43 për qind:

Të ardhurat e tatueshme, euro në vit		Tatimi në %
Mbi	Deri në:	
0	15,000	23
15,001	28,000	27
28,001	55,000	38
55,001	75,000	41
75,001		43

Tatimi mbi të ardhurat personale në **Japoni**, e treta në botë për volumin e PBB (pas ShBA dhe Kinës) është progresiv. Tarifa e tatimit për individët për vitin 2012 është nga 5 deri në 40 për qind. Kurse taksa mbi fitimin e bizneseve është 25.5 për qind. Në rastin japonez, si dhe në atë gjerman dhe francez vihet re një tarifë më e ulët për grupet e shkallës së parë dhe së dytë, përkatësisht 5 dhe 10 për qind. Pra, të gjithë ata që fitojnë 1,950,000 jen në vit, apo 24,405 usd, (1 usd = 79.9 jen) tatohen me vetëm 5 për qind.

Të ardhurat vjetore, në Yen		Tatimi në % dhe Yen
Nga	Deri	
1	1,950,000	5%
1,950,001	3,300,000	10%
3,300,001	6,950,000	20% të bazës mbi 3,300,000
6,950,001	9,000,000	23% të bazës mbi 6,950,000
9,000,001	18,000,000	33% të bazës mbi 9,000,000
18,000,001	Dhe mbi	40% të bazës mbi 18,000,000

Brazili është një shtet i madh që ka njohur zhvillim të shpejtë vitet e fundit, duke zënë vendin e 7-të në renditjen botërore të volumit të PBB. Tatimi progresiv mbi të ardhurat personale aty është i grupuar në 5 shkallë. Për shkallën e parë, deri në 17,989 real (monedha vendase) ose 9,569 usd (1 usd =1.88 real) shkalla e tatimit është 0. Veç kësaj, tarifa e tatimit për shkallën e dytë është mjaft e ulët-vetëm 7.5 për qind kurse tarifat e tjera janë me rritje graduale, gjë që tregon për një politikë më të moderuar tatimi.

Të ardhurat e tatueshme,real në vit		Tatimi në %
Mbi	Deri në:	
1	17,989	-
17,989	26,961	7.5
26,961	35,948	15
35,948	44,918	22.5
44,918		27.5

Kina renditet në vendin e dytë në botë, pas ShBA, për vëllimin e PBB. Sipas nenit 1 të Kushtetutës, sistemi socialist përbën bazën e R.P. të Kinës. Tatimi mbi të ardhurat personale është ndërtuar me 7 shkallë të ardhurave. Nga tabela del se të gjithë ata individë, që marrin deri 1,500 juan në muaj 238 usd (1 usd =6.3 juan) në vitin 2012 tatohen me 3 për qind, kurse ata që marrin 80,001 e më shumë juan në muaj (12,121 usd) tatohen me 45 për qind.

Të ardhurat e tatueshme, juan në muaj		Tatimi në %
Mbi	Deri në:	
1	1,500	3
1,501	4,500	10

4,501	9,000	20
9,001	35,000	25
35,001	55,000	30
55,001	80,000	35
80,001		45

Rrjeti tarifor tatimor në **Egjypt** është ndërtuar me 4 shkallë, ku të ardhurat deri në 5,000 EGP (Egyptian pound) - rreth 820 USD (1 Usd = 6.11731 EGP) në vit janë të përjashtuara nga tatimi. Tarifat e tjera janë përkatësisht 10, 15, 29 për qind. Tatimi mbi të ardhurat është vendosur mbi të gjitha të ardhurat në botë të shtetasve egjiptianë. Kurse jo-rezidentët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat e fituara apo realizuara vetëm në Egjipt.

Të ardhurat e tatueshme, EGP në vit		Tatimi në %
Nga	Deri	
Deri	5,000	0
5,001	20,000	10
20,001	40,000	15
Mbi 40,000		20

Prej 1 janarit 2009 shkallët e tatimit mbi të ardhurat personale në **Kosovë** janë progresive dhe taten në përqindje dhe në euro. Të ardhurat nën 960 euro në vit, apo 80 euro në muaj, nuk taten. Edhe shkallëzimet e tjera janë relativisht të ngushta.⁴⁴

Të ardhurat vjetore, në euro		Taksa në % dhe euro
Nga	Deri	
0	960	0%
Mbi 960	3,000	4 % mbi shumën 960 euro
Mbi 3,000	5,400	81,6 euro, plus 8 % të shumës mbi 3,000 euro
Nga 5,400	Mbi 5,400	273,6 euro plus 0% të shumës mbi 5,400 euro

44 http://www.eciks.org/english/publications/investing_in_kosovo/content/iguide_12.html

Në përfundim mund të shprehemi se sistemi i taksimit progresiv ka një përhapje të gjerë në shkallë botërore si në vendet e mëdha e të zhvilluara ekonomike ashtu dhe në vende të tjera në zhvillim, por sidomos në vendet Euro-Atlantike. Shkalla e progresivitetit ndryshon nga njeri vend në tjetrin por thelbi mbetet i njëjtë: kush siguron më shumë të ardhura paguan më shumë tatime, të cilat përdoren për rritjen e mirëqënies në përgjithësi.

4. Përdorimi i sistemit të tatimit përpjestimor

Tatimi përpjestimor (apo siç quhet ndryshe “taksa e sheshtë”) bazohet në parimin se të ardhurat e individëve dhe të bizneseve taten me tarifë të njëjtë për të gjithë taksapaguesit, pavarësisht nga shuma e të ardhurave që ata sigurojnë.

Dy studjuesit më me ndikim në mbështetjen e taksës të sheshtë janë ekonomistët Alvin Rabushka (1940) dhe Robert E. Hall (1943) të Institutit Huver të Universitetit të Stanfordit- qëndër kërkimore me prirje konservatore, ngritur me kontributin e H.Huverit më 1919, Presidenti i 31-të i ShBA (R) në vitet 1929-1933.

Hall dhe Rabushka e propozuan taksën e tyre sheshtë për herë të parë në një artikull të botuar në Wall Street Journal më 10 dhjetor 1981. Synimi, sipas tyre ishte korrigjimi i sistemit të taksave të vendosur në vitet e Depresionit të Madh dhe Luftës II Botërore, ndonëse reduktime të tarifave ishin bërë në vitet 1964, 1969, dhe 1981.

Këto çështje ata i detajuan më tej në librin e përbashkët “Taksa e sheshtë” (The Flat Tax) më 1985. Në hyrjen e ribotimit të librit, 25 vjet më vonë (2007), Rabushka shkruan se prej 1981, ata kishin folur për taksën e sheshtë në më shumë se njëmijë raste: duke filluar nga Kongresi, Senati, Shtëpia e Bardhë e deri në dhjetra universitete të ndryshme.

Hall dhe Rabushka propozojnë një “taksë të sheshtë” prej 19 për qind për të gjitha të ardhurat personale, duke përjashtuar të ardhurat prej 25,500 usd në vit për një familje me katër veta si dhe reduktimin e taksës të biznesit në 19 për qind nga 35 për qind, që është sot.

Një mbështetës i taksës së sheshtë është Stive Forbes, kryeredaktori i revistës të njohur të biznesit. Forbes ka qënë dy herë kandidat për president i ShBA në garën brenda PR, më 1996 dhe 2000, por pa sukses. Por, me gjithë përpjekjet, Hall dhe Rabushka, Forbes e ekonomistë dhe politikanë të tjerë republikanë, nuk kanë mundur të sigurojnë mbështetjen e vendimarrësve amerikanë, dhe perëndimorë në përgjithësi.

A.Rabushka ka hartuar një listë me 30 vende që zbatojnë “taksën e sheshtë” renditur sipas vitit të miratimit të legjislacionit përkatës, deri më 10 mars 2010. Kësaj liste duhet t’i shtohen Sejshellet, që prej 2010 përdor një taksë të sheshtë prej 15 për qind si dhe Hungaria, prej 16 për qind nga 1 janari 2011, pra, gjithsej 32 vende. Por për vitin 2013 duhet të hiqen nga kjo listë Slovakia⁴⁵ dhe Rumania⁴⁶ pasi do të zbatojnë sisteme të tatimit progresiv.

Tabela 1. Lista me disa nga vendet që zbatojnë “taksën e sheshtë”

Nr.	Shteti	Viti i aktit ligjor	Tatimi në % mbi	
			Të ardhurat personale	Fitimin e biznesit
1.	Estonia	1994	21	21
2.	Letonia	1995	25	15
3.	Lituania	1996	24	15
4.	Rusia	2001	13	24
5.	Sërbia	2003	14	10
6.	Iraku	2004	15	15
7.	Slovakia	2004	19	19
8.	Ukraina	2004	15	25
9.	Gjeorgjia	2005	12	20
10.	Rumania	2005	16	16
11.	Turkmenistani	2005	10	20
12.	Kirkistani	2006	10	10
13.	Shqipëria	2007	10	10
14.	Islanda	2007	36	18
15.	Maqedonia	2007	10	10

45 Parlamenti Slovak miratoi ndryshimin e sistemit të tatimit uniform prej 19 për qind duke e rritur tatimin mbi fitimin në 23 për qind dhe tatimin mbi të ardhurat personale në 25 për qind për shumat që kalojnë 2,867 euro (\$3,749) në muaj. Këto ndryshime bëhen për të ngushtuar defiçitin buxhetor, dhe hyjnë në fuqi më 1 janar 2013. (R.Tomek - Dec 4, 2012. bloomberg.com/news/2012-12-04/slovakia).

46 Qeveria e re rumune parashikon të heqë taksën e sheshtë nga 2013 dhe ta zëvendësojë me një sistem progresiv taksimi është shprehur Kryeministri V.Ponta, me një taksë prej 8 për qind për personat me të ardhura të ulta, 12 për qind të mesme dhe 16 për qind të larta.(A.Timu - May 11, 2012 .www.bloomberg.com/archive/news/2012-05-11/) Më 9.12.2012 aleanca e qëndrës së majtë e udhëhequr nga V.Ponta fitoi rreth 60 për qind të votave, me 95 për qind të votave të numuruara deri të hënë (10 dhjetor) .By A.Mutler. Associated Press. Dec. 10, 2012.

16.	Mongolia	2007	10	10
17.	Mali i Zi	2007	9	9
18.	Kazakistani	2007	10	15
19.	Bullgaria	2008	10	10
20.	Republika Çeke	2008	15	15
21.	Bosnja & Herceg.	2009	10	10
22.	Bjellorusia	2009	12	24
23.	Hungaria	2011	16	16

Lista përmban 23 vende, të cilët konsiderohen më të rëndësishëm. (Vendet e tjera janë: Jersey (1940, 20%), Hong Kong (1947, 16 dhe 17.5%) Gurnsey (1960, 20 dhe 0%); Jamaica, (1986, 25 dhe 33.3%); Trinidad & Tobago (2006, 25%); Pridnestrovie (2007, 10 dhe 0%); Mauritius (2009, 15%); Belize (2009, 25 %) dhe Sejshellet (2010, 15%).

Nga lista të bie menjëherë në sy fakti se në 21 vende (përjashtuar Irakun dhe Islandën) para vitit 1990 kanë qënë sisteme komuniste. Shteti më i madh është Rusia, që pasohen nga ish-republikat e tjera të BS (Estonia, Letonia, Lituania, Ukraina, Gjeorgjia, Turkmenistani, Kirkistani, Kazakistani, Bjellorusia). Në këtë listë përfshihen edhe ish vendet komuniste të Europës Lindore dhe Qëndrore (Republika Çeke, Republika Sllovaqe, Rumania, Bullgaria, Hungaria), si dhe të ish- Jugosllavisë (Sërbia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja & Hercegovina). Shqipëria dhe Mongolia gjithashtu kanë qënë sisteme komuniste.

Mungesa e traditës dhe e kapaciteteve për mbledhjen e tatimeve dhe taksave i ka nxitur qeveritë e këtyre vendeve të përdorin një “taksë të sheshtë”, që konsiderohet e thjeshtë.

Nga viti i miratimit dhe shtrirja gjeografike del se taksa e sheshtë është shtrirë në formën e një “sëmundje ngjitëse”. Estonia ishte vendi që vendosi e para taksën e sheshtë më 1994, e pasuar nga dy vendet fqinje balltike: Letonia më 1995 dhe Lituania më 1996. Më 2007 taksën e sheshtë e vendosën tre vende fqinje ballkanike: Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Shumica e vendeve të ish BS dhe të ELQ i kanë vendosur taksat e tyre të sheshta në vitet 2004-2009. Kjo, duket se është bërë për të ruajtur konkurrencën dhe për të tërhequr më shumë investime të huaja dhe të brendshme.

Nga 23 vendet e listës, 12 prej tyre (Iraku, Slovakia, Rumania, Kirkistani, Shqipëria, Maqedonia, Mongolia, Mali i Zi, Bullgaria, Republika Çeke, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Hungaria) kanë vendosur tarifa të njëjta tatimi si për të ardhurat personale ashtu dhe për fitimin. Kurse 9 vende, (Turkmenistani, Kirkistani, Shqipëria, Maqedonia, Mongolia, Kazakistani, Bullgaria, Bosnja

dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi) kanë vendosur tarifa të ulta tatimi, prej 10 për qind si për tatimin mbi të ardhurat personale dhe për tatimin mbi fitimin.

Periodha e shkurtër e zbatimit të taksës së sheshtë nuk të jep mundësi për analiza më të plota për efektin në të ardhurat publike. Megjithatë, shumica e këtyre vendeve nuk i bënë dot ballë krizës botërore dhe pësuan rënie të PBB dhe të treguesve financiarë.

Kështu, Estonia, pësoi një rënie të PBB prej 5.1 % më 2008, dhe 13.9 % më 2009. Nuk i shpëtoi krizës as Letonia, ku PBB më 2008 ra 4.2%, më 2009 18 % dhe më 2010 0.3 %. Në Lituani PBB ra 14.7% më 2009. PBB në Rusi më 2009 ra 7.8%, në Rumani 8.5 %, në Bullgari 5.5 %, në Sllovaki 4.9 %, në Republikën Çeke 4.1 %, në Gjeorgji 3.8 %, në Sëri 3.5 % etj. Në Islandë PBB ra 6.7 % më 2009 dhe shteti shkoi drejt kolapsit. Kurse të tjerat, përfshirë edhe Shqipërinë pësuan rënie të ndjeshme në ritmet e rritjes ekonomike.

Nga ana tjetër vendet ish-komuniste të ELQ, antare të BE si: Bullgaria, Republika Çeke, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia, kanë mbledhur më pak të ardhura publike në raport me PBB krahasuar me vitet 2005 - 2010.

5. Përdorimi i sistemeve të tatimit në Shqipëri

Prej vitit 1993 deri më 2007 në Shqipëri është përdorur sistemi i tatimit progresiv, kurse prej vitit 2008 po zbatohet tatimi përpjestimor i versionit të "taksës së sheshtë". Me "taksë të sheshtë" kuptojmë përdorimin e të njëjtës tarifë në përqindje si për tatimin mbi të ardhurat personale dhe për tatimin mbi fitimin, që në vendin tonë, si dhe në disa vende të tjera ish-komuniste është 10 për qind. Po cili është efektiviteti i sistemeve të tatimit që janë përdorur gjatë këtyre dy dekadave të fundit në raport me rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit dhe me parimet e tjera të përmendura më lart? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje po sjellim disa të dhëna krahasuese për të dy sistemet, duke filluar nga viti 2007, e në vijim.

5.1 Tatimi progresiv - deri më 2007

Tabela e tatimit mbi të ardhurat personale ka ndryshuar shpesh prej vitit 1993 por pa ndryshuar thelbin progresiv të tatimit. Ndryshimet më të fundit janë bërë në dhjetor 2005 të cilat kanë vazhduar deri në dhjetor 2007. Këto të dhëna paraqiten në tabelën që vijon:

Tabela 2. Tatimi mbi të ardhurat personale

E ardhura e tatueshme (në muaj)		Tatimi mbi të ardhurat personale	
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	Lekë	Në %
0	14.000	0	+ 1% të shumës mbi 0 lekë
14.000 +	40.000	140	+ 5% të shumës mbi 14.000 lekë
40.000 +	90.000	1.440	+ 10% të shumës mbi 40.000 lekë
90.000 +	200.000	6.440	+ 15% të shumës mbi 90.000 lekë
200.000 +	Më tepër	22.940	+ 20% të shumës mbi 200.000 lekë

Nga tabela del se sistemi i tatimi progresiv ka qënë me 5 shkallë apo grupime të të ardhurave të tatueshme që siguronin individët në formën e pagave apo shpërblimeve të tjera, me tarifa në lekë dhe në përqindje, në mënyrë rritëse nga njëra shkallë tek tjetra.

Shkalla e parë deri në 14.000 mijë lekë tatohej me vetëm 1 për qind, kurse shkalla e dytë nga mbi 14.000 lekë deri në 40 mijë lekë me 140 lekë plus 5 për qind të shumës mbi 14.000 lekë, ose 1.300 lekë (26,000 x 5%). Pra, një punonjës që merrte 40.000 lekë më 2007 paguante një tatim prej 1.440 lekë ose 3.6 për qind të pagës.

Shkalla e tretë nga mbi 40 mijë lekë në deri 90 mijë lekë tatohej 1.440 lekë plus 10 për qind të shumës mbi 40 mijë lekë. Nëse marrim si shembull pagën kufi prej 90 mijë lekë në muaj, atëherë për shumën mbi këtë kufi prej 50 mijë lekë do të paguhet një tatim prej 5,000 lekë, pra gjithsej 6.440 lekë ose 7.1 për qind të të gjithë pagës prej 90 mijë lekë.

Shkalla e katërt, nga mbi 90 mijë lekë deri në 200 mijë lekë, tatohej me 6.440 lekë plus 15 për qind të shumës 30 mijë lekë ose 4.500 lekë, pra gjithsej 10.949 lekë ose 5.6 për qind e shumës 200 mijë lekë.

Shkalla e pestë, më shumë se 200 mijë lekë tatohej me 22.940 lekë plus 20 për qind të shumës mbi 200 mijë lekë. Në rastin e shumës 50 mijë lekë kjo është 10 mijë lekë dhe i gjithë tatimi prej 32.940 lekë i pagës prej 250 mijë lekë është 13.2 për qind.

Pra, sipas këtij sistemi, tatimi mbi të ardhurat për grupin e parë është 1 për qind, për grupin e dytë 3.6 për qind, për grupin e tretë 7.1 për qind, për grupin e katërt 5.6 për qind. Tarifa rritet në 13.2 për qind për grupin e pestë, me të ardhurat më të larta.

5.2 Tatimi përpjestimor – prej vitit 2008

Më 1 janar 2008 hyri në fuqi sistemi i tatimit përpjestimor mbi të ardhurat personale, apo siç ka hyrë në fjalorin e përditshëm –“taksa e sheshtë”, sipas tabelës 3.

Tabela 3. Tatimi përpjestimor mbi të ardhurat personale

E ardhura e tatueshme, lekë në muaj		Tatimi
Nga	Deri	
0	10.000	0
10.001 +	30.000	+ 10% të shumës mbi 10.000 lekë
30.001 +	Më tepër	+ 10% të shumës mbi 0 lekë

Ky sistem nuk taton shumat deri 10 mijë lekë në muaj. Shumat nga mbi 10 mijë lekë deri në 30 mijë lekë në muaj tatohen 10 për qind. Kjo do të thotë në rastin e diferencës prej 20 mijë lekë në muaj (30.000-10.000) vlera e tatimit është 2000 lekë në muaj.

Shumat mbi 30 mijë lekë në muaj tatohen 10 për qind secila duke filluar nga 0 lekë. Në rastin psh të një shume prej 40 mijë lekë në muaj, vlera e tatimit do të ishte 4 mijë lekë në muaj (40.000x 10%). Nëse do të përdorej sistemi i tatimit progresiv, për shumën 14.000 lekë do të paguhej një tatim prej 1% ose 140 lekë. Për shumën tjetër nga 14.000 deri 40.000 lekë do të paguhej: 140 lekë + 1.300 lekë (5% e shumës 2.600 lekë) gjithsej 1.440 lekë.

Pra, për shumën të ardhurash prej 40 mijë lekë në muaj, në rastin e përdorimit të sistemit të tatimit progresiv do të paguheshin 1.440 lekë, kurse në rastin e “taksës së sheshtë” që përdoret tani 4.000 lekë ose 2.8 herë më shumë.

Me variantin e “taksës së sheshtë” prej 10 për qind, individi që siguron 50 mijë lekë të ardhura në muaj, paguan 5.000 lekë në muaj kundrejt 2,440 lekë që paguante me sistemin e tatimit progresive, ose 2.3 herë më shumë.

Në rastin e një page prej 250 mijë lekë në muaj do të kishim këto të dhëna: me tatimin progresiv, individi do të paguante 33.940 lekë në muaj (22.940 lekë plus 10 mijë lekë, që rrjedh nga 20% e shumës prej 50 mijë lekë). Kurse në rastin e “taksës së sheshtë” prej 10 për qind individi paguan 25.000 lekë, ose 8.940 lekë (26 për qind) më pak.

Për sa më sipër, duke mbajtur parasysh se pagat apo të ardhurat e tjera personale 40-50 mijë lekë në muaj përbëjnë pjesën më të madhe të pagave, mund të shprehemi se sistemi i “taksës së sheshtë” godet individët me të ardhura personale të ulëta dhe të mesme dhe favorizon individët me të ardhura të larta.

Meqënëse individët me të ardhura të ulta dhe të mesme përbëjnë shumicën, si në sektorin publik dhe privat, atëhere kontributi i tyre është më i madh në të ardhurat e buxhetit.

5.3 Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe mbi individët

Nga tabela 4 del se të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe mbi të ardhurat personale, që përbëjnë të quajturën “taksë të sheshtë”, në vlera absolute nuk kanë shënuar ndonjë rritje të ndjeshme pas vitit 2007, madje më 2012 kanë rënë kundrejt një viti më parë, kurse në vlera relative thuhetse kanë qëndruar në vend, me prirje rënie më 2012 dhe 1013. (Në këtë rast nuk kemi llogaritur edhe ndikimin e inflacionit, që do t’i ulte akoma më shumë këto nivele.)

Kështu, ndërsa në vitin 2007 të ardhurat nga këto dy burime ishin 35.927 milion lekë, në vitin 2008 arritën në 42.606 milion lekë, me një rritje prej 18.5 për qind, në vitin 2009 43.969 milionë lekë ose 3.2 për qind, më 2010 44.664 milionë lekë ose 1.6 për qind dhe më 2011 shuma 47.679 milion lekë, me një rritje prej 6.7 për qind.

Por në vitin 2012, bazuar në plotësimin e pritshëm, të ardhurat nga “taksa e sheshtë” kanë rënë në 44.703 milionë lekë ose -6.2 për qind. Sipas projektbuxhetit të vitit 2013 ato parashikojnë të arrijnë në 47,075 milionë lekë, 5.3 për qind më shumë se 2012 por gjithsesi më pak se në vitin 2011.

Tabela 4. Të ardhurat nga ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe individët, 2007-2012

Në milionë lekë


Nr.	Emërtimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012
I.	Të ardhurat gjithsej	251,555	291,238	299,597	324,721	330,450	340,820
	Në %	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
1.	Të ardhurat nga “taksa e sheshtë”	35,927	42,606	43,969	44,664	47,679	44,703
	Në %	14,3	14,6	14,7	13,7	14,4	13,1
a.	Tatimi mbi fitimin	21,077	18,108	17,149	17,606	19,712	16,863
	Në % ndaj gjithsej	8,4	6,2	5,7	5,4	5,9	4,9
b	Tatimi mbi të ardhurat personale	14,850	24,498	26,820	27,058	27,967	27,840
	Në % ndaj gjithsej	5,9	8,4	9,0	8,3	8,5	8,2

Burimi: Ministria e Financave. Viti 2012 i pritshëm. Viti 2013-projekt buxhet.

Të ardhurat nga “taksat e sheshtë”, shprehur në mënyrë relative, (kundrejt të ardhurave gjithsej të buxhetit), kanë shënuar ngritje dhe ulje (zikzake) : 14.3 për qind më 2007; 14.6 për qind më 2008; 14.7 për qind më 2009 që përbën edhe nivelin më të lartë të këtyre viteve.

Por në vitin 2010 ato kanë rënë në 13.7 për qind për t’u ringritur në 14.4 për qind më 2011. Kurba arrin kuotat më të ulëta prej 13.1 për qind sipas realizimit të pritshëm më 2012 dhe 13 për qind sipas projektbuxhetit të vitit 2013.


Zikzaket e “taksës së sheshtë” duken qartë në grafikun 1:



Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin në “taksën e sheshtë” në vitin 2007 zinin 58.7 për qind kundrejt 41.3 për qind të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Pas këtij viti raporti përmbyset: të ardhurat nga tatimi mbi fitimin bjenë në 42.5 për qind më 2008, deri në 37.7 për qind më 2012 dhe 2013. Në të kundërtën, ardhurat personale janë rritur 57.5 për qind më 2008 duke vijuar deri në 62.3 për qind më 2012 dhe 2013. (Grafiku 2).

Të dhënat tregojnë se kalimi nga sistemi progresiv në “taksën e sheshtë” nuk ka rezultuar efektiv pasi nuk ka arritur synimin kryesor, që është rritja e të ardhurave.

Pas analizave periodike për situatën ekonomike dhe financiare në vendin tone, ky “difekt” është vënë re edhe nga institucionet ndërkombëtare. Në qershor 2011, G.Bell ekspert i FMN ka sugjeruar që Shqipëria të ulë nivelin e borxhit duke e rritur “taksën e sheshtë”, nga 10 për qind në 12 apo 15 për qind, se edhe me këtë rritje do të mbetet konkurruese.



Por ky sugjerim i FMN-së nuk është pranuar nga Qeveria shqiptare. Ministri i Financave R.Bode, ka deklaruar se “në programin tonë të stabilitetit financiar afatmesëm, nuk do të ketë instrumente të rritjes së taksave”.⁴⁷ Prandaj për të mbuluar deficietet që i vijnë nga “taksa e sheshtë” qeveria do t’i zëvendësojë me hua duke rritur tavanin e borxhit publik në 63 për qind me pasoja në të gjithë treguesit e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Nga ecuria e deritanishme del se “taksa e sheshtë” nuk ka dhënë ndonjë efekt pozitiv në rritjen e të ardhurave, krahasuar me taksimin progresiv, ndonëse pagat e punës si dhe numri i bizneseve, sipas pohimeve zyrtare kanë shënuar rritje në pesë vjetët e fundit. Veç kësaj, rritja e masës të tatimit mbi të ardhurat personale dhe ulja në të njëjtën kohë e tatimit të fitimit e ka rënduar barrën e taksimit në shtresat me të ardhura të ulëta dhe të mesme pasi “taksa e sheshtë” merr edhe nga paga prej 30 mijë lekë në muaj, që përbën “minimumin jetik” për jetesën modeste të dy personave.

5.4 Tatimi mbi fitimin


Tarifa e tatimit mbi fitimin e biznesit deri në vitin 2007 ka qënë 20 për qind, kurse nga fillimi i vitit 2008 është ulur në 10 për qind, duke u “sheshuar” në të njëjtin nivel me tatimin mbi të ardhurat personale sëbashku dhe tregues të tjerë si: dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, interesat nga

⁴⁷ minfin.gov.al, 22.6.2011.

huatë, depozitat, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, nga lojërat e fatit, dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera.

Përgjysmimi i tatimit mbi fitimin u bë me synimin për të nxitur biznesin të rrisë të ardhurat për të investuar për zgjerimin e veprimtarisë ekonomike e hapjen e vendeve të reja të punës. Sigurisht një masë e tillë synon të tërheqë edhe më shumë investime të huaja direkte.

Por në fakt nuk ka rezultuar kështu: në të kundërtën të ardhurat nga ky lloj tatimi kanë rënë si në shumë absolute dhe relative. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin kanë qënë më të larta para vitit 2007, pra, para fillimit të zbatimit të “taksës së sheshtë”. (Tabela 4).




Kështu, nga 21.077 milionë lekë më 2007 këto lloj të ardhurash kanë rënë në 18.108 milionë lekë ose 14 për qind më 2008. Rënia ka vazhduar edhe në vitet pasues 2009 dhe 2010 për arritur në 19,722 milionë lekë më 2011. Por të ardhurat nga tatimi mbi fitimin kanë rënë në kuotën më ulët prej 16,863 milionë lekë më 2012.

Raporti i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin ndaj të ardhurave gjithsej, nga 8.4 për qind më 2007, ka rënë në 6.2 për qind më 2008, 5.7 për qind më 2009, 5.4 për qind më 2010. Pas 5.9 për qind më 2011, raporti parashikohet në 4.9 për qind më 2012 dhe 2013. (Grafiku 3).

5.5 Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë rritur në 24.498 milionë lekë më 2008 kur hyri në fuqi përdorimi i “taksës së sheshtë”, me një rritje prej 65 për qind kundrejt vitit 2007. Këto të ardhura kanë zënë 8.4 për qind të ardhurave gjithsej, nga 5.9 për qind më 2007. Niveli më i lartë i të ardhurave personale prej 26.820 milionë lekë u shënuar në vitin 2009, që përbëjnë 9 për qind të të ardhurave gjithsej. Në tre vitet pasues (2010, 2011, 2012) raporti i këtyre të ardhurave ka rënë përkatësisht në 8.3, 8.5 dhe 8.2 për qind kundrejt të ardhurave gjithsej. (Tabela 4, grafiku 4).



Rritja e ndjeshme dhe e menjëherëshme më 2008 kundrejt vitit 2007 reflekton jo vetëm zgjerimin e bazës së taksimit që dikton “taksa e sheshtë” por edhe rritjen nominale të pagave si në sektorin publik dhe atë privat. Referuar të dhënave të INSTAT-it, paga mesatare mujore në sektorin publik në vitin 2011 ka qënë është 46.665 lekë ose 38 për qind më e lartë se më 2007, kurse paga minimale zyrtare ka arritur në 20 mijë lekë kundrejt 14 mijë lekë ose 43 për qind më shumë. (Në këtë rast po analizojmë pagën nominale, pasi ajo reale është më e ulët. Kështu, në vitin 2011 rritja e pagës mesatare mujore është 6.9 për qind ndërsa çmimet e konsumit u rritën me 3.4 për qind, pra paga reale del 3.5 për qind).

Përfundime dhe sugjerime

Në literaturën financiare botërore njihen tre sisteme tatimi: *progresiv*, *përpjestimor* (*proporcional*) dhe *regresiv*. Në sistemin progresiv, tatimpaguesit (persona apo biznese), paguajnë më shumë tatime kur fitojnë më shumë të ardhura. Në sistemin përpjestimor tatimpaguesit i nënshtrohen të njëjtës përqindje tatimi, pavarësisht nga niveli i të ardhurave të tyre. Në sistemin regresiv tatimi ulët, kur të ardhurat rriten, psh tatimi mbi vlerën e shtuar.

Sistemi i tatimit progresiv përdoret në mbi 84 për qind të vendeve të botës: në BE, ShBA, Japoni, Brazil, Australi, Kinë, Egjipt, ... Kosovë e gjetkë. Një shtrirje e tillë globale tregon se motivet për përdorimin e këtij sistemi janë ekonomike dhe sociale. Ky sistem synon zbutjen e pabarazive (horizontale dhe vertikale) dhe krijimin e shoqërive sa më harmonike.

Sistemi i tatimit përpjestimor ("taksa e sheshtë") filloi të marrë përhapje pas vitit 1990. Estonia ishte e para që përdori këtë sistem më 1994, pasuar edhe vendet e tjera balltike, Rusia më 2001 dhe republika të tjera ish-sovjetike, Sërbia më 2003 dhe vende të ish-Jugosllavisë, Slovakia më 2004 dhe vende ish-komuniste të ELQ, gjithsej 32 vende. Sistemi synon të ruajë konkurrencën dhe të tërheqë më shumë investime të huaja dhe të vendit.

Duket se, mungesa e traditës dhe e kapaciteteve të nevojshme për mbledhjen e tatimve, i ka shtyrë qeveritë e këtyre vendeve, për të përdorur një "takse të sheshtë", që konsiderohet e thjeshtë në llogaritje dhe në mbledhjen e saj, por që nuk është "fair". Slovakia dhe Rumania, dy vende anëtare të BE, kanë njoftuar kalimin në sistemin progresiv në fillim të vitit 2013.

Në *Shqipëri* tatimet dhe taksat zenë rreth 92 për qind të ardhurave të buxhetit. Në raport me PBB, peshën më të madhe e ze tatimi mbi vlerën e shtuar me 9.2 për qind, pasuar nga akcizat me 3.1 për qind, tatimi mbi të ardhurat personale me 2.1 për qind, taksat nacionale 1.6 për qind, tatimi mbi fitimin 1.5 për qind etj (2011).

Nga viti 1993 deri më 2007, për 14 vjet, në vendin tone është përdorur *sistemi i tatimit progresiv*, mbi të ardhurat personale, kurse nga 1 janari 2008 ka filluar *sistemi përpjestimor*, ("taksa e sheshtë") ku të ardhurat personale dhe fitimi tatohen me 10 për qind.

Të ardhurat nga "taksa e sheshtë" kundrejt të ardhurave gjithsej të buxhetit kanë pasur një ecuri me zigzake me prirje rënie në fund të kësaj periudhe: 14.3 për qind më 2007, 14.6 për qind më 2008, 14.7 për qind më 2009 (niveli më i lartë i këtyre viteve), 13.7 për qind më 2010, 14.4 për qind më 2011, për të rënë në 13.1 për qind më 2012 e 2013.

Sistemi i tatimit progresiv ka qënë me 5 shkallë apo grupime të ardhurave të tatueshme të individëve në formën e pagave apo shpërblimeve të ndryshme, me shuma në rritje nga njëri grup në tjetrin, me tarifa tatimi në lekë dhe në përqindje. Tatimi mbi të ardhurat për grupin e parë ishte 1 për qind, për grupin e dytë 3.6 për qind, për grupin e tretë 7.1 për qind, për grupin e katërt 5.6 për qind dhe për grupin e pestë 13.2 për qind, kundrejt tarifës prej 10 për qind të sistemit të sotëm të tatimit përpjestimor.

Krahasimi midis këtyre tarifave nxjerr në pah faktin se tatimi përpjestimor godet grupet me të ardhura të ulëta dhe të mesme dhe favorizon ato me të ardhura të larta.

Tatimi mbi fitimin nga 20 për qind në sistemin progresiv u bë 10 për qind me “taksën e sheshtë”, për të tërhequr investime të huaja direkte, për të nxitur shtimin e biznesve dhe fitimet e tyre, për të rritur të ardhurat në buxhet. Por në fakt të ardhurat nga tatimi mbi fitimin kundrejt “taksës së sheshtë” gjithsej, nga 58.7 për qind më 2007 ranë në 42.5 për qind më 2008 dhe në 37.7 për qind më 2012.

Kjo prirje tregon “taksa e sheshtë” në tërësi nuk ka dhënë ndonjë efekt pozitiv në rritjen e të ardhurave, krahasuar me tatimin progresiv, ndonëse pagat e punës si dhe numri i bizneseve, bazuar në pohimet zyrtare, kanë ardhur në rritje në pesë vjetët e fundit. Veç kësaj, rritja e masës të tatimit mbi të ardhurat personale dhe ulja në të njëjtën kohë e tatimit të fitimit e ka rënduar barrën e taksimit në shtresat me të ardhura të ulëta dhe të mesme pasi “taksa e sheshtë” merr edhe nga paga prej 30 mijë lekë në muaj, që përbën “minimumin jetik” për jetesën modeste të dy personave.

Duke mbajtur parasysh sa më lart, strukturat qeveritare duhet të analizojnë me kujdes dhe në një këndvështrim ekonomik e social efektet e përdorimit të tatimit përpjestimor prej vitit 2008 dhe të bëjnë korrigjimet e nevojshme.

Fillimisht mendoj se duhet marrë në shqyrtim propozimi i FMN për të rritur “taksën e sheshtë” nga 10 për qind që është tani në 12-15 për qind. Rritja 2 deri 5 për qind e saj do të rriste të ardhurat në buxhet me 9.5 deri 23.8 miliard lekë. Tatimi mbi fitimin dhe tatimit mbi të ardhurat personale që janë në shuma mbi mesataren e tabelës së pagave në sektorin publik mund të ishin më të lartë se të ardhurat e ulëta dhe të mesme.

Pas këtij procesi emergjent (1-2 vjet), del e nevojshme të kalohet në zgjedhjen e një sistemi progresiv sipas përvojës të provuar prej mëse një shekulli në Europë e më gjerë. Zgjedhja e një varianti sa më eficient kërkon zbatimin e parimeve dhe funksioneve kryesore të tatimit që sistemi të jetë sa më i drejtë dhe të sjellë rritjen e të ardhurave në buxhet, për sigurimin e shpenzimeve për të gjithë sektorët publikë dhe për të hapur perspektiva punësimi përmes investimeve në infrastrukture. Në këtë rast, duke mbajtur parasysh edhe parimin e thjeshtësisë, mund të përdoret një sistem tatimi progresiv me sa më pak shkallë tarifore.

Bibliografia

1. Atkinson, A B .Growth, taxation and the long-run evolution of top incomes. *Nuffield College, OXFORD*. Pavia, Università, 7 - 8 ottobre 2004.
2. Arrupe, J. Economic ideas and tax policy: The introduction of progressivity in tax. Systems in Western Europe. The cases of France and Spain. *Facultat d'Economia i Empresa.Universitat de Barcelona*.2012
3. Bundo, Sh.Financë. AlbPAPER Tiranë, 2004.
4. Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.Tiranë, 2009.
5. Hadler, S; Moloj, Ch; W, Sally. Flat or Flattened? A Review of International Trends in Tax Simplification and Reform. (Development Alternatives, Inc).Analizë e kryer në qershor 2006 për USAID. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADH107.pdf.
6. Hilmia, S; Angjeli, A. Financat Publike. Tiranë, korrik 1994.
7. Hilmia, S; Luçi, E. Fjalor Enciklopedik Shqiptar.Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2009.
8. Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
9. Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar".
10. Ligj nr.9766, datë 9.7.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar'".
11. Portali <http://www.taxrates.cc/index.html> - guidë për taksat si dhe për tregues të tjerë ekonomikë dhe financiarë në shkallë globale.
12. Publikime të INSTAT-it.
13. Publikime të Ministrisë të Financave.
14. Rosen S.Harvey. Financa Publike.Botimi i 6-të. 2002. Albin, Tiranë, 2003.
15. Scheve, K. Yale University. Stasavage, D. New York University. The Conscripton of Wealth: Mass Warfare and the Demand for Progressive Taxation.July 2009.
16. Smith, Adam. Pasuria e Kombeve, 1776. (An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations). The Pennsylvania State University, Electronic Classics Series, Jim Manis, Faculty Editor (2005).
17. Steinmo, Sven.The evolution of policy ideas: tax policy in the 20th century. *British Journal of Politics and International Relations*, Vol. 5, No. 2, May 2003, pp. 206-236.
18. Walton, Tom.The Heartland Institute.Adam Smith on Taxes.Nov.1, 2003.

THE IMPACT OF GLOBAL RECESSION ON INTERNATIONAL TRADE

Biljana Ciglovska

International University of Struga
b.ciglovska@eust.edu.mk

Ramis Merko

International University of Struga
r.merko@eust.edu.mk

ABSTRACT

During 2008 and 2009 the unfavorable economic conditions and new world financial crises, give a new feature on the international trade and relations between countries which participate in it. Year 2009 is the year in which, for the first time after 25 years of continuous growth of international trade is seen the collapse and fall of the same one. It is believed that the reasons for this collapse are the simultaneous reduction in aggregate demand across all major world economies, the widespread use of international supply chains and drying up of trade finance. Immediate consequences of trade contraction are increasing protectionist's forces, which are supposed to become strengthen as the recession is getting worst. This paper suggests what should be done in order to surpass the adverse effects of the recession through utilization of international trade as a recovery and growth engine. International trade can play a major role in promotion of the economic development because the trade is a stimulus itself. Trade is the mechanism through which growth and prosperity are transmitted between countries. Maintaining open trade and investment is one of the most important economic challenges the world face with. Engagement in the global economy through increased trade has contributed in raising the average of world living standards.

Keywords: global recession, international trade, WTO, protectionism.

1. The trade response on the global recession

Although trade liberalization and increasing openness to trade flows and investment have been fundamental for the economic growth and prosperity, they are now under increasing challenge. What started in the financial sector has moved into the real economy, forcing company closures and significant job losses. No country is immune from the fallout. International trade is one of most important arenas in which we must combat the real effects of this crisis. Trade is itself a stimulus.

Preserving open trade flows must be a central part of the policy response to the economic crisis. If it is not, countries will be losing a significant opportunity to reinforce other expansionary fiscal and monetary policy measures taken by governments. Trade is the mechanism through which growth and prosperity are transmitted between countries. Every day billions of dollars of goods and services are bought and sold around the world, giving consumers access to new products and generating wealth and prosperity for the people and businesses that make them. According to OECD analysis, a 10% increase in trade is associated with a 4% rise in per capita income.

Unfortunately, however, the crisis we now face has thrown this process into reverse. World trade flows are falling, forcing businesses to close and threatening to drive millions into poverty. One thing is clear: protectionism is not the answer. In the long run it protects nothing, but erodes competitiveness, growth, employment and real incomes. Such trade-restrictive actions taken by one country can trigger similar actions by other countries, creating the possibility that protectionist trade policies will spread across the world.

For example, The United States Government instituted the Recovery and Reinvestment Act of 2009 in February 2009, which included a “buy American” clause to encourage the purchase of domestic products. As an answer of this provision, “buy Indonesian” and “buy Victorian” campaigns started (the latter in the Australian state of Victoria). European countries such as Germany, France, and the United Kingdom have successively announced bail-out measures for their automotive industries, and Argentina, India and Indonesia have introduced new import licensing systems. Ecuador, Russia

and Ukraine have raised tariffs on a wide range of imported products, including automobiles, electrical goods, iron and steel, and machinery, as shown in the Table 1. In October 2008, in response to a potential surge of trade-restrictive measures worldwide, the WTO established a task force to monitor the introduction of new trade-related measures⁴⁸

With regard to specific sectors, tariffs on iron and steel products were raised by a large number of countries. For instance, India increased its tariff on certain iron and steel products from zero to 5 % in November 2008. In January 2009, Turkey increased its tariff on hot flat-rolled steel from 5 % to 13 %, and on cold flat-rolled steel from 6 % to 14 %. In June 2009, Brazil increased tariffs on seven iron and steel products, including hot- and cold-rolled steel sheets, from zero to a maximum of 14 %⁴⁹.

Se pari: kontabilistët janë ne grupin dhe frontin e parë të verifikimit të librave të llogarive për të siguruar që transaksionet janë të vlefshme, dhe të regjistruara në përputhje me standardet e vendosura.

Se dyti: si profesionistë ato kane detyrimin e mbrojtjes se interesit publik, nga që ata janë të lidhur rigorozisht me kodet e etikës profesionale e personale, duke bërë thirrje për nivelet më të larta të integritetit dhe objektivitetit

Se treti: pozitat e tyre kyçe e strategjike në kuadër të një ndërmarrje ose organizate, pavarësisht nëse është si auditor i brendshëm ose i jashtëm, apo si këshilltar do të thotë se ata shumë shpesh kanë qasje në informata shumë të privileguara dhe konfidenciale.⁶⁷

Të dy këto shërbime, Kontabilistët dhe Auditët kryejnë funksionet e tyre përkatëse në bazë të praktikës së standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, që janë udhëzime të qarta në identifikimin, për shembull, të treguesve (indikatoreve) të mashtrimit dhe parregullsive të tjera si dhe të raportimit të këtyre në nivelet më të larta të pushtetit.

Atë se çfarë duhet të bëjë kontabilisti kur përballet me korrupsionin e kanë përcaktuar e mbuluar udhëzimet profesionale të IFAC-ut. Ai kërkon që të vepohet me vendosmëri në interes të publikut. Perceptimi i disa kontabilistëve është se ata nuk kanë se ç' bëjnë ndaj nuk bëjnë sa duhet për të luftuar korrupsionin. Për kundër kësaj keqperceptimi, kontabilistët nuk duhet të bëjnë kurrë kompromis me vlerat e tyre.

Nga ana tjetër, roli i ekspertëve kontabël është më tepër efikas në promovimin e transparencës, drejtësisë dhe të funksionit mbikëqyrës brenda organizatave të cilat auditohen.

Qartësisht asnjë prej dy grupeve të lartpërmendura nuk specializohet në funksionet anti-korrupsion dhe në përgjithësi nuk janë të ngarkuar shprehimisht me zbulimin ose hetimin e aktivitetit të korruptuar. Sidoqoftë ata kanë ekspertizë unike në auditimin dhe raportimin e fakteve dhe në përputhje me standardin për integritetin ata janë të detyruar të raportojnë aktet ilegale në asamblenë e aksionerëve ose bordin e kompanisë. Ata kanë autoritetet hetues të zgjeruar brenda subjektit të audituar për të mbledhur provat të cilat ndikojnë veprimtari korruptive apo të paligjshme.

Eshtë e rëndësishme të kuptohet se roli anti-korrupsion i kontabilistëve dhe ekspertëve kontabël nuk kufizohet brenda "mureve" të organizatës të biznesit

67 Frank Harding: "Corruption: Rising to the Challenge", IFAC, maj 1999

privat e cila auditohet apo këshillohet prej tyre. Ndonese përgjegjësia kryesore për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit mbetet tek autoritetet qeveritare si policia, prokuroria dhe institucione të tjera hetimore te cilat jane te veshura me pushtet per të hetuar korrupsionin; kontabilistet dhe ekspertët kontabël mund të kontribuojnë me përpjekjet e tyre në këtë luftë të vazhdueshme

Në pergjithesi mund te thuhet se roli dhe përgjegjesite e kontabilisteve dhe eksperteve kontabel kane të bëjne më shumë me parandalimin e korrupsionit se sa me zbulimin e fakteve qe ndikojne kryerjen e tij. Sidomos puna e ekspertit kontabel i cili gjate auditimit bën vlerësimin e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm eshte shume efikase sa i takon parandalimit. "Audituesi duhet të arrijë të njohë në mënyrë të mjaftueshme sistemet kontabël dhe të kontrollit të brendshëmAi duhet të përdorë gjykimin profesional për të vlerësuar rrezikun..."⁶⁸

Pavarësisht nga sa me siper, ne te gjitha ato raste kur ekspertët apo kontabilistët gjatë ekzaminimeve të tyre hasin ne shenja të veprimeve ata janë ligjërisht dhe moralisht te detyruar të venë në dispozicion të agjensive të zbatimit te ligjit (polici, prokurori, një komision hetimor parlamentar etj) qe merren me hetimin e korrupsionit, gjetjet dhe ekstraktet e raporteve të tyre për te mundësuar një hetim të mëtejshëm.

Pasi kemi evidentuar potencialin dhe rolin e përgjegjesite konkrete te kontabilisteve dhe eksperteve kontabël ne luftën kundër korrupsionit, vlen të theksohet fakti se ata përballen me një presion të konsiderueshëm nga punëdhënësit apo kontraktorët që të angazhohen në transaksione të dyshimta financiare dhe të kontabilitetit, si dhe të paraqesin raportet përkatëse të "pastra" nga këto transaksione.

Në këtë kontekst, duhet kujtuar se kontabilistët apo ekspertët mund të ndodhen nën përgjegjësi penale për deklaratimet e rreme në se pranojnë ti bëjnë ato. Nga ana tjetër ata duhet te kryejnë detyrën e tyre nën pushtetin e standardeve profesionale dhe parimeve të tjera etike. Zgjedhja midis këtyre alternativave varet nga integriteti moral dhe profesional i eksperteve dhe i kontabilistëve. Problemet dhe sfidat me të cilat përballen kontabilistet dhe ekspertet kontabel kërkojnë jo vetëm aftësi të lartë teknike, por edhe besimin e fortë për të kundërshtuar metodat e vjetra në të cilat kanë rrënjosur praktikat korruptive të kontabilitetit, të tilla si fshehja e te ardhurave, mbivendosja e shpenzimeve dhe manipulimi i destinacionit te tyre duke punuar me dy grupe të ndryshme të pasqyrave financiare (një për autoritetet tatimore dhe një për pronarët, të ashtuquajturat bilance te brendshme), të cilat synojnë të

68 Standartet ndërkombëtare te auditimit IFAC Handbook 1999 faqe 92 botimi shqip

shmangen nga taksat që rezulton në nivele të larta të ekonomive hije.⁶⁹ Mjafton te permendim se nga studimet e bera, ne 9 ndermarrje nga 10 , për afro 40'000 ndermarrje, qe janë ndermarrje të Vogla e të Mesme (SME), informacioni financiar i dhënë prej tyre nuk konsiderohet si i besueshëm⁷⁰

Roli i Kontrollit te Larte te Shtetit

Ketu do te trajtojme çështjet e mashtrimit dhe korrupsionit dhe përballjen Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) me to , duke ofruar disa ide për përmirësimin e performancës së KLSH-se në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit. Eksperienat boterore kane provuar se tashmë disa prej këtyre strategjive, janë testuar me sukses të konsiderueshëm. Keto ide kane per qellim qe te ndikojne zyrtarët e qeverisë dhe ligjvënësit në fjalë në lidhje me qeverisjen e mirë, përgjegjshmërine, transparencën dhe ndershmërine, veçanërisht aty ku mashtrimi dhe korrupsioni janë ngulitur edhe në kulturën lokale.

Mashtrimi dhe korrupsioni kane efekte shkatërruese, sidomos për qytetarët dhe vendet më të varfra dhe ato në zhvillim. Korrupsioni nuk ka kufij dhe është përhapur në mbarë botën, edhe në vendet që konsideroheshin si te “te pastra”. Korrupsioni infekton të gjitha format e qeverisjes. Ai gërryen besimin publik në institucionet politike dhe të çon në përbuzje për sundimin e ligjit, ai shtrembëron alokimin e burimeve dhe minon konkurrencën në treg, dhe ka një efekt shkatërrues mbi rritjen e investimeve dhe zhvillimin ne teresi .

Por procesi i korrupsionit është aq i padukshëm sa që lë pak prova të dokumentuara. Përkundër njohjes së faktit se korrupsioni është i përhapur në sektoret qeveritare, institucionet supreme te auditimit nuk kane nuk kane qene ne lartesine e ndonjë roli efektiv për të parandaluar atë. Ne kete aspekt ka luajtuar nje rol demoralizues per auditet edhe kultura e pandeshkueshmerise nga organet e zbatimit te ligjit, të cilët nganjehere besojnë se është e kotë për të zbuluar korrupsionin në një shoqëri ku niveli i ndeshkueshmerise eshte i dobet. Nga ana tjetër, stafet e auditimit shpesh kane per tendencë të marrë një qasje klerikale, duke kërkuar respektimin e rreptë te procedurave, ndërkohe qe shpesh keto procedura mungojne ose nuk jane te tilla qe mbrojne

69 Shkurti (Perri) Rezarta ,Leka (Gjoni) Brikena “Development of the accounting profession in Albania in the new era of market economy” Tirane 2011.

70 http://www.swiss-cooperation.admin.ch/albania/al/Home/Programs_and_Projects/Economic_Development/Corporate_Financial_Reporting_Enhancement_Project_CFREP

enitetin nga abuzimet dhe keqmenaxhimet. Ndonjehere auditet fokusohen ne shmangie të vogla te ligjit nderkohe kur ka keqpërdorimet e fondeve janë të theksuara, duke sjelle humbje të mëdha në burimet publike të cilat kalojne pa u identifikuar. Dhe duke vazhduar me tej, perkundrejt deklarimeve publike, nuk ka një dëshirë te dukshme te ligjvënësve për të marrë iniciativën per te kontrolluar rryshfetin , mashtrimin dhe korrupsionin.

Perkunder kesaj klime Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk duhet të qendroje indiferent ndaj vështirësive të veçanta me të cilat përballen ligjvënësit në kuadër të perpjekjeve per te luftuar mashtrimin e korrupsionin edhe ne se mjedisi ku ata operojne eshte i kontaminuar Në vitet e fundit eshte arritur në përfundimin se forcimi i kapaciteteve të auditimit është një strategji efektive për të mbështetur përmirësimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë ne qeverisje. Qeverisja e mirë është një antidot i fortë ndaj korrupsionit dhe mashtrimit.

Mashtrimi ne sektorin publik dhe korrupsioni lulëzojnë, kur përgjegjëshmeria dhe transparenca mungojnë. Raportimi i mirë financiar dhe auditimi ndihmojë në uljen dhe fshehjen e operacioneve mashtruese. Auditimi ofron siguri te arsyeshme se pasqyrat financiare të audituara mund jane te besueshme dhe se ato përfaqësojne besnikerisht aktivitetet ekonomike.

Ka një hendek në mes të pritjeve të palëve të interesuara dhe mandatit te auditimit për KLSH-ne. Tradicionalisht, institucionet supreme te auditimit kanë rënë dakord që përgjegjësia primare për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit qëndron te autoritetet administrative, të tilla si menaxheret, policia apo agjencitë antikorrupsion. KLSH-te nuk e kanë parë mashtrimin dhe korrupsionint si qëllimin e tyre kryesor; qasja ka qenë me teper për të parandaluar korrupsionin sesa zbulimin e aktiviteve të paligjshme. Nga ana tjetër publiku beson me shume ne rolin antikorrupsion te KLSH-se. Ky boshllëk duhet të terheqe vemendjen e auditimit, i cili duhet të veje me shume se deri tani theksin, në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit duke ngushtuar hendekun e pritshmerive. Ai duhet të vazhdojnë të luajnë një rol aktiv në ngritjen e vetëdijes për rrezikun e mashtrimit dhe korrupsionit dhe forcimin e qeverisjes së mirë si dhe zbatimit te standardeve te sjelljes, por njeherit ata duhet të shkojë më tej dhe të përqëndrohen më shumë në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit.

Nje qasje e tille do te lehtësoje edhe punen per te parandaluar mashtrimet dhe korrupsionin sesa për të zbuluar atë. Funkcioni kryesor i KLSH eshte konsideruar nxitja e një mjedisi parandaluese kundër mashtrimit dhe korrupsionit, duke përfshirë forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar,

vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e dobësive. Por sot krimi i “jakave të bardha” është rritur dhe përhapur, duke përfshirë edhe raportimet mashtruese financiare dhe keqpërdorimin e skemave të aseteve. Grupet terroriste dhe kriminalitetit i organizuar shpesh mbështeten në skemat e pastrimit të parave për të financuar dhe të maskuar aktivitetet e tyre. Kjo e bën imperative nevojën që auditet të marrin në konsideratë zhvendosjen e theksit të auditimit dhe të teknikave të auditimit të projektuara në një mënyrë të tillë që të mundësojnë zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe parandalimin e kësaj murtaje në shoqërinë moderne. Por trajtimet e mesiperme nuk nënkuptojnë që KLSH të shkojnë aq larg sa të merrte përsipër rolin e agjencive antikorrupsion. Në kuadër të punës së tyre të auditimit, megjithatë, ata duhet të jenë më vigjilentë dhe të aftë për zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit. Por një pengesë serioze ku thyhen të gjitha perpjekjet antikorrupsion të të gjitha strukturave dhe deshton suksesi i çdo strategjie kundër korrupsionit është një gjyqësori i korruptuar.

Jane keto arsye që Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) i ka kushtuar një vëmendje të vecantë rolit të institucioneve supreme të auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit dhe për këtë qëllim është mbajtur në Durban të Afrikës Jugut „kongresi i XVI nga data 10-15 tetor 1999 me temë: SAI parandalimi dhe zbulimi i mashtrimit dhe korrupsionit” duke u fokusuar kryesisht në;

☞ Rolin dhe përvojat e ISA në parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit dhe

☞ Metodatat dhe teknikat për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit.

INCOSAI (Kongresi nderkombetar i SAI) ka rënë dakord se korrupsioni në burimet publike, redukton rritjen ekonomike dhe cilësinë e jetës, minon kredibilitetin e institucioneve shtetërore, dhe zvogëlon efektivitetin e tyre. Ai vuri në dukje korrelacionin e fortë midis korrupsionit dhe dobësimin e institucioneve të shtetit. Aty u evidentua fakti se korrupsioni është i lidhur shpesh me mjedisin socio-ekonomik të popullsisë (sociale, padrejtësia varfëria, dhuna) dhe se traditat e një vendi, parimet dhe vlerat ndikojnë në natyrën e korrupsionit.

Në këtë kongres u ra dakord gjithashtu se, kur është e mundur, SAI-t midis të tjerash duhet:

- Te kërkojnë një nivel adekuat të pavarësisë financiare dhe operative dhe të gjerësisë së mbulimit të auditimit;

- Të marrë një rol më aktiv në vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe në mënyrë agresive të ndjekin rekomandimet e tyre;
- Auditimi të përqëndrohet më shumë në zonat strategjike dhe operacione të prirura për mashtrim dhe korrupsion me zhvillimin e indikatorëve efektive me rrezik të lartë për mashtrim;
- Të krijojë mjete efektive për përhapjen publike të raporteve të auditimit dhe informatave relevante, duke përfshirë krijimin e një marrëdhënie të mire me mediat;
- Te konsiderojnë një bashkëpunim më të ngushtë dhe shkëmbim të përshtatshëm të informacionit me organet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit;
- Te intensifikojnë shkëmbimin e përvojave në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit me SAI-t homologe.
- Te nxisin krijimin e procedurave të menaxhimit të personelit për shërbimin publik në zgjedhjen, mbajtjen, dhe motivimin e punonjesve të ndershëm dhe kompetent;
- Te nxisin krijimin e udhëzimeve për zbulimet financiare nga nëpunësit publikë, dhe monitorojnë pajtueshmërinë si pjesë e procesit të auditimit në vazhdim;

☞ Te konsiderojnë krijimin e një marrëdhënie të mire me publikun si mjet për të marrë dhe dhe përpunuar informacion nga publiku për parregullsitë e perceptuara dhe

Ndërsa këto rekomandime kanë qenë të përshtatshme në vitin 1999, tashme është bërë e qartë se më shumë përpjekje duhet të bëhen për të zbuluar mashtrimin dhe korrupsionin në kohën e sotme kur permasat e tij janë shtuar dukshëm dhe se SAI-t duhet të pozicionohen me mirë për të bërë këtë nepermjet persosjes së mekanizmave për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit vecanerisht në forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe vendosjen e një menaxhimi financiar të shëndoshe

Një drejtim tjetër ku kontributi i KLSH-se kerkohet është të ndikojë dhe të nxitet politikave qeveritare antikorrupsion. Ekspozimi ndaj mashtrimit dhe korrupsionit mund të zbutet nëse qeveria ka politikë efektive antikorrupsion. KLSH mund të kontrollojë dhe vlerësojë zbatimin e këtyre politikave dhe të japë rekomandime për zbatimin e tyre të metejshëm ose përmirësimin e politikave.

KLSH nepermjet auditimit të veprimtarisë së qeverisë mund dhe duhet të provoje pajtueshmërinë e veprimtarisë së zyrtareve me politikave të tilla si këto për të përcaktuar nëse qeveria ka mundur një politikë efektive

Antikorrupsion.

Mashtrimi zakonisht është i vështirë për t'u zbuluar, për shkak të ekzistencës së marrëveshjes së fshehtë dhe për faktin se transaksionet korruptive nuk regjistrohen. Kontrollat e brendshme të mirë-projektuara, ndihmojnë në parandalimin e mashtrimit. Mbeshtetja dhe inkurajimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik është një drejtim tjetër ku puna e KLSH-së duhet të fokusohet në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe të korrupsionit.

Fakt është se auditimi i brendshëm nuk është i zhvilluar në ato nivele për të luajtur kështu rolin e rëndësishëm që ajo duhet të ketë për të ndihmuar menaxherët qeveritare të menaxhojnë më mirë veprimtaritë për të përmirësuar sistemet e përgjegjshmërisë. Kështu jo shpesh KLSH-ja mbështetet në punën e auditorëve të brendshëm të qeverisë, për shkak të nivelit të besueshmërisë së punës së tyre dhe standarteve profesionale që aplikojnë.

Por KLSH-ja duhet të nxisin zhvillimin e auditimit të brendshëm në qeveri duke ndarë kapacitetet e tyre të trajnimit me komunitetin e auditimit të brendshëm. KLSH mund të bëhet lideri intelektual për auditet e brendshëm, edhe pse ata raportojnë drejtpërdrejt departamenteve qeveritare. KLSH zakonisht kanë metodologji të auditimit më të mira se auditet e brendshëm, e cili mund të ndahet me komunitetin e auditimit të brendshëm dhe përfitimet do të jenë reciproke dhe në interes publik.


Audituesit gjatë tërë punës së tyre duhet të jetë të kujdesshëm për të identifikuar shenjat paralajmëruese që i korrespondojnë çdo faze të proceseve të hetimit, të cilat lenë shteg për veprime korruptive. Këto shenja paralajmëruese duhen konsideruar si faktor rrisht dhe si "**red flags flamuj të kuq (red flags)**" për procesin e hetimit, në evidentimin e rasteve korruptive.

Me poshtë në mënyrë grafike janë fazat e auditimit të mashtrimit dhe korrupsionit:

Perfundime:

1. Pavaresisht nga lloji i auditimit, i brendshëm apo i jashtëm, publik apo privat; pavaresisht nga tipet e auditimit (financiar, pajtueshmërie apo

ZBULIMI I MASHTRIMIT DHE KORRUPSIONIT NE NJE PROCES AUDITIMI NORMAL



performance) qe nje audit eshte duke u kryer; skpeticizmi profesional dhe gjykimi i shendoshe jane parime baze mbi te cilat duhet te mbeshtetet audituesi per ekzaminimin e veprimtarise se subjektit dhe formulimin e opinioneve te auditit.

2. Sherbimet e auditimit te te gjitha llojeve duhet te permiresojne metodologjite per parandalimin dhe hetimin e mashtrimit dhe te korrupsionit.

3. Shteti duhet te ngreje mekanizma per mbikqyrjen e sherbimeve financiare dhe te auditimit perfshi edhe sektorin privat.

4. Qeveria duhet të ndermarre veprime konkrete për të siguruar transparencën e shërbimeve financiare.

5. Kërkohet të sanksionohet përgjegjësia e menaxhereve për zbatimin e rekomandimeve të auditimit

Bibliografia

1. Leter Politikat për Kontrollin e Brendshëm Financiar publik, Tiranë 2005
2. Guidelines for investigations; Florida Department of Education Office of Professional Practices Services 325 West Gaines Street, Suite 224 E Tallahassee, Florida 32399-0400.
3. Inspections and Investigations, Arizona departament, Juvenile corrections. Administrative Investigations. Arizona 2007.
4. Sharon Hansoon Cooper, Grant Wilson, Gjon Ndreja. "Kontrolli i brendshëm, Guide për menaxheret", Botim i USAID-it Tiranë Shtator 2009.
5. J. Edgardo Campos, Sanjay Pradhan: "The many faces of corruption" World Bank 2007
6. INTOSAI: The auditor's responsibilities relating to fraud in an audit of financial statements (ISSAI Nr.1240)
7. The role of Supreme Audit Institutions (SAIs) in Combating Corruption. Prepared by, Mr Magnus Borge Director General, INTOSAI Development Initiative (IDI), Norway
8. IFAC: The auditor's responsibility to consider fraud in an audit of financial statements (ISA 240)
9. By Kenneth M Dye: Corruption and Fraud Detection by Supreme Audit Institutions.
10. By David S Murphy: The SAI and Anti-Corruption Initiatives
11. "Internal auditing and fraud. Practical guide" published by IIA . December 2009
12. Ethics Code of Accountants. Published by IFACs
13. Tommie V. Singleton, Aaron J Singleton: "Fraud auditing and forensic accounting", Fourth edition, New Jersey, 2010
14. Gjon Ndreja, "Hetimi administrativ i veprave penale të korrupsionit" Botim i USAID-it, 2010
15. Standardet e Auditimit të brendshëm & kuadri i praktikave profesionale, botimi shqip, Tiranë, 2005.
16. European Commission - Albania 2012, Progress report

EFEKTI I POLITIKAVE MONETARE NË EKONOMI PËRGJATE RECESIONIT GLOBAL 2008-2011

Alqi Naqellari

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
a.naqellari@eust.edu.mk

Terida Mëhilli

Universiteti Ismail Qemali, Vlorë

ABSTRACT

Albanian economy in 2008 has seen the highest rate of economic growth, not only that but almost all macroeconomic indicators were satisfactory levels. Only the public debt had negative indicator.. This trend continued for the next years. From the second half of 2008 and following the Albanian economy is facing recession and the global financial crisis. Central Bank monetary policies tend to mitigate the negative impact of external pressure on the economy. Central Bank has had as its main objective of keeping inflation at 3 percent, with the interoval fluctuation + / - 1 percentage point around this central value. From the analysis we have made in the paper we concluded that its moderated policies the Central Bank did not have any impact on deposit interest rate and therefore loans. There is no impact on the rate of inflation. The link between the inflation rate and the interest rate is very poor, and generally in the same direction. From the analysis it is clear that the Central Bank can not control the rate of inflation which, mostly depends on the imported inflation rate.

Keywords: economic recession, Central Bank, Albanian economy

Hyrje

Në këtë material kemi analizuar qëndrimin e Bankës Qendrore ndaj inflacionit, disa nga objektivat që ka pasë Banka Qendrore e Shqipërisë për vitet 2008-2011 dhe shkallën e realizimit të tyre. Kemi analizuar instrumentet që ajo ka përdorur duke parë nga afër efektin e tyre, kjo e lidhur me kushtet e jashtme ndikuese në ecurinë e ekonomisë shqiptare. Arsyeja që e kemi ndërmarrë këtë analizë është të shikojmë se çfarë politikash ka zbatuar Banka Qendrore, në mbështetje të Politikave Fiskale të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare përballë Krizës financiare dhe recesionit global. Më tej të shikojmë efektivitetin e këtyre politikave në kuadër të treguesve kryesorë makroekonomikë. Do synojmë tju japim përgjigje pyetjeve: A ka pasë ndikim në realizimin e tyre, a i ka mbështetur ajo me politikat e saj monetare politikat fiskale të qeverisë? A ka ndikuar ajo në normat e depozitave dhe për pasojë edhe të kredive të cilat janë të lidhura në mënyrtë direkte me rritjen ekonomike? A ka pasë ndikim në kurset e këmbimit të lekut shqiptar me monedhat e tjera që qarkullojnë në tregun valutor shqiptar, etj?

Analizat që kemi realizuar në këtë material janë të shoqëruara me një sërë pasqyrash dhe grafikësh që përmbajnë tendencat, dinamikat dhe lidhjet e varjableve të analizuara. Këto e bëjnë studimin më të besueshëm dhe më të kuptueshëm për këdo që lexon materialin. Me këtë analizë nuk pretendojmë se kemi shterur problemin e shtruar por kemi dhënë mendimet tona të argumentuara se politikat e BQ duhet të ndryshojnë në një sërë drejtimesh.

Në material do jepen edhe konsiderata mbi strukturën e sotme të sistemit bankar i cili kaloi nga një sistem i njëanshëm, vetëm me banka me kapital tërësisht shtetëror në një sistem oligopol me një bankë drejtuese tërësisht me kapital privat. Në fund do të japim konkluzionet dhe do të bëjmë rekomandimet përkatëse.

1. Qëndrimi i Bankës Qendrore ndaj inflacionit

Banka e Shqipërisë ka pasur dhe ka si objektiv të saj të tashëm dhe të ardhshëm “arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve”. Sa u përket objektivave të tjerë kryesore makroekonomike si rritja e PBB dhe rënja e normës së papunësisë deri në nivelin e saj natyror ajo nuk ka pasë asnjë

objektiv konkret, për pasojë këto kanë mbetur objektiva të Qeverisë Shqiptare. Arsyeja pse kjo bankë nuk ka objektiva të tillë është se ajo ka marrë në mënyrë shabllone objektivin e Bankës Qendrore Europiane. Ky është një gabim që ajo ka bërë sepse ekonomia shqiptare nuk ngjason me asnjë nga ekonomitë e Europës Perëndimore. Këto ekonomi përgjithësisht veprojnë në produkt potencial, gjë që do të thotë se kanë përdorim të plotë të faktorëve ekonomikë dhe nuk kanë problem papunësinë dhe rritjen ekonomike. Problem për to në këto kushte është vetëm norma e inflacionit. Sa i përket sistemit financiar ato mbështeten kryesisht në Bursa dhe në sistemin bankar në një kohë që sistemi financiar shqiptar mbështetet vetëm në sistemin bankar. Dhe më tej në Shqipëri nuk ka asnjë Bankë Tregëtare të nivelit të dytë të jetë plotësisht me kapital shtetëror.

Ndryshe qëndron problemi për ekonominë shqiptare ku niveli i papunësisë i deklaruar është 13.28%. Në Shqipëri nuk është problem real kryesor arritja dhe ruajtja e nivelit të çmimeve por është rritja e PBB me ritme të larta dhe rënja e normës së papunësisë. Ekonomi, si ekonomia shqiptare nuk mund të zhvillohen pa rritje të normës së inflacionit. Të sigurosh rritje ekonomike në kushtet shqiptare duke pas objektiv frenimin e inflacionit ky është një absurditet. Frenimi i inflacionit më tej çon edhe në rritjen e normës së papunësisë dhe jo në rënjen e saj. Inflacion në kushtet shqiptare do thotë rritje ekonomike.

Banka e Shqipërisë sipas saj kontrollon normën e inflacionit, në fakt ne e kemi provuar në këtë analizë, pa e shterur problemin se ajo për kushtet specifike të ekonomisë shqiptare nuk e kontrollon dotë atë, ajo thjesht është një ndikues pa peshë sepse inflacioni në përgjithësi përcaktohet nga inflacioni i importuar dhe faktorë të tjerë subjektivë.

Cilat janë disa nga faktorët kryesorë që ndikojnë në inflacionin e ekonomisë shqiptare dhe kush ndikon mbi to?

1. Ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël e hapur ku normat e interesit të aplikuara prej saj varen nga normat e interesit të botës, ku të ardhurat nuk përputhen me shpenzimet. Politika monetare e saj është e varur nga politikat monetare të Bankave Qendrore të vendeve të tjera me ekonomi të madhe të hapur.

2. Prodhimet bujqësore nuk sigurojnë as nevojat e popullsisë fshatare. Vetëm rreth 30% e fermerëve shqiptarë dalin në treg. Shkalla e mekanizimit është shumë e ulët në raport me vendet me të cilat kemi marrëdhënie tregëtare. Prodhimi shqiptar për shumë arsye nuk ka fuqi konkurrese në treg.

3. Raporti eksport-import është $\frac{1}{4}$ dhe pjesa më e madhe e mallrave të shportës në bazë të së cilës llogaritet Indeksi i Çmimeve të konsumit (IÇK)

importohen. Pra çmimet e tyre përcaktohen jashtë kufirit shqiptar dhe ju imponohen pjesës tjetër të prodhuar në vend.

4. Kurset e këmbimit të lekut në Shqipëri janë fleksibile, pavarësisht se Banka Qëndrore herë pas here ndërhyt në treg duke blerë ose duke shitur valutë. Ato ndikojnë dukshëm në nivelin e çmimeve në vend dhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

5. Prurjet kryesore të valutës në ekonominë shqiptare nuk janë prej burimeve të eksportit por një pjesë e konsiderueshme e tyre vjen prej mallit fuqi punëtore të eksportuar, domethënë prej refugjatve shqiptarë që punojnë në vende të tjera. Krahas tij kemi edhe prurje nga sektori informal.

6. Në ekonominë shqiptare nuk kemi vetëm struktura tregu të tilla si konkurrencë monopolistike, monopol e oligopol por kemi dypole, karteles dhe marrëveshje të fshehta. Këto veprojnë nën emrin e shoqatave dhe shpesh kanë dalë hapur bile edhe me presione ndaj qeverisë. Sot ato së bashku me faktorët e tjerë përcaktojnë nivelin e çmimeve që sillen në treg.

7. Në tregun shqiptar ka abuzime të shpeshta prej tregtarve si të shumicës ashtu edhe të pakicës, veçanërisht në periudhat e festive siç është rasti i tanishëm në prag të fastave të Nëntorit, Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri.

8. Stabiliteti politik dhe social i vendit dhe i vendeve me të cilat realizojmë marrëdhënie tregtare.

Duke parë faktorët që ndikojnë në normën e inflacionit atëherë më të drejtë shtrojmë pyetjen se cilat janë arsyet kryesore që Banka Qëndrore e Shqipërisë nuk e kontrollon dotë inflacionin?

E para, se në Shqipëri qarkullojnë tre monedha pa kurfarë kufizimi, njësoj si leku shqiptar. Në Shqipëri sot njësoj si leku, që është monedhë zyrtare e Republikës së Shqipërisë, qarkullojnë edhe dy valuta të tjera, euro dhe dollarë. Këto dy valuta zënë pjesën më të madhe të kredive në totalin e përgjithshëm të tyre dhe po i afrohen 50% të depozitave. Nëse sot depozitat në lekë zënë 52% të totalit të depozitave prej tyre në formë kredie shkojnë 60%. Ndërsa nëse 48% të totalit të depozitave e zë valuta mbi 95% e tyre shkojnë për kredi. Duke parë raportet ndaj totalit të depozitave dhe ndaj dhënjes së kredive fare qartë shikohet se leku shqiptar është i mënjanuar në qarkullim. Ai zë peshën më të madhe të depozitave sepse depozitat në lekë kanë normë interesi të lartë dhe peshë të ulët në kredi sepse normat e interesit në euro dhe dollarë janë shumë më të ulta se normat e interesit në lekë. Kështu pjesa e mbetur e lekut në banka jashtë qarkullimit rifutet prej qeverisë në qarkullim nëpërmjet Bonove

të Thesarit. Në këtë mënyrë normat e larta të interesave të kredive në lekë ulin përdorimin e tyre në fushën e biznesit dhe rrisin përdorimin e tyre qeveritar. Këtu ndodh fenomeni i rrudhjes së investimeve private ose “crouding out”.

Banka Qëndrore ndikon pak në normën e interesit të depozitave e për pasojë të kredive në lekë, ndërsa nuk ndikon fare në normën e interesave të euros dhe dollarit. Normat bazë të tyre varen, e dollarit nga Rezerva Federale Amerikane ndërsa e euros nga Banka Qëndrore Europiane. Në këtë rast Banka Qëndrore e Shqipërisë mbetet me një ndikim simbolik në fushën e kredive ku pjesën kryesore e zënë kreditë në valutë. Nëqoftëse Bankave Tregëtare të nivelit të dytë do tu ndalohej të pranonin depozita në valutë dhe të jepnin kredi në valutë dhe ajo të bëhej monopol i Bankës Qëndrore atëherë kjo e fundit do të ndikonte në tregun e kredive dhe të depozitave që do të ishte vetëm në lekë. Në këtë rast efektiviteti i politikave të saj do që shumë më i dukshëm nga sa është sot.

Banka Qëndrore ka mbajtur një qëndrim gati asnjës ndaj situatave të pas 2008 duke parë vetëm treguesin e inflacionit i cili në këto vite ka qënë i ulët në Shqipëri por kjo jo për meritë të Bankës Qëndrore por më së shumti për hir të recesionit global dhe krizës financiare. Ajo ka ulur normën bazë të interesit(REPO) në kuota simbolike pa ndjekur veprimet e Bankës Qëndrore Europiane apo edhe të bankave të tjera qëndrore të vendeve jashtë BE. Një pjesë e këtyre bankave e ulën normën bazë deri në 0.5% në një kohë që Banka Qëndrore e Shqipërisë e uli atë dukshëm vetëm në vitin 2012. Konkretisht në 2008 ka qënë 6.25% në 2009 ka qënë 5.25%, në 2010 ka qënë 5%, në 2011 ka qënë 4.75% dhe sot në nëntor 2012 është 4%. Ky qëndrim i BQ ka ndikuar negativisht në rritjen e qarkullimit të lekut shqiptar në fushën e investimeve duke stimuluar kanalizimin e tij në buxhet nëpërmjet bonove të thesarit.

E dyta, se në Shqipëri nuk ka asnjë bankë të nivelit të dytë me kapital plotësisht shtetëror. Duke mos pasur një bankë të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, në kushtet kur qarkullojnë lirshëm për depozita dhe kredi euroja dhe dollari Banka Qëndrore e ka pasur shumë të vështirë të ndikojë në tregun e valutave si dhe në një sërë treguesish apo agregatësh monetarë. Kështu nga analiza që kemi bërë nuk ka pasur ndonjë lidhje midis normave bazë të interesit dhe rritjes së PBB dhe agregateve të tjerë monetarë. Këto tregues dhe të tjerë tregojnë se Bankat Tregëtare nuk shoqërojnë veprimet e BQ në fushën e rënjes së normës bazë të interesit për llogari të çiftit depozitë-kredi por më së shumti shikojnë interesat e tyre të ngushta dhe strategjike. Ato operojnë pak me lekun dhe shumë më tepër me valutat, kështuqë ato kanë gati një pavarësi të plotë prej saj. Shprehje e kësaj pavarësie janë edhe thirjet

e shpeshhta që Guvernatori i BQ dhe Kryeministri apo Ministri i Financave ju bëjnë këtyre Bankave për të rritur nivelin e kredive për biznesin. Duke ju lënë dorë të lirë Bankave të nivelit të dytë për depozita dhe kredi në valutë ajo e ka humbur rolin e saj ndikues edhe në kurset e këmbimit. Me kurset e këmbimit më së shumti luajnë bankat e nivelit të dytë, ndërsa kjo e fundit shpesh është viktimë e veprimeve të tyre për interesa të ngushta. Nëse valuta do ishte monopol i saj shumë fenomene negative do të eliminoheshin dhe ekonomia do të merrte frymë më lirisht.

Sot sistemi bankar përbëhet vetëm nga banka me kapital privat përgjithësisht të huaj dhe nga asnjë bankë me kapital shtetëror. Kjo situatë ka bërë që në sistemin bankar të krijohet një strukturë tregu oligopol me një bankë drejtuese tërësisht me kapital të huaj që është Raifajzen Bank. Kriza e vitit 2008 theksoi ndikimin e bankave të huaja në procesin e transmetimit të politikës monetare në vendet me ekonomi në zhvillim. Kanë qenë të shpeshta rastet kur bankat qendrore të vendeve me tregje në zhvillim, ku bankat e huaja luajnë rol dominues, ulën normën bazë të interesit, gjë që nuk u shoqërua me ulje të normave të kreditimit.

Këto çështje kanë një rëndësi të veçantë për vendet me ekonomi në zhvillim, të cilat nuk ishin shkak i krizës financiare të vitit 2008, por që ishin ato të cilat vuajtën në mënyrë të veçantë nacionalizmin financiar që u ndez nga kriza⁷¹.

Kriza aktuale ndër të tjera nxorri në pah edhe lidhjen midis pranisë të bankave të huaja dhe efikasitetit të politikës monetare. Nëse bankat e huaja janë aktorë të rëndësishëm financiarë në ekonominë e brendshme dhe nëse aktiviteti i tyre huadhënës dhe huamarrës ndikohet më shumë nga kushtet e ekonomisë në vendin mëmë sesa nga kushtet e vendit pritës, atëherë efikasiteti i zbatimit të politikës monetare është i dobët.

BQ mori një sërë masash që në vitin 2008 por efekti i tyre nuk ishte ai i prituri pavarësisht se situata vlerësohet nën këndvështrime të ndryshme. Vetë Guvernatori i Bankës Qëndrore në 14 dhjetor 2010 ka pohuar se "Kreditimi u ngadalësua ndjeshëm, kursi i këmbimit filloi të zhvlerësohej dhe parashikimet lidhur me rritjen ekonomike dhe inflacionin pësuan rënie. Ndërkohë, tërheqjet e depozitave vijuan më tej dhe problemet e lidhura me likuiditetin u thelluan". "Përpara krizës, Banka e Shqipërisë i shihte me shqetësim kërcënimet e

71 Meir Sokoler. Lidhja ndërmjet Stabilitetit Monetar dhe Financiar – Mësime për Ekonomitë në Zhvillim. Meir Sokoler, Këshilltar i FMN -së për politikën monetare në Bankën e Shqipërisë.

mundshme financiare që po akumuloheshin gjatë viteve të ndërmjetësimit të shpejtë financiar. Për ta ilustruar më konkretisht: pjesa më e madhe e rritjes së kredisë shkante për sektorin e patregtueshëm të ekonomisë, ku shërbimet dhe ndërtimi përbënin pjesën më të madhe të kësaj rritjeje. Për më tepër, më shumë se 70% e totalit të kredisë ishte në valutë, ku ajo në euro zinte peshën kryesore të tepricës së kredisë⁷².

Privatizimi total i sistemit bankar zëvendësoi një formë të centralizuar me një tjetër por që nuk është subjekt shtetëror. Ky zëvendësim i pronësisë nuk largoi apo mënjanoi fenomenin, përkundrazi sot është më i theksuar efekti oligopol në treguesin e çmimeve.

2. Realizimi Objektivave të Politikës Monetare

Gjatë viteve 2008-2011, rritja e ofertës monetare ka pasur për synim të bëhet në përputhje me ecurinë e sektorit real të ekonomisë duke ju përshtatur kërkesës për para të faktorëve ekonomikë. Në përgjithësi politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë neutrale, duke ndihmuar në konsolidimin e mëtejshëm të ngadalësimit të ritmit të ekspansionit monetar me synim të shmangjes së presioneve inflacioniste të brendëshme dhe të jashtme.

Zhvillimet monetare kanë pasqyruar kërkesat e faktorëve ekonomikë për mjete monetare, kështu rritja e kreditimit të sektorit privat ka dominuar shtesën e stokut të parasë. Gjatë këtyre viteve ritmet e kredisë për valutë kanë qenë më të larta se ritmet e depozitave në valutë.

Treguesit monetarë kanë pasur një dinamikë të gjerë si në strukturë ashtu edhe sasi, kështu është ulur pesha e depozitave ndaj parasë së gjerë. Agregati M_3 është rritur me ritme më të shpejta sesa agregati M_2 dhe gjithë agregatët e tjerë. Monedhat e huaja si euro dhe dollari kanë ardhur vazhdimisht duke u forcuar përball lekut shqiptar.

Politikat monetare të Bankës Qëndrore e japin efektin e tyre në agregatët monetarë siç janë Baza Monetare, Paratë Jashtë Banke, Agregatët M_1 , M_2 dhe M_3 , njëkohësisht ndikim indirekt japin edhe në treguesit e tjerë siç janë kurset e këmbimit të lekut me valutat e tjera. Në analizën tonë jemi mbështetur në Pasqyrën Nr.1.

72 "Stabiliteti makrofinanciar në vendet candidate dhe vendet e mundshme candidate për në BE: mësimet për t'u nxjerrë", Frankfurt, 14 dhjetor 2010. Data e publikimit 16.12.2010

Pasqyra Nr.1 Tregues monetarë⁷³

Oferta e parasë Në milionë lekë Fundi i periudhës	2008	2009	2010	2011
Baza monetare	271,729.2	284,839.7	283,453	289,809
Ndryshimi vjetor në %	19.1	4.8	-0.5	2.2
Paraja jashtë bankave	195,817.3	209,043.8	195,059	194,923
Ndryshimi vjetor %	26.4	6.8	-6.7	-0.1
Rezervat e bankave	67,793.3	68,071.5	80,810	86,800
Ndryshimi vjetor në %	1.1	0.4	18.7	7.4
Depozitat	619,887.4	662,425.7	785,224	875,228
Ndryshimi vjetor në %	2.9	6.9	18.5	11.5
Agregati M₁	282,862.3	284,505.6	275,427	276,898
Ndryshimi vjetor në %	16.6	0.6	-3.2	0.5
Agregat M₂	555,004.7	578,181.5	604,517	647,007
Ndryshimi vjetor në %	9.7	4.2	4.6	7.0
Agregat M₃	815,704.6	871,469.5	980,283	1,070,153
Ndryshimi vjetor në %	7.7	6.8	12.5	9.2
Infl. mes. vjetor %	3.4	2.2	3.4	3.3
Ndryshimi vjetor në %	17.2	-34.6	54.5	-2.9
Kursi këmbimit euro	123.18	137.17	138.81	138.3
Ndryshimi vjetor në %	1.96	11.4	1.2	-0.4
Kursi këmb. në dollarë	90.96	93.98	104.95	105.08
Ndryshimi vjetor në %	9.5	3.3	11.7	0.1

Në analizën e treguesve monetarë, lidhjeve midis tyre dhe inflacionit ne kemi bërë disa grupime duke gjykuar për afërsitë dhe lidhjet midis tyre, kështu kemi ndërtuar grafikët e Bazës Monetare, Parave jashtë banke dhe të agregatit M₁ më vehte, kemi ndërtuar grafikët e M₂, M₃ në një figurë tjetër më vete. Në këtë mënyrë kemi mundësi të analizojmë më nga afër lidhjet midis tyre.

Baza Monetare. Baza Monetare në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 ka një rritje prej 19.1%, rritje kjo që është plotësisht e justifikuar nëse e krahasojmë

73 Të dhënat e kësaj pasqyre dhe të pasqyrave të tjera janë marrë nga burime të ndryshme. Në rastin konkret janë marrë nga 4 Raporte Statistike të viteve 2009-2012. Është kjo arsye që ne nuk i kemi cituar ato por i kemi vendosur në fund të studimit.

rritjen e Bazës Monetare me atë të rritjes ekonomike. Në 2009 në krahasim me 2008 ka një rritje me 13.1 miliardë lekë ose u rrit me 4.8%. Në vitin 2010 kemi rënje të saj dhe në 2011 kemi përsëri një rritje të lehtë vetëm me 5 miliardë në krahasim me 2009. Në këtë mënyrë tendenca e përgjithëshme e këtyre 4 viteve është se Baza Monetare në *shumë absolute ka ardhur në rritje*. Kjo shihet edhe nga grafikët që kemi ndërtur në figurën Nr.1

Përsa i përket ndryshimit të saj vjetor në përqindje kemi një tendencë të kundërt me atë në shumë absolute, pra në *vite ajo ka ardhur në rënje*. Këtë dinamikë e kemi paraqitur në figurën Nr.2

Para Jashtë Banke. Në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 paratë jashtë banke janë rritur me 26.4% më shumë, ndërsa në vitin 2009 në krahasim me 2008 janë ulur me -6.8%. Në dy vitet pasardhëse kemi rënje me 6.7% në 2010 dhe me -0.1% në 2011. Paratë jashtë banke në 2010 dhe në 2011 janë në shumë absolute më të ulta se në vitin 2008 dhe në vitin 2009. Ashtu sikundër Baza Monetare edhe ky tregues është i lidhur me rritjen ekonomike.




Fig.Nr.1 Dinamika e Bazës monetare, Parave jashte banke dhe agregatit M_1

Agregati M_1 . Në shumë absolute në 2008 në krahasim me vitin 2007 është rritur me 16.6%, në 2009 në krahasim me 2008 është rritur me vetëm me 2.24 miliardë lekë, në 2010 dhe 2011 është ulur me respektivisht me 9 miliardë lekë

dhe 7.6 miliardë. Në 2011 në krahasim me 2010 është rritur me 1.47 miliardë lekë. Siç shihet ka paqëndrueshmëri rritje edhe në shumë absolute. Sa i përket dinamikës në përqindje tendencat e tij janë të njëjta me ato të BM dhe PJB, në rënje.




Fig.Nr.2 Dinamika e M_2 dhe M_3 në shumë absolute

Agregati M_2 . Në 2008 ka një rritje të ndjeshme në krahasim me 2007 si në shumë absolute ashtu edhe në përqindje. Në të gjitha vitet e tjera pas 2008 në shumë absolute ka rritje por jo me ritëm të njëjtë. Sa i përket dinamikës së rritjes në përqindje ajo është në rënje.

Agregati M_3 . Në 2008 ka ritmin më të ulët të rritjes në krahasim me të gjithë agregatët e tjerë. Ritmi i tij ka rënë në 2009, është rritur në 2010 dhe përsëri është ulur në 2011. Ky agregat ndryshon me të tjerët sepse është i lidhur me depozitat në valutë të cilat kanë ardhur vazhdimisht në rritje si ndaj totalit të depozitave edhe ndaj totalit të kredive. Kredia në valutë zë pjesën kryesore në totalin e kredive ndërsa në depozita ka tendencën që të shkojë në 50%. Është kjo arsye që ky tregues ka një indeks lidhjeje me depozitat më të madh se treguesit e tjerë. Koeficienti i rolacionit midis depozitave dhe M_3 është mbi 99%, ndërsa me agregatin M_2 është 98 %. Tendencat e kurbave të tyre në përqindje i kemi dhënë në fig Nr.3.

Tendencat tregojnë se përqindja e rritjes vjetore është në rënje deri në 2010, ndërsa në 2011 ka filluar të vijë në rritje.




Fig.Nr.3 Tendencat e kurbave të agregatëve monetarë




Fig. Nr.4 Lidhja e agregatit M3 dhe depozitave.

Lidhjet midis agregatëve monetarë dhe PBB në shumë absolute janë:

PBB/BM +0.86

PBB/PJB -0.37

PBB/M₁ -0.81

PBB/M₂ +0.99

PBB/M₃ +0.99

Nga sa shihet lidhja me M₂ dhe M₃ janë të forta, arsyet për këtë janë se të dy këta agregatë kanë ardhur në rritje në shumë absolute ndërsa agregatët e tjerë ose kanë luhatje të mëdha ose kanë ardhur në rënje.

Pasqyra Nr.2 PBBn me çmime të fiksuara dhe në % ndaj viteve të mëparëshme

Emërtimi	2008	2009	2010	2011
PBB në % me çmime të fiksuara	7.5	3.3	3.5	2.73
PBB në % ndaj vitit të kaluar	7.8	3.7	2.4	0.3
PBB në milionë lekë	1,089,293	1,151,020	1,238,093	1,314,702

Nëse do tu referoheshim shifrave relative në përqindje kjo situatë do ndryshojë si më poshtë:

PBB/BM +0.87

PBB/PJB +0.79

PBB/M₁ -0.81

PBB/M₂ -0.64

PBB/M₃ -0.62

Dy janë lidhjet që nuk kanë ndryshuar si në shifra absolute ashtu edhe në shifra relative, lidhjet midis Bazës Monetare dhe PBB dhe lidhjet midis Bazës Monetare dhe agregatit M₁, ndërsa lidhjet e tjera kanë ndryshuar në mënyrë të dukëshme.

Lidhjet midis agregatëve monetarë dhe normës së inflacionit janë:

Bazë Monetare/Inflacion -0.24

Para Jashtë Banke/Inflacion -0.99

Agregati M1/Inflacion -0.68

Agregati M2/Inflacion 0.26

Agregati M3/Inflacion 0.33

Nga të dhënat shihet qartë që nuk kemi ndonjë lidhje të fortë midis agregatëve monetarë dhe nivelit të inflacionit. *E vlen të theksohet këtu se me tre agregatët e parë kjo lidhje është negative gjë që do të thotë se kur banka aplikon një politikë ekspansioniste inflacioni në vend që të rritet ai ulet.* Pikërisht është ky fakt dhe shumë fakte të tjera që ne na kanë çuar në konkluzionin se Banka Qëndrore e Shqipërisë nuk e kontrollon dot normën e inflacionit.

Forca e lidhjes midis Depozitave dhe M₂ është 0.98

Forca e lidhjes midis M₃ dhe depozitave është 0.99

Forca e lartë e lidhjeve të mësipërme është fare normale dhe e shpjgueshme sepse në depozita gjithnjë e më shumë po predominojnë ato në valutë.

Politikat e Bankës Qëndrore janë të lidhura edhe me kurset e këmbimit dhe këto të fundit nga ana e tyre janë të lidhura me normën e inflacionit.




Figura Nr.5 Dinamika e kurseve të këmbimit sipas muajve për vitet 2008-2011 në dollarë

Deri në muajin e shtatë kurset vijnë në rënje pas muajit korrik kurset vijnë në rritje. Kjo tendencë nuk vihet re në kurset e këmbimit të euros, kjo sepse oferta e saj është e lidhur më së shumti me hyrjen dhe daljen e emigrantëve shqiptarë. Nëse do analizojmë euron do shikojmë tendenca të tjera, për shembull ajo zhvlerësohet në korrik, gusht dhe dhjetor, pikërisht në periudhat kur kemi një dyndje të madhe emigrantësh. Në përgjithësi në periudhën e verës të dy valutat humbasin pikë ndaj lekut shqiptar.




Figura Nr.6 Dinamika e kurseve të këmbimit sipas muajve për vitet 2008-2011 ne euro

Nga figurat shihen qartë një sërë tendencash të cilat kanë ndikuar si në vëllimin e importeve ashtu edhe në normën e inflacionit e në përgjithësi në rritjen e përgjithëshme ekonomike.

Viti 2008 ka pasë një qëndrueshmëri në kurse, një rënje dhe stabilitet 5 mujor, një rritje në muajin shtator dhe në këtë kuotë kurset kanë qëndruar deri në fund të vitit.

Në vitin 2009 kemi rritje të kursit deri në maj, rënje deri në mes të korrikut dhe rritje tepër të lartë deri në muajin nëntor kurs i cili u ruajt edhe për dhjetorin.


Në 2010 kursi ka ardhur në rënje deri në korrik duke ju qasur kuotave të dhjetorit të 2009 pastaj në rritje duke kaluar edhe kuotat e dhjetorit të 2009.

Në 2011 kemi rritje të kursit deri në muajin qershor pastaj kemi rënje dy muaj, rritje dhe rënje në dhjetor, gjithmonë këto kuota më të larta se ato të 2010. Vetëm në muajt janar dhe dhjetor kurset e këmbimit kanë qënë të njëjta.

Tendanca e katër kurbave shihet qartë që kurset në periudhën e verës dhe në dhjetor vijnë duke u ulur ndërsa në muajt e tjerë në rritje në mënyrë të veçantë në çdo tremujor të parë të çdo viti.

Nga pasqyra dhe tabela përkatëse shihet qartë se si në shifra absolute ashtu edhe në shifra relative kanë ardhur në rritje pavarësisht nga madhesia e tyre. Kjo tendencë është më e dukëshme në kurset e këmbimit të lekut me dollarin, kurs i cili nuk ka njohur në asnjë vit rënje përkundrazi ka ardhur gjithnjë e në rritje. Kursi i euros në 2011 u ul me 0.51 pikë në dhjetor në krahasim me dhjetorin e vitit 2010.

Fig.Nr.7 Dinamika e Kurseve të këmbimit



Kjo tregon se në përgjithësi ndikimi i tyre në normën e inflacionit ka qënë pozitiv, pra ato kanë ushtruar presione inflacioniste. Nëse analizojmë lidhjet

midis tyre dhe normës së inflacionit do shikojmë se lidhja midis kursit lekë/euro me normën e inflacionit është negative ndërsa ajo lekë/dollar është pozitive. Kjo lidhje vërehet në të gjitha vitet e analizuara sipas muajve, pra është tendencë e shtrirë jo vetëm në vite por edhe brenda muajve të një viti. Ka vite të veçanta që ky koeficient është shumë më i lartë.

Çfarë tregojnë këto lidhje? Këto lidhje janë shumë të dobëta megjithatë ja vlen të analizojmë tendencat e tyre. *Këto lidhje tregojnë se kur zhvlerësohet leku shqiptar ulen importet dhe rritet prodhimi vendas gjë që për pasojë ka sjellë edhe një rritje të inflacionit.* E kundërta ta ndodhur me dollarin, kur leku është zhvlerësuar ndaj tij është ulur norma e inflacionit

Lidhja midis inflacionit dhe kurseve të këmbimit:

Lekë/Euro në lidhje me inflacionin -0.26

Lekë/Dollarë në lidhje me inflacionin 0.42

Këto lidhje janë thuaj për çdo vit të marrë në analizë, kështuqë kjo tendencë është e përgjithëshme.

3. Instrumentet që janë përdorur për realizimin e objektivave të Bankës Qëndrore

Banka e Shqipërisë ka përdorur një sërë instrumentesh për aplikimin e politikave të saj monetare siç janë operationet në tregun e hapur, norma e rezervës së detyrueshme dhe normën e REPO-ve ose siç e quajmë ndryshe normën bazë të interesit. Instrumenti më kryesor i vlerësuar prej saj janë normat bazë të interesit.


Pasqyra Nr.3 Instrumentet e Bankës Qëndrore në %

Emërtimi	2008	2009	2010	2011
Depozita njëditore	4.5	3.5	3.25	3
Marrëveshje riblerje një javore	6.25	5.25	5	4.75
Kredi njëditore	8	6	5.75	6.5
Kredi mbështet.për likujditet	12.25	11.25	11	10.75
Bono Thesari 3 mujore	6.27	6.3	5.59	5.31
Bono Thesari 6 mujore	7.45	7.52	6.41	6.23
Bono Thesari 12 mujore	8.56	9.14	7.09	6.95

Nga të dhënat shihet se Banka Qëndrore në këto katër vjet ka aplikuar një politikë monetare ekspansioniste të moderuar, nga 6.25% që ishte në 2008 në dhjetor të 2011 ka shkuar 4.25% ndërsa në 2012 është bërë 4%. Themë politikë të moderuar sepse Bankat Qëndrore të vendeve të tjera si të SHBA dhe Europës kanë aplikuar politika agresive ekspansioniste duke arritur në më pak se 0.5% dhe 1%.

Ulja e NBI nuk ka pasur ndonjë ndikim të ndjeshëm në produktet bankare për të cilat është aplikuar. Kështu nëse analizojmë Bonot e Thesarit, shikojmë se në 2009 normat e tyre janë rritur me përjashtim të Bonove me maturim tremujor, rënja e tyre është realizuar në vitin 2010, ndërsa kanë qëndruar thujtë të pandryshuara në vitin 2011. Bonot me maturim 12 mujor kanë normën më të lartë të interesit, arsyeja për këtë pozicion qëndron në strategjinë e Qeverisë për të kaluar nga instrumentet me maturim tre mujor në instrumente borxhi 12 mujor.

Fig. Nr.8 Dinamika e normave të interesit Bonove të Thesarit




Ndikim rënja e Normës Bazë të Interesit duhet të sjelli edhe në normat e interesit të depozitave dhe të kredive në lekë.

Pasqyra Nr.4 Norma e depozitave dhe kredive në lekë

Emërtimi	2008	2009	2010	2011
Norma e depozitave (6-m)	5.76	5.76	5.16	4.77
Norma e depozitave (12-m)	6.86	6.77	6.07	5.82
Norma e depozitave (24-m)	6.83	7.43	6.86	6.51
Norma e huasë (6-m)	11.18	12.91	11.52	10.25
Norma e huasë (12-m)	10.76	12.29	15.42	14.63
3-5 vjet	x	x	14.1	11.29
mbi 5 vjet	x	x	10.61	10.82

Fig.Nr.9 Dinamika e normave të depozitave dhe kredive në lekë



Nga të dhënat e pasqyrës dhe grafikëve përkatës shikojmë se norma e depozitave 6 mujore në vitin 2009 ka një rënje fare të lehtë, ndërsa me ritme më të larta është ulur në vitet 2010 dhe 2011, të njëjtën gjë mund të themi edhe për depozitat me afat maturimi 12 mujor. Përsa i përket normës së interesave të depozitave 24 mujore ato kanë ardhur në rritje dhe vetëm në 2011 janë ulur vetëm me -0.32 pikë përqindje. Këto të dhëna tregojnë se nuk ka ndonjë lidhje të ngushtë midis NBI dhe normave të depozitave dhe kredive.

Lidhja midis NBI dhe Normave të depozitave dhe kredive sipas afatit të maturimit paraqitet si më poshtë:

Dep6m	0.78
Dep12m	0.83
Dep24m	0.18
Hua6m	0.14
Hua12m	-0.88

Nga të dhënat shihet që ka lidhje midis normës së depozitave 6 mujore dhe 12 mujore me NBI ndërsa me të gjithë treguesit e tjerë nuk ka lidhje për tu shënuar. Me normat e kredive 12 mujore ka lidhje të kundërta që do të thotë se nëse NBI ka ardhur në rënje, pavarësisht të moderuar normat e interesit për huatë 12 mujore kanë ardhur në rritje.

Lidhjet midis normave së interesit të depozitave dhe normave të interesit të kredive janë:

Depozita 6 mujore/Hua 6 mujore 0.73


Depozita 12 mujore/Hua 12 mujore -0.91

Midis depozitave dhe huave 6 mujore ka lidhje dhe ajo është për tu vlerësuar, ndërsa midis kredive dhe huave 12 mujore lidhja është krejtë e kundërt dhe në përmasa të mëdha. Për vitet 2010 dhe 2011 nuk mund të përcaktojmë ndonjë lidhje por është e nevojshme të theksojmë se norma e kredive 3-5 vjeçare ka rënë në një kohë që norma e kredisë afatgjatë mbi 5 vjeçare është rritur me 0.21 pikëpërqindje.

Çfarë tregojnë këta tregues korelacioni? Ata tregojnë se pavarësisht politikave që ka aplikuar Banka Qëndrore në drejtim të Normës Bazë të Interesit, Bankat e nivelit të dytë zbatojnë politikat e brendëshme të tyre të mbështetura në strategjinë afatmesme dhe afat gjatë.

Diferenca midis normave të depozitave dhe normave të kredive në lekë është dhënë në figurën nr 10.

Fig.Nr.10 Diferenca e normave të interesit të depozitave dhe normave të interesit të kredive në lekë



Për të parë më nga afër lidhjen e brendëshme midis tyre ne kemi bërë diferencat midis normave të huave 6-12 mujore me depozitat 6-12 mujore. Këtu, në këtë diferencë ne shikojmë "fitimin" e bankave nga normat e interesit. **Figura e shpreh qartë se në tre vitet e para kemi rritje të kësaj difference dhe vetëm në 2011 është ulur, por kjo ulje nuk është më e ulët se diferenca e krijuar në 2008, përkundrazi për kreditë dhe depozitat 12 mujore është rritur me 225% në 2011 në krahasim me 2008.**

Konkluzioni i përgjithshëm është se Banka me politikat e saj të moderuara rrudhëse nuk ka ndonjë ndikim në normën e depozitave apo të kredive. Në këtë mënyrë nuk ka as

ndonjë ndikim në normën e inflacionit, sepse norma e inflacionit në ekonomitë klasike varet nga sasia e parasë në qarkullim. Në këtë mënyrë ajo nuk e kontrollon dot normën e inflacionit e cila më së shumti është e varur prej normës së inflacionit të importuar.

Sa i përket bankave të nivelit të dytë ato janë të interesuara më së shumti për euron dhe dollarin sesa për lekun shqiptar, kjo për arsye se subjektet ekonomike janë të interesuara të depozitojnë paratë e tyre në lekë meqënëse ka normë më të lartë interesi se dy monedhat e tjera ndërsa janë më të interesuar të marrin kredi në euro sepse ka normat më të ulta të interesit. Në këtë mënyrë me lekët që mbeten në banka pa u dhënë në formë kredie për subjektet e ndryshme bankat e nivelit të dytë blejnë Bonot e Thesarit të Qeverisë. Nëse Banka do aplikonte politika më agresive atëhere do të mund të ndikonte në rënjen e interesave të lekut shqiptar. Në krahun tjetër Banka Qëndrore duhet të ndikojë në frenimin e kërkesës së subjekteve ekonomike për valutë dhe kjo në një sërë formash. Për shembull, të frenohet shitja e apartamenteve prej firmave të ndërtimit në euro, shitja e tokës apo mjeteve të tjera themelore në euro, dalja e valutës jashtë prej subjekteve ekonomike të huaj që veprojnë në Shqipëri etj.

Pasqyra Nr.5 Norma e depozitave dhe kredive në dollarë

Emërtimi	2008	2009	2010	2011
Depozita 6 mujore \$	x	x	1.31	1.71
Depozita 12 mujore \$	x	x	1.83	2.41
Depozita 24 mujore \$	x	x	2.04	2.19
Kredi \$ 6m-1 vit	x	x	6.66	7.05
Kredi \$1-3vjet	x	x	7.84	7.31
Kredi\$3-5vjet	x	x	9.22	6.41
Kredi\$mbi 5vjet	x	x	6.82	7.11

Sa u përket depozitave në dollarë norma e interesit të tyre për tre produktet e para ka ardhur në rritje, ndërsa vetëm norma e kredive afatshkurtëra dhe afatgjata ka ardhur në rritje. Normat e kredive afatmesme kanë ardhur në rënje, **kjo për arsye se bankat duan të stimulojnë kreditë afatmesme në dollarë**, pavarësisht se në shumë absolute kredia në dollarë nuk ka ndonjë peshë ndaj totalit të krdisë. E vlen të theksojmë këtu se diferencat e normave të interesit midis kredive dhe depozitave në dollarë janë të larta. Konkretisht në muajin dhjetor të 2010 dhe 2011 kanë qënë:

Pasqyra Nr.6 Norma e depozitave dhe kredive në euro

Emërtimi	2008	2009	2010	2011
Dep 6 mujore,euro	x	x	2.69	2.38
Dep 12 mujore,euro	x	x	3.2	3.29
Dep 24 m(euro)	x	x	4.08	3.72
Kredi 6m-1 vit(euro)	x	x	6.18	7.16
Kr. 1-3 vjet,euro	x	x	8.49	8.12
Kr. 3-5 vjet,euro	x	x	7.24	7.26
Kr.mbi 5 vjet,euro	x	x	7.59	7.35

Pasqyra Nr.7 Diferenca midis normave të interesit në disa produkte monetare

Emërtimi	Lekë		Euro		Dollarë	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011
dep6/kred6-1vit	6.4	5.48	4.4	4.78	5.4	5.34
dep12m/k1-3 vjet	9.5	8.81	4.4	4.83	6.0	4.9
dep24m/1-3vjet	8.8	8.12	3.7	4.4	5.7	5.12
dep24m/3-5vjet	7.2	4.31	3.7	3.54	3.7	4.22

Nga pasqyra Nr.6 shihet qartë se depozitat 6 mujore kanë ardhur në rënje në një kohë që kredia 6m-1vit ka ardhur në rritje, pra midis tyre kemi lidhje të kundërta. Normat e depozitave 12 mujore janë rritur ndërsa janë ulur ato të kredisë 1-3 vjeçare. Normat e depozitave 24 mujore janë ulur ndërsa janë rritur ato të kredive 3-5 vjeçare që zënë edhe pjesën më të madhe ndaj totalit të kredisë.

Nga pasqyra Nr.7 shikojmë se normat më të larta të fitimit nga normat e interesit e kanë depozitat dhe kreditë në lekë që varjojnë nga 6.4% deri në 9.5%. Pas lekut vjen dollari me 4.22% dhe me një maksimum prej 5.34%. Normat e fitimit më të moderuara i kanë depozitat dhe kreditë në euro me një minimum prej 3.54% dhe një maksimum 4.83%.


Edhe në produktet në valutë shikohet se nuk kemi ndonjë lidhje të fortë midis normave të interesit të depozitave dhe normës së interesit të kredive. Ato janë vendosur sipas strategjive të brendëshme të vetë bankave të nivelit të dytë.

Pasi bëmë një analizë të hollësishme vjetore të disa treguesve kryesorë monetarë ndërtojmë edhe lidhjen midis normës së inflacionit dhe normës bazë të interesit për të parë ndikim e politikave monetare të BQ në këtë tregues.

Pasqyra Nr. 8 Lidhja midis normës bazë të interesit dhe normës së inflacionit

Vitet	2008	2009	2010	2011
Infl. mes. vjetor %	3.4	2.2	3.4	3.3
Marrëveshje riblerje një javore	6.25	5.25	5	4.75

Fig.Nr.11 Norma e inflacionit dhe norma bazë e interesit



Nëse do analizojmë këto dy tregues që nga 2003 atëherë di shikojmë se kanë të njëjtën tendencë rënie të normës së interesit e shoqëruar me rënie të normës së inflacionit në një kohë që duhej të ndodhte e kundërta. Në këtë mënyrë mund të nxjerrim konkluzionin se Banka Qendrore gjatë periudhës së recesionit ka mbajtur po atë qëndrim që e ka mbajtur edhe para tij në periudha normale të rritjes ekonomike të vendeve që kemi marrëdhënie tregëtare.

Emërtimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Nr e interesit	6,5	5,25	5	5,5	6,25	6,25
Nr inflacionit	3,3	2,2	2	2,5	3,1	2,6

Përfundime

=Banka e Shqipërisë ka aplikuar politika përgjithësisht rrudhëse të moderuara që nuk kanë pasur ndonjë ndikim në politikat e bankave të nivelit të dytë në fushën e kreditimit. Pra ajo ka qënë asnjëherë në ecurinë e

ekonomisë shqiptare. Ka parë vetëm treguesin e inflacionit i cili për shkak se është përgjithësisht i importuar dhe vendet kanë qënë në recesion ka qënë i ulët. BQ nuk ka pasë asnjë problem me të përkundrazi ai tregues i ka shërbyer asaj si motiv për tu vetëlavdëruar për “politikat” e saj efektive.

=Për të gjithë treguesit e tjerë BQ nuk ka mbajtur asnjë qëndrim kritik ndaj politikave të saj përkundrazi i ka parë si palë e Tretë pa kurrfarë përgjegjësie por përkundrazi si një përgjegjësi e qeverisë shqiptare.

=Fortësia e lidhjeve midis agregatëve monetarë dhe PBB ishte e dobët, po kështu fortësia midis normave bazë të interesit, normave të depozitave dhe normave të kredive.

=Lidhja midis normave bazë të interesit dhe normës së inflacionit ka qënë fare e dobët dhe me të njëjtin kah, kur duhej të ndodhte e kundërta. Kjo tregon se norma e inflacionit përcaktohet përgjithësisht prej faktorëve të tjerë dhe se efikasiteti i instrumenteve në duart e saj ka qënë i ulët.

=Nëse BQ do të aplikonte politika ekspansioniste atëherë leku shqiptar do të dilte jashtë banke në drejtim të biznesit dhe të qytetarëve shqiptarë që përgjithësisht marrin kredi për banesa dhe nuk do të shkonte për blerjen e BTH të qeverisë.

=Politika e BQ ka bërë që të krijohet një stok leku në bankat e nivelit të dytë, në interes kjo edhe të vetë këtyre bankave për të zbutur diferencën midis depozitave dhe nivelit të përdorimit të tyre për produkte bankare, nga njëri krah dhe nga krahu tjetër si produkt (BTH) me risk zero.

=Krizë aktuale financiare dhe recesioni global ndër të tjera nxorri në pah edhe lidhjen midis pranisë së bankave të huaja dhe efikasitetit të politikës monetare. Nëse bankat e huaja janë aktorë të rëndësishëm financiarë në ekonominë e brendshme dhe nëse aktiviteti i tyre huadhënës dhe huamarrës ndikohet më shumë nga kushtet e ekonomisë në vendin mëmë sesa nga kushtet e vendit pritës, atëherë efikasiteti i zbatimit të politikës monetare është i dobët.

=Krizë e vitit 2008 theksoi ndikimin e bankave të huaja në procesin e transmetimit të politikës monetare në vendet me ekonomi në zhvillim. Kanë qënë të shpeshta rastet kur bankat qendrore të vendeve me tregje në zhvillim, ku bankat e huaja luajnë rol dominues, ulën normën bazë të interesit, dhe që ky veprim nuk u shoqërua me ulje të normave të kreditimit. Kjo ishte një dukuri konkrete edhe në ekonominë shqiptare.

=Recesioni global në ekonominë shqiptare ka pasur ndikime negative por ka pasur edhe ndikime pozitive për arsyet e përmendura në këtë material që më së shumti e theksojmë për llogari të prapambetjes së tregjeve dhe të sistemit të pa zhvilluar financiar shqiptar.

Bibliografia

1. Raport i Politikës Monetare për Tremujorin e katërt 2011. Banka e Shqipërisë
2. Raport Vjetor 2009. Banka e Shqipërisë
3. Raport Vjetor 2010. Banka e Shqipërisë
4. Raport Vjetor 2011. Banka e Shqipërisë
5. Raporti Vjetor 2008. Banka e Shqipërisë
6. Raporti Statistikor Dhjetor 2011. Banka e Shqipërisë
7. Raporti Statistikor Gusht 2010. Banka e Shqipërisë
8. Raporti Statistikor Korrik 2011. Banka e Shqipërisë
9. Raporti Statistikor Maj 2010. Banka e Shqipërisë
10. Raporti Statistikor Maj 2012. Banka e Shqipërisë
11. Raporti statistikor mujor. 2011. Banka e Shqipërisë
12. Raporti Statistikor Nëntor 2009. Banka e Shqipërisë
13. Raporti Statistikor Prill 2010. Banka e Shqipërisë
14. Raporti Statistikor Prill 2011. Banka e Shqipërisë
15. Raporti Statistikor Prill 2012. Banka e Shqipërisë
16. SHQIPËRIA NË SHIFRA.2010. INSTAT
17. A.Angjeli. SHQIPËRIA DREJT NJË MODELI TË RI TË ZHVILLIMIT EKONOMIK.
18. A.Fullani. „Stabiliteti makrofinanciar në vendet candidate dhe vendet e mundshme candidate për në BE: mësimet për t’u nxjerrë“, Frankfurt, 14 dhjetor 2010. Data e publikimit 16.12.2010
19. *Ardian Fullani, Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 31 gusht 2010*
20. Ardian Fullani, Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, në konferencën për shtyp për Raportin e Stabilitetit Financiar 2008. Datëa e publikimit 09.07.2009.

NDIKIMI I KRIZËS EKONOMIKE NË TREGUN E SIGURIMEVE DHE KOMPANITË NË RAJONIN TONË

Zhanina Dapi

Universiteti i Tiranës

Jovan Stojanoski

Fakulteti i Turizmit dhe Mikëpritjes. FYROM

Klime Poposki

President i Mbikqyrjes së Sigurimeve. FYROM

Liljana Elmazi

Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

Insurance is part of the general economy and was affected by global crisis. But, insurance products were not involved in the credit crisis except secondarily in the form of certain security bonds and coverage of directors' and officers' and errors and omissions liability. Our paper will give answers for these questions: How has insurance regulatory direction changed due to the economic crisis, e.g., implementation of Solvency II, imposition of risk management requirements, coordination with regulatory schemes for other financial services? How can regulation deal effectively with abnormal market risks? By what methods? How can the special considerations required for insurance be recognized within a more coordinated financial services regulatory regime? What are the prospects for greater consistency in insurance regulatory approaches among nations? How can trends toward recognizing market-based economic values and company-model measures of solvency and financial performance improve industry financial security and efficiency?

Keywords: insurance market, economic crisis, Balkan region

Tregu i Sigurimeve ashtu si edhe tregjet e tjera financiare, ka një rëndësi të madhe për ekonominë e çdo vendi, sepse siguruesit kanë kapacitet për të përqëndruar një sasi të madhe të kursimeve të bëra nga kompanitë dhe popullsia, në mënyrë që të investohet më tej në aktivitetet ekonomike. Për vendin tonë, tregu i sigurimeve është më sfiduesi, pasi ky nuk është zhvilluar sa duhet dhe ka shënuar norma të mëdha në rritje gjatë viteve të fundit. Megjithatë, ky trend mund të pësojë avari për shkak të krizës financiare të rregjistruar në vendet e zhvilluara, të cilat duhet të kenë një ndikim negativ mbi trendet botërore ekonomike.

Kriza globale financiare që filloi në mesin e vitit 2007 në SHBA, ndikoi në ekonominë globale në shkallë, në krahasim me krizën e Depresionit të Madh të viteve '30. Që kur burimi i kësaj krize, ishte rënia e tregut të pasurive të patundshme në SHBA dhe politika liberale e kredisë në fushën e kredive hipotekare kishte si përfitues të parë institucional të krizës financiare, pikërisht sektorin bankar. Megjithatë, institucionet e tjera, duke përfshirë edhe kompanitë e sigurimit janë prekur nga pasojat e krizës.

Sigurimi është pjesë e ekonomisë së përgjithshme dhe është ndikuar nga rënia e përgjithshme. Por, produktet e sigurimit nuk janë përfshirë në krizën e kredive, përveç në formën e sigurisë të disa obligacioneve dhe mbulimit të Drejtorëve "dhe oficerëve" si dhe gabimet dhe përjashtimet në përgjithësi. Shqetësimi është rritur se rregullat do të krijohen për shërbimet financiare që nuk e njohin karakteristikat unike të sigurimit.

Kriza e fundit ngriti disa pyetje në lidhje me përshtatshmërinë e kontrolleve të menaxhimit të rrezikut në shërbimet financiare në përgjithësi. Kjo përfshin sigurimin për arsyet e përmendura më lart. Menaxhimi i riskut është gjithashtu një shqetësim i veçantë në sigurime, duke pasur parasysh rolin e saj qendror në biznesin e marrjes së riskut. Si rezultat, menaxhimi i riskut ka potencial kritik strategjik për mundësitë e reja të biznesit, nga supozimi i matur i rreziqeve të reja.

Rregullorja e sigurimit dhe kontabilitetit dhe performanca në proceset e matjes, janë duke ndryshuar për t'i bërë ato më realiste përsa i përket aseteve bazuar në risk ekonomik dhe të vlerësimit të tregut të qëndrueshme në përgjegjësi. Këto trende duhet të përmirësojnë të kuptuarit dhe kontabilitet për rreziqet e qenësishme në biznese, për rregullatorët dhe publikun. Ata gjithashtu kërkojnë që siguruesit të kenë më shumë kujdes në menaxhimin e rrezikut dhe kapitalit, duke njohur rritje në paqëndrueshmëri afatshkurtër.

Pavarësisht nga kjo rrugë, siguruesit do të duhet të monitorojnë zhvillimet

ekonomike dhe ngushtësisht rregullat si dhe të zhvillojnë analiza të brendshme analitike për të përmirësuar të kuptuarit e modeleve të riskut dhe përzgjedhjen e tij. Në veçanti, më shumë vëmendje është e nevojshme ti vihet të kuptuarit të riskut që lidhet me kreditë e siguruar dhe risiguruesit. Edhe pse përdorimi i sigurimit mund të kërkojë dhënien e informacioneve shpjeguese për profilet e riskut, modelin e fundit të vazhdueshëm, nëse është e mundur, si dhe përdorimin e kësaj qasje në tregjet e kapitalit, për të mbështetur riskun që duket se ka gjasa të zgjerojë rolin e tregjeve të kapitalit.

Siguruesit *c'fare* duhet të shikojnë për të? Kjo është shpesh e vërtetë në sigurim, se rritja e shpejtë në biznes të ri, veçanërisht në linjat e biznesit ose tregun e segmenteve që nuk janë themeluar mirë, mbart risk të jashtëzakonshëm të përjetojnë humbje të paparashikuar. Siguruesi dhe risiguruesit duhet të jënë vigjilent veçanërisht në tregjet e sotme ku ndryshimet e shpejta mund të ofrojnë sigurime të reja dhe mundësi akumulimin e aseteve, shpesh me pasiguri të risk të lartë.

Ekonomitë zakonisht mund të thithin saktë ndryshimet në kushtet që ndodhin gradualisht. Ajo është një goditje e papritur që tenton të inkurajojë reagim të tepruar dhe rënie të pjerrta që e dëmtojnë shumë dhe kërkojnë shumë kohë për të rifituar besimin e publikut dhe rimëkëmbjen. Por, me të gjitha këto paralajmërime, është e qartë se kushtet e reja të tregut dhe ndryshimet në rregullat rregullative do të ofrojnë mundësi të reja të rëndësishme për zhvillimin e biznesit që duhet, me vlerësimin e riskut të përshtatshme që duhet të ndiqet.

Vështrim i tregut të sigurimit të jetës në Shqipëri: Tregu i sigurimeve në Shqipëri është ende i pazhvilluar krahasuar jo vetëm me vendet e Evropës Perëndimore, por me vendet e Europës Lindore si: Sipas mendimit tonë themelor për fushat e kësaj situate, është mbyllja totale e Shqipërisë gjatë periudhës së komunizmit. Shqipëria është vendi i fundit ku shteti ka humbur monopolin e tij në tregun e sigurimeve. Në krahasim me vendet e rajonit, Shqipëria ka depërtimin më të ulët në densitetin e indekseve. Kjo mund të vërehet lehtë se shqiptarët, të ndjekur nga Kosovarët kanë shpenzuar më pak për produktet e sigurimit. Në vitin 2008, shqiptarët kanë shpenzuar më shumë se 20 USD për frymë, ndërsa Bullgaret kanë shpenzuar rreth 144 USD për frymë, apo shtatë herë më shumë se shqiptarët.

Indekset me depërtimim me të ulët në rajon, konsiderohen në Shqipëri dhe Kosovë, përkatësisht 0,58 për qind dhe 0,61 për qind. Gjatë dekadës së parë të periudhës së tranzicionit, themelet e reformës në sektorin e sigurimeve në Evropën Lindore kanë qenë heqja e monopoleve të sigurimit të shtetit, liberalizimi i hyrjes në treg për siguruesit e huaj dhe krijimi i një kuadri efektiv

mbikëqyrës për industrinë e sigurimeve. Në vitin 1999, Insig në Shqipëri, ishte i fundit monopol gjithëpërfshirës shtetëror që do të bjerë në Evropën Qendrore dhe Lindore, në të gjitha vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore shteti kishte jo më monopol Sigurimi, madje edhe ish-monopolistët shtetërorë kanë humbur terren në veçanti për degët e reja të vendosura nga grupet financiarisht të fortë të sigurimive të huaja (Sigma, 2001). Investitorët e huaj të tregut të sigurimit, hynë në Shqipëri vetëm në vitin 2007, me pjesëmarrjen substanciale të “Aspis Holdings Public Company Ltd “ me 51 për qind në shoqërinë e sigurimit “Interalbanian”. Ajo u pasua nga pjesëmarrjen e “TBHI Financial service Group” Amsterdam, me një vlerë prej 75 për qind. Siç u përmend më lart, vetëm nëntë vjet pas periudhës së tranzicionit, dy kompanitë e para private të sigurimit janë licencuar (Sigma dhe Sigal). Në fakt aktualisht po veprojnë 10 kompani Sigurimi: shtatë prej tyre janë Jo Jetë dhe dy prej tyre janë kompani të sigurimit të Jetës dhe një kompani është operuar në dy aktivitete - Jeta dhe Jo Jeta.

Kompanitë e sigurimeve rreth globit janë të ri-përqëndruar në operacionet e tyre thelbësore. Disa paten humbje në të ardhurat nga investimet gjatë krizës, të tjerët përballen me ndryshimin e preferencave të konsumatorëve, shumica duhet të trajtojnë një mjedis të ri të rrepte rregullash. Në vitin 2011, “Raporti Botëror Sigurimit” shqyrton disa nga mënyrat sesi siguruesit mund të analizojnë biznesin e tyre, për të identifikuar mundësitë dhe për të bërë përmirësime thelbësore dhe të qëndrueshme në operacionet - përmirësimeve që do të sigurojnë themelet për sukses afat-gjatë. (Raporti Botëror i Sigurimit, 2011).

Kriza globale financiare dhe ekonomike, e ka prekur përfitimin, në mënyra të ndryshme në të gjitha kompanitë e sigurimeve të jo-jetës, në mbarë globin. Më qartë, ende kanë qenë në rënie në të ardhurat nga investimet. Në gjysmën e dytë të vitit 2009, kushtet kishin filluar të përmirësoheshin dhe shumë Sigurues të jo-jetës kishin filluar të shikonin trendin e të ardhurave në rritje. Megjithatë, kriza u dha Siguruesve një përkujtesë të zymtë, që ata nuk mund të mbështeteshin në të ardhurat e investimeve për të dhënë rezultate, por ata duhet të rifokusohen në drejtuesit thelbësore të përsosmërisë operative, sidomos të faktorët që drejtojnë treguesit e shkruar, për të arritur rritje të qëndrueshme.

Konsolidimi i biznesit dhe investimeve të reja për të përmirësuar proceset administrative kanë kontribuar në një raport të lartë operacional. (World Insurance Report, 2011)

Siguruesit janë duke bashkëpunuar me bankat dhe rrjetet e tjera, të cilat i kanë rritur kostot e integritit si dhe kanë rritur treguesit operacional. Presioni i vazhdueshëm i çmimit, është duke detyruar siguruesit, të përmirësojnë proceset operative dhe administrative, për të arritur efikasitet më të madh dhe afatgjatë.

Strategjia e shpërndarjes ka qenë duke kaluar nëpër ndryshime radikale, sikurse siguruesit qe ndjekin më shumë kanale të drejtpërdrejta, të tilla si, Interneti, bancassurance dhe aplikacione mobile (levizese). (Raporti Botëror Sigurim, 2011)

Shpenzimet e blerjes kanë qenë të qëndrueshme, si shitjet nëpërmjet kanaleve direkte kanë qenë trend ne rritje. Faqet e rrjeteve sociale janë duke u bërë të zakonshëm të përdoren për kërkim dhe shkëmbim informacioni, në lidhje me produktet e sigurimit, përvojën e konsumatorit, dhe vleren për para.

Secila, është kritike për marrëdhëniet e konsumatorëve dhe rezultatet, dhe ka leva të shumta që ndikojnë në performancën që ofron potencial të madh për përmirësim. Pretendimet, megjithatë, janë më të rëndësishme për Siguruesit e Jo-Jetës, ndërsa aktivitetet janë po aq përkatëse për jetën, shëndetin dhe biznesit te Jo-Jetës.

Bibliografia:

1. Booz, Allen & Hamilton (1982), *New Products Management for the 1980s*, Booz Allen & New York, NY.
2. Blom F., Kuenen J.W. (2009), *Building a Crisis-proof Insurance Sector in The Netherlands* Boston Consulting Group, BV
3. Marietta Janowicz- Lomott and Krzysztof : *Domestic insurers in Poland and the global crisis*
4. De Brentani, U. (1991), *'Success Factors in Developing New Business Services'*, Euro Marketing, Vol. 25 No. 2 , pp. 33-59.
5. Cooper, R. G: *The New Product Process : a Decision Guide for Management*, Journal of Marketing Management, Vol.3, No 3.
6. Peters, T. *Get Innovations or Get Dead*, California Management Review, Vol 33, No1.
7. Scheuing, P. *A Proposed Model for New Service Development*, Journal of Service Marketing, Vol.3, No.2.
8. *World Insurance Report*, 2011

DISA PROBLEME MBI RITMET E RRITJES DHE MODELET E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Hysen Xhaja
Universiteti Vitrina
Alban Beqaj

ABSTRACT

Some of the main topics addressed in this paper are: GDP growth rates as an indicator of the evaluation of the level of economic development. The concept of economic development rates and the correlation with the level of economic and social development of a country. When can a developing economy be considered high rates economy. What is the trend of the growth rate in the global, regional and national economy. Sustainable economic development and growth rates. Why there is the need for more than one indicator to reflect the level of economic and social development of a country. The trend of „braking“ rates in global and national level. The new concept of sustainable development level and the need to educate the public on the „stem“ of growth rates.

Keywords: GDP growth rates, economic development model, Albania

I. Ritmet e rritjes në mendimin ekonomik

Problemet ekonomike të shfaqura në formën e dukurive të ndryshme kanë preokupuar njeriun gjatë gjithë historisë së zhvillimit ekonomik, së paku që nga koha kur lindën sistemet e zhvillimit ekonomik.

Të parët që u morën me problemet e zhvillimit ekonomik ishin filozofët e

lashtë grekë dhe indianë, ku spikatën Aristoteli (382-322 p.e.s) dhe Platoni (427 - 347 p.e.s). Ata kanë shkruar rreth problemeve të pasurisë, prodhimit, mbi mënyrën e shtimit të tyre, si dhe për tregtinë, ku spikat qëndrimi kritik ndaj saj. Në veprën e tyre diskutonin për artin e zotërimit të tyre, nëse pasuria duhej të zotërohej nga qytetarët apo nga qeveritë në përfitim të qytetarëve. Kemi të bëjmë me zanafillën e nevojës së shtetit si institucion dhe të funksioneve të tij.

Mendimin ekonomik e gjejmë më pas në besime dhe ideologji të ndryshme, të cilat janë munduar të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për problemet ekonomike të kohës, në interes të njerëzve, duke ndikuar kështu në rrjedhën e marrëdhënieve ekonomike. Më pas, për një periudhë të gjatë kohe, debati për këtë problem u venit derisa vijmë në shekullin e 18-të, ku pati një shpërthim të mendimit ekonomik që filloi nga koncepti bazë mbi ekonominë e që u pasua me formësimin gradual të doktrinës ekonomike.

Filozofët klasikë mbi ekonominë si Adam Smith (1773-1790), Thomas Robert Maltus (1766-1834) dhe David Rikardo (1772-1923) janë të parët që filluan të përdorin konceptet bazë si kërkesa dhe oferta, specializimi i punës, bilanci i tregtisë ndërkombëtare. Ky mendim i tyre ishte produkt i zhvillimit ekonomik të kohës, që kërkonte në një farë mënyre konceptim të drejtë të marrëdhënieve të krijuara. Ai u hodh në një territor të pazbuluar dhe ravijëzuar, por pati rëndësinë e vet dhe ndihmoi në krijimin e bazave të shkencës ekonomike, e cila në mënyrë më të hollësishme u konturua nga mendimtarët dhe ekonomistët e ardhshëm. Këta pionierë të shkencës, zbuluan ligjet ekonomike dhe u përpoqën ta bëjnë ekonominë një shkencë me objekt, ashtu si shkencat ekzakte, fizika dhe astronomia, që lulëzuan në atë periudhë. Ata vepruan dhe menduan në kontekstin dhe mentalitetin e kohës që jetuan dhe të marrëdhënieve ekonomike që përjetuan.

Në shekullin e 17-te dhe të 18-të, si rrjedhojë e kolonizimit të territoreve, u evidentuan dukuri të tjera. Struktura politike në Evropë po kërcënohej me shfrytëzimin e kolonive, tregtarët po pasuroheshin, ndërkohë që hasën pengesa në zgjerimin e pasurive e të privilegjeve nga aristokracia dhe institucioni i kulteve - kisha.

Adam Smith në veprën e tij "Pasuria e Kombeve", një nga shtyllat e rëndësishme të mendimit politiko-ekonomike, bën fjalë për një epokë të artë, e cila i paraprin përvetësimit të tokave dhe akumulimit të kapitalit, në të cilën vetëm puna merrej parasysh, ndërsa toka ishte në dispozicion të të gjithëve. Çdo mall tregtohej me çmimet, të cilat ishin proporcionale me punën e harxhuar për prodhimin e tyre. Smith shikonte një marrëdhënie dallimi midis interesit të individit dhe interesit të shoqërive. Ai përcakttoi se marrëdhënia midis tyre

sigurohet nga mekanizmat e kombinimit. Kombinimi lejon lojën e përbashkët të kërkesës dhe ofertës. Ky përcaktim ka vlerë edhe sot.

Nga ana e vet, Maltusi studioi lidhjen që ekziston midis popullsisë dhe ekonomisë në kushtet e një rritjeje të pabalancuar. Teoria e tij mbështetet në të ardhurat marzhinale zbritëse. Sipas Maltusit, nëse rritja e popullsisë nuk kufizohet, atëherë ajo do të rritet në progresion gjeometrik për çdo brez pasardhës. Për rrjedhojë, çdo individ do të ketë më pak tokë dhe burime natyrore për të punuar. Por, kjo epokë e artë nuk mund të vazhdojë për shumë kohë, kur toka të popullohet plotësisht. Ajo bëhet burim i rrallë dhe me rritjen e popullsisë, prodhimi mund të rritet ngadalë. Ai përcaktoi për herë të parë dukurinë e rënies së ritmeve, që sot është ndër problemet thelbësore të teorisë dhe praktikës ekonomike, në kushtet e krizave permanente.

Në periudhën e ekonomisë politike klasike zë fill shkencat moderne ekonomike, e cila kulmin e saj e arriti në fillim të shekullit të XIX. Duhet të saktësojmë se, mendimtarët ekonomistë e filozofë të kësaj periudhe ishin të lidhur drejtpërsëdrejti me punën dhe interesat ekonomike. Disa prej tyre ishin afaristë si David Rikardo. Ata i studionin problemet që i interesonin klasës kapitaliste dhe ishin të lidhur ngushtësisht me interesat e nevojat e tyre. Periudha e profesionalizmit të shkencës ekonomike është ajo e marzhinalizimit. Në këtë kohë mësimdhënësit e universiteteve filluan të merren me “ekonomiken” dhe ajo bëhet shkencë universitare .

Teoricienët e ekonomisë përcaktuan se instrumenti kryesor dhe “arbitër” i kërkesës dhe ofertës, ishin çmimet, të cilat ndikonin në realizimin e shpërndarjes së burimeve, madje shumë më mirë se një menaxher, administrator apo burokrat.

Pikëpamjet e tyre të shekullit të XVIII-të ishin të natyrës klasike-liberale, nga ku buroi dhe termi “*laissez faire*”, nga frëngjishtja “*le të bëjmë*”. Ata treguan se drejtuesit e ekonomisë, menaxherët duhet t’i lënë tregjet të funksionojnë vetë, të përballojnë çmimet e mallrave dhe të shërbimeve pa ndërhyrje nga jashtë, (nënkuptonin qeverinë). Ata shpjeguan qartë se, tregu, si një hyjni dashmirëse, punonte dhe funksiononte vazhdimisht në të mirën e njerëzve duke shpërndarë të mirat e natyrës dhe produktet e punës njerëzore, sa më drejtë dhe më sa më shumë efektivitet. Në fakt, jo të gjithë përfitonin njësoj nga proceset e industrializimit dhe politikat kolonizuese. Tregu më shumë punonte dhe punon në favor të atyre që bërjen e parasë e kishin moton kryesore të punës, interesin kryesor të jetës (bankierëve, tregtarëve, industrialistëve etj.). Të privilegjuarit ishin dhe janë të pasurit që dinë të administrojnë dhe menaxhojnë mirë pasurinë në çdo kohë.

Këtë pabarazi sociale dhe ekonomike, shumica e ekonomistëve dhe teoricienëve të ekonomisë e konsideronin si të drejtë. Sipas tyre, ai që punon dhe rrit aktivitetin ekonomik duke aktivizuar të tjerë në shtimin absolut të këtij aktiviteti, ndihmon në plotësimin e interesave të tyre. Për këtë arsye, tregu nuk mund të jetë i padrejtë. Ky ishte argument që justifikon padrejtësisë dhe deformimet e tregut.

Teoricienët e hershëm të ekonomisë ishin të ndërgjegjshëm dhe kuptonin drejtë karakterin e kufizuar të burimeve natyrore. Kjo është arsyeja që, qysh në kohën e tyre, ato shpjegonin saktë “fundin e rritjes” ekonomike, problem ky imediat në kohën e sotme. Ata saktësisht parashtruan se, faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik ishin puna, toka dhe kapitali. Me tokë, ata kuptonin të gjitha burimet natyrore, të papërsëritshme me karakter të kufizuar. Do të vijë një moment kohor që zhvillimi i ekonomisë me ritme do të përfundojë, nënvizonin ata. Këto pikëpamje i gjejmë shumë qartë te Smithi dhe Maltusi. Madje në mendimin e Jon Stjuart Mill, filozof dhe teoricien i ekonomisë politike gjejmë, gjejmë këtë konkluzion: *“Duhet të këtë qenë gjithmonë e qartë për ekonomistët e politikës se, zmadhimi i pasurisë nuk mund të vazhdojë pa fund, se, në vazhdim të zhvillimit progresiv, vjen stanjacioni”*.

Për herë të parë, problemin e ritmit të rritjes e hasim tek Adam Smith, i cili hodhi idenë e “përmirësimit” të jetës. Dalëngadalë nga idea e mjegullt e “përmirësimit” ose “progresit” u kalua tek “rritja” në kuptimin e tanishëm ekonomik-formalisht si rritje e prodhimit të brendshëm bruto (GDP).

Adam Smith, por edhe Tomas Maltus e përshkruajnë zhvillimin ekonomik duke analizuar lidhjen që ekziston midis burimit të prodhimit, tokës dhe rritjes së popullsisë. Në veprën e tij *“Pasuria e kombeve”*, Adam Smith bën fjalë për një epokë të re të artë, e cila i paraprin epokës së përvetësimit të tokës dhe kapitalit në të cilën merrej parasysh vetëm puna e harxhuar për prodhimin e tyre. Kur toka të popullohej plotësisht vjen dhe fundi i epokës së artë. Toka bëhej burim i rrallë dhe shoqëruar me rritjen e popullsisë çon në uljen e ritmeve të rritjes së prodhimit. Ndërsa Tomas Maltusi e studion lidhjen e popullsisë me ekonominë në kushtet e një rritje të pabalancuar. Teoria e tij mbështetet në teorinë e të ardhurave marzhinale zbritëse, duke mos marrë parasysh efektin e ndryshimit të teknologjisë në rritjen e prodhimit. Ai argumenton se, shkak i varfërisë (por dhe i rritjes së prodhimit) ishte rritja e popullsisë në progresion gjeometrik në krahasim me rritjen e prodhimit.

Në shekullit e XIX pati ndryshime të rëndësishme në konceptimin e faktorëve të prodhimit, të teorisë së maksimizimit të fitimit (si risi) dhe zgjedhjes racionale. Në këtë periudhë, gjithnjë e më shumë vlerësoheshin puna dhe kapitali si faktorë ekonomike të zhvillimit. Toka u konceptua si nënkategori

e kapitalit. Një konceptim i tillë ishte baza e reformimit të teorisë ekonomike klasike në neoklasike.

Në shekullin e XX, teoria ekonomike arriti pjekurinë e saj duke u plotësuar me koncepte e kategori të reja, nga mendimi ekonomik. Kështu u eksploruan modelet e konkurrencës jo perfekte, teoritë e formimit të tregut etj. Madje u përdor metoda e analizës dhe grafiku i te ardhurave marxhinale. Për shkak të një terminologjie disi të pakuptueshme, teoria ekonomike filloi të njihej edhe pranohej si shkencë, por siç nënvizohej rëndom, ishte e “zymtë”.

Adam Smith “ndërtoi” ngrehinën e parë të mendimit ekonomik e cila u lëkund kur Karl Marks, ekonomisti dhe filozofi më me influencë në shekullin e XIX, sistemin ekonomik të kohës e emërtoi kapitalizëm. Ishte sistemi që mbështetej mbi kapitalin, që deri në atë herë reduktohej në një formë tjetër të parasë. Kapitali ishte pasuri, tokë, ndërtesa apo makina, që është lënë mënjanë, akumuluar, për tu futur në qarkullim më pas, me synim prodhimin më shumë vlera pasuruese dhe materializuar në formulën P-M-P (para - mall- para). Si pasuri private, kapitali ka në tendencë rritjen në procesin konkurrues të kapitaleve. Ndërsa kapitalizmi i shekullit ishte i përqendruar, sipas Karl Marksit, ai çoi në rritje të madhe ekonomike, por dhe në tensione sociale nga pabarazia e thelluar pasurore.

Pas depresionit të 1893, kolapsit të 1907 dhe depresionit të madh të 1930, për shumë analistë të kohës dukej se, kapitalizmi po dështonte. Revolucioni bolshevik i tetorit 1917, i udhëhequr nga Lenini, shërbeu si frymëzim i ideve të Karl Marksit dhe teorisë së tij të marksizmit mbi bazën e se cilës u formuluan ide dhe kategori ekonomike që do t'i shërbenin sistemit të centralizuar të ekonomisë.

Teoricienët e hershëm të ekonomisë ishin të ndërgjegjshëm dhe kuptonin drejtë karakterin e kufizuar të burimeve natyrore. Kjo është arsyeja që, qysh në kohën e tyre, ato shpjegonin saktë “fundin e rritjes” ekonomike, problem ky imediat në kohën e sotme. Ata saktësisht parashtruan se, faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik ishin puna, toka dhe kapitali. Me tokë ata kuptonin të gjitha burimet natyrore, të papërsëritshme me karakter të kufizuar. Do të vijë një moment kohor që zhvillimi i ekonomisë me ritme të larta do të përfundojë, nënvizonin ata. Këto pikëpamje i gjejmë shumë qartë te Smithi dhe Maltusi. Zbatimi i ideve të Kejnesit mbi ndërhyrjet shtetërore, në mënyrë të plotë gjetën materializim në programin e viteve 30-të i quajtur “Marrëveshje e Re” e Franklin Rusvelt me shpenzimet dhe kredimarrjen masive që u zbatuan gjatë periudhës së luftës apo pas depresionit të kohës.

Mendimi ekonomik në vijim u zhvillua me tej mbi bazën e një konkurrence idesh midis tri palëve: social-liberaleve, kejnesianëve, pasuesve të Karl Marksit

dhe mendimtarëve ekonomistë neoklasikë, ose neoliberalë. Thelbin e kësaj përplasje mendimesh dhe platformash e përcaktonte raporti midis shtetit dhe tregut të lirë, e cila për një kohë të gjatë pengoi eficensën e tregut të lirë.

Një vend të veçantë në mendimin ekonomik të asaj kohe, në aspektin teorik e praktik zë teoria e cikleve ekonomike. Në punimet e Hotrit, Kejnesit dhe Robertsonit trajtohet analiza e raportit në mes të çmimeve dhe politikës monetare si dhe ndikimi i tyre në ecurinë ekonomike, për rrjedhojë dhe ritmeve të rritjes. Në teorinë e cikleve shpjegohet qartë se, kush janë faktorët përcaktues të rritjes ekonomike që u zhvilluan me pas nga Haroldi etj.

Pas rënies së sistemit socialist, pikëpamjet neoliberale gjetën një terren më të gjerë për zbatim. Në shumë vende të zhvilluara gjetën zbatim politikat e liberalizmit ekonomik. Në këtë drejtim spikasin Anglia she Sh.B.A ku u zbatuan rastet e neoliberalëve për ekonominë. Sipas Margaret Theçer, *“shteti nuk është zgjidhja, por problemi”*.

Si Margaret Theçer ashtu edhe Ronald Regan ishin idhtarë të shkollës së Çikagos ku u diplomuan disa gjenerata ekonomistësh të shquar monetaristë si Milton Fridman (1912-2000) dhe Fridrich Aron Hayek (1899-1992), të dy nobelistë në ekonomi. Më pas shquhet një tjetër ekonomist neoliberal më ndikim të madh në Sh.B.A si Alan Greenspan, i cili nxiti politikat e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, duke qenë në detyrën e Guvernatorit të Rezervës Federale në vitet 1987-2006. Si shkolla e Çikagos, ashtu edhe ajo e austriake, zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e saj e shikonin tek liria e tregjeve.

E gjithë historia e zhvillimit ekonomik botëror vërteton karakterin ciklik të zhvillimit. Krizat kanë qenë bashkudhëtarë të historisë të zhvillimit ekonomik. Gjithsesi, duhet pranuar se për një periudhë të gjatë kohe, vendet më kryesore (të zhvilluara) kanë pasur ritme të kënaqshme rritjeje.

Që nga viti 1870 e deti në fund të viteve 90 të të shekullit të kaluar, treguesi i rritjes mesatar vjetore për fryme të GDP-se ka qenë rreth 2.4%, duke pasur një karakter të qëndrueshëm zhvillimi në 16 vendet më të zhvilluara përfshirë Amerikën e Veriut, Evropën Perëndimore, Japoninë dhe Australinë. Për periudha të caktuara, treguesi i rritjes mesatare për frymë të GDP-se varion si më poshtë vijon:

Periudha e llogaritur	Ritmi monetar për fryme të GDP-së.
1870 - 1913	2.5%
1913 - 1930	1.9%
1930 - 1973	4.8%
1973 - 1996	2.6%

Kur flasim për rritje ekonomike, si parametri thelbësor që shpreh përmbajtjen e zhvillimit ekonomik në nivel kombëtar e më gjerë, kemi parasysh periudhën afatgjatë të zhvillimit. Përveç faktorëve bazë, kjo rritje (rritja e mësipërme) ka ardhur për shkak të zbatimit të teknologjive të përparuara dhe zbulimeve shkencore të avancuara. Periudhat e llogaritura pasqyrojnë dhe ndikimin e krizave ekonomike, si bashkudhëtare të zhvillimit.

Kriza më e hershme financiare financiare është ajo e vitit 1907, ku treguesi i bursës amerikane u rrënuar brenda një viti 2 herë dhe Banka Kombëtare Amerikane falimentoi për shkak të menaxhimit të dobët. Një tjetër krizë e madhe dhe e rëndë është ajo që quhet “e marta e zezë” në vitin 1929, kur 10 miliardë dollarë në tregun e bursës u kthyen në hi. Kjo ishte një ngjarje që shërben si pararendëse e “depressionit të madh. Kriza e naftës e vitit 1973 ishte gjithashtu me përmasa të mëdha dhe u pasua nga ajo e vitit 1987 me karakter global.

E hëna e zezë e 19 tetorit 1987 çoi në shkatërrimin masiv të tregut të bursës ku u zhdukën 500 miliardë dollarë, nga Banka e New Yorkut. Kriza e 1987 nuk u paralajmërua fare, një pikëpyetje e madhe që nuk ka marrë përgjigje nga analistët e krizave deri më sot. Në fund të tetorit të vitit 1987, tregu australian ra 41% ai i Kanadasë 22% dhe ai i Britanisë së Madhe ra 26%, etj. Një teori e kohës ja atribuoi këtë shkatërrim global të tregjeve një programi mbi rritjen e menjëhershme të tregtisë së kompjuterave “Wall Street”

Që nga viti 1980, kur filluan luhatjet e shpeshta, ato vazhdojnë edhe sot e kësaj dite në ekonominë botërore. “Fatkeqësia” greke ka trokitur edhe në Spanjë, Portugali, Itali etj. Ekonomia globale është në krizë, përjashtuar disa vende në zhvillim. Kjo ka bërë që të shtrohet përpara mendimit ekonomik bashkëkohor çështja e vazhdimësisë së rritjes ekonomike e globale e rajonale. Ky realitet i zymtë përbën një sfidë për të dy kampet e mendimit ekonomik. Është sfidë për neoliberalët, politikën liberale të cilave ishin kryekëput përgjegjëse për filluskën e hipotekave, plasja e të cilave nga shumica e analistëve besohet si interesi i krizës. Por është rebus dhe për keinesianistët, paketat stimuluese të cilave në shumë raste kanë dështuar, me synimin e tyre për të krijuar punësim dhe zgjerim të ekonomisë.

Pra, sot kemi jo vetëm krizë të ekonomisë, por edhe krizë të teorive dhe mendimit ekonomik. Kriza tregon se ka ardhur koha të mendohet më seriozisht për të ardhmen e ekonomisë globale e të shoqërisë njerëzore. Rritja ekonomike nuk është dëshirë, nuk realizohet me urdhra dhe eufori politike. Rritja ekonomike është një nevojë e domosdoshme për zhvillimin ekonomik e social, në çdo stad të këtij zhvillimi. Ajo varet nga faktorët e saj, të cilët po

u konsumuan, pa menduar për të nesërmen e largët, të bëjnë të mendosh seriozisht për të sotmen dhe të ardhmen.

Në pikëpamjen tonë, por jo vetëm, gabimi kryesor i dy rrymave të mendimit ekonomik është se ekonomia mundet dhe duhet të rritet vazhdimisht, duke "harruar" karakterin e kufizuar të burimeve të rritjes. Nga pothuaj të gjithë ekonomistët postklasikë, toka klasifikohet si nënkategori e kapitalit, ndërsa natyra konceptohet si bashkësi e ekonomisë njerëzore, si një grumbull i pafund burimesh që mund të transformohen në pasuri. Më tej, kjo nënkupton gjithashtu se, burimet natyrore mund të zëvendësohen gjithmonë në forma të tjera të kapitalit. Mjafton të disponosh para dhe teknologji. Në të vërtetë, ekonomia globale dhe kombëtare ekziston brenda natyrës dhe është plotësisht e varur prej saj, pasi edhe shumë burime natyrore janë të pazëvendësueshme. Përdorimi i tyre duhet të jetë racional dhe me kritere shkencore, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë edhe brezat e ardhshëm.

Një interpretim i tillë logjik e çoi shoqërinë gradualisht drejt ndryshimeve klimatike si dhe drejt shterimit të burimeve natyrore. Me këtë shpjegohet mossauesi i interpretimit teorik dhe i përballimit të suksesshëm të kërcënimeve ekzistenciale ekonomike dhe ambientale që rrezikojnë njerëzimin. Ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur si rezultat i shkatërrimit të mjedisit global, janë një sinjal që duhet vlerësuar seriozisht. Ndërsa, krizat e vazhdueshme që prekin ekonominë botërore, kombëtare apo rajonale janë një tregues që tregon se, zhvillimi ekonomik social ka vështirësi rritje.

"Frenim", apo fundi i rritjes ekonomike

Rritja ekonomike shprehet nëpërmjet treguesit të G.D.P për frymë të popullsisë për më shumë se 75 vjet. Ecuria e zhvillimit të ekonomisë globale rajonale dhe e vendeve të zhvilluara po tregon se treguesi i rritjes ekonomike ka një trend negativ në rënie. Rënit e vazhdueshme ekonomike janë pasqyrim i këtij trendi. Ky fakt ka hedhur për diskutim problemin e qenies së GDP-së si matës i rritjes ekonomike. Në shumë artikuj, madje edhe në seminare apo konferenca shkencore është diskutuar ky problem, kohë më parë, ku mbështetet kjo tezë apo ky argument dhe sa të qëndrueshme janë.

Sipas disa autorëve, rritja e GDP-se nuk mund të shërbejë si matës i vetëm i rritjes ekonomike, sepse ajo ka karakter të kufizuar në aspektin e llogaritjes së mallrave apo shërbimeve që prodhohen në një vit kalendarik. Në këtë kuptim, ky tregues nuk shpreh në mënyrë të saktë dhe të plotë nivelin e jetesës. Tre janë faktorët sipas të cilëve GDP nuk kryen saktë funksionimin e mësipërm.

- Si treguesi i pasqyrimin të rritjes ekonomike, GDP mat vetëm vlerën e mallrave dhe shërbimeve që hidhen në treg, pra kufizon madhësinë e vërtetë të vlerës që prodhohet brenda një viti.
- Treguesi i GDP-së nuk mund të masë dhe shprehë në vlerë monetare veprimtarinë e sektorëve jashtë tregut si ekonominë familjare, ekonominë informate, e cila teorikisht llogaritet nga 30% deri në 50% në vende të caktuara, apo kostot e shërbimit, të ruajtjes së rendit, mbrojtjes së mjedisit prej ndotjes, etj.
- Është i njohur fakti që GDP është treguesi kryesor që shpreh nivelin e jetesës, mirëqenies së popullit, ndonëse jo plotësisht. Nisur nga argumentet e mësipërme, GDP nuk mund të shprehë në terma nominalë nivelin e individëve, familjeve dhe më gjerë, sidomos kur ke të bësh me shërbime që japin kënaqësi apo strese, që janë pasojë e pabarazisë ekonomike, papunësisë, varfërisë, etj.

Në zhvillim të këtyre tre problemeve duhet theksuar se, jo çdo rritje e GDP-së është tregues zhvillimi, aq më tepër në vendet e zhvilluara. Duhet parë nga vjen rritja. Nëse vjen si rezultat i shfrytëzimit të tepruar të pasurive natyrore dhe i eksportit nuk ka të njëjtën vlerë me një rritje modeste në dukje, por që vjen si pasojë e përpunimit në vend të pasurive (e dyta ka shanse për rritje të qëndrueshme). Kur flasim për rritje duhen analizuar faktorët që kanë sjellë rritjen në vende dhe periudha kohore të ndryshme, pasi ato japin efekte jo të njëjtë. Kështu nga përllogaritjet del se, për të prodhuar një njësi GDP-je në vendet e Evropës Juglindore është përdorur 1.7 dhe 3.9 herë më shumë energji në krahasim me mesataren e BE-së. Kjo tregon mungesën e efikasitetit ekonomike me ndikim në ritmet e rritjes.

Nisur nga ecuria 10-vjeçare në luhatjet e GDP-së dhe treguesit e ritmeve të rritjes së saj, që në vitet 60 -70-të, në literaturën e kohës u hodh për diskutim ajo që u quajt "ndal rritjes", e cila gjeti publikim në klubin e Romës.

Sot ekziston një rrymë e cila parashtron teorinë që, ekonomia e rritjes nuk duhet të konsiderohet si lineare, por i nënshtrohet problemeve që mbështeten në tre parime:

a. Kapacitetet e asimilimit të burimeve të natyrës jo të kufizuara dhe sistemet e modelet ekonomike duhet të shihen në proces transformimi

b. Duhet mbajtur në konsideratë kushtet e zëvendësimit midis burimeve të rinovueshme dhe atyre të parinovueshme.

c. Duhet respektuar kushtet e rinovimit të burimeve natyrore të rinovueshme dhe fakti që njerëzit nuk janë vetëm përdorues të burimeve natyrore, por edhe ndërtues e zhvillues.

Në periudhën e tanishme, analiza e treguesve makroekonomike tregon se, kriza e viteve 2008 që vazhdon, ka ndërprerë trendin pozitiv të zhvillimit të vendeve të Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Në raportin e fundit të Bankës Botërore, lidhur me zhvillimin ekonomik të këtij rajoni, parashikohet një rritje e ngadaltë në vitin 2012, në raport me vitet e mëparshme që ishte diku (tek 6-10 %).

Kriza 2007-2008 ka qenë e parashikueshme dhe e pashmangshme. Kjo krizë shënon një kthesë të thellë të përhershme për disa dekada zhvillimi pas një periudhe ku ekonomistë të ndryshëm përhapin mendimin se rritja ekonomike e vazhdueshme është e mundur për tu arritur. Koha po vërtetohet të kundërtën.

Tashmë janë krijuar pengesa të pakapërcyeshme ndaj rritjes së mëtejshme ekonomike dhe bota në përgjithësi i përjashton disa vende në vazhdim, po ballafaqohet me këto pengesa dhe po ndjen efektin tyre.

Kur flitet për rritje ekonomike duhet të kemi në konsideratë një rritje afatgjatë të qëndrueshme e cila përballon zhvillimet strategjike dhe përmirësimet e nivelit të jetesës. Kjo do të thotë se rritja afatshkurtër, nga një tremujor në tjetrin ose nga një vit në tjetrin nuk shpreh atë që kërkohet.

Trendi i përgjithshëm është rënia ekonomike, ulja e ritmeve të rritjes.

Faktorët e rritjes ekonomike (dhe zhvillimet ekonomike)

Zhvillimi ekonomik varet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, endogjen dhe ekzogjen. Mobilizimi dhe bashkëveprimi i këtyre faktorëve në kohë çon në rritjen ekonomike. Nëse njeri nga grupi faktorët nuk funksionon atëherë nuk ekzistojnë kushtet dhe premisa për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Sot duket se, ndër faktorët që kanë kufizuar rritjen dhe zhvillimin ekonomik, si dhe uljen e ritmeve të rritjes janë kriza e borxheve, borxhet e mëdha dhe të pakthyeshme, publike dhe private, si dhe kredia hipotekare, plasja e flluskës së pasurive të paluajtshme. Prezumohet nga shumë analistë se, kur këto probleme të zgjidhen, rritja ekonomike dhe mund të fillojë (afatgjate.)

Për të gjykuar për rritjen ekonomike duhet doemos të analizohen faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në mënyrë të veçantë duhen analizuar faktorët e jashtëm të cilët mundësojnë fillimin e rritjes ekonomike.

Katastrofa e naftës në vitin 2010 në SHBA (në Gjirin e Meksikës) tregoi se, kanë shteruar burimet e naftës afër tregut, ku si shpimi ashtu edhe nxjerrja janë me kosto më të ulët. Zonat afër bregut janë të eksploruara dhe fushat naftëmbajtëse të tyre janë në shterim. Sipas disa studimeve, një pjesë e mirë

e prodhimit botëror të naftës do të vijë nga fushat naftëmbajtëse në det, ku kostoja dhe çmimi në treg i produkteve të saj do të jetë më i lartë.

Në kohët e sotme janë evidente ndryshimet klimaterike, që shkaktojnë thatësia rajonale, përmytje, pse jo edhe kriza në produktet ushqimore.

Pakësimi i ujit dhe energjisë, shoqëruar nga krizat financiare që kanë çuar në falimentimin e bankave, bizneseve, si dhe ngurtësimi i shtëpive në hipoteka janë probleme që duhen vlerësuar me seriozitet. Kriza greke, ajo spanjolle e portugeze janë sinjale për situata të vështira që mund të përsëriten dhe që rrezikojnë sistemet ekonomike dhe politike për ekzistencën.

Problemet e mësipërme kanë karakter të ndërvarur, në kushtet kur popullsia njerëzore vjen në rritje, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, shtohet kërkesa për rritjen e konsumit për frymë të burimeve të shterueshme (me burime të parinovueshme) të cilat kanë çuar në ndikime negative në mjedis.

Faktorët e rritjes ekonomike duhen parë në unitet në kompleksitetin e tyre, jo të shkëputur, siç ndodh rëndomtë nga analistët financiarë. Kriza e zgjatur e viteve të fundit ka treguar se, këto faktorë kanë vepruar njëkohësisht, pavarësisht nga masa e ndikimit të tyre, veç e veç, e cila gjithsesi nuk është simbolike.

Dekada të tëra grumbullimi borxhesh kanë krijuar një kolaps financiar që ka çuar në rënien e ritmeve në nivel global e rajonal. Ne jemi dëshmitarë të një tranzicioni, nga dekada rritje ekonomike, në periudha rënie, apo frenimi.

Rëndësia e rritjes ekonomike

Treguesi i rritjes ekonomike ka shërbyer dhe shërben dhe si motor i nivelit të jetesës dhe treguesve të tjerë socialë që pasqyrojnë këtë nivel.

Që nga shekulli i kaluar e më herët, ky tregues shprehte jo në mënyrë simetrike dhe parametrat e tjerë të zhvillimit. Kështu, rritja ekonomike shoqërohej me rritjen e nivelit të punësimit të investimeve dhe të ardhurave. Ndërsa, në rastin e rënies ekonomike të përkohshme, siç ndodhi gjatë depressionit të madh, sistemet financiare hynë në kolaps dhe ekonomia shfaqti patologjinë e krizës. Ekonomia do të jetë në stanjacion ose recension, do të qarkullojnë më pak para dhe të mira material për frymë, që çojnë në rënien e nivelit të jetesës.

Politikat e rritjes ekonomike kanë shërbyer për “zhvillimin” e ekonomive të varfra në botë. Në sajë të rritjes ekonomike, vendet e industrializuara gëzojnë nivelin e konsumit që kanë sot. Për sa kohë që, ekonomia është në rritje, pritshmëritë janë të larta, njerëzit blejnë më shumë të mira, bizneset marrin më

shumë kredi dhe investimi mbi kredinë shlyhet më lehtë dhe në të kundërtën. Ky është një rreth vicioz që nuk zgjidhet pa vështirësi. Situatat e ekuilibrit nuk janë afatgjata. Ka ose rritje ose recension.

Gjatë dy shekujve të kaluar, rritja ekonomike ishte një dukuri normale që nuk u vu në asnjë moment në diskutim. Kur perandoritë ngriheshin dhe binin, ekonomitë lokale rriteshin dhe tkurreshin, por aktiviteti ekonomik global u zgjerua gradualisht. Revolucioni i burimeve fosile e minerale u shoqërua nga një rritje e shpejtë dhe në përmasa të papara në historinë njerëzore. Bota globale e në veçanti vendet e zhvilluara gëzojnë tregues pozitiv si rrjedhojë e përdorimit të gjithë burimeve dhe faktorëve të zhvillimit. Madje, burimet e parinovueshme e të lira janë përdorur në shumë raste në mënyrë barbare deri në shterrimin e tyre.

Mund të themi se, po “përfundon” epoka e burimeve të lira dhe të bollshme dhe në të njëjtën kohë, është tronditur zhvillimi i qëndrueshëm me ritme të larta. Po shtrohet pyetja, jemi në fund të rritjes? Nëse është kështu, si duhet të jetë sjellja e njerëzimit në të ardhmen. Fundi i rritjes nënkupton fundin e një epoke dhe të mënyrave aktuale të organizimit të ekonomisë, politikës dhe të mënyrës së jetesës. Ka autorë që shkojnë deri në ekstrem. Po vjen koha të rikorigojmë jetën e njeriut në tokë nënvizojnë ato, problem ky shumë relativ dhe i diskutueshëm.

Një gjë është e qartë, lipset të vlerësohet drejtë ky moment sidomos nga politikanët, për të mos pasur iluzione për një rritje ekonomike pambarim, në aspektin kohor. Duhet analizuar momenti kohor që po kalon ekonomia globale. Jemi në momentin e “shterimit” të burimeve dhe pamundësisë së zëvendësimit alternativ, simetrik të tyre. Nëse kjo qëndron, duhet të përgatitet gradualisht infrastruktura mbështetëse për të jetuar me një ekonomi jo në rritje, siç jemi mësuar për shumë kohë.

Natyrisht, kur flasim për rritje globale të ekonomisë dhe rënie të ritmeve të saj, kemi parasysh dhe vendet e zhvilluara. Kjo, sepse në vendet në zhvillim dhe tranzicion do të vazhdojë modeli i ritmeve të larta të zhvillimit ekonomik, por dhe në këtë rast duhet të përcaktojmë saktë çfarë kuptojmë me zhvillim me ritme të larta dhe më pas zhvillim të qëndrueshëm.

Në literaturën ekonomike ka dy koncepte mbi ritmet e larta të rritjes.

Sipas konceptit të parë, ritmet përcaktohen nga niveli bazë. Kështu, në ekonominë e centralizuar të vendit tonë, niveli bazë i rritjes ishte viti 1933. Me këtë shpjegohet dhe niveli i ritmeve që propagandohej në atë periudhë. Për analogji, ekonomia krahasohet me krahët e fishkura të një zogu të vogël, i cili, për të fluturuar lirë, i lëviz ato shpejt. Kështu, një ekonomi me bazë më të ulët

do të karakterizohet nga ritme të larta në fazat e zhvillimit. Sipas konceptit të rritjes, ritmi i rritjes konsiderohet i lartë, kur ai është dy herë më i lartë nga ai i rritjes së popullsisë njerëzore.

Duke u nisur nga dukuritë e tanishme të zhvillimit global, rajonal e kombëtar, shtrohet problemi i ritmit normal dhe cilët janë faktorët e kushtet që përcaktojnë një tregues të tillë. Ky koncept është shumë relative.

Ekonomia është sistem kompleks që funksionon si një organizëm i gjallë. Në një masë të caktuar ndjek rregulla të ngjashme me sistemet biologjike. Bimët dhe kafshët kanë prirje të rriten shpejt kur janë fidanë, (të rinj, por arrijnë përmasa pak a shumë të qëndrueshëm kur rriten. Te këto organizma, shpejtësia e rritjes (ritmi i rritjes) përcaktohet nga faktorë gjenetikë dhe mënyra e të ushqyerit.

Në ekonomi, rritja varet nga burimet disponibël energjetike “si ushqim”, për sistemin e industrisë dhe të kredivë si “oksigen” për zgjerimin e ekonomisë. Kjo rritje realizohet në mënyrë të programuar dhe kërkon menaxhim sa më shkencor të burimeve. Kur planifikojmë përdorimin e burimeve në mënyrë sa më eficiente, duhet të kemi parasysh t’i përgjigjemi nevojave të brezit të sotëm, pa rrezikuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të përballuar nevojat e tyre.

Ishin burimet minerare që mundësuan zhvillimin e shpejtë gjatë shekullit 19-të dhe 20-të. Kjo bëri që, në mendimin ekonomik të mbizotërojë ideja që rritja me ritme të larta mund të jetë e vazhdueshme. Ashtu si në sistemet biologjike edhe në ekonomi vjen një moment që ndërpritet rritja si pasojë e karakterit të kufizuar, të pamjaftueshëm të burimeve. Një drejtim tjetër që ndikon në rënien e ritmeve është dhe zëvendësimi alternativ i produkteve.

Ky zëvendësim nuk mund të veprojë përjetësisht, përfshirë këtu dhe eficienten si faktor të rëndësishëm rritjeje. Këto dy faktorë janë gjithashtu nën ndikimin e magjisë së tregut. Gjetja e zëvendësimit të burimeve në shterim dhe rritja e eficientës janë problem më i vështirë dhe padyshim synimi strategjik për përshtatje në ekonominë e tregut. Kjo duhet të ndodhë, në një kohë që bota reale nuk komandohet nga ligjet e ekonomisë, sesa nga ligjet e fizikës. Në botën reale disa të mira nuk kanë zëvendësues. Disa zëvendësues janë me kosto shumë të lartë. Disa të tjerë nuk mund të prodhohen shpejt në kohë për të bërë zëvendësime të tjerave që shterojnë. Kurse eficienta ka të bëjë më masën e shtimit ose pakësimit të përfitimeve. Çdo rritje e eficientës bëhet me kosto më të madhe, derisa rritja e saj mund të bëhet e paleverdishme. Në fund të fundit, jo çdo produkt mund të zëvendësohet dhe jo çdo gjë mund të transformohet. Kjo do të thotë që, rritja brenda një sistemi funksional ka kufij. Teknologjitë e reja mund të krijojnë mundësi që të vazhdojë rritja ekonomike, por baza e

kësaj rritjeje ndryshon, në një kohë që kërkimi shkencor synon të gjejë burime alternative zëvendësuese. Gjithsesi, kjo është hipotetike.

Argumenti se, rritja ekonomike mund të mbarojë një ditë është i vetëkuptueshëm. Ka një ligjësi për rritjen ekonomike. Nëse një sasi rritet rregullisht me një përqindje të caktuar fikse çdo vit, do të thotë së sasia do të shumohet (dyfishohet) çdo disa vite. Sa më e madhe të jetë shpejtësia e rritjes, aq më i shpejtë është dyfishimi. Ekziston një metodë e përafërt e llogaritjes së kohës së dyfishimit që quhet rregulli i 70-ës. Sipas saj, nëse shpejtësia e rritjes është 2% në vit dyfishimi do të ndodh brenda 35 vjetëve. Kur rritja është 5% në vit dyfishimi do të ndodh brenda 14 viteve. Shembulli i rritjes së popullsisë në botë e vërteton këtë. Bumet e popullimit gjithmonë shoqërohen nga rënie drastike dhe vdekje masive. Sot ka hyrë në veprim edhe planifikimi familjar, si masë kufizuese për rritjen e popullsisë. Rasti i Kinës në rritje të lartë ekonomike dhe në kufizim të popullsisë (relativ) tregon se, bota është para një pyetje që është vështirë t'i përgjigjesh. Si do të jetë ecuria e zhvillimit? Ekonomia nuk është një koncept absolut. Ajo përcakton në fund të fundit se si jetojmë në luks apo në mjerim. Rënia e ritmeve na bën të mendojmë se duhet të përshtatemi me realitetet e reja, pavarësisht se nuk e dimë se kur do të ndodhë një ndalim ose fundi i rritjes. Jemi përpara një situatë ku po hidhet në diskutim mendimi ekonomik, modelet e zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Kriza botërore dhe rajonale (Evropiane) është një sinjal. Ekonomia nuk zhvillohet nga deklaratat dhe platformat e fushatave elektorale Deklaratat euforike i shërbejnë politikës, ndërsa ekonomia kërkon mendim e llogaritje ekonomike. Fusha e betejës në këndvështrim pikëpamjesh dhe modelesh është e hapur.

Teoritë ekonomike janë vënë në dyshim. Bashkërendimi i ligjeve të ekonomisë dhe fizikës etj., mund të japë një përgjigje të përafërt për tendencat e zhvillimit të afërt. Tregu dhe konkurrenca janë përcaktuesit e këtij zhvillimi.

Problemet që ngrihen në këtë material nuk ushqejnë situatë pesimizmi. Popullsia globale, rajonale apo e çdo kombi duhet të ndërjegjësohet se, po afrohen situata pa rritje apo me rritje të qëndrueshme. Ato kërkojnë ripërkufizimin e konceptit të zhvillimit dhe të parametrave që e masin e shprehim këtë zhvillim. Kjo kërkon një qëndrim të ri për mendimin ekonomik dhe një mentalitet të ri për popullatën njerëzore kudo që jeton. Veçoritë e zhvillimit të çdo vendi vjen një moment dhe kanalizohen me dukuritë e përgjithshme të zhvillimit të vendeve të zhvilluara. Pa rënë në fatalizëm, duhet që të mendojmë që sot për brezat e ardhshëm, sidomos kur flitet për zhvillim të qëndrueshme.

Konkluzioni:

Zhvillimi i ekonomisë globale, rajonale dhe kombëtare është një dukuri shumë e rëndësishme që ndikon në mënyrën e jetesës dhe plotësimin e nivelit të kënaqësive të individit si konsumator.

Treguesi që pasqyron nivelin e këtij zhvillimi është rritja ekonomike, që shpreh sasinë e GDP-se për frymë të popullsisë. Karakteristikë e këtij treguesi është shpejtësia e tij, që nënkupton rritjen me ritme të shpejta. Rritja me ritme të shpejta ka karakterizuar zhvillimin e ekonomisë globale të vendeve të zhvilluara gjatë dy shekujve të kaluar. Niveli i këtij treguesi varet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të ekonomisë. Nga mënyra se si përdoren këta faktorë, varet edhe niveli i treguesit të ritmeve të rritjes. Eksperiencia e vendeve të ndryshme në botë tregon se, rritja ekonomike nuk kryhet në mënyrë konstante, me një tregues simetrik në kohë.

Gjatë gjithë historisë njerëzore, zhvillimi ekonomik është karakterizuar nga kriza. Ato janë një dukuri të pashmangshme që në çfarëdo lloj forme që shfaqen ndikojnë në rënien e ritmeve të rritjes, sidomos në vendet e zhvilluara.

Përdorimi i koeficientit të burimeve si faktorë të rritjes ekonomike, ka bërë që mendimi ekonomik të vihet përpara dilemës: do të këtë në periudhat e ardhshme rritje ekonomike apo duhet të mendojmë një tjetër model zhvillimi të ekonomisë, që të garantojë jetesën e popullsisë njerëzore. Sot flitet dhe për një koncept tjetër të zhvillimit – zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Ky është një koncept që deri më sot është parë dhe trajtuar në mënyrë të njëanshme. Ka ardhur koha që në treguesit e zhvillimit ekonomik të gjejnë pasqyrim dhe problemet e mjedisit dhe të pasurive kulturore. Kjo sepse zhvillimi i qëndrueshëm duhet parë edhe në aspektin social, kulturore, pse jo dhe politik.

Gjithsesi problemet që ngrihen në këtë material kanë karakter joshterues. Ato kërkojnë një debat të gjerë teorik – shkencor për të përcaktuar modelin dhe alternativën më të mirë të zhvillimit të ardhshëm global, rajonal dhe kombëtar. Një situatë e zhvillimit pa rritje do të kërkonte një ripërkufizim e konceptit të zhvillimit. Ky ripërkufizim duhet shoqëruar dhe në përgatitjen e popullsisë njerëzore me një “mentalitet të ri” të jetuarit pa rritje ekonomike, në një “normalitet të ri”.

Bibliografia

1. Adam Smith "Pasuria e Kombeve" Tiranë 1803;
2. David Ricardo "On the Principles of Political Economy and Taxation" 1817;
3. Th. Maltus "Principles of economie" 1848;
4. John Maynard Keynes "The General Theory of Employment, Interest and Money" 1936;
5. M. Blanque "Historie de l'economie politique en Europe I-II" Paris Guillaumin 1945,1948;
6. A.C Pigou "Economic of welfare (Ekonomia e Mirëqënies)" 1920;
7. J.A. Shumpeter "Historie del'evolucion ekonomique" Paris 1985;
8. Paul Heyne "Mënyra ekonomike e problemeve", Libri Universitar 1994;
9. Jacques Freyssinet "Le concept de sous developpement" Paris 1977.

TIPARET E TRANZICIONIT EKONOMIK NË SHQIPËRI

Leontiev Çuçi
Universiteti Kristal
leontievc@gmail.com

ABSTRACT

The transition of our economy has started in 1990-1991, having some specific characteristics. We went on the road to a market economy completely beginning from an absolutely centralized economy, with no kind of experience for the operating mechanisms of a typical market economy. In this performance, monitor the striking impact of the international financial and economic institutions, particularly the IMF, we followed a particular path restoration the mechanisms of a market economy. Our experience in the way of restoring market structures, known as "shock therapy" was an experience that has specific features in comparison with the experiences of other countries entering rregën transition from planned economy to market economy.

Key words: transition, Albanian economy, IMF,

Ekonomia shqiptare në pragun e tranzicionit të saj.

Ekonomia shqiptare e periudhës socialisto-komuniste ishte një ekonomi *absolutisht* e centralizuar dhe e planifikuar. Nuklin e sistemit të kësaj ekonomie e përbënte prona shtetërore, e cila përfaqësonte pronën e të gjithë popullit ose nivelin më të lartë të shoqërizimit të saj. Në suazën e kësaj prone ekzistonte dhe prona kooperativiste, si pronë e një grupi të caktuar punonjësish bujqësorë në fshat, të cilët formalisht gëzonin të drejtën e përdorimit të një sipërfaqeje toke

të caktuar nga shteti dhe ishin pronarë vetëm të produktit të prodhuar, pasi edhe mjetet e prodhimit bujqësor ishin pronë e shtetit. Kjo pronë e grupit, siç emërtohej ajo në atë epokë, përbënte formën më të ulët të pronës shoqërore dhe tërë perspektiva e ecurisë së zhvillimit të saj, ishte ngritja e nivelit të kësaj prone në nivelin e pronës së të gjithë popullit.

Në thelbin e kësaj strukture të marrëdhënieve të pronësisë, çdo element i pronës private ishte *ekstremisht i papajtueshëm* madje dhe *armiqësor* me të.(1) Ky mohim absolut i privatizmit në pronësinë shkoi edhe deri në denatyrimin dhe mohimin e disa elementëve të pronës dhe të punës individuale. Tufëzimi i objekteve të pronësisë së oborrit kooperativist të familjeve fshatare, efektivisht i privoi ata edhe nga e drejta e plotësisimit të nevojave individualo-familjare nëpërmjet punës individuale. Kur sistemi i marrëdhënieve në prodhim arriti në këtë pikë në fashat, kupëtohet se për familjet qytetare nuk kishte asnjë lloj shtegu për ushtrim të *punës individuale*. E thënë me pak fjalë, sistemi ekzistues ndalonte dhe dënonte, jo vetëm çdo lloj forme të pronës së vogël private, por edhe çdo lloj aktiviteti të punës individual për përfitim personal apo familjar. Kjo përbën dhe një veçori ekstreme dhe tipike të ekonomisë sonë në prag tranzicioni: ekonomi e mbyllur tek shoqërizimi dhe planifikimi; ekonomi e mbyllur në guaskë e vet dhe e udhëhequr nga parimimi i mbështetjes tërësisht në forcat e veta; ekonomi e izoluar me sistemin e marrëdhënies të tregut kombëtar ndërkombëtar; ekonomi që nuk njihnte asnjë përvojë të mekanizmave të funksionimit të tregu të brendshëm dhe të jashtëm. Ndërkohë që në vendet e tjera të ish Lindjes socialisto- komuniste situata ishte shumë më ndryshe në lidhjet me ekonominë e tregut, ne ishim në nivelin zero.(2)

I theksova këto tipare të raportit të ekonomisë sonë të planifikuar dhe të çentralizuar në lidhje me ekonominë e tregut për të treguar se tranzicioni ynë i kalimit në një ekonomi tregu nuk kishte asnjë bazë objektive dhe asnjë pikënisje të mbështetur mbi këtë bazë. Ishte e natyrshme që në këto kushte *tranzicioni të fillonte nga lart*, të fillonte nga ndërhyrja e rregullimit politik. Dhe kjo ndërhyrje (le ta quajmë mikroreformuese në kuadrin e ngurtësisë së sistemit) filloi me mikrondryshime në gjirin e sistemit të vjetër nga viti 1987 me disa masa mikroliberalizuese që kishin të bënin vetëm me të *drejtën* e ushtrimit të punës individuale për qëllime *përfitimi personal*. Kështu, ju dha e drejta të ushtronin aktivitet të lirë disa profesioneve të prodhimit dhe të tregëtimit të vogël në fushën e ushqimit social dhe të shërbimeve shoqërore. Në këtë rrugë lindën mikrosipërmarrjet apo mikrobizneset e prodhimit dhe të shitjes së ëmbëlsirave, të ushqimit social, të transportit dhe të kioskave. Sado që këto struktura ishin të pallogaritshme në vëllimin e prodhimit dhe të tregëtimit,

ato krijuan embrionin e një tjetër mënyre prodhimi, krijuan psikologjinë dhe mentalitetin e *punës private*. E theksoj këtë moment, sepse prej tij lindi një tjetër mënyrë të menduari dhe të vepruari, lindi fenomeni i *vetëpunësimit për fitim personal*, u dha, apo “u gjet”, një rrugë e re për të plotësuar nevojat individualo-familjare, pa qënë e nevojshme që kjo gjë të pritej nga prodhimi shtetëror. Më e rëndësishmja e tërë këtij procesi është së prej tij filloji nevoja dhe *presioni për pronën private*, pronë që nuk mund ta lejonte sistemi i vjetër i marrëdhënieve ekonomike. Duhej revolucioni politik i vitit 1991-1992 që t'i hapej rruga restaurimit të pronës private dhe ekonomisë së tregut.

Fillimet e tranzicionit të ekonomisë shqipëtare.

Elementët e parë të themeleve të një ekonomie tregu fillojnë në gjysmën e parë të vitit 1991. Ndër ligjet e para të parlamentit pluralist të asaj kohe ishte ai i privatizimit të tokës bujqësore të kooperativave. Rreth 430000 mijë ha tokë bujqësore ju dha në pronësi familjeve që jetonin dhe banonin në fshat, duke shoqëruar më tej këtë proces edhe me privatizimin e blegtorisë, pemëtarisë, ullishteve dhe vreshtave. Ky *revolucion i ri agrar* mund të konsiderohet si pikënisja e bazave të *restaurimit* të ekonomisë së tregut. Me këtë reformë lindi prona e vogël private e mbështetur në punën për vete, lindi tregu i vogël privat i prodhimeve bujqësoro-blegtorale, i cili e shdëroi fshatarin nga konsumator të këtyre produkteve (fshatari ynë në fundt të viteve '90-të, për shkak të rrënimit të prodhimit kooperativist, një pjesë të produkteve bujqësoro-blegtorale i blinte në rrjetin e tregëtisë me pakicë në zonat urbane) në prodhues të tyre. Në rrjetin e tregëtisë shtetërore me pakicë u privatizuan pothuajse të tëra dyqanet, depot dhe magazinat duke u dhënë ato në pronësi shitësave dhe punonjësve të tyre. Ndërsa në degën e transportit filloji privatizimi i mjeteve të lehta, e më tej të rënda të aseteve të saj, me përjashtim të hekurudhave. Kriteri i privatizimit në këto degë ishte kalimi i tyre në pronësi të punonjësve që i përdornin. Në qoftë se në fshat toka u privatizua pa shpërblim, pra ju dha fshatarit falas, njësitë e rrjetit të tregëtisë dhe mjetet e transportit ju shitën përdoruesve të tyre me çmime simbolike. Ndërkohë, nga fundi i vitit 1992 dhe përgjatë vitit 1993 u privatizuan të gjitha apartamentet ku banonin me qira të gjithë rezidentët e zonave urbane.

Këto proceseve të privatizimeve të sipërpërmendura u shoqëruan edhe me politika qeveritare liberalizuese në fushën e heqjes së barrierave administrativo-burokratike për funksionimin e një tyregu sa më të lirë. Kështu, periudha vitit 1991 u karakterizua nga heqja, pothuajse në tërësi, e barrierave doganore dhe

fiskale; në fund të këtij viti u liberalizua kursi i këmbimit të lekut me valutat e huaja; u hoq çdo barrierë administrative për futjen e investimeve të huaja duke i privilegjuar, për një periudhë 5-vjeçare, për mospagimin e taksës së fitimit; u stimulua me politika të veçanta nxitja e hapjes së bankave të huaja private duke i dhënë prioritetë të veçanta liberalizimit të tregut financiaro-bankar.

Sa i përket privatizimit në fushën e ndërmarrjeve industriale, ky proces filloji me shpërndarjen e letrave me vlerë për çdo punonjës të punësuar, me idenë e bërjes së tyre bashkëpronarë të aseteve vlerore të këtyre ndërmarrjeve. Kjo platëformë që u konceptua nga monitoruesit e FMN-së po eksperimentohej në modelin e privatizimit të aseteve të ndërmarrjeve industriale në Poloni.⁽³⁾ Por nërsa në Poloni ekzistonte bursa e kapitaleve, pra shitëblerja e titujve të letrave me vlerë, ose aksioneve në institucionin e bursës, në kushtet e ekonomisë sonë mendohej që ky treg të krijohet paralelisht me emetimin e letrave me vlerë. Ky koncept i praktikuar në kushtet e tranzicionit tonë nuk dha rezultatin e parashikuar, por përkundrazi shtrëmbëroi procesin e privatizimit të aseteve industriale. Këto letra me vlerë, në kushtet e mungesës së institucionit të bursës, filluan të qarkullojnë në tregun informal duke pësuar një shvlerësim drastik. Përballë dështimit të kësaj rruge, *privatizimi i aseteve industriale* e të degëve të tjera të ekonomisë u realizua në rrugë e metoda, më shumë *administrativoburokratike* dhe *klienteliste-partiake*, se sa në logjikën e koncepteve të *kërkesë-ofertës së tregut*. Për pasojë, mund të them se në këtë ecuri spikati inefficënca në privatizimin e këtyre aseteve, se privatizimi në këta sektorë humbi thelbin e tij, atë të rritjes së efektivitetit të përdorimit dhe shfytëzimit të aseteve shtetërore. Në vend që këto asete do të zotëroheshin nga subjekte të afta e të përgjegjshme në kompetenca profesionale, ato ranë në duar të të "paditurve", të cilët në vend që t'i vinin në eficientë ekonomike, i shvlerësuan më shumë, pa llogaritur që një pjesë e tyre edhe i shpërdoroi, apo i shiti "për pesë lekë".

Periudha e fundit të viteve '90-të dhe fillimit të viteve 2000 e më e më tej, vazhdon me privatizimet e objekteve strategjike në rrugë e metoda të mbështetura më shumë tek *kërkesë-oferta e tregut*. Ky proces ka qënë më i kontrolluar dhe më i monitoruar edhe nga institucione dhe ekspertë ndërkombëtarë, pavarësisht se në disa raste ka patur edhe probleme të mosfunksionimit me performancën e kërkuar. E rëndësishme është se prirja në këtë drejtim ka qënë ajo e orientimit dhe përzgjedhjes së investitorëve me përvojë dhe reputacion, duke eliminuar preferencat e llojit të rezidentëve të huaj ose vendas. Vlen të theksojmë se ky proces privatizimi u realizua në rrugë të njëkohëshme me hartimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e tërheqjes së investimeve të huaja. Sado që këto investime kanë qënë evidente, ato kanë

mbetur të spikatura në nivelin e bizneseve të vogla dhe të mesme, ndërsa investitorët e mëdhenj strategjikë janë akoma të rendit njëshifror.

Në këtë proces të restaurimit të ekonomisë së tregut, ekonomia shqipëtare ndryshoi shumë shpejt fizionominë e thelbit të saj. Në mesin e viteve 1990-të ajo ishte shndëruar në një ekonomi tregu të prodhimit dhe këmbimit të mallrave; në një ekonomi të qarkullimit të lirë të kapitaleve brenda dhe jashtë vendi; në një ekonomi të qarkullimit dhe të këmbimit të lirë të parasë me valutat e huaja; në një ekonomi të hapur dhe të gatshme që të thithte çdolloj investimi formal(4)

Disa tipare kryesore të tranzicionit të ekonomisë shqipëtare.

Këto tipare po përpiqem ti rendis sipas rëndësisë së tyre pavarësisht ndonjë kriteri të veçantë.

Tipari i parë është “befasia” politike dhe sociale që shtroi nevojën e ndryshimit të sistemit të marrëdhënieve ekzistuese në prodhim. Është e vërtetë se shëmbja e murit të Berlinit dha një sinjal mjaft domethënës për të ardhmen e këtij sistemi, por në realitetin shqipëtar të pakët ishin ata që besonin se ndryshimi do të vinte aq shpejt dhe aq papritur. Thënë ndryshe, ne ishim totalisht të papërgatitur nga çdo pikëpamje. Edhe klasa politike që doli në udhëheqje të revolucionit politik dhe ekonomiko-social, doli pa ndonjë parapërgatitje, dhe për rrjedhojë, ishte pa përvojë. Të gjithë hyjmë në një rrugë të panjotur dhe pa trashëgimi nga e kaluara. Po të kemi parasysh edhe faktin se sistemi socialisto-komunist u ndërtua më shumë nga e kaluara feudale se sa ajo kapitaliste, kupëtohet se na mungonin edhe rrënjët e një të kaluare të kapitalizmit të zhvilluar. Për ne kishte rëndësi vetëm *përmbysja*, por se si do të ndërtohej e ardhmja më e mirë kishte pak interes, për të mos thënë se nuk mendohej fare. Për rrjedhojë, u detyruam të pranojmë këshillat e institucioneve ndërkombëtare dhe të vendeve fqinje dhe europiane, pasi këto ishin dhe vendet më të mëdha të dhënies së ndihmave dhe kredive lehtësuese për procesin e tranzicionit në tërësi, dhe atij ekonomik në veçanti.

Parë në këtë kontekst, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe aspektin tjetër që lidhet me faktorin ndërkombëtar. FMN-ja, Banka Botërore, Banka Europiane për Rrindërtim dhe Zhvillim si dhe mjaft institucione dhe shtete të zhvilluara nuk kishin një përvojë (5) në këtë lëvizje me kahe të kundërt. Lëvizja e kahes historike kishte treguar se sistemi kapitalist kishte lindur në një etapë të caktuar të zhvillimit të marrëdhënieve të mallit dhe të parasë dhe kishte formësuar vetëveten kur nga liria ekonomike, lindi kapitali si forma më e pashtershme e energjisë së brendshme që mban gjallë sistemin. Akumulimi i

kapitalit karakterizon një lloj cikli “perpetum”, i cili mesa duket ka një sinergji të tillë që jep performancën më të lartë në zhvillimin ekonomik. Kapitalizmi i fund shekullit të XX-të kishte arritur pjekurinë e tij duke kaluar në shumë sprova dhe duke dalë fitimtar edhe në garën me sistemin e kundërt me të. Triumfi i ekonomisë së tregut ndaj ekonomisë së planifikuar dhe të çentralizuar ishte evident dhe i pakthyeshëm, por mungonte njohja e rrugës së re, e rrugës për të kaluar nga sistemi i ekonomisë totalitare dhe të ngurtësuar në suazat e planifikimit, në ekonominë e lirë të tregut të llojit perëndimor. Përthithja e ekonomisë së dobët të Gjermanisë Lindore nga ekonomia e fuqishme e Gjermanisë Perëndimore, ishte rast unik brenda një kombi të ndarë në dy shtete dhe aspak një përvojë që mund të ndiqej nga të tjerët. Të gjithë aktorët, lindorë apo perëndimorë, po hynin një rrugë me të *panjohura*, por të bindur se nuk kishin zgjidhje tjetër, se do të provonin dhe eksperimentonin, me besimin tek e ardhmja e tregut dhe e potencialeve të tij, tashmë të konfirmuara.

Tipari i dytë, që lidhet ngushtë me të parin, është se FMN-ja dhe Banka Botërore sygjerman dhe zgjodhën për Shqipërinë si rrugë tranzicioni, atë që njihet me emërin si “*terapia e shokut*”. Me këtë term dhe koncept, FMN-ja kuptonte një proces tranzicioni të llojit radikal, të cilin do të përpiqem t’a përkufizoj si një proces agresiv, gjithëpërfshirës dhe të shpejtë të privatizimit të pronës shtetërore dhe të kthimit të saj në pronë të mirëfilltë private. Në thelb FMN-ja synonte që tranzicioni ynë i shndërrimit të ekonomisë së planifikuar në një ekonomi tregu, të fillonte nga “niveli zero”(6), duke eliminuar sa më parë strukturat ekzistuese të ekonomisë së vjetër dhe duke u hapur rrugë të gjërë elementëve të ekonomisë private (thekrsoj se nuk bëhet fjalë për “nivele zero” të bazës materialo-prodhuese, pra për shkatërrimin e saj, siç ndodhi në fillimet tranzicionit tonë). Natyrisht që kjo strategji mbështetej në faktin se, në ndryshim nga vendet e tjera, ne nuk trashëguam asnjë element, apo sistem marrëdhëniesh të ekonomisë së tregut, përkundrazi, kishim mohuar në mënyrë absolute, jo vetëm pronën e vogël private, por kishim shoqëruar edhe elementë të pronës individuale, sidomos në prodhimin bujqësor. Pra, si nga pikëpamja e elementëve të tregut, ashtu edhe ajo e përvojës, ne duhet t’a fillonim gjithshka nga e para, gjithshka nga zeroja. Ky realitet ishte i ndryshëm nga ai i vendeve homologe, të cilat kishin implementuar gjatë reformave të tyre, jo vetëm elementë të konsiderueshëm të tregut, por kishin akumuluar edhe përvoja të rëndësishme në funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të tij. Në një lloj konkluzioni, mund të them se kjo strategji, apo ky eksperiment, ishte tipik në llojin e tij për vendin tonë, ndërkohë që në vendet e tjera ish-socialiste, ky privatizim u zhvillua mbi një bazë përvojë dhe gradualiteti.

Tipari i tretë, ka të bëjë me fakti se tranzicioni ynë politik, nga sistemi diktatorial dhe njëpartiak në një sistem multipartik ose pluralist *nuk kishte një kulturë të trashëguar* në fushën e demokracisë përendimore. Në realitetin tonë, kultura demokratike pluripartiake po restaurohej për herë të parë, pa trashëguar asnjë lloj baze nga e kaluara monarkisto-feudale dhe, më tej, ajo socialisto-komuniste. Edhe Revolucioni Demokratik i 1924 mbeti më shumë një realitet virtual, se sa një praktikë në kuptimin e një përvoje, pa llogaritur këtu ndalimin absolut, jo vetëm të lejimit të konkurrencës shumë partiake, por edhe të dënimit të mendimeve të kundërta jashtë vijës unike të partisë-pushtet të periudhës së sistemit socialisto-komunist. Kjo situatë tranzicioni i dha luftës politike për pushtet një *karakter konfliktualiteti*,⁽⁷⁾ për të mos thënë edhe *armiqësor*. Dy forcat kryesore politike, Partia Demokratike si parti e djathtë dhe Partia Socialiste si parti e majtë, të mbarsura fillimisht me filozofi të kundërta për procesin e tranzicionit ekonomik i konceptuan dhe ndërtuan qëndrimet e tyre në antagonizëm me njëra-tjetrën. Një frymë e tillë konfliktualiteti krijoi mosbesimin reciprok ndërmjet tyre deri në pikën që ligjet e miratuara nga njëra palë, abrogoheshin me ardhjen në pushtet të palës tjetër.

Kjo situatë paqëndrueshmërie dhe përplasjesh të paprincipia politike u reflektua edhe në *paqëndrueshmërinë* e reformave ekonomike. Të dy forcat kryesore politike, të përfshira në luftën konfliktuale politike nuk mund të arrinin edhe në hartimin e strategjive të tyre të përbshkëta dhe të mirëpërcaktuara ekonomike. Madje ato nuk arritën të gjenin edhe gjuhën e përbashkët për problemet e mëdha të reformës strategjike në ekonomi. Sejcila mendonte se rruga e saj ishte më e mira dhe nuk toleronte për rrugën e sygjeruar, ose të ndjekur nga tjetra. E thënë me pak fjalë ne nuk arritëm, edhe sot e kësaj dite, që të kemi *një strategji të përbashkët tranzicioni ekonomik*, të paktën në problemet më kryesore të tij. Këtë situatë e ndërlikoi dhe më shumë ajo që njihet me emërin “kriza e piramidave”, e cila përveç traumve dhe dëmeve social-ekonomike, përshtjelloi edhe më shumë marrëdhëniet e besimit midis aktorëve politikë, duke rritur dozat e konfliktualitetit ndërmjet tyre.⁽⁸⁾

E ngërthyer në këtë tranzicion politik, ekonomia jo vetëm nuk arriti të ketë një strategji udhërrëfyese dhe të mbarëpranuar, por u end në vorbullën e interesave partiake. Një situatë e tillë bëri që edhe politikat makroekonomike të ndërhyrjes së qeverive në rregullimet e domosdoshme të ishin afatshkurtëra, të paqëndrueshme dhe të kontestuara nga pala opozitare. I vetmi mjet rregullator, përgjithësisht i mirëpranuar nga të dy forcat politike për tranzicionin ekonomik, ishin rekomandimet pothuajse detyruese dhe urdhëruese të FMN-së, të Bankës Botërore dhe të Komisionit Europian.

Tipari i katërt, që është rrjedhojë e tre tipareve të mësipërme, ka të bëjë me konkluzionin se tërë procesi i tranzicionit ekonomik ka filluar dhe vazhdon të ecë në rrugën e drejtimit “nga lart”, e drejtimit nga politika. Në këtë këndvështrim fus edhe rekomandimet e politikave ekonomike të institucioneve ndërkombëtare, të cilat në këtë rrugë i dhanë jetë strukturave dhe mekanizmave të restaurimit të ekonomisë së tregut. Një ekonomi tregu e krijuar “nga lart”, pra nga politika, natyrisht që nuk mund të jetë një rrugë natyrale dhe si e tillë mbart edhe probleme më të mëdha dhe më të vështira për t’u kapërcyer.(9) Këto probleme bëhen edhe më të komplikuar kur mungon kultura e dialogut dhe e gjetjes së konsensualiteve, të cilat bëhen më të domosdoshme, sa më i papërgatitur është vendi që ka hyrë në rrugën e tranzicionit ekonomik.(10) Ky realitet i llojit shqipëtar e ka bërë edhe më të vështirë orientimin e rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, të cilat jo rrallëherë vihen në pozita të vështira për t’u dhënë zgjidhje bëmave specifike të tranzicionit tonë ekonomik. Po t’u shtojmë këtyre, sa më sipër, edhe trubullirën që krijohet nga informacioni i politizuar i shifrave (në të cilin në mënyrë të konsiderueshme mungon edhe transparenca), ku njëra palë e paraqet realitetin të ndritur, ndërsa tjetra të errët, kupëtohet se ajo që e karakterizon më tej këtë tranzicion është fakti, se në krahasim me të tjerët, ai po shfaqet si *më i vështirë, më i zgjatur dhe më problematik*.

Tipari i pestë ka të bëjë me *shpejtësinë* e rrugës së ndjekur në procesin e privatizimit të aseteve shtetërore dhe përfshirjen pothuajse tërësore të aseteve publike . Ndoshta jemi i vetmi vend në botë që kemi privatizuar në një kohë pothuajse rekord pjesën dërrmuese të aseteve të pasurisë shtetërore dhe të pasurive nëntokësore, madje jemi të bindur që të privatizojmë edhe çka mbetur tjetër prej tyre. Një përvojë e tillë *unikale*, pa dashur që të krijoj elementë paragjykes, të fut në dyshime për të ardhmen e funksionimit eficient të këtij lloji tregu. Shteti ynë (më saktë qeveria) duke hequr dorë edhe nga pronësia mbi asetet kryesore strategjike, po shdërohet në një subjekt me pronësi mjaft të kufizuar, gjë që në mënyrë të natyrshme do të çojë edhe në kufizimin e mjeteve për të ndjekur politika të caktuara publike, sociale dhe rregulluese. Fakti që nuk ndeshim në një përvojë të tillë, të këtyre përmasave privatizues, shtrun disa pyetje. P. sh., a mund të luajë qeveria e nesërme me politika lehtësuese kredituese kur ekzistojnë vetëm banka private të nivelit të dytë? A mund të ndikojë ajo në politika punësimi me sektorin publik kur ky po bëhet gjithnjë e më i vogël? Përse një përvojë e tillë nuk është ndjekur nga vendet me ekonomi të zhvilluar dhe përgjithësisht të stabilizuara në parametrat kryesorë? A do të jetë në gjëndje qeveria jonë e nesërme të përballojë trauma të shkakëtuara nga fatëkeqësitë natyrore, apo nga situata të rënda të krizave ekonomike? A të mbështetet zgjidhja e këtyre problemeve, e të tjerë si

këto, vetëm me politika fiskale, apo me politikën e borxheve? Këto pyetje, e të tjera të kësaj natyre, gjykoj se nuk mund të marrin *përgjigje të sakta teorike*. Teoria e shpjegimit të tyre mbetet më shumë hipotetike dhe më pak realiste. Megjithatë, prirem që dyshimet e ngritura t'ia lëmë edhe kohës, e cila do të na tregojë më shumë nga sa dimë deri tani.

Këto tipare të tranzicionit kanë peshën dhe rolin e tyre për të kuptuar nëse procesi i tranzicionit të ekonomisë sonë drejt një ekonomie të formësuar tregu ka përfunduar apo po vazhdon. Në parantezë dëshiroj të bëj sqarimin se çfarë do të kuptojmë *me përfundim* të procesit të këtij tranzicioni? Në literaturën e derisotme ekonomike procesi i përfundimit të tranzicioni ekonomik, të paktën për vendet e ish Lindjes socialiste komuniste ku bëjmë pjesë edhe ne, është lidhur me periudhën e anëtarësimit të tyre në BE. Ky eveniment ka presupozuar, se brenda specifikave të sejcilit vend, është arritur standarti i parametrave që karakterizojnë një ekonomi të formësuar tregu, se me këtë anëtarësim ekonomitë e vendeve respektive, kanë pëmbushur reforma të tilla që i kanë bërë ato kompatibël "*në standarte dhe mekanizma funksionimi*" për të luajtur në fushën e konkurrencës së tregut. Natyrisht, të qënurit ekonomi tregu në përmbajtje dhe përfundimi apo jo procesi i tranzicionit, janë dy çështje të ndryshme.

Gjykuar në këtë këndvështrim, tranzicioni ynë ekonomik krijoi shumë shpejt *tregun e mallrave dhe të shërbimeve*, i cili u pasua, më tej, edhe nga krijimi i një sistemi bankash private. Ne kemi aktualisht një treg mallravsh dhe shërbimesh të konsoliduar e të formësuar që përbën një nga shtyllat kryesore dhe vendimtare të një ekonomie tregu, i mbështetur fuqishëm nga tregu bankar dhe sistemi i kreditit. Por ndërkohë në ekonominë e tregut shqipëtar, *mungojnë* edhe dy elementë të tjerë të një ekonomie të formësuar dhe të pjekur tregu të llojit perëndimor. Mungon *tregu i kapitaleve* dhe *tregu i punës*. Tregu i kapitaleve lidhet me lëvizjen e asetëve ekonomike, jo vetëm në formën e shitëblerjes fizike të tyre, por kryesisht me lëvizjen dhe shitëblerjen e tyre në formë vlerore, pra krijimit të tregut të letrave me vlerë dhe derivateve të tyre, që realizohen nga *institucioni i bursës* dhe tërë institucionet monitoruese dhe funksionueso-kontrolluese të saj. Krijimi i këtij tregu është i lidhur me pjekurinë e zhvillimit të sistemit të institucioneve monetaro-financiare, të cilat lindin e krijohen si nevojë dhe domosdoshmëri e progresit të ekonomisë reale.(11)

Të njëjtën gjë do të thosha edhe për tregun e punës. Në ekonominë tonë aktuale ekziston vetëm shërbimi institucional i regjistrimit të të papunëve dhe ndihmës sociale ndaj tyre, por është pothuajse inekzistent tregu i mirëfilltë i punës, *si treg i njohjes dhe i monitorimit të kërkesë-ofertës për llojet e ndryshme të profesioneve*, ose të njerëzve që ofrohen për punë dhe të bizneseve që kërkojnë t'i punësojnë ata. Tregu i punës nënkupton një rrjetë të tërë institucionesh, në rradhë të parë, publike, por edhe private, të cilat mirëinformohen për njerëzit

e profesioneve të ndryshme që janë të aftë dhe që kërkojnë punë, ose që kanë nevojë të bëjnë rikualifikime të veçanta dhe të pjesëshme për t'u risistemuar në punë të profesioneve të përafërta. Nënkupton, më tej, njohjen e vendeve të lira të punës, ose ofertën e punëdhënësve për të punësuar ata që kërkojnë punë. Eshtë pikërisht kjo "përputhje" e kërkesë ofertës për punë, detyra dhe funksioni themelor i një tregu të formësuar pune, i cili i mungon ekonomisë sonë.(12)

Nisur nga sa më sipër, do të qëndroja në mendimin se tranzicioni i ekonomisë drejt tregut akoma nuk ka përfunduar. *Ekonomia jonë vazhdon të jetë në proces tranzicioni*, jo vetëm se nuk ka krijuar tregun e kapitaleve dhe tregun e punës, por edhe sepse krijimi i këtyre dy tregjeve kërkon rrjetin përkatës të institucioneve të funksionimit të tyre, gjë që kërkon një kohë, e cila nuk lidhet vetëm me nxitjet nga ana e politikave makroekonomike, por lidhet edhe me kushtet objektive që krijohen në procesin e zhvillimit material të saj.(13)

Përsheptimi i procesit të integritimit europian, marrja së shpejti e statusit të plotë të vendit kandidat në BE do të progresojë, jo vetëm procesi e përfundimit të tranzicionit, por do të shërbejë edhe për të arritur nivele dhe standarte kompatibël me ato të tregut të madh europian.

Bibliografia

1. Raporti vjetor i FMN-së, viti 1992
2. Raporti vjetor i FMN-së, viti 1993
3. Raporti vjetor i FMN-së, viti 1994
4. Buletin vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2000
5. Raporti vjetor i Bankës Botërore, viti 1996
6. Raportet vjetore: të FMN-së viti 1993; të Komisionit Europian, viti 1994
7. Raport i Komisionit të Jahstëm të Parlamentit Europian, viti 1995
8. Raporti i Komisionit Europian, viti 1998, 1999, 2001
9. Gorbaçov M. "Riflessioni sulla rivoluzione d'ottobre", Editori riuniti, Roma 1997
10. Gorbaçov M. "Umanesimo e nuovo pensiero", Multimage, Torino 1997
11. Krugman P. "Lessons of Massachusetts for EMU", in F. Torres and F. Giavazzi (eds), 1993. Adjustments and Growth in the European Monetary Union, London: CEPR, and Cambridge: Cambridge University Press, (1993)
12. Bernanke B., and Laubach T., Mishkin F., Posen A., "Inflation Targeting. Lessons from the International Experience", Princeton, NJ: Princeton University Press. 1999
13. Buti M., and Sapir A., "Monetary and Fiscal Policy Interactions Under a Stability Pact", Palgrave; New York, 2002

Referenca nga interneti

- <http://www.dw/article/0..15817781,00.html>
<http://unicef-irc.org/publications/244>

**ZHVILLIMI I EKONOMISE REALE,
REFORMAT STRUKTURE
DHE SEKTORET PRIORITARE**

EKONOMIKSI I MIREQENIES – NJË DISKUTIM I MUNGUAR GJATE TRAJEKTORES SONË TË ZHVILLIMIT

Gjergj Filipi

Instituti AGENDA

gjergji.filipi@agendainstitute.org

Elena Polo


polo_elena@hotmail.com

ABSTRACT

Despite the growing inequality around the world in these last 3 decades, the policy awareness in this regard has only lately intensified, all together with the challenges posed by the global economic crisis. Although it seemed like the Albanian economy managed to diverge from the first wave of the global financial shock, since the beginning of 2009 the signs of a crisis were showing up on the economy and particularly on the pockets of the already poor Albanian citizens. Up to this moment, the deep inequality existing in the country was hidden not only by the high remittance flows but also by relatively easy access to loans. Nowadays, at a height of the crisis in the Albanian economy, inequality is exacerbated even more, which means that the lower class but even the middle class are left behind in the distribution of welfare, not only in relative terms, but also in absolute terms. The debate in developed countries is focused on raising the income tax rate of the affluent. If Albania is aiming towards a sustainable socio-economic development, this is high time to discuss about a balanced distribution and equal opportunities for all.

Keywords: *welfare economics, sustainable development, Albania*

Pavarësisht pabarazisë në rritje në mbarë botën në këto 3 dekadat e fundit, ndërgjegjësimi politik në lidhje me këtë ka ardhur me vonesë, njëkohësisht me sfidën e krizës ekonomike globale. Ndonëse u duk sikur ekonomia shqiptare i devijoi valës së parë të goditjes financiare globale, që prej fillimvitit 2009 u shfaqën sinjalet e ndikimit të krizës mbi ekonominë reale të vendit dhe sidomos mbi xhepat, edhe ashtu të varfër, të qytetarëve shqiptarë. Sic duket edhe nga grafiku, pavarësisht të gjitha përpjekjeve për të manipuluar mënyrat sesi kriza e fundit financiare mund të depërtonte te ne, edhe nëpërmjet atij që quhet efekti contagion apo i kontaminimit, sipas një studimi të Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH, 2010) mendohet se realisht prekja nga kriza nga vende të ndryshme ka qënë e tillë.



Grafiku 1 : Ndikimi nga kriza për vende të ndryshme në periudhën 2007-2009

Burimi: Life in transition, EBRD, 2010

Thellësia e pabarazisë në vend ishte fshehur deri në këtë kohë nga prurjet e remitancave por edhe nga kreditimi i lehtë dhe relativisht pa shumë kosto. Në ditët e sotme, në kulmin e krizës ekonomike, pabarazia ashpërsohet edhe më shumë që do të thotë që shtresa e ulët, madje edhe ajo e mesme, mbeten pas në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave në terma relativë, por edhe absolutë. Debati në vendet e zhvilluara është përqendruar tek taksimi i të ardhurave të të pasurve, ndërsa në një grup më të gjerë vendesh, edhe në rastin e Shqipërisë, ai duhet të fokusohet mbi sigurimin e aksesit dhe ofrimin e mundësive të barabarta ndaj të gjitha shtresave nëse synohet zhvillimi socio-ekonomik i qëndrueshëm i vendit.

Bazuar në këtë kompleksitet të situatës por edhe në faktin që shqiptarët e nisën tranzicionin me të njëjtin nivel shumë të ulët të mirëqënies, gjykohet me

vend diskutimi publik mbi një karakteristikë tipike e gjerësisht të prekshme të realitetit ekonomik shqiptar, pabarazia në shpërndarjen e mirëqënies apo të të ardhurave. Në rang global, tashmë që qeveritë janë motorët më të rëndësishëm të shpërndarjes së të ardhurave, ndërhyrja me politika është bërë thelbësore.

Ky punim, duke pasur në fokus pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave, do të prekë disa tregues të tjerë ekonomikë, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte thellojnë pabarazinë e të ardhurave në një ekonomi, e specifikesht ekonominë tonë. Korrupsioni, informaliteti apo evazioni fiskal në një ekonomi ndikojnë në mënyrë direkte shpërndarjen e të ardhurave. Nga ana tjetër, në mënyrë më specifike, rënia ekonomike, edhe si rezultat i krizës së fundit financiare – ekonomike e deri edhe besimi, rënia në remitancat për familjet shqiptare apo edhe deri vendosja e sistemit të taksës së shështë nuk kanë bërë gjë tjetër vecse kanë thelluar pabarazinë në ekonominë tonë.

Treguesi që përdoret me gjerësisht për matjen e pabarazisë nga institucionet ndërkombëtare, por edhe nga qeveritë kombëtare dhe lokale është indeksi GINI. Ky tregues mat masën e devijimit në shpërndarjen e të ardhurave ndaj nivelit të shpërndarjes perfekte. Në rastin e vlerës 0 të këtij treguesi nënkuptohet barazi perfekte, pra të gjithë qytetarët përfitojnë identikisht njësoj, ndërsa në rastin e vlerës 1 nënkuptohet pabarazi perfekte, pra vetëm një qytetar përfiton gjithçka. Në vendet me ekonomi të polarizuar, potencialet për dhunë rriten. Ky është rasti i Zimbabve, shtet i cili koeficientin e të ardhurave për frymë të shpërndara në mënyrë të papërputhshme e ka shumë më të lartë se mesatarja botërore e përcaktuar. Ajo është 0,6 %, nga 0,25%. Ky përfundim vjen nga analiza e Lloyd Brown-John⁷⁴, i agjencisë prestigjioze “The Windsor Star”, i cili është bazuar në një studim të Institutit të Politikave Ekonomike të Uashington D.C., për raportin e të ardhurave mesatare të të pasurve të Amerikës dhe të të varfërve të saj, dhe të disa vendeve të tjera. Analiza përfshin periudhën nga 1980 në 2006. Në këtë periudhë studimi prej 26 vjetësh, Instituti i Politikave Ekonomike doli me përfundimin se 1% e popullsisë kishin të ardhura 10 herë më shumë se të ardhurat e pjesës tjetër të popullsisë në 1980. Në këtë mënyrë, kjo është shumëfishuar me 20 herë krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë deri në 2006. Sipas studimit në fjalë, pabarazia mund të rritet me një hap dramatik.

Është një fakt tashmë që pjesa më e madhe e njerëzve në planet jetojnë në vende ku pabarazia e të ardhurave është me e madhe sesa ç’ ishte një brez me parë. Shumë shtete si Amerika, Britania e Madhe, Kanadaja, Kina, India, madje edhe Suedia kanë njohur rritje të pjesës së të ardhurave kombëtare që përfitohen nga 1% i popullsisë që kanë nivelin më të lartë të të ardhurave. Indeksi GINI në

74 Economic Inequality, University of Windsor, 2011

rastin e SHBA është rritur me rreth një të treten që prej vitit 1980 duke arritur vlerën 0,39, ndërsa për Suedinë ky indeks u rrit me një të katertën, duke arritur vlerën 0,24. Kina ka parë një rritje të këtij indeksi me një të dytën duke kapur vlerën 0,42. Përjashtimi i vetëm është tendenca në Amerikën Latine, si psh rasti i Brazilit, ku ky indeks ka rënë vazhdimisht gjatë 10 viteve të fundit.

Sipas analistit dhe studiuesit Lloyd Brown-John, nivelet e dhunës janë më të larta në shoqëritë me varfëri të madhe dhe shpërndarje të të ardhurave në mënyrë të papërpëthur. E si rrjedhojë, sipas tij, është e mundur që shtrirja e të ardhurave në mënyrë të pabarabartë mund të lidhet me paqëndrueshmërinë politike të demokracive. Në këtë mënyrë, edhe rasti i Shqipërisë, ku klasa e mesme është vështirë të dallohet, ndërsa kemi një dallim të qartë mes të pasurve dhe të varfërve dëshmon se demokracia sa vjen e lëkundet dhe tranzicioni thellohet.


Po çfarë mund të thuhet më specifikisht për rastin e Shqipërisë? Për fat të keq matjet e nivelit të jetesës në Shqipëri janë bërë vetëm në 2002, 2005 dhe 2008. Sidoqoftë, tendenca e tre matjeve, që i përkasin dekadës së shkuar tregon për një thellim drastik të pabarazisë sipas matjes së indeksit GINI. Në 2002 ky indeks për Shqipërinë shënonte vlerën 0,282, në 2005-ën u rrit në 0,33 dhe në 2008-tën preku vlerën 0,345. Gjithashtu bazuar në të dhënat e po këtyre viteve, 20% -shi i shqiptarëve me të ardhurat më të larta në 2008-tën përfitonte 43 përqind të totalit të të ardhurave, ndërsa në 2002-shin këta përfitonin vetëm 37,4 përqind të totalit. Në kontrast, 20% -shi i shqiptarëve i renditur me të ardhurat më të ulëta në 2008-tën përfitonte 8,1 përqind të totalit të të ardhurave, ndërsa në 2002-shin këta përfitonin 9,1 përqind.

A janë këto shifra shqetësuese? Çfarë pasojash sjell thellimi i pabarazisë në këto nivele mbi mbarë shoqërinë, duke menduar se kriza ekonomike pritet t'i ketë thelluar edhe më tej? Në çfarë mase duhet adresuar kjo problematikë dhe në çfarë rendi prioritar duhet vendosur ajo në politikat qeverisëse? A duhet të përbëjë kjo problematikë strumbullarin absolut të strategjive zhvillimore apo të modelimit ekonomik të vendit?

Për më tepër, sa do të ndikohet kjo situatë sikur të ishte qoftë edhe pjesërisht i vërtetë informacioni i fundit i publikuar nga Global Financial Integrity⁷⁵, se rreth 1.3 mld dollarë dalin jashtë vendit, përmes korrupsionit, aktivitetit ilegal dhe evazionit fiskal? Dhe pasojat dihen, kur burimi i këtyre fondeve janë 60% nga evazoni fiskal, 35% nga ekonomia informale dhe 5% nga korrupsioni, të pasurit do të bëhen më të pasur në kurriz të të varfërve të cilët bëhen gjithnjë e më të varfër. Dhe kështu pabarazia në mirëqënie ka prirje të thellohet edhe më tej duke shkaktuar polarizim të ethshëm të shoqërisë.


75 Global Financial Integrity, Washington

Grafiku 2 : Niveli i korrupsionit për vende të ndryshme Burimi: Life in transition, EBRD, 2010



Niveli i korrupsionit në Shqipëri ka qënë dhe mbetet i lartë. Niveli i perceptimit të korrupsionit, në të cilin janë marrë në konsideratë 176 vende, Shqipëria renditet e 113, cka do të thotë se ka një nivel të lartë të korrupsionit dhe një ndjeshmëri të lartë perceptimi ndaj tij. Sic duket edhe nga grafiku më lart, niveli i korrupsionit në Shqipëri na rendit ndër “kampionët” pas tre vendeve ish-sovjetike, mbetet jo vetëm mbi 10 herë më i lartë se mesatarja e Europës Perëndimore, por edhe mbi nivelin mesatar të rajonit të ekonomive trazitore.

Grafiku 3: Indexi GINI për Shqipërinë




Burimi: BB, World Economic Developments

Nga grafiku i mësipërm duket qartë sesi kanë ardhur në rritje vlerat e koeficientit GINI për Shqipërinë, ku pas vitit 2002 tendenca ka qënë vazhdimisht rritëse. Që pas 2002, gjithmonë e më shumë është rritur pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave në Shqipëri, ndërkohë që periudha e vetme me

tendencë rënëse e koeficientit GINI ka qënë ajo e pasluftës së 1997. Por, akoma më keq duket situata nëse shohim se çfarë ecurie ka pasur pjesa e zotërimit të të ardhurave nga ana e pesë segmenteve të 20% - sheve të ndryshme të shoqërisë, ku pabarazia në shpërndarje duket qartë. Grafiku i mëposhtëm ndërtohet mbi bazën e ndarjes së shoqërisë në 5 grupime sipas nivelit respektiv të të ardhurave.


Grafiku 4: Ecuria e aksesit në të ardhurat kombëtare, përfituesit ndahen në pesë grupime 20%-she



Burimi: BB, World Economic Developments

I vetmi grupim që ka pasur tendencë rritëse është 20%-shi i shqiptarëve me të ardhurat më të larta, cka do të thotë se pikërisht kjo shtresë e lartë nga pikëpamja e të ardhurave ka pas mundësi të përfitojë më tepër të ardhura të cilat i janë hequr nga pjesa grupimeve të ulta e të mesme. Konkluzioni është i dukshëm nga linjat e grafikut, në harkun e vetëm gjashtë viteve pabarazia në shpërndarjen e mirëqënies është thelluar dukshëm.


Grafiku 5: Ecuria e pjesës që zotëron shoqëria e ndarë në nivele 10%



Burimi: BB, World Economic Developments

Gjithashtu e thellë duket pabarazia kur shihet nga grafiku më lart sesi ka pasur rritje në pjesën e zotërimit të të ardhurave nga 10% i shoqërisë me përpjesën më të lartë në zotërimin e të ardhurave.

Grafiku 6: Harta e Shqipërisë sipas vlerave të koeficientit GINI




Burimi: CIESIN,
Columbia University

Në hartën e mësipërme të Shqipërisë, ku me ngjyrë më të errët janë shënuar vlerat më të larta të koeficientit GINI apo thënë ndryshe të shpërndarjes më të pabarabartë, shihet se zonat gjeografike me pabarazi më të madhe në shpërndarjen e të ardhurave janë po ato zona që karakterizohen si zona me më shumë burime. Pra, kjo paraqitje më sipër mund të shërbente disi si tregues për zonat ku duhet të jetohej më mirë në Shqipëri, ndërkohë që synimi i hartimit ka qënë indikacioni i pabarazisë. Nuk është e rastësishme mbivendosja e zonave me potenciale më të larta me zonat me pabarazinë gjithashtu më të lartë.

Ky është treguesi më kuptimplotë i dështimit të shoqërisë shqiptare për të krijuar skemat dhe institucionet e nevojshme për të mundësuar, në mënyrë solidare ngritjen e kohezionit shoqëror. Ndërsa në zonat natyrshëm të varfëra ka barazi

në fukarallëk, në zonat me potencial ekonomik jo vetëm që nuk gjenerohet mirëqënie e cila duhet te kompensojë për zonat e varfëra të vendit duke realizuar kështu konvergencën e domosdoshme për të realizuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, por edhe ajo mirëqënie që arin të gjenerohet grumbullohet në pak xhepa dhe nuk gjen kanalizimet e shëndetshme për të realizuar zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror të vendit.

Po çfarë është bërë në këtë drejtim nga ana e politikave ekonomike e sociale shtetërore? Një nga politikat kryesore që ndikon në shpërndarjen e të ardhurave në ekonomi është potika fiskale në forma të taksimit, subvencionimit apo transfertave e ndihmave ekonomike, të cilat njihen ndryshe edhe si procesi i rishpërndarjes apo shpërndarjes së dytë në ekonomi. Shqipëria që prej 1 janarit të vitit 2008 ka në fuqi të ashtuquajturën sistemin e taksës së sheshtë.

Grafiku 7: Të ardhurat mujore para dhe pas vendosjes së taksës së sheshtë

Burimi: Instituti AGENDA (2007)

Në këtë grafik, duket qartë se si pas vendosjes së taksës së sheshtë, sipas një studimi kryer nga Instituti Agenda, pjesa e tatimit mbi të ardhurat pas një niveli të caktuar page bëhet më e ulët pas këtij rregulli fiskal në dallim të dukshëm nga rregulli pararendës i taksimit progresiv. Me justifikimin që vendosja e taksës së sheshtë, e aplikuar në disa vende të ish-blokut lindor, do të sillte përveç të tjerave një lehtësi në procedurat e mbledhjes dhe më pak evazion fiskal, njëkohësisht me sheshimin e tatimit mbi të ardhurat personale u vendos edhe përgjysmimi i tatimit të fitimit që paguajnë kompanitë. Me pak fjalë, vendosja e taksës së sheshtë përgjysmoi barrën fiskale mbi bizneset, uli barrën e taksës për pjesën e shoqërisë me të ardhura më të larta, mbi 141'300 Lekë në muaj në 1 Korrik 2007, dhe e rriti atë për personat me të ardhura të ulëta e të mesme, ku grafiku tregon dukshëm që të ardhurat e mesme, afërsisht nga 300 deri ne 900 mijë Lekë në muaj, pësuan dëmtimin më të thellë.

Ndonëse shifrat e shpërndarjes së të ardhurave që përmendëm më lartë folën qartë për nivelin e pabarazisë në vend, ato i referohen periudhës deri në vitin 2008 sepse matje të mëpasshme nuk ka patur. Ndërkohë që taksë e sheshtë filloi të aplikohet e plotë në 1 Janar 2008, pra atyre tendencave të pabarazisë të

interpretuara më lartë me siguri që do të na duhet ti shtojmë dozën e alarmit të pabarazisë kur të përballemi me shifrat e pas 2008-tës që do të perfijmë edhe ndikimin e reformës fiskale të taksës së sheshtë por edhe ndikimin e krizës ekonomike rajonale.

Grafiku 8: Ecuria e PBB dhe punësimit në Shqipëri



Burimi: Llogaritje të Institutit Agenda bazuar në të dhënat e Instat


Natyrshëm mund të ngiheshe, në këtë pikë, pyetja lidhur me nivelin e punësimit në vend pas taksës së sheshtë. Disa prej vendeve që eksperimentuan përpara shqipërisë me këtë system taksimi patën efekte pozitive në tregjet e punës. Në fund të fundit do kish qënë e shëndetshme për ekonominë nëse rritja e barrës fiskale mbi pagat e shumicës së shqiptarëve në punë do të prodhonte më shumë vende pune për pjesën e panunë të shoqërisë.

Në fakt, grafiku i mësipërm na tregon të kundërtën. Për arsye se viti i fundit që Instat ka certifikuar rritjen ekonomike të vendit është 2009-ta, grafiku ndalon pikërisht aty. Duket qartë që në vitin e pare të zbatimit taksa e sheshtë nuk na prodhoi rritje te punësimit, por përkundrazi. Shifrat paraprake të viteve në vijim justifikojnë të njëjtën tendencë. Pra, taksa e sheshtë nuk arriti të prodhojmë ndonjë ekuilibrim të pabarazisë që përshkruam më lartë nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës, përkundrazi pas kësaj reforme kemi rënie në vazhdim të numrit total të të punësuarve.

Siç duket gjithashtu nga grafiku i mësipërm, nuk është se ekonomia shqiptare ka ditur si të nxisë një zhvillim ekonomik që krijon punësim, pra mirëqenie të përgjithshme, as në vitet përpara taksës së sheshtë. Shumë teori

ekonomike argumentojnë nevojën e shoqërimit të rritjes ekonomike të lidhur drejtpërdrejtë me nivele më të larta punësimi, lidhje kjo e ndërsjelltë. Grafiku më sipër tregon se jo vetëm që nuk është bërë asnjë përpjekje për nxitje të punësimit, por më keq akoma, as rritja ekonomike në formë mekanike apo natyrale, nuk ka mundur të krijojë vende shtesë pune, në kuadër kjo edhe të vetë ciklit të shpërndarjes së të ardhurave në ekonomi, fare pa u futur në sistemin e rishpërndarjes apo shpërndarjes së dytë, sikurse njihet ndryshe. Në këto kushte kur rritja ekonomike nuk arrin të përkthehet në të ardhura shtesë nga rritja e punësimit, kjo shkon në thellim të pabarazisë së mirëqënies.

Grafiku 9: Ecuria e tregut të punës




Burimi: Llogaritje të Institutit Agenda bazuar në të dhënat e Instat

Nga ana tjetër, shohim se megjithë faktin se Shqipëria është një vend me moshë mesatare relativisht të re, që prej 2000 ka pasur një trend rënës në forcën e saj punëtore. Ndër shkaqet kryesore duhet të jetë zhgënjimi nga ana e individëve të shoqërisë në lidhje me mundësitë për tu punësuar dhe dalja në këtë mënyrë nga statistikat e të regjistruarit si i papunë, ndihmuar kjo edhe nga migracioni. Heqja në këtë mënyrë dorë nga të ardhurat që mund të merren nga puna apo nga pagesa e panunësisë, nxit varfërinë dhe rrjedhimisht edhe diferencën në të ardhura e mirëqënie.

Një burim i rëndësishëm i kapitalit për vendet pritëse janë investimet e huaja direkte (IHD), të cilat mbështesin nxisin zhvillimin e ekonomisë pritëse dhe sigurisht gjenerojnë mirëqënie duke hapur vende të reja pune. Në më të shumtën e rasteve IHD-të shoqërohen edhe me transferim të teknologjisë dhe nxisin kështu rritjen ekonomike. Sipas një studimi të Neuhas (2005), IHD-të konsiderohen si promotor të rritjes dhe zhvillimit të vendeve të Europës Juglindore, duke kontribuar 2.3% në totalin prej 3.5% të rritjes së tyre mesatare vjetore.

Grafiku 11: Përpjesa e flukseve të IHD në sektorë të ndryshëm të ekonomisë



Burimi: UNCTAD (2011)


Në rastin e Shqipërisë, thithja e këtyre investimeve është bërë pa objektiva të qartë të lidhura me ekuilibrimin e pabarazisë. Mjafton të risjellim në vëmendje dështimin e zonave të lira dhe parqeve industriale apo rendjen e viteve të fundit drejt sektorit energjetik, duke lënë në harresë sektorë të tjerë të ekonomisë që i japin hov zhvillimit të zonave të pafavorizuara nga pikëpamja burimore apo zhvillimit të punësimit. Për shembull, në vitin 2010 IHD-të në sektorin bujqësor kanë zënë vetëm një pjesë prej 0.3% të totalit. Nëse synohet krijimi i një klime për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, theksi për thithjen e IHD-ve duhet vënë tek cilësia e flukseve të IHD-ve dhe jo vetëm tek sasia e tyre, aq më tepër kur pas krizës së fundit në rajon, pritjet që flukset hyrëse të vazhdojnë shtrëngohen edhe më tej.

Nëse do të duhej të vrojtojmë segmentet e shoqërisë që janë prekur më së shumti prej krizës ekonomike, një burim i mirë informacioni është vrojtimi i jetës në tranzicion që kryen BERZHi. Ashtu sic pritej, në Shqipëri pjesa më e madhe e familjeve janë ndikuar në një masë të madhe nga kriza e fundit, ndikim ky në një nivel prej gati 60%, më i madh se në Maqedoni dhe se mesatarja e rajonit në tranzicion.

Grafiku 12: Ndikimi i familjeve Shqiptare nga kriza e fundit ekonomike

Almost three-fifths of households have been affected by the crisis

% of respondents whose households have been affected by the crisis, either a great deal or a fair amount




Burimi: Life in transition, EBRD, 2010

Kjo duket edhe nga paraqitja e mësipërme, ku Shqipëria ka një ndikim në nivelin 59% nga kriza e fundit ekonomike, ndërkohë që mesatarja e rajonit tranzitor, e cila është diku te 49%, shumë më e lartë se mesatarja e prekjes së vendeve perëndimore. Kjo do të thotë që jo vetëm që ekonomia shqiptare është prekur nga kriza ekonomike njëkohësisht me rajonin, pra që në vitin 2008-të, por dhe masa e prekjes së saj nuk ka qënë aspak e pandjeshme, përkundrazi ka qënë shumë rënduese mbi shtresën me të ardhura të ulta dhe atë të mesme (tre kolonat e fundit të grafikut).

Sipas BERZH (2010) linjat kryesore në të cilat janë shfaqur ndikimet nga kriza kanë qënë shkurtimi i pagave dhe humbja e vendeve të punës, të cilat në vazhdim të analizës së mësipërme pritet të kenë thelluar diferencat në shpërndarje të të ardhurave.

Grafiku 13: Linjat kryesore të përcimit të krizës




Burimi: Life in transition, EBRD, 2010

Shumë studime kanë analizuar ndikimin nga kriza për vendet, të cilat kanë një përpjesë të lartë të remitancave në GDP. Ndërkohë që vazhdimisht është menduar e thënë se sistemi bankar ka qënë përgjithësisht i mbrojtur, kanali kryesor i transmetimit të krizës ka qënë rënia në nivelin e përgjithshëm të remitancave. Mjafton të thuhet se sipas Bankës së Shqipërisë (2009) rreth 65% e remitancave të përgjithshme shkojnë për zonat rurale, ndërkohë që sipas një analize nga Banka Botërore thuhet se 35% e popullsisë shqiptare, pa këto remitanca, do të jetonte në varfëri.

Në periudhën e parakrizës, remitancat kanë qënë në nivelin e tyre më të lartë, e kanë rënë vazhdimisht gjatë viteve më pas. Sipas BB (2011), remitancat për 2011 kanë qënë në nivelin 692 milionë euro, duke pasur një rënie prej 27% kundrejt 2007.

Grafik 14: Ecuria në terma reale e relativë e remitancave




Burimi: ACIT (2012)

Çdo vit që nga viti 1990, Raporti i Zhvillimit Njerëzor (HDI) ka publikuar Indeksin e Zhvillimit Njerëzor, i cili u prezantua si një alternativë ndaj masave konvencionale të zhvillimit kombëtar, të tilla si niveli i të ardhurave dhe norma e rritjes ekonomike. HDI paraqet një shtytje për një përkufizim më të gjerë të mirëqenies dhe siguron një masë të përbërë prej tre dimensionesh bazë të zhvillimit njerëzor: arsim, shëndetësi dhe të ardhura. Vlera e HDI sot për Shqipërinë është 0.74 duke u pozicionuar si vendi i 70 - të në 187 vende gjithsej, duke bërë kështu pjesë në vendet me indeks të lartë në rang global. Për Shqipërinë, sipas të dhënave nga UNDP (2012), jetëgjatësia në lindje është 76.9 vjet, vitet mesatare për arsim 10.4 vjet, ndërsa të ardhurat për frymë janë 7803\$.

Në vazhdim të idesë së mësipërme, sipas barazisë së përsosur apo perfekte, IHDI është i barabartë me HDI, por bie nën HDI kur pabarazia rritet. Në këtë kuptim, IHDI është niveli aktual i zhvillimit njerëzor (duke marrë në konsideratë pabarazinë), ndërsa HDI mund të shihet si një indeks i zhvillimit njerëzor potencial, që mund të arrihet nëse nuk ka pabarazi në shpërndarje të të ardhurave.

Grafiku 16: Kalimi nga HDI në IHDI për shkak të pabarazisë




Burimi: Human Development Report (2011)

Humbja mesatare në HDI për shkak të pabarazisë është 23%, që do të thotë se vendet me më pak zhvillim njerëzor janë të prirura të kenë humbje më të mëdha në indeksin e zhvillimit njerëzor, duke pasur një nivel më të lartë pabarazie, sic u tha më lart.

Si përfundim, është interesant realiteti, që paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Shqiptarët pavarësisht të gjithave, mbeten më optimistët në rajon edhe më gjerë, ku edhe pse ka pasur rënie në këtë aspekt nga ndikimet e krizës, ata qëndrojnë ende shumë më shumë optimistë se rajoni e jo vetëm.

Grafiku 17: Niveli i optimizmit para dhe pas krize



Burimi: Life in transition, EBRD, 2010

Konkluzione

1. Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave është kthyer në një nga problematikat më të mëdha për ekonomite rajonale e më gjerë, por veçanërisht për ekonominë tone në polarizim e sipër.

2. Rritja në pabarazinë e shpërndarjes së të ardhurave, vënë re gjatë analizës së ecurisë së koeficientit GINI, bëhet akoma më shqetësuese kur vërehet diferenca në aksesin në të ardhura ndërmjet 10% apo 20%-shit me të ardhurat më të lartë karshi 10% apo 20%-shit me të ardhurat më të ulta.

3. Niveli i lartë i korrupsionit, niveli i lartë i informalitetit në ekonomi si dhe evazioni fiskal janë disa nga kushtet, që kanë favorizuar e favorizojnë shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave.

4. Vendosija e sistemit fiskal të tipit të taksës së sheshtë në ekonominë shqiptare që prej vitit 2008, ka kontribuar në nxitjen e pabarazisë.

5. Rënia në nivelin e remitançave, si burim të ardhurash për shumicën e familjeve më të varfëra shqiptare, ka ndikuar përvece në rënien e ritmit të rritjes ekonomike të vendit, por edhe në rritjen e nivelit të varfërisë e rrjedhimisht edhe të pabarazisë në shpërndarje të mirëqënies.

6. Investimet e huaja direkte, si kontribuese në rritjen ekonomike për vendet në zhvillim, kryesisht në kuadër të nxitjes së punësimit, pas një rënieje relativisht të lartë nga kriza e fundit, do të duhet të fokusohen më tepër nga ana cilësore në sektorët me ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik e të qëndrueshëm të vendit.

Bibliografia

1. Life in Transition Report, EBRD (2010)
2. Life in Transition Report, EBRD (2012)
3. Human Development Report, UNDP (2012)
4. World Economic Developments, World Bank
5. CIESIN, Columbia University (2010)
6. La pauvreté, les inégalités et l'exclusion sociale, vers l'horizon, CEPE (2013)
7. Shqipëria: Një vlerësim i varfërisë, BB (2003)
8. Global Financial Integrity
9. The Flat - tax system, Agenda Institute, 2007
10. Faktoret e rritjes ekonomike ne Shqipëri, Instituti Agenda
11. Pabarazia e te ardhurave dhe varferia para dhe gjate krizes, Jurgen Faik, May 2012
12. Les inegalites des revenues, Forum de Paris, 2 May 2011
13. Toujours plus d'inegalites: pourquoi les encarts des revenues creusent, OECD
14. Plus ou moins, Finance and Developments, Branko Milanovic, 2011
15. www.instat.gov.al

INDUSTRIA E ENERGJETIKËS (NAFTËS) DHE EKUILIBRI I SISTEMIT TATIMOR

Vladimir Mici

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
ladimici@yahoo.com.sg

ABSTRACT

Since 1997, the output of the extraction and refining have increased. This is as a result of agreements that state company Albetrol conducted with foreign companies that have the technology and money to increase oil extraction. Beside this, the processing of oil and gas have increased too. That was until 2008, after the privatization of state-owned ARMO, this processing has come in the fall as this year, at the lowest levels since 2000. Through this period consumer demand for refining products has seen a trend in growing, and its biggest amount has been provided from the import. In the oil exploration industry, during the 22 years of transition, over \$ 500 million have been invested. Since the year 2000 no research in this field has been made by the Albanian state or by the company owned by the state, and all this activity is left to foreign companies.

Keywords: Oil industry, taxation system, Albania

Hyrje

Eshte e qarte, se qe pas vitit te veshtire 1997, prodhimi i nxjerrjes dhe perpunimit te naftes, ka njohur rritje, te cilat kane nje pershpejtim te tyre edhe me futjen e kompanive te huaja ne procesin e nxjerrjes se naftes nga

vendburimet egjistuese. Kjo si rezultat i mareveshjeve qe kompania shteterore Albetrol ka kryer me kompani te huaja te cilat kishin teknologji dhe para per te rritur naftenxjerrjen.

Krahas ketij projekti ka ardhur ne rritje edhe perpunimi i naftes dhe gazit gjate vitin 2008. Mbas privatizimit te shoqerise " ARMO", ky perpunim ka ardhur gradualisht ne rnie sa kete vit eshte ne nivelet me te ulta qe nga viti 2000.

Gjate kesaj periudhe kerkesa konsumatore per produkte te perpunimit te naftes ka njohur nje tendence ne rritje , (rritje qe nuk vertetohet pas vitit 2008 ku kemi ulje te kerkeses), ku sasia me e madhe e saj sigurohet nga Importi.

Ne situaten kerkimore te naftes, gjate 22 viteve te tranzicionit jane kryer mbi 500 milion dollare investime dhe rezultati eshte, se deri me sot, nuk jane zbuluar vendburime te reja naftes apo gazi.

Pra e permbledhur situata paraqitet : Nje rezultat negative ne shtimin e vendburimeve me rezerva te reja te naftes dhe gazit , nje shtim te aktivitetit prodhues ne vendburimet egzistuese dhe nje ulje e aktivitetit ne perpunimin te produkteve te vendburimeve.

Nga e gjithë kjo sinoptike dallojme, qe pas vitit 2000, nga ana e shtetit Shqiptar, apo nga kompania e zoteruar prej tij, nuk ka pasur asnje aktivitet kerkimi, dhe i gjithë ky aktivitet i eshte lene ne dore kompanive te huaja, si dhe i gjithë ky aktivitet, drejtohet dhe monitorohet nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore.

Kjo agjensi ka dhe mjafttribute qe lidhen edhe me sistemin fiscal, qe rregullon aktivitetin e kerkim prodhimit, mbeshtetur ne atributet e dhena kesaj agjensie dhe rregullimeve speciale.

Thelbi i ketij diskutimi, eshte pozicioni Tatimor ne kete pjese te industrise qe vuan me shume se cdo industri, vullen e pakontrolluar te vendosjes se tatimeve, shpesh here edhe ne kundërshtim me interesat e vete konsumatoreve perfundimtare te saj.

A- Sistemi tatimor veprues aktual

Rregullimet tatimore ne Shqiperi permbledhin dy fusha

- 1- Fusha e kerkim prodhimit te naftes
- 2- Fusha e perpunimit te naftes dhe gazit te prodhuar dhe importuar ne Shqiperi

Ne fushen e kerkim prodhimit rregullimi fiscal eshte i bazuar ne ligjin nr. 7811 date 12.04.1994 "Per sistemin e hidrokarbureve" i cili per vendburimet e reja eshte i mbeshtetur ne nje sistem tatimor progresiv me shkalle reshqitese

bazuar ne nivelet ditore te prodhimit ;

- Tatim fitimin ne masen 50% te fitimit te realizuar cdo vit fiscal dhe ajo mund te jete e paguar ne lloj apo para ne varesi te mareveshjes.
- Nese ky subject eshte Albpetroli dhe ky ka interesa pune nga 50-100% atehere ky tatim eshte 10% per vendburimet e vena ne pune para vitit 1993. Nese Albpetrol ve ne pune vendburimet pas dates 31.12.1993 atehere skeda e tatimit eshte:

Nr	Perqindja e tatimit	Marzhi i prodhimit ditore ne barele
1	30	1-20000
2	50	20000-50000
3	55	50000-65000
4	60	Mbi 65000

- Per shfrytëzimin e vendburimeve Marxhinale te zbuluara ose te kthyer ne marxhinale KM mund te nxjerre VKM te vecanta .
- Fitimi i llogaritur per vitin fiscal ka te zbritur koston kapitale, ato shpenzime administrative etj, sipas specifikimeve ne mareveshjen hidrokarbure te miratuara nga ministri dhe sipas praktikave nderkombetare te industrise se naftes qe zbatohen ne cdo mareveshje hidrokarbure.

I dyti eshte ligji Nr 7928 date 27.04.1995, ndryshuar me ligjin nr 8070 date 27.04.1996 "Per tatimin mbi vleren e shtuar" i cili ne nenin 25/1 thuhet:

Konsiderohen furnizime te perjashtuara nga TVSH

a-furnizimi i sherbimeve qe kryhen nga kontraktoret e nenkontraktoret e tyre , vertetuar si i tille nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve (Sot AKBN), lidhur me realizimin e fazave te kerkimit dhe zhvillimit te operacioneve hidrokarbure.

b-Furnizimi mallrave qe bejne kontraktoret per njeri tjetrin, ose kontraktoret ose nenkontraktoret, te importuara sipas nenit 26/1 te ketij ligji.

I treti eshte ligji nr. 9975 date 28.07.2008 ndryshuar me ligjin nr 10065 date 29.01.2009 "Mbi Taksat kombetare" ku ne grupin VII, te shtojces nr 2, vendoset renta minerare ne masen 10%.

Pra ne menyre te permbledhur ky aktivitet ka dy elemente tatimore. Tatimin e fitimit 10% dhe renten minerare 10%, e cila eshte e aplikueshme ne totalin e shitjeve ne natyre ose lloj ne varesi te kontrates se lidhur.

Por sistemi fiscal plotesohet nga kontrata, dhe kjo ne vet vete eshte sistemi real fiscal. Kjo do te thote qe negocijimi i termave fiscal, eshte baza e tere zhvillimit te marre ne konsiderate. Termi i perdorur ne ligj per percaktimin e kostove referuar praktikave nderkombetare ne kete sector, na con ne nje larmi sistemesh fiskale, sa qe eshte e pamundur te perfshihen ne thelbin e ketij artikulli, per me teper te behet analiza e cdo sistemi ne vecanti. Baza e tere ketyre sistemeve fiscal eshte KNP (Kontratat me ndarje prodhimi)

Ajo qe mund te thuhet eshte se ne sistemin tone vendosja e rentes minerare e ka kthyer sistemin tatimor ne nje sistem tatimor regresiv.

Percaktimi i sistemit tatimor regresiv, ka qene qe ne themel te ligjit nr. 7811 date 12/04/1994 "Per sistemin e hidrokarbureve", ku me ligj percaktohet qe niveli i mbulimit te kostove nga nafta e nxjere, te jete jo me shume se 50%, duke qene se limiti i kosos ne vetvete, perdorej, si nje burim i kufizimi te njohjes se shpenzimeve per vitin actual, duke i mbartur ato ne vitet e meparshme. Ndersa sistemi kthehet ne progresiv pas viti 1998 ku limiti i kosos hiqet dhe rivendoset kur vendoset tatimi mbi te drejten minerare ne vitin 1998.

Percaktimi i ketyre ndryshimeve nga regresiv ne progresiv, dhe pastaj ne regresiv, mund te interpretohet vetem nepermjet disa faktoreve ku duhet te merret ne konsiderate:

1-Sa eshte efekti i ketyre masave ne rritjen e te ardhurave tatimore

2-Sa eshte Influenca ne rritjen e investimeve

3-Sa eshte impakti mbi rritjen e raportit te rezervave dhe nxjertes se naftes dhe gazit.

Por me aplikimin e incetivave qe Kontratat e KNP-ve, qe Shteti ka lidhur me cdo kompani te vecante, kane bere qe edhe efektet negative tatimore te ulen. Jemi perpara fakteve qe p.sh. Bankers nje kompani qe nuk kryen kerkime (jo se nuk ka program kerkimi), por aplikim te teknologjise ne vendburimet egzistuese te jete e perjashtuar nga efektet tatimore per nje periudhe 5 vjecare, dhe nga ana tjetere 50% tjetere, kompania shteterore Albpetrol te vuaje sistemin tatimor ne te gjitha gjeresine e vet, duke qene shpesh here ne pamundesine e financimit te pjeses se saj se operacioneve, qe detyron mareveshja MOP. (Mareveshja e operacioneve te perbashketa). Ne te njejten situatë eshte edhe me kompanite tjera, ku Albpetrol eshte ne kushtet e mareveshjeve te tipit MOP.

Privatizimi actual i Albpetrol duhet te mbarte edhe keto probleme, te cilat duhet te detyrojne qeverine, apo me sakte ta kushtezojne ate te marre te

njeta masa, per te perjashtuar per nje periudhe tatimore nga tatimet edhe kete kompani, pasi shteti lan duart nga keto MOP-e.

Kjo do te coje, qe ne esence te kemi renie ne te ardhurat tatimore ne te ardhmen, nga ana e shtetit edhe per pjesen nga Albetroli .

Vendosja e tatimit mbi renten (te drejten minerare) e ktheu sistemin tatimor ne nje system regresiv, ku kompanite duhet te paguanin 10% te sasise se naftes se nxjerre, dhe mandej te llogarisin efektet e tjera tatimore. Ne konceptin ekonomik ajo eshte si nje mase preventuese per te ndalur kompanite, qe nuk kane para apo ne veshtiresi falimentimi nga kompanite e shendosha financiarisht.

Per Kompanite "Bankers petroleum" , "Stream Oil"... etj, te cilat kane marre persiper rritjen e naftes nxjerjes dhe rritjen e koeficientit te shfrytezimit te rezervave nepermjet teknologjive te reja, kjo eshte nje pengese qe ul burimet e investimit ne keto fusha.

Nga ana tjetere, vendosja e ketij tatimi ka reduktuar perfitueshmeria qe kompanite, mund te merrin per shkak te kufizimit te limitit te kostos. Por fakti ka treguar, qe kompanite e kane perballuar kete tatim. Ndoshta ne kete sens eshte edhe fakti, qe cmimete e naftes kane tejkaluar prishemerite e tyre dhe ka cuar ne nje politike me shtrenguese ne shpenzimet. Ne Bankers vihet re nje ulje e kostos se transportit , qe ka sjell edhe nje mundesi manovrimi.

Pra, ne konkluzion qeveria rendoi bazen tatimore per keto kompani, por nga ana tjetere cmimet favorizuese lejuan, qe keto kompani te vazhdonin programin e investimeve te tyre pikerisht edhe pas ndryshimit te bere ne vitin 2008 per Vendosjen e tatimit mbi renten minerare. Ka egzistuar nje periudhe ne vitin 2008, ku cmimet e naftes u ulen, dhe Shtetet nga ku financoheshin keto kompani, detyruan bankat e tyre te mos nxirrnin jashte likuiditete dhe keto kompani vuajten efektin e ngadalesimit te investimeve dhe te uljes se rritmeve te rritjes se prodhimit , sepse tregu nuk favorizonte mundesine e intensifikimit dhe zbatimin e planit te investime te parashikuara ne angazhimet e tyre kontraktore.

Cdo fushe, pasi zhvillohet ka nje pik prodhimi dhe fushat egzistues kane nje jete te gjate ne shfrytezim, dhe nderhyrjet me metodat e para dhe ne zonat me te mira e kapin efektin ne 6 vitet e para , dhe pas kesaj sado te shtohen investimet ato jane per te mbajtur sa me te bute renien e prodhimit , gje qe do te coje shume shpejt ne nje suate te veshtire te ketyre kompanive. Nese kjo do te shoqerohet me renien e cmimit ne tregun Nderkombetar, kjo do te paraqiste nje suate aspak te favorshme ne rritjen e investimeve.

Shenja e pare do te jete renia e perfitueshmerise se tyre, e kjo do te conte ne renien e vleres se aksioneve ne burse, per pasoje nje renie ne vazhdueshmerine

e investimeve dhe ecurine e prodhimit dhe zgjerimit te kompanise.

Nga ana tjeter privatizimi i Albpetrol, eshte i lidhur edhe me nje sere pasigurish qe shoqerojne mardheniet qe priten te ndertohen midis partnerit te ri dhe kompanive te tjera te lidhuar me MOP, kur Albpetroli trashegon vetem nje vendburim nafte nga privatizimi dhe ajo qe pritet eshte ndarja e prodhimit, qe do te shoqerojne marreveshjen dhe ecurine e tyre.

Sidoqofte pas kesaj ka edhe efekte pozitive qe sigurojne nje manazhim me te mire se sa manaxhimi nga burokracite shteterore shpesh te motivuar politikisht shoqerine shteterore.

Treguesi mbi rezervat e naftes dhe raportin e prodhimit mbi rezervat ne total ka nje permiresim te dukshem. Por ajo qe vleresohet nuk eshte se keto jane rezerva te reja, por te revizionuara, qe nenkuptojne nje ndryshim metodike ne llogaritje ,nje permiresim e i parametrave te vertetuar nepermjet instalimit te metodave, pra ne essence nuk kemi asnje punim gjeologo kerkues per keto rezerva. E pare ne kete kendveshtrim ky tregues eshte perkeqesuar dhe tregon se jemi duke ngrene ate qe kemi zbuluar. Sidoqofte ketu ka nje boshllek shteteror qe lidhet me legjitimitetin e rezervave te raportuara si te shtuara.

Ne literaruren boterore per llogaritja e treguesve te tille behet ne menyre te vecante dhe shpesh per te vleresuar nje kompani, treguesi i tille, qe llogarit ne rezervat e shtuara, rezervat e revizionuar perjashtohet nga llogaritjet e ketij treguesi. Kjo per efektet negative qe jep ne krijimin e imazheve per cmimin e tregut te aksioneve.

Ende kompanite nuk kane filluar operacionet per futjen e metodave EOR, qe rrisin nafte nxjerrjen dhe koeficientin e nafte nxjerrjes .Per pasoje nuk jemi ne fazen te vertetojme efektshmerine metodave dytesore ne rritjen e prodhimit, per pasoje ne rritjen e rezervave te nxjerrshme .Kjo eshte faza per te cilat jane te ndertuar edhe marveshjet me keto kompani.

Menyra e marjes se tatimit mbi renten nga ana e shtetit.

Ne lidhje me kete ka mjaft vend per gjykime subjective dhe qe lene shteg per abuzime me sasine e naftes dhe gazit te prodhuar.

Sipas VKM nr 1203 date 27.08.2008 "Per percaktimin e vleres se sakte, ne % te rentes se pasurise minerare ,sipas vleres se tregut per cdo grup minerar apo grup mineralesh" vlera e saj llogaritet ditën e eksportit te saj me nje kusht, qe perllogaritjet mbyllën me date 15/02/ te vitit pasardhes.

Ne se do ti referohemi cdo mareveshje, kjo ne kete rast duhet te perbeje, qe cdo ton nafte apo M³ gaz i nxjerre eshte i ndare 10% per shtetin dhe 90% per

kompanite qe shesin produktin e tyre jashte.

Kjo do te thote, qe perllogaritja e cmimit nuk duhet te behet mbi bazen e cmimit te shitjes apo kontrates se lidhur ne ditën e eksportit, por ne cmimin mesatar te vitit i llogaritur sipas ponderimit te cmimit brent i koorektuar me graden API te naftes shqiptare dhe sasine e prodhimit ose te ndonje metode tjeter, qe merr per baze perberjen cilesore te naftes dhe cmimin nderkombetar te ketyre nenprodukteve.

Metodika e saj duhet te jete transparente dhe e lexueshme. Ne te kundert dorezimi ti behej ne natyre fizike, per te cilat enti administrues i saj te merrej me shitjen e kesaj sasie.

Emerimi dhe vendosja e kesaj sasie ne ngarkim te nje enti tjeter eshte nje praktike, qe mund te kete pasoja me efekt korupsioni. Faktet e deritanishme paraqesin shenjat e nje ndodhie te tille.

Kesaj shtoi edhe faktin qe kompania shitese mer edhe komisionet e saj.

Kjo tregon se sistemi fiskal ne kete sector eshte problematic dhe nuk ka nje interes ne rritjen e rezervave dhe te prodhimit, por ne zgjidhjen momentale te nevojave te shtetit per burime financiare dhe capital politik ne fushen e futjes se investimeve te huaja.

E krahasuar me periudhen para vitit 2000, situata kerkimore eshte mjaft e dobesuar, dhe lehtesisht e verifikueshme. Kjo sa per faj te metodikave te ndjekura ashtu edhe per shkaqje te paqendrueshmerise se sistemit tatimor te hartuar dhe zbatuar ne vite. Ne perbejme nje shembull te keq te ndryshimeve te vazhdueshme tatimore.

Sistemi fiskal ne sistemin e perpunitimit dhe shitjen e prodhimit vendas.

Eshte e qarte se perpunitimi i naftes vendase ne vend do te sillte nje situatë positive ne bilancin tregëtar te shqiperise. Sot mbi 500 mije tone nafte i drejtohen eksportit ose drejtohen e shiten si lende djegese ne vend, duke ulur ne kete menyre impaktin e fuqishem qe produktet e perpunuara do te kishin ne rritjen e te ardhurave. Por qeveria nuk eshte e orientuar ne mbeshtetjen e ketij sektori, ndonese mban 15% te aksioneve ne kompanine e perpunitimit te naftes ARMO, duke e vene ate perpara fakteve, qe ajo te ule kapacitetet e saj perpunuese, dhe te filloje te jape shenjat e mungeses se likuiditetit dhe te paftesise paguese ndaj te treteve dhe punonjesve. Nese ketu do te shtonim edhe tatimet dhe taksat qe shtohen vit per vit e cojne barren fikse te taksave ne nivele te papranueshme per xhepat e qytetarit duke ulur ne kete menyre edhe kerkesen ne treg per keto produkte.

Kjo eshte lehtesisht e verifikueshme nga te dhenat e publikuara nga instat ku konsumi per vitet 2008-2011 vazhdon tendecen e uljes se saj ne nivelin prej 10-12%.Kjo ne nje kohe, kur ne kemi edhe rritje te prodhimit te naftes brut me nivele prej 50%, po per kete periudhe.

Rritja e aksportit te lendes se pare dhe rritja e importit te nenprodukteve te naftes eshte nje ekuacion mjaft i thjeshte ne bilancin tregetar te nje shteti, ku treguesi me i thjeshte matet me vleren e valutes shtese qe del jashte.

Ne kushtet e cmimit te naftes 100\$ barele sipas brent, qe nenkupton nje cmim per naften tone(me nje tregues 15.5grade Api) 75\$ /barele,eksporti i nje sasie prej 500000 tone duhet te kompesohet e nje import prej 500000 tone nenprodukte . Kjo per faktin sepse nevojat tona per nenprodukte nafte jane ende me te medha sesa prodhohet ne vend. Sipas structures aktuale rreth 75% e burimeve me baze energjitike naften shkon per transportin dhe vetem pjesa tjeter per qellime te tjera. Eshte e kuptueshme, qe baza e cmimit duhet te jete cmimi i gazoilit dhe i benzines platz. Keto cmime jane 2.2-2.5 here me te larta se toni i nje nafte te tipit brent dhe rreth 3 here me shume se cmimi i naftes sone.Kjo do te thote , qe ne kemi shtuar dyfishin ne importe vetem nepermjet politikes se zgjedhur dhe me ndergjegje te plote.Efekti negative llogaritet rreth 500 milion \$ ne bilancin tregetar.

Cfare duhet te beje qeveria. Ne planin e ngushte qeveria eshte Ok sepse sistemi i tatimit eshte me i kontrollueshem dhe me i lehte kur keto produkte importohen dhe jo kur ato prodhohen. Parate e veta tatimore shteti i merr te gjitha . Ajo qe ndryshon eshte erozioni i monedhes kombetare , e perkthyer ne nje zhvleresim te qendrueshem te lekut. Eshte me vend te thuhet se ndersa banka qendrore ben politika te gjeneroj leke duke e bere ate me te lire, (ku likuiditeti eshte shenja e nje krize qe troket ne dere,) dhe me te ndjeshme ndaj valutave e ka bere edhe deficit tregetar ne rritje. Kunder efektin e vete shteti vazhdon duke aplikuar tarifa te reja ose duke shtuar tarifa.Pra ka nje politike fiskale, qe shkon ne drejtim te kundert me politiken monetare.

Po marrim nje shembull te thjeshte. Ne vitin 2003 akciza egzistonte ne masen 18-19 leke per gazoilin e prodhuar ne vend dhe 65% por jo me shume se 27 leke per gazoilin e importit. Ne thelb kjo ishte nje politike qe inkurajonte prodhimin vendas ne kushtet kur cmimi i gazoilit ishte i larte , por kjo nuk favorizonte kompanine shtetore kur cmimi ishte i ulet . Viti 2003 mbahet mend si nje vit me cmime te ulta perjashto periudhen e luftes ne Irak.

Me Vone me nje vendim akciza vendoset 65% por jo me shume se 37 leke per liter dhe sot eshte fiksuar 37 leke/per liter.

Me vone me nje vendim tjeter vendoset edhe taksa e karbonit 3 leke mbi cdo liter. Pra totali i taksave eshte shtuar 20 leke per liter. Duke aplikuar mbi

kete edhe TVSH atehere efekti neto qe kane marre qytetaret eshte 24 leke per liter.

Ne kushtet qe vendi kalon, ku dukshem efektet e krizes financiare duken qarte ne mungesen e likuiditetit, te borxhit public ne nivele maksimale , qeveria eshte e pamundur financiarisht te nderhyje ne politika fiskale, qe synojne uljen e barres fiskale per te bere te mundur rritjen e konsumit dhe per te ndihmuar sektoret e ekonomise .

Sipas nje studimi amerikan, efekti i dyfishimit te cmimt te naftes brut ka nje efekt ne cmimet e mallrave te konsumit 14%. Nga viti 2008 kur cmimi ra ne 46\$ per barel, sot jemi ne pikerisht dyfishin e cmimit dhe vetem ky efekt ka ndikuar mbi 14% (sepse ekonomia amerikane 60% e gazoilit shkon per transport).

Monedha jone eshte ndikuar nga 125 leke kursi i kembimit ne 2008, sot kursi i kembimit varion ne 140 leke duke paraqitur zhvleresimin e monedhes vendase ne raport me euron monedhen me te cilen ajo eshte e lidhur 12%. Pra edhe ky sector i eshte bashkuar krizes.

Po si duhet vepruar ne keto raste.

Ne fakt ky eshte nje diskutim i lene pergjysem ne piken e mesiperme ku shteti eshte zoterues i 10% te naftes se prodhuar ne vend, te cilen atij nuk i duhet ta shese jashte por te dyfishoj vleren e tij brenda vendit duke forcuar dhe ndihmuar biznesin, qe ushtrohet ne Shqiperi. Ne kushtet kur Shqiperia prodhon mbi 800000 ton nafte kjo eshte e barabarte me mbi 80000 ton nafte nenprodukte te hequra nga importi nga e cila 40% vetem gasoil, 30-40% bitum komponente te tjere. Tregu i shitjes per to eshte i garantuar. Kjo me politikat e ndikimit per subvencionet ne buqesi apo peshkim si dhe ne plotesimin e nevojave vjetore per funksionimin e institucioneve buxhetore. Arritja e saj eshte mjaft e thjeshte nepermjet nje kontrate porosie qe kompania aktuale Armo te realizonte me shtetin. Kostoja e perpunimit te kesaj nafte nuk kalon 15% te vleres se naftes brut. Nuk eshte gjetje , por fakt cdo shtet ben politika per te rritur prodhimin ne vend te produkteve energjitike, ku nuk ben dallim as SHBA e ku nuk duhet te beje dallim edhe Shqiperia. Ne fakt ndodhemi perballe faktit, qe kompanite prodhuese jane te lira te bejne cte duan me gjithe prodhimin e tyre, qe i perkthyer ne gjuhen e shifrave shkon ne permasa mjaft te medha, sepse duke luajtur rolin e operatorit ne MOP, ato nga i gjithe prodhimi i marre mbulojne me sasine kostot dhe vetem pjesa qe mbetet i nenshtrohet ndarjes se interesave dhe tatimeve. Rezultatet e deritanishme kane treguar se mbi 80% e produktit te prodhuar nga keto kompani shkon per titullimin e tyre (Nafta e kostos +ndaja e saj e fitimit), gje qe nenkupton se nga 750 mije tone te prodhuar nga keto

kompani 600000 tone kane pare rrugen e eksportit te tyre ose te djegjes se tyre si lende djegese dhe jo perpunimit te tyre ne uzinat Shqiptare.

Mjaft shtete ne klauzolat e tyre parashikojne aplikimin e DMO-ve (detyrimin e shitjes se nje sasie ne vendin e prodhimit). Cmimet per to zakonisht kane nje skonto qe shkon deri 10% me te ulta se cmimet platz te konvertuara me cilesine e naftes brutt.Gjithashtu merren parasysh edhe ulja qe vjen per shkak te shpenzimeve te transportit, qe firma prodhuese i duhet te bej per evadimin e kesaj sasie per eksport.A eshte e mundur? . Sigurisht, qe po pasi firmave ju eshte dhene incentive i perjashtimit nga tatimet ne vitet e pare . Pas pese viteve aktivitet prodhimi nivelet e prodhimit ne vitin 6-8 arrijne maksimumin. Eshte koha per te nderhyre . Kjo behet edhe me akute edhe per shkak te remitancave ne ulje. Kjo do ti jape fryme marje kesaj dege te ekonomise dhe do te krijoje edhe frymemarrjen per kryerjen e investimeve per rinovimin e teknologjise se perpunimit te naftes dhe uljen e ndotjes mjedisore e me te cilat ndeshemi ne teknologjine egzistuese.

Ne keto aresyetime konkludojme :

Strategjia e sektorit hidrokarbur eshte nje strategji e palidhur me sistemin fiscal dhe permiresimin e mirqenies ekonomike te popullsisë . Ajo Nuk lidhet ne vendosjen e tatimeve dhe mbytjen e biznesit ne kete dege me tatime dhe taksa ,qe ndryshojne ne varesi te buxheteve dhe nevojave te dites se qeverise.

Strategjia e rritjes se prodhimit te naftes eshte nje strategji, qe nuk ka funksionuar. Shteti ka luajtur rolin amorf te grumbullimit te tatimeve pa pare efektet ne rritjen e rezervave ne rradhe te pare , punesimit te popullsisë dhe shtimit te mirqenies.Realiteti eshte gjykim afat shkurter.

Tatimet e vendosura nuk kane pasur impact mbi prodhimin dhe investimet, perkundrazi ato kane renduar situaten e biznesit ne kete dege industrie. Perdorimi i incentivave vetem sa kane shperfytyruar transparencen, por nuk i kane sherbyer rritjes se te ardhurave buxhetore dhe as permiresimit te raportit prodhim/rezerva te reja.

Politika shtetere duhet te fokusohet ne permiresimin e bilancit tregetar duke rritur shkallen e perpunimit te naftes ne vend dhe jo te angazhohet ne nje system tatimi, qe i siguron me lehte dhe ne menyre me komode te ardhurat shtetere. Ajo duhet te impenjohet ne rritjen e te ardhurave kombetare, si burimi kryesor i rritjes se mirqenies kombetare nepermjet forcimit te lekut.

Bibliografia

1. Standarte nderkombetare te kontabilitetit.
2. Standarte te kontabilitetit amerikan GAAP
3. Kontabiliteti i naftes ne USA botimi vitit (gusht) 2008 Rebecca Gallun etj
4. Ligji dhe tatimi i naftes dhe gazit ne nafte dhe gaz botim i viti 2005 Grup autoresh.
5. Tatimi federal i te ardhurave ne nafte dhe gaz botim i viti 2007 Patricc Hennesi, Sean Hennesi
6. Sistemet fiskale te naftes nderkombetare dhe kontratat me ndarje prodhimi. Daniel Jhonston viti 1994.
7. Bazat ekonomike te kerkimit nderkombetar, risku dhe analiza e kontratave botim i vitit 2005 Daniel Jhonstoun.
8. Kontabiliteti i naftes botim i viti 2005 Grup autoresh
9. Raportet financiare te Albpetrol sha per vitet 2005,2006,2007.
10. Raporte financiare te Bankers 2005,2006,2007, 2008,2009,2010,2011
11. Historiku i zhvillimit te industrise se naftes botim i vitit 2005
12. Te dhena statistikore te INSTAT
13. Raporti vjetor i AKBN 2011
14. Dokumentet standarte te ankandit public "Per shitjen e 30000 tone dhe 100000 ton nafte brut te Albpetrol sha" faqja zyrtare Mnistria e ekonmise, tregetise dhe energjetikes.
15. Ligji nr 7811 date 12.04.1994 "Per sistemin e hidrokarbureve"
16. Ligj nr 10280 date 20.05.2010 " per disa ndryshime ne ligjin 9975 date 28.07.2008 " Per taksat Kombetare"
17. VKM nr 1207 date 27.08.2008 "per percaktimin e vleres se sakte, ne % te rentes se pasurise minerare sipas vleres se tregut, per cdo mineral apo grup mineralesh.
18. Urdher nr 477 te METE date 27.06.2011 "Per miratimin e forms, permbajtjes dhe procedures se hartimit te aktit te refuzimit per lejet minerare".
19. Urdher nr 478 te METE date 27.06.2011 "Per miratimin e forms dhe permbajtjes se vendimeve te keshillave teknike te institucioneve te SHGJSH-se dhe AKBN per aplikimet e lejeve minerare, per shtyrjen e afatit te lejes minerare dhe per shnderimin e lejeve minerare te kerkim zbulimit ne leje minerare shfrytezimi.
20. Oil and gas Journal date 12.10.2012 (Botim pennwell corporate)
21. Udhezim nr 40 date 3.12.2010 " Per nje shtese ne udhezimin nr 7 date 16.06.2003 "Per akcizat"

MENAXHIMI I RISQEVE BANKARE NË SHQIPËRI NË KUADRIN E KRIZËS GLOBALE FINANCIARE

Erisa Xhaxho

Universiteti Amerikan i Tiranës

e.xhaxho@uat.edu.al

ABSTRACT

Risk management is a complex issue. It helps project managers to determine priorities, allocate resources and implement processes and methods that reduce risk without sacrificing the goals of the project. The hypothesis in this paper is: financial risk management in Albania has been unsatisfactory levels, which has affected the financial result of banks system, much more in the terms of the global financial crisis. Many modern methods of managing financial risks are not recognized and applied by banks in the system, which affects the maintenance of a relatively high spread, to cover operating costs and resulting with profit. For this is designed a questionnaire for the risk management system in 15 commercial banks in Albania. The total score of the questionnaire confirmed the hypothesis of this paper and at the same time, helped to give a clear picture of bank risk management.

Keywords: Risk Management; Financial Crisis, Methods of Managing the Risk Implementation Methods, Spread.

1.Sistemi Financiar Shqiptar nën efektin e Krizës Financiare Global


Bazuar në deklaratën e Bankës së Shqipërisë “Mbi Stabilitetin e Sistemit Financiar në Shqipëri”, Mars 2011, nuk evidentohet ndonjë rrezik i përcjellë

nga zhvillimet rajonale e globale ose i brendshëm, i cili ka mundësi të lartë materializimi dhe që mund të dëmtojë në mënyrë të menjëhershme dhe të rëndë veprimtarinë e sistemit bankar dhe atë financiar. Megjithatë vlerësohet që spektri i rreziqeve po zgjerohet. Më poshtë do japim një pasqyrë të sistemit bankar shqiptar nisur nga treguesit dhe rreziqet më të rëndësishme duke analizuar madhësinë dhe trendin e tyre. Kjo analizë do thellohet në metodën “stress-testing” për të parë sesi mund të përballlet sistemi ynë bankar si rezultat i goditjeve ekstreme por të mundshme

2. Analiza e treguesve kryesor të Sistemit Bankar Shqiptar

2.1. Analiza e depozitave

Rritje e depozitave me 16.1% (Qershor 2009-Qershor 2010), pas rënies së pësuar (Qershor 08-Qershor 09) me -1.8%, dhe rritje e tyre me 12.6%, krahasuar me dhjetor 2008 kur filloi dhe rënia e depozitave. (Këtu duhet marrë parasysh edhe zhvlerësimi i kursit të këmbimit Euro/Lekë për të njëjtën periudhë me 4.4%, duke qenë se depozitat në Euro zenë peshën më të madhe të depozitave në valutë të huaja.) Por gjithësesi në terma real kemi rritje të depozitave. Kështu po të shikojmë vetëm depozitat në lekë ato janë rritur në krahasim me dhjetor 08 me 8.3% (ku nuk ekziston efekti i kursit të këmbimit)




Burimi: Banka e Shqipërisë

2.2 Analiza e Likuiditetit

Analiza e treguesve të likuiditetit tregon se pesha e aktiveve likuide të sistemit ndaj totalit

Figure 1: Ecuria e aktive likuide, qershor 05-qershor 08.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Aktivet likuide të bankave paraqiten 47 % në qershor 2009 dhe gjykoen përgjithësisht të mjaftueshme për të mbuluar një tërheqje të konsiderueshme të depozitave. Edhe nëse supozohet një tërheqje masive e depozitave me 10 për qind, niveli i aktiveve do zvogëlohet vetëm me 17 për qind duke u prezantuar sërish në nivele të mjaftueshme.

Ndërkohë, treguesi kredi ndaj depozitave paraqitet në rritje si rrjedhojë e rritjes së kredisë më shumë se prirja për të grumbulluar depozita. Por, përsëri ky tregues paraqitet në nivele të pranueshme. Ky tregues shfaq vlera të ulët në monedhën vendase dhe në Usd, ndërkohë ai në Euro shfaq vlera të larta dhe në rritje si pasojë e rritjes më të kufizuar të depozitave në valutë krahasuar me rritjen e kredisë në valutë. Kjo sinjalizon se në të ardhmen burimet e kufizuara në valutë të huaj mund të rrisin financimet nga grupi bankar i huaj, në zvogëlim të marxhit neto nga interesat për aktivitetin në valutë dhe rritjen e preferencës për të mbledhur valutë që ka një normë të ulët interesi. Në të gjitha rastet rritet rreziku i likuiditetit.

Tabela 1: Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave në %

Kredi/depozita (%)	Dhjetor 04	Dhjetor 06	Dhjetor 07	Mars 08	Qershor 08
ALL	5	17	22	23	25.3
EURO	106	98	97	106	114
USD	95	36	34	32	33
Te gjitha monedhat	18.7	37.7	46.4	49.5	53.3

Burimi: Banka e Shqipërisë


Një burim i rëndësishëm financimi për disa nga filialet apo degët e bankave të huaja në Shqipëri janë huatë e dhëna nga mëma. Në fund të qershorit të vitit 2008 fondet nga mëma rezultojnë në 55.7 miliardë lekë. Por edhe pse pesha e tyre në totalin e detyrimeve të sistemit ka ardhur gradualisht duke u rritur, nga 2.8 për qind në fund të qershorit 2007 në 7.6 për qind në këtë tremujor, depozitat e klientëve paraqiten burimi kryesor i financimit.

2.3 Analiza e kredisë

Rritje e teprcës së kredisë me 11.3% po për periudhën qershor 09 - qershor 10, krahasuar me një rritje prej 22.5% për peridhën qershor 08-qershor 09. Kjo tregon që gjatë kësaj periudhe janë rritur kreditë e reja të dhëna po është ulur ritmi i rritjes së tyre gati dy herë.

Kjo flet për një politikë më të shtrënguar nga ana e bankave, e cila ka ardhur kryesisht nga fakti i rritjes së kredive me probleme, dhe i frikës së bankave për ndikimet që mund të ketë kriza globale mbi kredimarrësit.

Nga ana tjetër konstatohet një rritje më e madhe e kredisë në lekë se e kredisë në valutë që vjen si rezultat i orientimit të dhënë nga Banka Qendrore për marrjen parasysh të rrezikut shtesë në vendosjen e normave të interesit, në rast mospërputhjeje së monedhës me të cilën është dhënë kredija dhe asaj të të ardhurave.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Rritje e treguesit kredi me probleme / totalit të kredisë me 39.9% nga 8.73% në 12.21%,(qershor 09-qershor 10) që është një nivel i lartë dhe mjaft problematik, sepse tendenca është të vazhdojë përkeqësimi i tyre dhe kjo për dy arsye kryesore:


1. Vështërsitë që po hasin bizneset e konsumatorët familjarë nga situata e përgjithshme makroekonomike;

2. Dhe për mendimin tim dhe që është me peshë më të madhe dhe më problematike, fillimi i shfaqjes së problematikave të dhënies së kredive nga bankat, për efekt të punës së dobët të tyre. Kjo si rezultat:

Së pari: i një kualifikimi të pamjaftueshëm të stafit të bankave dhe

Së dyti: i elementëve korruptive në procesin e dhënies së kredive.

Teknikisht kreditë me probleme fillojnë të shfaqin probleme mbas 1/3 të kohës së dhënies së tyre. Kështu duke qenë se pjesa dërmuese e kredive në sistemin bankar janë dhënë këto 3-4 vjetët e fundit, (pasi sistemi ynë bankar është relativisht i ri sidomos në procesin e dhënies së kredive) dhe duke qenë dhe kredi me afat të mesëm e të gjatë (hipotekare), tani fillojnë të duken edhe mangësitë në dhënien e tyre.



Burimi: Banka e Shqipërisë


Rritja e kredive me probleme me një rritëm me të lartë se rritja e kredive gjendje, do të çojë në një situatë të vështirë financiare të bankave, duke ndikuar në rezultatin e tyre financiar. Kjo gjë është e dukshme dhe aktualisht.

2.4 Analiza e Rezultatit Financiar

Përmirësim i rezultatit financiar nga një ROA 0.1% qershor 09 në 0.4% qershor 10 dhe një ROE 0.8% qershor 09, në 4.4% qershor 10.


Shumica e bankave të vogla rezultojnë me humbje, por kryesorja është se të tre bankat më të mëdha, Raiffesen, BKT dhe Intesa San Paolo, rezultojnë që të treja me fitim, dhe të treja së bashku zenë 56.1% të aktiveve të të gjithë sistemit. (qershor 2010). Nga ecuria e deritanishme e të ardhurave pritët që viti

2012 të rezultojë me një dyfishim të tyre në krahasim me një vit më parë. Kjo është më shumë si rezultat i diversifikimit të investimeve dhe të shërbimeve nga ana e bankave me lloje të reja instrumentash, duke neutralizuar efektin e të ardhurave jo të mira nga kreditë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Një kapitalizim i mirë i bankave, ku norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për disa banka është 2-3 herë më e madhe se niveli minimal i kërkuar nga banka Qendrore prej 12%. Kjo është një situatë mjaft pozitive sepse tregon se bankat kanë burime të brendshme të mjaftueshme për të asimiluar humbjen që janë duke pësuar këtë periudhë, por që ky nivel kapitali nuk është një faktor i përhershëm



Burimi Banka e Shqipërisë

2.5. Përmirësimet në kuadrin rregullativ të mbikëqyrjes bankare

- Banka Qendrore ka ndjekur një politikë më aktive në media, duke rritur numrin e publikimeve, nëpërmjet të cilave tentohet të sqarohet pozicioni i sistemit tonë bankar si dhe efektet e krizës mbi këtë sistem me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut në sistemin tonë bankar.
- Është ndryshuar dhe përmirësuar korniza raportuese e bankave, në lidhje me afatet e kohës, dhe cilësinë e raportimeve, në mënyrë të veçantë në lidhje me ekspozimin e tyre në tregjet ndërkombëtare (dhe bankat-mëmë) si dhe janë bërë modifikime dhe hartime rregulloresh të reja, për të forcuar mbikëqyrjen.
- Janë shtuar disa amendamente në rregulloren "Për menaxhimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"; hyrë në fuqi më 02.08.2009. Përmes këtyre amendamenteve Banka e Shqipërisë ka reduktuar përqindjen e maksimumit të ekspozimit me bankat mëmë apo brenda grupit nga 25% në 10% të kapitalit të tyre rregullator.
- Është riparë sistemi rregullativ i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit duke nxjerrë për herë të parë rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" hyrë në fuqi më 07.12.2009. Kjo rregullore kërkon nga ana e bankave të përcaktojnë:
 - strategjitë dhe politikat që do të ndjekin,
 - strukturat administrative të rrezikut të likuiditetit,
 - sistemin e kontrollit të brendshëm,
 - sistemin e administrimit të informacionit
- Vendosjen e një seti të ri informacioni shtesë nga bankat në muajin shkurt 2009, i cili konsiston në:
 - Analizat e GAP-it për cdo monedhë,
 - Parashikimi i flukseve të parasë,
 - Depozitat e klientëve (depozitat e reja, depozitat e tërhequra përpara afatit të maturimit, etj.),
 - Ndarjen e depozitave sipas disa intervaleve të shumave,
 - Informacion për portofolin e huasë
- Janë rritur kontrollet "on side" jo vetëm të përgjithshëm, por më shumë ato tematike, për një problem të caktuar, të konstatuar nga analizat e bëra dhe informacioni i mbledhur nga bankat.

Këto kontrolle janë shoqëruar me detyra specifike për t'u ndjekur nga ana e bankave dhe kanë ndikuar në përmirësimin e mangësisë së konstatuar.

- Është dyfishuar niveli i përdorimit të normës së rezervës së detyrueshme,

me qëllim që bankat të përdorin më shumë nga rezervat e tyre në Bankën e Shqipërisë, për ta përdorur atë gjatë periudhës së mbajtjes së kësaj rezerve.

- Ka filluar zbatimi i çmimeve fikse (me shuma të pakufizuara) javore të transaksioneve Reverse Repo dhe transaksione Reverse Repo me afate më të gjata, për t'ju përshtatur më mirë nevojave të likuiditetit të bankave;
- Gjithashtu bazuar në analizën e Grup-it të Task force është kërkuar informacion shtesë për cilësinë e portofolit të huasë dhe masat e mara nga cdo bankë individualisht për të identifikuar klientët/sectorët problematikë për të përmirësuar situatën financiare.

Në përfundim, duke parë ecurinë e sistemit bankar nxjerrim konkluzionin, se të gjitha këto masa të marra nga BSH kanë qenë efektive dhe rezultative. Ato I kanë shërbyer dhe do t'i shërbejnë ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve tona financiare dhe si rrjedhim edhe ekonomisë sonë.

Në shumëllojshmërinë e informacionit të kërkuar nga bankat ka vend disa për disa përmirësime:

Së pari informacionet e kërkuara të jenë më konsistente me njëra tjetrën

Së dyti: Të rishikohen pasi ka përsëritje dhe ekzagjerime të informacioneve të kërkuara duke u bërë një barrë jo e vogël për bankat, të cilat angazhojnë 2-3 persona që merren vetëm me raportimet në Bankën e Shqipërisë

2.6. Analiza e sistemit bankar shqiptar me anë të stress-testing

Roli i 'testim stresit' është të sigurojë informacion në lidhje me një ekspozim të jashtzakonshëm në nje institucion (p.sh., humbjet në nivelet më të larta të besimit se ato të para-përcaktuara nga sistemet VAR) ose të paparashikuara. Për të qenë më specifike, testimi i stresit mund të ndihmojë, për të vlerësuar dobësitë në korrelacion, avari, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e përqëndrimit, dhe rrezikun makroekonomik.

Testimi i stresit mund të ndahet në dy forma të gjëra:

(1) Mekanike e variablave të ndryshme matematikore të përfshirë në menaxhimin e metodologjive të rrezikut të një institucioni dhe

(2) Analiza e skenarëve (historike ose hipotetike), skenarët potencialisht të dëmshëm janë të specifikuar dhe vlerësuar me ndikimin real të tyre.

Disavantazhi kryesor i testeve theksoj, është se ata, në dallim nga sistemet VAR, nuk do të caktojnë probabilitetin individuale të rezultateve, i cili lë në

përgjegjësi të menaxhimit , për të gjykuar rëndësinë e vlerave individuale apo skenarëve. Megjithatë, testim i stresit mund të konsiderohet si “një plotësim natyror” me sistemet VAR dhe, në fakt, “Kërkohet nga Komiteti i Bazelit, si një nga shtatë kushtet që duhet plotësuar në modelet e brëndshme. Edhe pse testimi i stresit është disi arbitrare, kontributi i tij është të ndihmojë në menaxhimin e rrezikut, si dhe të bëhemi të vetëdijshëm për dobësitë në analizat ekzistuese të probabilitetit

Duke u përpjekur të dallohen paraprakisht rreziqet e mundshme dhe të propozohen veprimet për shmangien e tyre në sistemin bankar shqiptar, në këtë seksion do të trajtohet analiza e sistemit me anë të metodës “stress-testing”. Kështu do shihet sesi mund të përballet sistemi ynë bankar si rezultat i goditjeve ekstreme por të mundshme. Ndër rreziqet e mundshme analizohet rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesit dhe rreziku i kredisë si dhe rreziqet indirekte të kreditit nëpërmjet kredidhënies në valutë.

2.6.1 Rreziku i kursit të Këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit merr në konsideratë ndikimin e mbiçmimit/nënçmimit të lekut kundrejt dy monedhave kryesore (euro, usd) mbi kapitalin rregullator të sistemit dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në fund të qershorit 2011 pozicioni valutator neto i sistemit në monedhat euro dhe usd është respektivisht, “short” në 1.5 miliardë lekë dhe “long” në 1 miliardë lekë, duke e ekspozuar sistemin ndaj mbiçmimit të euros dhe nënçmimit të dollarit amerikan, ndaj monedhës vendase lek. Nëse do të supozonim një mbiçmim të monedhës euro ndaj asaj vendase lek me 40 % ndikimi në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit do të ishte rënie e tij me 0.2 pikë bazë

Nëse do të supozonim një nënçmim të monedhës usd ndaj asaj vendase lek me 40 %, ndikimi në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit do të ishte rënie e tij me 0.1 pikë bazë

2.6.2 Rreziku i normës së interesit.

Në lidhje me rrezikun e normës së interesit janë përgatitur tre teste që përfshijnë monedhat lek, usd, dhe euro.

Shock-u i normës së interesit për monedhën vendase (zhvendosja paralele e normës aktuale të interesit prej 2.1 % me 5 pikë bazë) pakëson kapitalin rregullator të sistemit bankar me 12.7 miliardë lekë dhe normën e tij të mjaftueshmërisë me 4 pikë bazë.

Shock-u i dytë mat ndikimin mbi kapitalin rregullator të ndryshimit prej 5

pikë bazë të normës aktuale të interesit për euron, sipas normës së interesit 2.1 % dhe normës së re të interesit prej

7.1 % .Norma e mjaftueshmërisë së sistemit do të ulej në 16.3 % pas aplikimit të shock-ut.

Rezultatet e shock-ut të tretë, rritja prej 5 pikë bazë e normës aktuale të interesit në monedhën Usd, flasin për rënie në nivelin e kapitalit rregullator të sistemit me 920 milionë lekë edhe ulje prej 0.3 pikë bazë të normës së mjaftueshmërisë për sistemin.

2.6.3 Rreziku i kreditit.

Në lidhje me stress testing e rrezikut të kreditit simulohet rritja me 100 % e kredive me probleme, rritja e tyre do të thotë rritje e provigjionimeve dhe njëkohesisht ulje e rezultatit neto të bankës e cila do të reduktonte normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit nga 17.3 % në 15.7 %.

2.6.4 Rreziku indirekt i kreditit nëpërmjet kredidhënies në valutë

Testet e përgatitura masin ndikimin e shock-ut të kurseve të këmbimit mbi ndryshimin e nivelit të kredive me probleme në monedhë të huaj, ku të ardhurat e kredimarrësit janë në lekë. Kështu, nënçmimi i monedhës vendase me 40 % kundrejt monedhës euro ndikon në rritjen me 400 % të kredive me probleme në euro, pakëson kapitalin rregullator me 4.8 miliardë lekë dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar me 1.3 pikë bazë

Shock-u i dytë, nënçmimi i monedhës vendase me 40 % ndaj monedhës usd ndikon në rritjen me 400 % të kredive me probleme në usd , pakëson kapitalin rregullator me 286 milionë lekë dhe normën e mjaftueshmërisë të tij me vetëm 0.1 pikë bazë.

3. Një analizë studimore në bankat shqiptare sa e njohin ato, procesin e menaxhimit të rrezikut

Sipas analizës së realizuar në 17 bankat e nivelit të dytë në Sistemin Shqiptar u evidentua që në sistemet bankare me pronësi të huaj, siç është rasti i Shqipërisë, ku kriza globale është e evidente, mbikqyrja dhe politika duhet të përqëndrohen tek rreziqet që lidhen me paqëndrueshmërinë e flukseve të kapitalit të ndërmjetësuar nga bankat. Këto rreziqe vijnë si rezultat i:

1. Faktit që pjesa më e madhe e kredive vjen nga financimi i huaj
2. Nga nënvlerësimi i shtimit të rreziqeve si rezultat :

- a) Mospërputhja e maturiteteve të aktivitetit me pasivin
- b) Mbajta e pozicioneve të hapura valutore

Ajo që ishte e evidente gjatë analizës së këtij studimi, ishte fakti që të gjitha bankat e njihnin rolin e menaxhimit të riskut në rezultatin financiar të bankës , por jo të gjitha kishin krijuar struktura të qarta të menaxhimit të rrezikut sipas kategorive përkatëse të tij. Vetëm 4 , nga 15 banka kishin departamente të vecanta për secilin kategori të rrezikut, kurse në bankat e tjera , analiza gjeti një tentativë për të ndërthurrur dhe shkruar kategori të ndryshme të rrezikut me njëri tjetrin. Kjo vinte si rezultat :

1. I madhësisë së Bankës
2. I kufizueshmërisë së burimeve financiare, njerëzore dhe teknologjike
3. I mungesës së ekspertëve të specializuar në fushën e menaxhimit të rrezikut
4. I mos njohjës si duhet e rrezikut
5. Dhënies prioriteteve një kategorie të rrezikut të cilës i kushtojë vëmendje maksimale , dhe duke " lënë pas dore", kategori të tjera të rrezikut , po aq të rëndësishme
6. Mosmenaxhimi në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur
7. Implementimi i metodave tradicionale të menaxhimit të rrezikut dhe mos azhurnimi me metodat e fundit si Risk Metrics - VAR

4.Risqet Bankare dhe Kriza Financiare në Sistemin Bankar

Nga analiza e përgjithshme në 15 banka vihet re se :

Një nga paradokset e rolit të menaxhimit të riskut është se efica e kontrollit të riskut dhe mjedisit operues është përgjegjësia bazë e menaxhimit të biznesit. Në raste të tilla lind natyrshëm pyetja: kush është përgjegjësia bazë e menaxherëve të riskut? Paradoksi tjetër që ja vlen të përmendet në këtë analizë , është fakti që Risku Operacional vazhdon të mbetet si risi në disiplinat e riskut, me burime të pamjaftueshme informacioni për shkallën e gjerë dhe rolin kritik që ai luan në bankë. Nëse gjithë grupi i Riskut Operacional në industri do të zhdukej brenda natës, çfarë ndryshimi do bënte?

4.1 Menaxhimi i riskut operacional

Menaxhimi i Riskut Operacional duhet parë si pjesë e gjithë platformës së përputhshmërisë që Bankat duhet të respektojnë. Përcaktimi i profilit të riskut

të bankës, si dhe vlerësimi sasior dhe cilësor i aktivitetit të saj, realizohen nëpërmjet inspektimeve në vend nga ekspertë të Bankës së Shqipërisë dhe analizave nga jashtë. Banka e Shqipërisë gjykon se industria bankare duhet të rishikojë strategjitë e rritjes së aktivitetit bankar, duke harmonizuar më mirë nevojat për njerëz të kualifikuar si dhe ato financiare dhe teknologjike

A ndjekin Bankat që operojnë në Shqipëri politika të qarta dhe aktive për menaxhimin e Riskut

Operacional? Në analizën e realizuar në 15 banka të nivelit të dytë rezultoi se : .Identifikimi dhe menaxhimi i Riskut Operacional mbetet një përparësi. Në terma më praktik, ky proces duhet të synojë në ndërtimin e mekanizmave të brendshëm që përvetësojnë krijimin e tepricave në drejtime të caktuara të veprimtarisë bankare dhe synojnë një diversifikim më të mirë të investimeve, si dhe mbështetjen e formave më të qëndrueshme të burimeve financiare. . Të gjitha këto kërkojnë forcimin e sistemit të auditimit të brendshëm, nxitjen e strukturave për të vlerësuar dhe administruar Risqet Operacionale në përgjithësi, personel me ekspertizë bankare, si dhe vendosjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozituesit dhe klientët e tjerë të shërbimeve bankare përmes rritjes së transparencës.,Të gjitha bankat e njihnin rëndësinë e madhe të një menaxhimi të mirë të riskut , por shumica e tyre nuk kishin krijuar struktura të qarta të menaxhimit të këtij risku . Më konkretisht :

Sipas analizës në : *Raiffeisen Bank*

Risku operativ i caktohet Drejtimit të Lartë për çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e riskut operativ në fushat e mëposhtme: kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve; kërkesa për bashkërendimin dhe monitorimin e transaksioneve; përputhja me kërkesat ligjore dhe regullative; dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave

Disa nga sistemet informatike kanë natyrë të lartë operacionale dhe në disa raste kanë paraqitur vështirësi në dhënien e informacionit në kohë dhe me efikasitet duke mbartur kështu rreziqe operacionale.Në përgjithësi është konkluduar se ka nevoja reale për sisteme informatike të reja apo module të ndryshme për të mbështetur aktivitetet kryesore bankare.”

Sipas analizës në :*Tirana Bank*

Në 2011, për shkak të mungesës së vazhdueshme të likuiditetit në tregun ndërkombëtar njësia e menaxhimittë riskut vazhdon të jetë e fokusuar në monitorimin periodik të pozitës së likuiditetit të Bankës, prirja janë kreditë

problematike dhe parandalimi i rreziqeve të tjera të mundshme. Në përputhje me vendimet e Grupit për të miratuar praktikat më të mira të menaxhimit të Riskut, përveç monitorimit dhe kontrollit, theksohet cilësia e të dhënave dhe reduktimi i kohës së raporteve. Pika kryesore e aktivitetit në lidhje me Riskun Operacional është: Kontrolli i Riskut dhe Vetë-Vlerësimi (RCSA)

Sipas analizës në *:Banka Kombëtare e Greqisë*

Banka e konsideron riskun operacional si kategori të veçantë risku i shkëputur nga risqet e tregut, të kredisë dhe ai i likuiditetit. Për këtë arsye, Banka po zhvillon një sistem aktiv dhe të qëndrueshëm për Menaxhimin e Riskut Operacional ("ORM" bazuar në Basel II), në një linjë me praktikat më të mira dhe në përputhje me kërkesat e rregullatorëve, si pjesë e Menaxhimit të Riskut të përgjithshëm të Bankës.

4.2 Risku i likuiditetit në Shqipëri dhe mbikëqyrja

Sistemi bankar në Shqipëri është prekur dy herë nga tërheqje masive të depozitave. Kështu ishte kriza e vitit 2002, e cila nxorri jashtë sistemit bankar rreth 8 % të totalit të depozitave dhe kriza e vitit 2008.

Karakteristikat e ketyre krizave ishte se në dallim nga të tjerët mund të thuhet që Shqipëria nuk u prek nga mungesa e likuiditetit, por nga mungesa e besimit të klientëve në sistemin financiar, pasi në dallim nga të tjerët është një ekonomi cash-I. Në vitin 2008, madje u vu re një dalje e cash-it të filialeve të bankave në Shqipëri, drejt kompanive mëmë jashtë vendit.

Për të shmangur këtë dalje të cash-it, Banka e Shqipërisë, nxorri dhe udhëzimin që u ndalonte bankave nxjerrjen e valutës jashtë vendit, por se sa kjo u arrit mbeti e panjohur. Shumë e rëndësishme në këto periudha ishte besimi që u arrit të përcillej tek publiku që sistemi bankar në Shqipëri ishte shumë i sigurtë. dhe pavarësisht tërheqjeve të bëra, mund të thuhet që gati të gjitha depozitat të tërhequra në vitin 2002 dhe një pjesë e konsiderueshme e atyre të 2008, u arrit të kthehej në sistemin bankar. Krahas pranisë së vazhdueshme në media për sqarimin e publikut, Banka e Shqipërisë vendosi një regjim të përforcuar të monitorimit të zhvillimeve, duke nisur nga marrja e një informacioni ditor kryesisht për zhvillimet në situatën e likuiditetit të sektorit bankar dhe së fundi edhe për ato të kredisë. Gjithashtu, për të ruajtur gjendjen e likuide të sektorit bankar, u ndërmorën operacionet e nevojshme të tregut të hapur duke ofruar likuiditet të bollshëm për bankat tregtare, kryesisht me maturime javore por edhe me maturime mujore e tremujore. Banka e Shqipërisë ka nxjerrë për

zbatim rregulloren nr 71, "Për administrimine rrezikut të likuiditetit"

Menaxhimi I riskut të likuiditetit në Shqipëri bëhet nga struktura të përcaktuara të cdo banke, që janë komitetet e menaxhimit të aktiv- pasiveve ALCO. Bankat janë përgjegjëse për ngritjen e një sistemi raportimi të tillë që u mundëson të njohin me saktësi gjendjen e likuiditetit ditor dhe mujor.

4.3 Risku i kredisë në shqipëri dhe mbikëqyrja

Sipas analizë së realizuar në sistemin bankar shqiptar rezultoi se :

1- Bankat operojnë brenda kriterëve të mirëpërcaktuara për kreditë e reja dhe ato ekzistuese.

2- Kreditë jepen në përputhje me strategjinë dhe brenda tregjeve të synuara.

3- Në çdo bankë ekzistonin struktura të monitorimit periodik të ecurisë së kredisë, të cilat siguronin që kredia është përdorur sipas qëllimit të financimit të kredimarrësit.

4- Nisur nga problematikat e evidentuara nga kriza globale financiare, tashmë, në politikat e dhënies së kredisë , në të gjitha bankat e sistemit shqiptar, fokusi primar në disburisimin e një kredie ishte, aftësia për të paguar dhe reputacioni i kredimarrësit duke mos u mbështetur më, vetëm tek kolaterali

5-Portofoli i kredisë ishte një portofol i diversifikueshëm sipas monedhës, afatit të maturimit, llojit të kredisë dhe kolateralit.

6-Vendosja e limiteve.

7- Plotësimi i dokumentacionit në përputhje me termat e aprovimit, monitorimi, dhe ruajtja në kasaforta të dokumentave të garancisë dhe kolateralit.

4.4 Risku i normave të interesit në Shqipëri dhe mbikëqyrja

Normat e interesit ndryshojnë vazhdimisht. Ato janë në varësi të kushteve të tregut monetar dhe atij financiar, të cilët në vetvete, janë në varësi të të gjithë veprimtarisë ekonomike të vendit, të ndërhyrjes së autoriteteve monetare e financiare në tregje monetare e të kapitalit, si edhe të ndryshimit të kushteve në tregjet financiare e monetare ndërkombëtare..Pra risku i normave të interesit është mundësia që ndryshimi i normave të interesit të ndikojë në të ardhurat nga interesat dhe në vlerën e aktiveve në treg të çdo investitori.

Si e menaxhon riskun e normave të interesit BKT?

Një nga funksionet e bankave si transformues asetesh është dhe kthimi i tyre nga pasive përgjithësisht afatshkurtra në aktive afatgjata.

Normat e interesit në 31Dhjetor 2011 kanë qenë si më poshtë

	<i>Lek</i>	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
Assets			
Cash and balances with Central Bank	3.68%	0.10%	0.70%
Placement and balances with banks	-	1.64%	0.40%
Treasury bills held-to-maturity	9.23%	-	-
Investment securities held-to-maturity	10.46%	6.54%	8.05%
Loans and advances to banks	-	2%	2.39%
Loans and advances to customers	13.34%	8.81%	9.17%
Liabilities			
Customer deposits	5.33%	1.52%	3.38%
Due to banks	5.32%	0.10%	0.10%

Si indikator të vendosjes së normave të interesit për monedhën tonë, BKT përdor REPO-t. Kuptohet depozitave u vendos norma më të ulëta se normat e REPO-ve. Ndërsa normat e kredive në përgjithësi janë mënyrë të konsiderueshme më të larta se REPO-t. Ndërsa normat e interesave për monedhat e huaja vendosen nga tregu ndërkombëtar, psh për Euro-n përdoret EUROBOR-i ndërsa për USD përdoret LIBOR-i. BKT përdor një ndër metodat më bashkëkohore të llogaritjes së riskut të normave të interesit sic është modeli “Repricing”.

Modeli Repricing analizon diferencat midis atyre aseteve dhe pasiveve interesat e të cilave do të rivlerësohen apo ndryshohen brenda afateve të caktuara kohore. Kështu aktivet dhe pasivet të ndjeshme ndaj normave të interesit ndahen sipas kohëzgjatjes deri në maturim në afate kohore të ndryshme .

- Kur GAPI është negativ tregon nëse normat e interesit do të rriten gjatë vitit te analizës, banka do të paguajë më shumë si për pasivet që riçmohen, ashtu dhe për aktivet që riçmohen. Si pasojë shpenzimet për interesat do të rriten më shumë se sa të ardhurat nga interesat, kështu që marzhi i interesave neto do të ulet. N.q.s normat e interesit do të ulen do të ndodh e kundërta

- Kur GAPI është pozitiv (rasti i psh. deri 1 muaj) dhe normat afatshkurtra të interesit ngrihen atëherë të ardhurat nga interesat shtohen më shumë se sa shpenzimet për interesat dhe e kundërta kur normat e interesit do të ulen.

- N.q.s GAPI do të ishte zero, ndryshimi i normave të interesit nuk do të kishte asnjë ndikim në të ardhurën neto nga interesat. Në këtë rast dhe risku është zero. Një rrugë tjetër është që banka të spekulojë. Ajo mund të rrisë

të ardhurat neto nga interesat në rast se ajo është në gjëndje të parashikojë drejtimin e ndryshimit të normave të interesit. Por drejtimi i GAP-it duhet të menaxhohet në mënyrë të kujdesshme. BKT për t'u mbrojtur ndaj ndryshimit të maturiteteve të aktiveve me pasivet, adapton normat e ndryshuara të interesave në perfundim të afateve të maturimeve të kontratave të depozitave apo kredive. Ndërsa efekti i ndryshimit të normave të interesit në investimet si obligacionet shtetërore të Vendeve tëhuaja, nuk ka ndikim fare në vlerën e tyre kontabel. Pra nuk ndikojnë aspak në bilanc rivlerësimi apo zhvlerësimi i tyre. Pra sic shihet BKT diversifikon si depozitat përse i përket afateve të maturimit ashtu dhe investimet në letra me vlerë në monedhën shqiptare dhe atë të huaj.

Konkluzione

1. Identifikimi dhe vlersimi i rritjes së rrezikut të kredisë mbetet një dimension i ri për mbikqyrjen.

2. Lind nevoja për ekspertizë të vazhdueshme e cila duhet të jetë në proporcion me:

- o kompleksitetin e aktivitetit dhe
- o me ekspozimin përkatës

3. Vëmendje i duhet kushtuar përshtatjes së kufizimit lidhur me maturitetin dhe ndryshimet në vlerën e monedhës me qëllim sigurimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut valutor.

4. Drejtimi i mirë dhe monitorimi i ngushtë.

5. Vlerësimin dhe matja e vazhdueshme e rrezikut

6. Nevoja për të krijuar dhe mbajtur një infrastrukture mbështetese,

7. Përcaktimin e qartë të përgjegjësive dhe të linjave raportuese

Një Menaxhimi i rrezikut apo i Kornizës Politike është çelësi për të përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë. Qëllimi i këtij punimi ishte për të ofruar masa konkrete dhe për të përshkruar rreziqet e menaxhimit të rrezikut në tërësinë e tyre. Megjithatë, sugjerohet që ndërgjegjësimi në nivel institucional i kufijve të menaxhimit të rrezikut mund të bëjë një ndryshim pozitiv dhe në këtë mënyrë shmangien e paragjykimeve njohëse, të tilla si: subjektivizmi, vetëbesimi, over-optimizmi, apo iluzioni i kontrollit të cilat mund të shmangen. Kriza e fundit financiare ka theksuar të metat në aftësinë e politikë-bërësve për të matur

rrezikun sistematik. Mangësitë janë të dukshme si në kornizën analitike dhe në metodat e matjes së të dhënave. Sistemi i menaxhimit të rrezikut vazhdon të mbetet një sistem brënda kornizave tradicionale duke krijuar në këtë mënyrë vështirësi reale në një mirë -menaxhim. Kjo përvojë duhet të sigurojë një përmirësim në nivel makro të mbikqyrjes dhe mbledhjes së të dhënave. Një aspekt tjetër i cili nuk duhet neglizhuar është rreziku sistematik i cili mund të përkufizohet si rreziku i përçarjes në shërbimet financiare, që rezulton, nga një dëmtim i sistemit financiar, me potencialin që të dëmtojë ekonominë reale. Ky rrezik mund të lindi kudo në pasqyrat financiare, dhe mund të përforcohet si nga pjesëmarrësit e tregut ose nga informatat jo të sakta. Mënyra, se si ky rrezik është shpërndarë në të gjithë subjektet dhe sektorët, varet nga struktura e lidhjeve në bilanc, të cilat mund të jenë komplekse. Politikë-bërësit të cilët monitorojnë rrezikun sistematik duhet të aplikojnë metoda analitike, për të kapur këtë kompleksitet. Kjo kërkon tregues të shumtë, duke u bazuar mbi një gamë të të dhënave, që japin një pamje të gjerë të sistemit financiar, në mënyrë ideale, nga disa pika të favorshme. Pjesëmarrësit e tregut kanë shumë nevojë për informacion , në lidhje me strukturën e tregut dhe pozitat agregate.

Për parandalimin e krizës, rregullatorët, duhet të jenë në gjëndje të analizojnë së - bashku bilancet e shumë bankave me qëllim të zbulimit, për shembull, të ekspozimit të përbashkët , ndaj klasave të veçanta për asetet ose përqendrimet në tregjet e fondeve. Detyra e rëndësishme është për të vlerësuar rrezikun e kredisë, kundërparti në tregun ndërbankar dhe për të vlerësuar , se çfarë efekti mund të ketë dështimi i një institucioni të veçantë. Kjo kërkon informacion të detajuar dhe frekuencë të lartë në lidhjet bilaterale, për të vlerësuar nivelin e pozicioneve të bilancit, duke përfshirë të dhënat për palët individuale. Por pa shpërndarjen e tyre më të gjerë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë, një analizë më e pasur e rrezikut sistematik është e pamundur.

Ky material ka vënë në dukje një numër fushash ku duhet të ushtrojmë kujdes në mënyrë që të bëjmë një menaxhim të mirë të rrezikut.

8.Së fundi, menaxhimi i rrezikut është ende një fushë e re dhe në zhvillim, i cili është larg nga të ofruarit të zgjidhjeve të strukturuara dhe të unifikuara për probleme të tilla si monitorimi financiarë dhe jo-financiarë i rreziqeve, grumbullimi i rrezikut, rreziku i alokimit të kapitalit. Efektet negative të menaxhimit të rrezikut nuk duhen neglizhuar nga ana e institucionve financiare në sjelljen e tyre për menaxhimin rrezikut.

Rekomandime

1- Sistemit bankar shqiptar i rekomandohet të jetë më konseguentë me sistemin e menaxhimit të riskut dhe të përdori metodat bashkohore si VAR, Risk Metrics, dhe Duration, pasi jo të gjitha bankat i njohin dhe i zbatojnë

2- Bankat duhet të kufizojnë kredidhënien ndaj klientëve në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ato gjenerojnë të ardhurat e tyre. Kjo pasi një mospërputhje e tillë i vë klientët përpara një rreziku shtesë që është rreziku nga luhatshmëria e kursit të këmbimit.

3- Tregu bankar dhe ai financiar nevojitet të ndërtohet dhe zhvillohet paralelisht me sistemin ligjor. Nuk mund të ketë transaksione financiare vendase apo ndërkuftare, nëse nuk ka siguri në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave kontraktore. Aktualisht, ekzekutimi i kolateralit tek ne ka pasur probleme. Çdo shërbim i ri financiar i ofruar nga bankat duhet të jetë i mbrojtur me bazë ligjore të plotë.

4- Nevojitet rishikimi i skemës së sigurimit të depozitave në mënyrë periodike

5- Mbështetje në, teknikat dhe metodologjitë për të mbështetur Menaxhimin e rrezikut (p.sh. krijimi i një harte të rrezikut, planifikimi i një skenari për rrezikun, hartimi i sitemeve software, analizave statistikore dhe cilësore

6- Mbikqyrja duhet të përqëndrohet tek struktura e financimit të bankave, tek rreziku i tregut , rreziku i likuiditetit, i normës së interesit dhe i kredive. Kjo kërkon një drejtim më të fuqishëm makroekonomik, për të përballuar më lehtë goditjet e jashtme.

7- Për shkak të materializimit të rrezikut të kredisë, duhet bërë një rivlersim për objektivave ambicioze të ROE-së që bankat mëmë vënë për filialet e tyre. Filialet duhet të rritin përqindjen e provigjonimit, në përputhje me rivlerësimin e tyre për rritjen e rrezikut të kredisë, duke e detyruar bankën të pakësojnë projektimet për ROE-në.

Bibliografia

1. Raporti vjetor i Mbikëqyrjes, (2009-2011), Banka e Shqipërisë.
2. Trichet Jean-Claude: "Key lessonsm from the crisis", annual conference 2009, organized by the Asociation de Mercados Financieros, Madrid, 23 November 2009.
3. Trichet Jean-Claude, "The financial crisis and our response so far", Global financial forum, New York, 27 April 2010

4. <http://www.economics-ejournal.org/economics/discussionpapers/2008-43> Adrian, T.; Shin, H. S. (2007), Liquidity and Leverage, Working Paper, September 2007, available at:
5. Bank for International Settlements [Basel Committee on Banking Supervision] (November 2011), International Convergence of liquidity and Capital Standards: A Revised Framework – Comprehensive Version,
6. Adrian, T.; Shin, H.S. (2008a), Liquidity, Monetary Policy, and Financial Cycles, in: *Current Issues in Economics and Finance*, Vol. 14, No. 1,
7. Allen, L.; Boudoukh, J.; Saunders, A. (2004), *Understanding Market, Credit, and Operational Risk: The Value at Risk Approach*, Oxford et al. 2004.
8. http://www.banque-france.fr/gb/publications/rsf/rsf_022008.htm (last
9. retrieved: April 3, 2011) Caprio, G.; Klingebiel, D. (2002), Episodes of Systemic and Borderline Banking Crises, in: Klingebiel, D.; Laeven, L. (eds.), *Managing the Real and Fiscal Effects of Banking Crises*, World Bank Discussion Paper No. 428, Washington (D.C.) 2002, pp. 31-49. <http://info.worldbank.org/etools/docs/library/83851/WBDP428.pdf> (last retrieved: March 23, 2008). Chincarini, L. B. (2007),
10. Clarke, R. G. (2003), Measuring and Managing Investment Risk, in: Warwick, B.
11. Crockett, A. (2008), Market liquidity and financial stability, in: Banque de France, *Financial Stability Review: Special Issue on Liquidity*, No. 11,
12. 2006, pp. 183-203. Eichengreen, B. (2008), Ten questions about the subprime crisis, in: Banque de France, *Financial Stability Review: Special Issue on Liquidity*, No. 11, February 2008, pp. 19-28. – Available at: <http://www.banquefrance>.
13. Jorion, P. (2000), Risk management lessons from Long-Term Capital
14. Management, in: *European Financial Management*, Vol. 6, No. 3,
15. September 2010, pp. 277-300.
16. “Neary to retire as Financial Regulator”. RTÉ 2010
17. “Greens call for stronger finance regulator”. RTÉ. 2011
18. From Wikipedia, the free encyclopedia
19. “Stocks slide despite reassurances”. BBC News. 2011
20. <http://news.bbc.co.uk/1/hi/business/7658277.stm>. Retrieved on 2008-10-08.
21. “Hansard”. Hansard.2010
22. <http://www.publications.parliament.uk/pa/cm200708/cmhansrd/cm081008/debtext/81008-0004.htm#08100877000003>. Retrieved on 2008-2010.
23. Capital base of HSBC UK strengthened, 9 October 2008
24. Standard Chartered welcomes UK Government announcement 8 October 2008

LIRIA EKONOMIKE DHE KULTURA SI NXITËS TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

Rudina Ramaj

Universiteti Kristal

lipi.rudina@gmail.com

Ilirjan Lipi

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

lipi.ilirjan@gmail.com

Etleva Leskaj

Universiteti i Tiranës

etlevaleskaj@gmail.com

ABSTRACT

In "The Wealth of Nations", Adam Smith mentions that if the institutions protect the individual's freedom there will be more prosperity for the society. This theory is applied and tested by the Index of Economic Freedom, which for more than a decade applies Smith's theories of prosperity and economic freedom. However, economic development considers not only the role of formal institutions such as property rights and legal regulations, but also considers the influence of social norms and rules under the framework of which are based economic activities such as exchange, investment, savings, and activities of individuals, organizations and institutions. Although the role of formal and informal institutions does not reflect very often in economic development models, it is important for the development of the Albanian economy, an unconventional perspective development, perhaps until well established institutions and other stakeholders begin being effective.

Keywords: Economic development, Index of Economic Freedom, Cultural Index,

1.Hyrje

“If we learn anything from the history of economic development, it is that culture makes all the difference.”

David Landes, the Wealth and Poverty of Nations

“To build a better world, we must have the courage to make a new start. We must clear away the obstacles with which human folly has recently encumbered our path and release the creative energy of individuals. We must create conditions favourable to progress rather than “planning progress.”... The guiding principle in any attempt to create a world of free men must be this: a policy of freedom for the individual is the only truly progressive policy.”

Friedrich A. Hayek

Megjithëse përgjithsisht gjykohet se shoqëritë e lira zakonisht janë më të pasura se shoqëritë e tjera, këtë aspekt më mirë mund ta dëshmoj lidhja dhe efekti i lirisë ekonomike në normat e rritjes së ekonomisë së një vendi. Shumë studiues janë të mendimit se shkalla e lirisë ekonomike ndikon rritjen, megjithatë të tjerë e zbusin këtë gjykim, duke e standartizuar këtë fenomen dhe duke u përqendruar tek lidhja ose marrëdhënia që mund të ekzistoj mes përmirësimit të shkallës së lirisë ekonomike dhe rritjes ekonomike. Institucionet ekonomike të tilla si pronësia private, rregullimet ligjore dhe zbatimi i kontratave janë shumë të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Siç është përkufizuar nga North (1990; 1991), institucionet mund të perceptohen si “rregullat e lojës”, formale ose informale, të cilat e drejtojnë dhe udhëheqin veprimin përmes stimuljeve. Institucionet formale janë struktura të kodifikuara ose rregulla të shkruara, ndërsa institucionet jo-formale përfshijnë kulturën, normat, dhe traditat e imponuara përmes zakoneve sociale (Boettke & Coyne 2009). Kështu nën këtë këndvështrim duke iu referuar dhe problemeve, vështirësive që po kalon sistemi ekonomik shqiptar gjatë fazave të tij të zhvillimit, është e rëndësishme të studiohet dhe përshkruhet lidhja mes institucioneve formale dhe informale me rritjen ekonomike, si dhe efekti i tyre në të. Për shpjegimin e efektivitetit të institucioneve ekonomike, në zhvillimin

ekonomik të një vendi do të përshkruajmë Indeksin Botëror të Lirisë Ekonomike të Heritage Foundation. Ndërsa për të shpjeguar kulturën dhe vlerat, do të përshkruajmë pikërisht karakteristikat që janë të rëndësishme për shkëmbimin ekonomik, dhe dy dimensionet kryesore të indeksit të përgjithshëm (të matur sipas Inglehart) për vëzhgimin e vlerave botërore, i cili konvergjon me vlerat kryesore të matur edhe prej Hofstede dhe Triandis, si Schwartz duke prezantuar në mënyrë të përgjithshme shkallën e besimit, respektit, vendosmërisë dhe bindshmërisë së popullatës së një vendi. Qëllimi i këtij artikulli është të paraqes dhe të përshkruaj efektin që kanë institucionet ekonomike pra ato formale dhe institucionet informale pra kultura ekonomike në zhvillimin ekonomik. Në këtë mënyrë ky studim do të pasuroj literaturën rreth rëndësisë që kanë institucionet në zhvillimin ekonomik, duke i bashkëngjitur këtij këndvështrimi edhe faktorin kulturor. Pra studimi synon që krahas një variabli me hard si efektshmëria e institucioneve, të sensibilizoj marrjen në konsideratë edhe të një variabli më soft ose më cilësor, por që mund të jetë vendimtar në varësi të karakteristikave kulturore gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Kjo çështje u zgjodh për studim duke u mbështetur edhe në shumë studime të mëparshme rreth lidhjes së lirisë ekonomike dhe rritjes ekonomike (Dawson 1998, 2003; Gwartney, Lawson, & Holcombe, 1999; Heckelman 2000; Gwartney, Holcombe, Lawson, 2004), si dhe studimeve rreth lidhjes së kulturës me rritjen ekonomike (Guiso, Sapienza, & Zingales, 2006; Licht, Chanan, & Schwartz, 2007; Tabellini 2008, 2009).

2. Çështjet kryesore të studimit

2.1 Kultura

Para se të mund të përshkruajmë lidhjen e kulturës me rritjen ekonomike, duhet të kujtojmë edhe një herë se çfarë është kultura. Kështu Guiso, etj. (2006: 23), e përkufizojnë kulturën “. . . si besimet zakonore dhe vlerat e pandryshuara që grupet etnike, fetare, dhe sociale trashëgojnë nga një brez në tjetrin”. Ndërsa kultura ekonomike është një tërësi karakteristikash kulturore që janë të rëndësishme për bashkëveprimin dhe shkëmbimin ekonomik. Nën këtë këndvështrim Porter (2000) e përcakton kulturën ekonomike si “ besimet, qëndrimet dhe vlerat që mbështesin aktivitetet ekonomike të individëve, organizatave, dhe të institucioneve” (fq. 14). Duke u mbështetur në këtë përkufizim konceptin e kulturës mund gjithashtu ta ngushtojmë duke u përqëndruar dhe përshkruar vetëm disa prej aspekteve ekonomike të kulturës dhe lidhjes së tyre me zhvillimin ekonomik. Variablat ekonomik kulturor mund

të përfaqsohen prej katër kategorive të veçanta të kulturës të cilat ndikojnë sjelljen në lidhje me ndërveprimin social dhe ekonomik dhe si rezultat ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik të një vendi. Kryesisht këto variabla janë besimi, respekti, vet-vendosja dhe bindja, të cilat do të shërbejnë si rregulla që drejtojnë ndër-veprimin mes individëve, tregut dhe sipërmarrjes. Variabli i besimit, respektit, dhe vet-vendosjes mendohet se e ndikojnë pozitivisht ndër-veprimin ekonomik dhe social, kurse bindja konsiderohet si një faktor që e kufizon ndërveprimin dhe zhvillimin ekonomik, përmes dekurajimit të marrjes së riskut e cila është karakteristika kryesore e sipërmarrjes.

- Nese i referohemi variablit të parë pra, besimit, ai mund të influencoj zhvillimin ekonomik përmes ndikimit që ka tek kosto e transaksioneve. Kur njerëzit i besojnë më tepër njëri-tjetrit kosto e transaksioneve dhe kostot e kontrollit janë më të vogla, dhe të drejtat e pronësisë janë më të sigurta (Williamson & Kerekes 2008). Sipas këtij këndvështrimi theksohet se nivele më të mëdha besimi përqaasen me zhvillim dhe rritje më të madhe ekonomike (Fukuyama 1996; Knack & Keefer 1997). Ndërsa një nivel i ulët besimi zhvillon network të vegjël tregtar mes individëve për shkak të kostove të larta të transaksioneve dhe monitorimit të tyre dhe si pasojë, tregjet janë më të vogla në krahasim me rastet kur këto nivele transaksionesh do të ishin më të mëdha.
- Variabli i dytë kulturor, ai i zgjedhjes individuale është një tregues sasiar i madhësisë së kontrollit që individët ndiejnë se kanë në zgjedhjet dhe veprimet e tyre. Pra me pak fjalë nëse individët kanë kontroll mbi zgjedhjet e tyre pavarësisht rezultateve të veprimeve të tyre, individët do të kenë më shumë motivim në punë, do të jenë më novator dhe do të kenë më shumë gjasa të investojnë në të ardhmen (Tabellini 2009; Coyne dhe Williamson 2009). E thënë ndryshe, nëse individët e perceptojnë suksesin apo dështimin e tyre ekonomik si pasojë e përpjekjeve të tyre (në këtë rast psh. ata kanë vet-vendosje të lartë), atëherë ata do të përpiqen më shumë të jenë eficientë për tu paguar më shumë dhe për të përmirësuar kështu mirëqënien e tyre. Kështu sa më i madh vet-kontrolli individual i një populli, aq më i madh do të jetë zhvillimi ekonomik i vendit të tyre (Banfield 1958).
- Treguesi i tretë i kulturës ekonomike i zgjedhur për tu përshkruar në këtë studim, pra respekti, është i rëndësishëm për faktin se një nivel më i madh respekti sjell një nivel më të madh tolerance për të tjerët. Sa më e madhe toleranca aq më i pranishëm është qëndrimi pro-tregtisë me të tjerët, duke zgjeruar kështu tregun dhe ndikuar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Coyne dhe Williamson (2009: 13) kanë arsyetuar se, “ në shoqëritë me nivele

të ulta të kapitalit social, dhe nivele të ulta të respektit, shtrirja e tregut të transaksioneve kufizohet tek network-et farefisnor dhe miqësor.” Sipas kësaj llogjike, nivelet e larta të respektit sjellin nivele të larta zhvillimi ekonomik.

- Dhe treguesi i fundit kulturor që do të përshkruhet, është bindja, e cila gjykohet se ka një lidhje negative me rritjen ekonomike. Nëse fëmijët në një shoqëri edukohen të jenë rrëptësisht të bindur dhe individualizmi nuk mirëpritet, fëmijët mund të gëzojnë nivele të ulta vet-kontrolli dhe autonomie dhe si pasojë do të kenë më pak inisiative nëse i referohemi kryesisht sipërmarrjes (Tabellini 2009). Sipas studimeve dëshmohet se për shkak të ndikimit negativ të niveleve të larta të bindjes në autonominë e individit dhe si pasojë në inisiativën e ulët ndaj marrjes së riskut, bindja do të ndikoj negativisht zhvillimin ekonomik sepse do të ketë më pak ndërveprim ekonomik sesa në shoqëritë ku autonomia dhe individualizmi vlerësohen më shumë sesa bindja.

Kështu nivele të larta të besimit, vet-vendosjes dhe respektit do të mbështesin rritjen ekonomike, ndërsa bindja dekurajon zhvillimin e ekonomisë. Megjithëse në modelet ose teoritë e zhvillimit ekonomik kultura shpesh neglizhohet ose konceptohet si një faktor konstant, ekzistojnë gjithashtu studime ku janë zbuluar lidhje mes kulturës dhe zhvillimit ekonomik (si përmes ndikimit direkt ose indirekt në sjelljen ekonomike). Kështu Banfield (1958) dhe Putnam (1993) kanë arritur në konkluzionin se aspektet kulturore dhe besimet duhen marrë në konsideratë, sidomos gjatë hartimit të strategjive të zhvillimit ekonomik në mënyrë që këto politika të jenë të sukseshme dhe të qëndrueshme.

Ekonomistët modernë neoklasike tentojnë të minimizojnë rëndësinë dhe lidhjen e kulturës me zhvillimin ekonomik të vendit. Kryesisht ekonomistët i peshojnë supozimeve të thjeshta se qëniet njerëzore janë individë racionale dobi-maksimizues, dhe se kjo sjellje dobi-maksimizuese është kryesisht e pandikueshme prej shoqërive të ndryshme njerëzore. Modeli standart i rritjes ekonomike i inicuar fillimisht prej Robert Solow i cili fokusohet veç tek inputet ose kryesisht tek kapitali dhe puna, i quajtur në vazhdim si modeli “endogjen” i rritjes thekson gjithashtu rolin e teknologjisë në zhvillim. Kështu në këtë këndvështrim, kultura dhe impakti i saj në zhvillimin ekonomik duhen marrë në konsideratë për tu studiuar kur impakti i faktorëve të tjerë të ketë dështuar. Sociologët, nga ana tjetër, kanë tentuar të besojnë se normat kulturore pushtojnë jetën ekonomike, por këto të fundit nuk mund të kuptohen vecmas tyre. Sociologët kanë argumentuar se tregjet e përshkruara prej ekonomistëve në vetvete nënkuptojnë norma të përbashkëta (psh., njerëzit shkëmbejnë të mirat në vend që të vjedhin apo të vrasin njëri-tjetrin), dhe pastaj sociologjia e vëzhgon

shkakësinë më thellë sesa ekonomistët. Max Weber (1930) tregoi se supozimi i ekonomistëve që rritja e pagës fikse për njësi pune do të rrisë outputin ka efekte të kundërta në shoqëritë rurale sepse, duke qenë se punonjësit vlerësojnë më tepër kohën e lirë sesa punën, mund të punojnë edhe me pak gjatë një dite. Ai u përqendrua të tregonte sesi shfaqja e një bote moderne ekonomike varej nga ndryshimi paraparak i vlerave kulturore që kanë të bëjnë me protestantizmin. Sot, ndikimi i kulturës në zhvillim është më tepër fushe studimi e socio-ekonomistëve sesa e ekonomistëve. Një përjashtim i rëndësishëm në gjithë këtë përgjithsim janë ekonomistët e zhvillimit, të cilët janë ekonomistët që specializohen në problemet e rritjes në shoqëritë më pak të zhvilluara, paramoderne, ose jo-Perëndimore. Ata kanë studiuar se shumë sjellje që mund të jenë të mirëqena në SHBA ose në vendet e Europës Perëndimore, si mungesa e korrupsionit tek zyrtarët e administratës publike ose mungesa e paaftësisë, nuk është domosdoshmerisht prezente edhe në shoqëri të tjera. Natyrisht impakti i kulturës nuk mund të krahasohet me një faktor ekonomik zhvillimi siç mund të jetë kursimi ose investimi. Pra kultura nuk mund të shpjegoj e vetme diferencat që ekzistojnë mes zhvillimit ekonomik të vendeve të ndryshme, pasi çdo vend pëson luhatjet e veta në zhvillim si pasojë e luhatjeve të inputeve ose dhe rrethanave të paparashikuara. Gjithashtu edhe efektiviteti i institucioneve ekonomike dhe politike shkakton diferenca në zhvillimin ekonomik të vendeve. Psh qysh para vitit 1945 Koreja e Jugut dhe Koreja e Veriut kanë pasur kulturë të njëjtë, por zhvillimi ekonomik i Koresë së Jugut ka qënë më mirë, pikërisht për shkak të diferencave të institucioneve ekonomike dhe politike. Gjithsesi ka fakte se edhe diferencat kulturore kanë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve, psh. para disa dekadave të shkuara vendet konfuciane të Azisë Lindore kapërcyen shumë vende të tjera të botës përse i përket normave të zhvillimit ekonomik (pavarësisht edhe diferencave që ekzistojnë në llojin e institucioneve ekonomike apo politike të tyre). Ndërsa gjatë të njëjtës periudhë ekonomite e shumicës së vendeve afrikane përjetuan norma të ulta rritje. Kështu psh. në mbështetje edhe të argumentave më sipër përse i përket kulturës, shoqëritë e vendeve para-industriale nuk e përkrahin mobilitetin social apo akumulimin ekonomik të individit. Weber gjithashtu ka argumentuar se një version protestant i Krishtëritimit ka luajtur një rol kyç në kapitalizëm, dhe po kështu më vonë një version modern i Konfucianizmit përmes suportit të edukimit dhe arritjeve promovuan rritje ekonomike. Kështu pra, të gjitha kulturat kanë disa karakteristika të cilat mund ta nxisin ose ta ndalojnë aktivitetin ekonomik dhe si pasojë zhvillimin ekonomik të një vendi.

Vëzhgimet rreth vlerave botërore janë hartuar për të matur të gjitha fushat

kryesore të problemeve njerëzore, prej politikës tek ekonomia dhe jeta sociale. Megjithatë rezulton se dy janë dimensionet që dominojnë këtë tablo vlerash kulturore të vendeve të botës:

- Vlerat tradicionale të besimit kundrejt atyre laike/rationale, si dhe vlerat e mbijetesës kundrejt atyre të vet-realizimit. Këto dy dimensione shpjegojnë më tepër se 70 përqind të diferencave ndër-kulturore të vendeve të ndryshme. Vlerat laike-rationale reflektojnë diferencat mes shoqërive në të cilën feja është më shumë e rëndësishme dhe mes atyre në të cilat nuk është. Një tërësi orientimesh të tjera janë të lidhura gjithashtu me këtë dimension. Shoqëritë të cilat në hartën kulturore rezultojnë më pranë polit tradicional i kushtojnë tepër rëndësi dhe janë më të tepër të orientuara në lidhjen prind-fëmijë dhe respektin ndaj autoritetit, të cilat krahas standartave absolute dhe vlerave tradicionale familjare, refuzojnë divorcin, abortin, eutanasinë, etj. Këto shoqëri kanë nivele të larta krenarie kombëtare si dhe qëndrime dhe sjellje nacionaliste. Shoqëritë me preference laike-rationale kanë qëndrime dhe orientime të tjera përsa i përket të gjitha çështjeve të mësipërme.
- Dimensioi tjetër i dytë i madhi diferencave kulturore mes vendeve lidhet me tranzicionin prej shoqërive industriale tek ato post-industriale, të cilat rezultojnë me një polarizim rreth vlerave të mbijetesës ose atyre të vet-realizimit të individit. Pasuria e akumuluar në shoqëritë e avancuara gjatë brezave të mëparshëm nënkupton se një pjesë e popullatës është rritur duke e pasur mbijetesën të garantuar. Ndaj dhe prioritetet e këtyre shoqërive janë zhvendosur prej sigurimit të nevojave fizike dhe ekonomike drejt atyre që përqendrohen tek rritja dhe përmirësimi i mirëqënies subjektive të individit, vet-realizimit dhe cilësisë së jetës.

2.2 Përfitimet e Kulturës

Teorit rreth motivimit e theksojnë rolin e kulturës në performancën ekonomike, përmendur edhe prej Weber (1904-1905) në studimin e etikës protestante. Ky mendim i dha rrugë kërkimeve historike të Tawney (1926, 1955), rasteve studimore të Harrison (1992), dhe punës empirike të McClelland etj. (1953), si dhe të tjera studimeve rreth motivimit për arritje. Inglehart (1971, 1977, 1990) e zgjeroi këtë studim duke vëzhguar zhvendosjen prej vlerave prioritare materialiste tek ato post-materialiste. Megjithëse studimet e mëparshme përqendroheshin tek pasojat politike të këtyre vlerave, studimet e mëvonshme u zhvendosen tek roli i vlerave në rritjen ekonomike. Këto vlera të reja mund të konceptohen si erosion i etikës protestante mes popullatave që përjetojnë nivele të larta të sigurisë ekonomike. Statusi social është më tepër i trashëguar sesa i

arritur, dhe normat sociale e inkurajojnë kështu individin ta pranoj pozicionin e vet social në jetë. Aspiratat drejt mobilitetit social janë ashpërsisht të shtypura. Këto sisteme vlerash ndihmojnë të mbahet solidariteti social por dekurajojnë akumulimin ekonomik. Harta kulturore e vlerave botërore reflekton se një numër i madh vlerash bazë janë ngushtësisht të korreluara, dhe ato mund të përshkruhen prej variancave të dy dimensioneve kryesore ndërkulturore “vlerave tradiconal/racionale” dhe dimensionit “mbijetesë/vet-realizim”, siç prezantohen edhe në hartë. Çdo vend në hartë është pasqyruar dhe vendosur sipas vlerave të njerëzve të vet dhe jo sipas lokacionit gjeografik. Në një pjesë të madhe këto dy pozicionime qëndrojnë pra rasisht të njëjta, por gjithësesi kjo hartë prezanton afërsinë kulturore të vendeve dhe jo atë gjeografike. Kështu psh., Australia, Kanadaja, U.S.A dhe Britania e Madhe rezultojnë fqinjë kulturore, pavarësisht shtrirjes së tyre gjeografike. Zhvendosja prej vlerave të mbijetesës drejt vlerave të vet-realizimit përfshin gjithashtu edhe vlerat e rritjes dhe edukimit të fëmijëve, dhe zhvendosjes së fokusit prej të punuarit fortë drejt zhvillimit të imagjinatës dhe tolerancës si vlera të rëndësishme për edukimin

e një femije. Dhe kjo lidhet me rritjen e ndjenjës të mirëqënies subjektive që mund të arrihet në një mjedis tolerance, besimi dhe moderimi politik, duke prodhuar kështu një kulturë në të cilën njerëzit i kushtojnë një rëndësi të veçantë lirisë individuale dhe vet-shprehjes si dhe pasjes së orientimeve aktive politike. Këto janë gjithashtu edhe karakteristika thelbësore të cilat literatura mbi kulturën politike i përcakton si thelbësore për demokracinë.




Figura 1. Harta e vlerave kulturore botërore (vëzhgimi 1999-2004)

2.3 Liria Ekonomike

Një tjetër variabël i zgjedhur në këtë studim si faktor impakti në rritjen ekonomike është edhe liria ekonomike. Liria ekonomike, në përkufizimin bazë të vet, i referohet mbrojtjes së të drejtave të pronësisë private dhe lirisë vullnetare për kryerjen e transaksioneve (Gwartney, Lawson, & Block, 1996). Kështu për shembull një qeveri që nuk nxit zbatimin e kontratave, por uzurpon pronat e qytetareve të vet pa iu dhënë kompesimin e duhur, si dhe vendos kufizime në shkëmbimin vullnetar shkel parimet ekonomike. Pra në këtë mënyrë dekurajohet sipërmarrja dhe produktiviteti dhe individët nuk kanë besim se përpjekjet e tyre do të shpërblehen, sepse është pikërisht pritshmëria për fitim përtej aktiviteteve produktive dhe ideve të reja që e bën të mundur sipërmarrjen dhe si rezultat edhe rritjen ekonomike. Shumë studime janë përpjekur të vëzhgojnë lidhjen mes lirisë ekonomike dhe rritjes ekonomike, psh. Gwartney, Lawson, dhe Block (1996), krijuesit e Fraser Institute të treguesit të lirisë ekonomike, vunë re se vendet me lirinë më të lartë ekonomike kanë pasur një normë rritje vjetore të GDP-së reale për frymë prej 2.4 përqind, ndërsa ato me nivelin më të ulët të lirisë ekonomike kanë normë mesatare rritje me 1.3 përqind (gjatë periudhës 1980–1994). Kështu me të drejtë mund të gjykojmë se nëse vendet përmirësojnë ose rrisin nivelin e lirisë ekonomike mund të përmirësojnë edhe rritjen ekonomike.

2.4 Indeksi i Lirise Ekonomike

Indeksi i Lirise Ekonomike (sipas Heritage Foundation) përfshin një tablo të madhe dhe gjithë përfshirëse, që mat performancën e këtij vendi nën këndvështrimin e lirisë ekonomike, duke matur 10 fusha të veçanta të lirisë ekonomike. Disa prej indekseve të matura nën fokusin e lirisë ekonomike lidhen me ndërveprimet e një vendi me vendet e tjera të botës, si për shembull hapja e ekonomisë së një vendi ndaj investimeve ose tregtisë botërore. Kështu shumica e këtyre aspekteve orientohen dhe vlerësojnë në mënyrë sasiore politikat e një vendi, duke vlerësuar kështu lirinë e individëve të një vendi për të përdorur punën ose financat e tyre pa kufizime dhe pa ndërhyrje të tepruara shtetërore. Të gjitha aspektet e lirisë ekonomike luajnë një rol vital në zhvillimin dhe mbështetjen personale si dhe për progresin kombëtar gjithashtu. Ato nuk janë reciprokisht përjashtuese, madje progresi në një aspekt shpesh ndihmon dhe nxit progresin edhe në një aspekt tjetër, psh nëse të drejtat e pronësisë nuk

respektohen sa duhet, më i vështirë do të jetë gjithashtu progresi në shumë aspekte të tjera të lirisë ekonomike.

Kështu sipas Heritage Foundation për të rritur nivelin e analizës dhe qartësin e indeksit, për vitin 2012, janë vëzhguar 10 aspekte të lirisë ekonomike, të cilat janë grupuar në katër kategori ose shtylla kryesore të indikatorëve që masin dhe vlerësojnë lirinë ekonomike të një vendi.

1. **Mbizoterimi i Ligjit** (të drejtat e pronësisë, lira prej korrupsionit)
2. **Kufizimi i Qeverisë** (liria fiskale, shpenzimet qeveritare)
3. **Eficienca Rregulluese** (liria e biznesit, liria e punës, liria monetare)
4. **Hapja e Tregjeve** (liria tregtare, liria e investimit, liria financiare)

Secila prej këtyre katër shtyllave kryesore vlerësohet prej 0-100 pike secila, dhe indeksi i përgjithshëm i lirisë ekonomike të një vendi do të jetë një mesatare e thjeshtë e pikëve të këtyre 10 treguesve të lirisë ekonomike të përdorur në studim.

Përfitimet prej Lirisë Ekonomike

1. Mbrojtja e të drejtave të pronësisë. Një nga aspektet kryesore të mbrojtjes së të drejtave të pronës është zbatimi i kontratave. Sipërmarrja vullnetare e detyrimeve kontraktuale është baza e një sistemi tregu dhe gjithashtu baza për specializimin e ekonomive, prej fitimit tej shkëmbimit tregtar, si dhe këmbimit apo tregtisë mes kombeve. Megjithatë edhe përfshirja e qeverisë për zbatimin e kontratave private është e rëndësishme për të garantuar barazinë dhe intergritetin në tregje të ndryshme.

2. Korrupsioni. Korrupsioni mund të shtrihet gjithandej në ekonomi; dhe ka një lidhje direkte mes shtrirjes së rregullimeve qeveritare ose ndërhyrjeve shtetërore në aktivitetin ekonomik dhe madhësisë së korrupsionit. Transparenca është një nga armët më të mira në luftën kundër korrupsionit, ndaj transparenca e procedurave dhe proceseve rregulluese mund të promovoj trajtimin e barabartë si dhe një eficence dhe efikasitet më të madh rregullator.

3. Niveli i përgjithshëm i taksave. Në Indeksin e Lirisë Ekonomike, barra e taksave prezantohet prej matjes së barrës së përgjithshme të taksës prej të gjitha formave të taksimit si përqindje totale e GDP-se. Norma marxhinale e taksës që has një individ është, realisht një pjesë që qeveria i pret fitimit të njësisë pasuese të punës ose angazhimit në një sipërmarrje rrisht, dhe vetëm ajo çfarë mbetet pas taksës është shpërblymi aktual për përpjekjen e individit. Të gjitha shpenzimet qeveritare të cilat do të financohen vetëm prej taksimit më të lartë, shoqërohen me një kosto oportune të barabartë me vlerën e konsumit privat

ose të investimit që do të ishte bërë nëse këto burime monetare do të liheshin sektorit privat dhe nuk do të akumuloheshin buxhetit të shtetit.

4.Liria e Biznesit. Liria e biznesit i referohet të drejtës së një individi për të ngritur dhe drejtuar një biznes pa ndërhyrjen e shtetit. Rregullimet e rënda dhe të tepërta janë barrierat më të zakonshme për sjelljen e lirë të aktivitetit sipërmarrës. Mundësia e një individi të punoj aq sa ai dëshiron dhe kurdo që dëshiron është komponenti kyç i lirisë ekonomike. Rregullimet qeveritare përfshijnë një sërë formash, duke iu referuar kontrollit të pagës, kufizimeve në punësim dhe pushimit nga puna, si dhe të tjera kufizimeve. Kështu sa më e madhe shkalla e lirisë së punës aq më e vogël norma e papunësisë në një ekonomi.


5.Liria Monetare. Liria monetare, që reflektohet në një monedhe të qëndrueshme dhe cmimeve të përcaktuara nga tregu, është për një ekonomi një tjetër komponent kyç i lirisë apo demokracisë ekonomike. Njerëzit e lirë kanë nevojë për monedhe të qëndrueshme dhe të besueshme si një mjet kembimi, njësi llogaritje apo rezervë vlere. Pa lirinë monetare, është e vështirë që një ekonomi të arrijë vlerë afat-gjatë ose akumulimin e kapitalit. Liria tregtare reflekton hapjen e ekonomisë në importin e të mirave dhe shërbimeve nga vendet e tjera të botës dhe mundësinë e qytetarëve për të ndërvepruar lirshëm si blerës ose shitës në tregun ndërkombëtar. Kufizimet tregtare shfaqen në formën e tarifave, taksave të eksportit, kuotave tregtare ose të drejtave të tregtisë. Gjithsesi, kufizimet e tregtisë shfaqen edhe në forma më të fshehta, veçanërisht në formën e barrierave rregullatore. Masa në të cilën qeveria pengon lëvizjen e lirë të tregtisë së jashtme ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në aftësinë e individëve për ndjekjen dhe arritjen e qëllimeve ekonomike dhe maksimizimin e produktivitetin dhe mirëqënies së tyre.

6.Liria e Investimit. Një mjedis i lirë dhe i hapur siguron oportunitete sipërmarrëse maksimale dhe nxitje për zgjerimin e aktivitetit ekonomik, rritjen e produktivitetit, dhe krijimin e punës. Prej përfitimeve të një mjedisi të tillë përfitojnë jo vetëm kompanitë që marrin riskun sipërmarrës në pritje të një kthimi më të madh, por edhe shoqëria në përgjithësi. Një strukturë efektive investimi do të karakterizohet prej transparencës dhe barazisë, duke ndihmuar të gjitha tipet e firmave dhe jo thjeshtë firmat e mëdha ose kompanitë me rëndësi strategjike, duke inkurajuar kështu novacionin dhe konkurrencën.

7.Liria Financiare. Nje sistem financiar transparent dhe i hapur garanton drejtesi në aksesin e financimit dhe promovon sipërmarrjen. Një mjedis i hapur bankar inkurajon konkurrencën për të siguruar ndërmjetësimin eficient financiar mes familjeve, firmave, investitorëve dhe sipërmarrësve. Nëse

rregullimet bankare dhe financiare shtetërore do të shkojnë përtej garantimit të transparencës dhe ndershmërisë në tregjet financiare mund të pengojnë eficiencën, të rrisin kostot e financimit të aktivitetit sipërmarrës, duke kufizuar zhvillimin ekonomik.

Figura 2. Harta e lirisë ekonomike botërore (Heritage Foundation)




Berggren (2003) ka përmbledhur studimet e mëparshme rreth lidhjes së lirisë ekonomike me rritjen ekonomike dhe ka arritur në konkluzion se pavarësisht studimeve të shumta të kryera rreth kësaj çështje nevojiten ende studime të tjera për ta zbuluar më tepër këtë lidhje. Wu dhe Davis (1999) kanë vëzhguar korelacionin mes lirisë ekonomike, lirisë politike dhe rritjes, dhe kanë gjetur se liria ekonomike ka rëndësinë e vet dhe të veçantë për qëllimin e rritjes ekonomike. Studiuesit kanë zbuluar se disa aspekte të lirisë ekonomike kanë lidhje më të fortë pozitive me rritjen ekonomike në krahasim me disa karakteristika të tjera. Carlsson dhe Lundstrom (2002) kanë investiguar katër prej shtatë fushave të indeksit të lirisë ekonomike (si struktura ekonomike dhe përdorimi i tregjeve, liria për të përdorur monedha të tjera, struktura ligjore dhe siguria e pronësisë, dhe liria e shkëmbimit në tregjet e kapitalit) të cilat kanë rezultuar të lidhura pozitivisht me rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Dy prej komponenteve të indeksit të lirisë ekonomike (si madhësia e qeverisë dhe shkëmbimi ndërkombëtar, dhe liria për të tregtuar me të huajt) kanë

lidhje të rëndësishme negative me rritjen ekonomike. Ndërsa komponenti i fundit (politika monetare dhe stabiliteti i çmimit) ka rezultuar me lidhje të parëndësishme me rritjen ekonomike.

3. Përfundime

Ky studim ka synuar të përshkruaj rëndësinë e indeksit të lirisë ekonomike dhe të vlerave kulturore si dy komponente ose ingrediente të zhvillimit ekonomik. Sepse të dy këto treguesa agregate përbëjnë një pjesë të rëndësishme të mjedisit ekonomik formal dhe jo- formal ku agjentet ekonomik në një vend apo shoqëri të caktuar ndërveprojnë.

Figura 3. Harta e GDP nominal për frymë, 2009 (sipas FMN)



Pra duke synuar kështu të përshkruaj dhe të përmbledhi këto tregues ose faktorë të zhvillimit ekonomik të cilët duhen marrë në konsideratë për rëndësin që kanë gjatë hartimit të politikave ekonomike dhe sociale të një vendi do të prezantoj edhe një mini-panel të dhënash dytësore të aksesuara prej databazave të ndryshme të indekseve globale rreth çështjeve në fjalë, rreth indeksit kulturor të vendeve, indeksit të lirisë ekonomike si dhe të indekseve të zhvillimit ekonomik të vendeve (pikërisht të GDP-së për frymë). Në përpjekje për të prezantuar një përmbledhje të sintetizuar përta i përket vlerave dhe lirisë ekonomike, për ta bërë më aktuale studimin është ndërtuar një panel prej disa vendeve të botës si dhe indekseve të vlerave, lirisë ekonomike dhe GDP-së për frymë, për të ditur aktualisht sesi vende të ndryshme po përformojnë.

Tabela 1. Renditja e vendeve të panelit të studimit sipas GDP-së për fryme (Heritage Foundation, 2012)


Nr	Vendet më të varfra	Renditja sipas GDP frymë	GDP frymë (PPP)
1	Togo	10 Vendet me te Varfra	\$858.0
2	Malawi	10 Vendet me te Varfra	\$827.1
3	Sierra Leone	10 Vendet me te Varfra	\$807.1
4	Niger	10 Vendet me te Varfra	\$755.3
5	Central African Republic	10 Vendet me te Varfra	\$744.7
6	Eritrea	10 Vendet me te Varfra	\$681.0
7	Zimbabve	10 Vendet me te Varfra	\$433.9
8	Burundi	10 Vendet me te Varfra	\$410.8
9	Liberia	10 Vendet me te Varfra	\$392.3
10	Congo, Dem. Rep.	10 Vendet me te Varfra	\$328.1
11	Shqipëria	Renditet ne vend te 86-te	\$7,453.5
12	Qatar	10 Vendet me te Pasura	\$88,558.8
13	Luxembourg	10 Vendet me te Pasura	\$81,383.3
14	Singapore	10 Vendet me te Pasura	\$56,521.7
15	Norway	10 Vendet me te Pasura	\$52,012.5
16	United Arab Emirates	10 Vendet me te Pasura	\$48,820.9
17	United States	10 Vendet me te Pasura	\$47,283.6
18	Hong Kong	10 Vendet me te Pasura	\$45,736.3
19	Switzerland	10 Vendet me te Pasura	\$41,663.0
20	Netherlands	10 Vendet me te Pasura	\$40,764.5
21	Australia	10 Vendet me te Pasura	\$39,699.4

Paneli me sipër ofron një tablo të të dhënave të panelit të zgjedhur për studim rreth njërit prej indekseve të zhvillimit ekonomik, dhe pikërisht të GDP-së për frymë, ku Shqipëria renditet në vendin e 86 (2012), me rreth \$7,453.5 për frymë, ndërsa vendi me GDP-në për frymë më të lartë në botë rezulton Katari me \$88,558.8 për frymë, dhe ai me GDP për frymë më të vogël rezulton Togo, në rajonin e Afrikës me vlerë \$858.0 për frymë. Këto ekstreme mirëqenie, varfërie apo pasurie sigurisht nuk shpjegohen vetëm prej diferencave kulturore apo shkallës së lirisë ekonomike por sigurisht dhe prej variablave të tjerë ekonomike ose jo të papërfshirë në këtë studim. Gjithsesi për ekonomistët e zhvillimit si dhe për vendimarrësit publike është e rëndësishme të tentojnë


të kuptojnë edhe modele zhvillimi mbështetur në rolin e kulturës dhe lirisë ekonomike për të përfituar ndoshta edhe një këndvështrim më të plotë dhe më të domosdoshëm, sidomos për shoqëritë e mbijetesës.

Nëse do ti referoheshim të dhënave të panelit të ndërtuar për këtë studim përsa i përket treguesve të dy dimensioneve kulturore, të dhënat do të renditen si më poshtë. Rendin më të ulët racional e zënë vendet afrikane të panelit të cilat ndërkohë përbëjnë edhe vendet më të varfra në botë, ndërsa ky dimension rezulton më i lartë në Hong Kong dhe Norvegji, ndërsa mirëqënia gjithësi rezulton më e lartë në Norvegji.

Grafiku 1. Indeksi i vlerave tradicionale/racionale (për vendet e panelit të studimit)




Grafiku 2. Indeksi i vlerave mbijetese/vet-realizim (për vendet e panelit të studimit)



Ndërsa përsa i përket dimensionit të dytë, atij të vlerave mbijetese/vet-realizim, vlerën më të ulët të tij prej vendeve të panelit e zënë Zimbabve dhe pastaj Shqipëria, ndërsa GDP-për frymë e Zimbabve është \$433.926 dhe e Shqipërisë \$7453.474. Pra vihet re një diferencë e madhe në nivelin e mirëqënies, diferencë e cila shprehet edhe përmes faktorëve të tjerë të zhvillimit (duke përmendur se kultura nuk është i vetmi faktor që ndikon zhvillimin e ekonomisë, por në fazat e para të zhvillimit mund të jetë i rëndësishëm). Ndërkohë që vendet me indeks më të lartë të këtij dimensionit rezultojnë Australia dhe Holanda, ndërsa indekset e GDP-së për frymë për këto vende rezultojnë \$40764.5 për frymë për Holanden dhe \$39699.4 për Australinë.

Grafiku 3. Indeksi i Lirise Ekonomike (2012, për vendet e panelit të studimit)



Gjithashtu siç duket në grafikun e indeksit të lirisë ekonomike vendi me indeksin më të ulët të lirisë ekonomike rezulton Zimbabve dhe ai e indeksin më të lartë Hong-Kong, ndërsa Shqipëria renditet në vendin e 57-të me një indeks prej 65 pikësh. Duket qarte se ka polarizime përsa i përket indeksit kulturor dhe atij të lirisë ekonomike në lidhje me GDP-për frymë të vendeve, por madhësia, rëndësia si dhe marrëdhënia e lidhjes së këtyre faktorëve me zhvillimin ekonomik kërkon një panel më të plotë të dhënash duke iu referuar madje disa periudhave zhvillimi dhe një paneli më të gjerë vendesh, si edhe duke konsideruar edhe tregues të tjerë zhvillimi si psh. normën e rritjes së GDP-se, duke krijuar kështu klustera dhe duke nxjerrë saktë në pah këtë efekt, për të gjeneruar rezultate dhe konkluzione objektive për hartuesit e

politikave dhe studiuesit e kësaj fushe. Gjithësesi përderisa tabloja e zhvillimit është shumëfaktoriale atëherë, duhet patjetër ti kushtojmë rëndësi çdo faktori, referuar kryesisht kështu vlerave dhe lirisë sidomos në vendet ku këto indekse kanë vlerë të ulta (ose jo fortë të kënaqshme), për të furnizuar me këndvështrime të reja literaturën e ekonomiksit të zhvillimit të këtyre vendeve.

Bibliografia

1. North, D. C. (1990) *Institutions, Institutional Change and Economic Performance*. Cambridge:Cambridge University Press.
2. North, D. C. (1991). 'Institutions'. *Journal of Economic Perspectives*, 5(1): 97-112.
3. Boettke, Peter, and Christopher Coyne. 2009. "Context Matters: Institutions and Entrepreneurship," *Foundations and Trends in Entrepreneurship Monograph Series*.
4. Inglehart, Ronald (1997). *Modernization and Postmodernization: Cultural, Economic and Political Change in 43 Societies*. Princeton: Princeton University Press, 1997.
5. Hofstede, G. (1980). *Culture's consequences: International differences in work-related values*. Beverly Hills CA: Sage.
6. Triandis, Harry C. (1995). *Individualism and collectivism*. Boulder, CO: Westview.
7. Schwartz, Shalom H. (1992). *Universals in the content and structure of values: Theory and empirical tests in 20 countries*. In M. Zanna (Ed.), *Advances in experimental social psychology* (Vol. 25) (pp. 1-65). New York: Academic Press.
8. Dawson, J.W. (1998). "Institutions, Investment, and Growth: New Cross-Country and Panel Data Evidence," *Economic Inquiry*, 36: 603- 619.
9. Dawson, J.W. (2003). "Causality in the Freedom-Growth Relationship," *European Journal of Political Economy*, 19(3): 479-495.
10. Gwartney, J.D., R.A. Lawson, R.G. Holcombe. (1999). "Economic Freedom and the Environment for Economic Growth," *Journal of Institutional and Theoretical Economics*, 155: 643- 663.
11. Gwartney, J.D., R.A. Holcombe, and R.G. Lawson. (2004). *Economic Freedom, Institutional Quality, and Cross-Country Differences in Income and Growth*," *Cato Journal*, 24(3): 205-233.
12. Guiso, L., P. Sapienza and L. Zingales. (2006). "Does Culture Affect Economic Outcomes?" *Journal of Economic Perspectives*, 20(2): 23-48.

13. Licht, A.N., G. Chanan, and S.H. Schwartz. (2007). "Culture Rules: The Foundations of the Rule of Law and Other Norms of Governance," *Journal of Comparative Economics*, 35: 659-688.
14. Tabellini, G. (2008). "Presidential Address: Institutions and Culture," *Journal of the European Economic Association*, 6 (2-3): 255-294.
15. Tabellini, G. (2009). "Culture and Institutions: Economic Development in the Regions of Europe," *Journal of the European Economic Association*, forthcoming.
16. Porter, Michael E. (2000). "Attitudes, Values, and Beliefs, and the Microeconomics of Prosperity," in ed. Lawrence Harrison and Samuel Huntington *Culture Matters*:
 17. *How Values Shape Human Progress*. New York: Basic Books, 202-218.
 18. Williamson, C.R. and C.B. Kerekes. (2008). "Securing Private Property: Formal versus Informal Institutions," Mimeo.
 19. Fukuyama, F. (1996). *Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity*. New York: Simon and Schuster.
 20. Knack, S. and P. Keefer. (1997). "Does Social Capital Have an Economic Payoff?" *The Quarterly Journal of Economics*, 112(4): 1251-1288.
 21. Coyne, C.J. and C. Williamson. (2009). "Trade Openness and Culture," Mimeo.
 22. Banfield, E.C. (1958). *The Moral Basis of a Backward Society*. New York: The Free Press.
 23. Putnam, R.D. (1993). *Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
 24. Gwartney, J.D., R.A. Lawson, and W. Block. (1996). *Economic Freedom of the World: 1975-1995*. The Fraser Institute, Vancouver.
 25. Weber, M. (1930) 'Author's Introduction', in *The Protestant Ethic and the Spirit of Capitalism* (trans. T. Parsons; London: George Allen & Unwin).
 26. Berggren, N. (2003). The benefits of economic freedom: A survey. *The Independent Review*, 8(2), 193-211.
 27. Wu, W. and Davis, O. A. (1999). "The Two Freedoms, Economic Growth, and Development: An Empirical Study." *Public Choice*, 100: 39-64.
 28. Carlsson, F., Lundström, S., 2002. Economic freedom and growth: decomposing the effects. *Public Choice* 112, 335 - 344.
 29. Working paper *Economic Freedom, Culture, and Growth* By Claudia R. Williamson and Rachel L. Mathers
 30. Altman, Morris (2001), Culture, human agency, and economic theory: Culture as a determinant of material welfare, *Journal of Socio-Economics* 30, 379-391.
 31. Banfield, E.C. (1958). *The Moral Basis of a Backward Society*. New York: The Free Press.
 32. Casson, Mark C. (1993), Cultural determinants of economic performance, *Journal of Comparative Economics* 17,418-442.
 33. Cole, Harold, George Malaith, and Andrew Postlewaite. (1992), "Social Norms,

Savings Behavior, and Growth." *Journal of Political Economy* 100:1092-125.

34. Ali A. and W.M.Crain (2001), "Political Regimes, Economic Freedom, Institutions, and Growth", *Journal of Public Finance and Public Choice* 19, no.1, pp.3-22.

35. Berggren N. (2003), "The Benefits of Economic Freedom: A Survey" *The Independent Review*, v .VIII, n.2 fall 2003, pp.193-211.

36. De Haan J. and Siermann C.L. J. (1998), "Further Evidence on the Relationship Between Economic Freedom and Economic Growth" *Public Choice* 95, no.3-4, pp.363-80.

37. Wu Wenbo, and Otto A. Davis (1999), "The Two Freedoms, Economic Growth and Development: An Empirical Study", *Public Choice* 100, nos, 1-2, pp.39-64.

38. Harrison L E 1992 *Who Prospers? How Cultural Values Shape Economic and Political Success*. Basic Books, New York.

39. Smelser NJ, Swedberg R 1994 *The Handbook of Economic Sociology*. Princeton University Press, Princeton, NJ.

40. Esposto, Alfredo G. (1999) "Economic Freedom and the quality of life: an Empirical Analysis", *Constitutional Political Economy* 10,185-197.

41. Johnson, B.T., Holmes, K.R. and Kirkpatrick, M. (1998) "Index of Economic Freedom", Heritage Foundation, Washington and Wall Street Journal.

42. Johnson, B. and Sheehy, T. (1998) "Economic Development and Economic Freedom", *Revolution in Development Economics*, Cato Institute 1998,289-299.

43. O'Driscoll, G. and Holmes, K. (2001) "Explaining the Factors of the Index of Economic Freedom", 2002 *Index of Economic Freedom*: Heritage Institute.

44. Ali, Abdiweli. 1997. *Economic Freedom, Democracy, and Growth*. *Journal of Private Enterprise* 13 (fall): 1-20.

45. Ayal, Eliezer B., and Georgios Karras. 1998. *Components of Economic Freedom and Growth*:

46. *An Empirical Study*. *Journal of Developing Areas* 32, no. 3: 327-38.

47. Easton, Steven T., and Michael A. Walker. 1997. *Income, Growth, and Economic Freedom*. *American Economic Review* 87, no. 2: 328-32.

Burime ne internet

1. <http://www.heritage.org/index/download>
2. <http://www.heritage.org/index/download>
3. http://www.worldvaluessurvey.org/wvs/articles/folder_published/article_base_54

IMPAKTI I KRIZES EKONOMIKE FINANCIARE NE NIVEL LOKAL – RAJONI I GJIROKASTRES

Lindita Rova

Universiteti Eqerem Cabej
lindita_rova@yahoo.com

Klodian Muço

Universiteti Eqerem Cabej,
klodianmuco@hotmail.com

Daniela Qiqi

Universiteti Eqerem Cabej,
daniela_qiqi@yahoo.com

ABSTRACT

The economic recession is tangible in Gjirokastra region even if the clear observable effects on the macroeconomic regional scenario are less visible in compare with the national or international level. Paradoxically “the fate” of Gjirokastra despite the fact that it is a region bordering Greece, depends more from the national economic maneuvers than from the global economic tornado. In any case our region even with weak integration in the international markets was unable to avoid the painful consequences of the last financial crisis which every day more is infecting the economic life of the whole planet. The paper focuses on the crucial role of the public regional administration in response to the less favorable economic conditions. The objective of this paper is to evaluate the economic reflection starting from the local jurisdiction, promoting the initiatives which affect the economic growth of a region starting from the evaluation and integration of local resources joining together actions, thoughts and social cohesion.


Keywords: economic crisis, regional development, crisis impact, public administration, Gjirokastra region

Hyrje

Jemi akoma duke përjetuar krizën më të madhe ekonomiko - financiare mbas asaj të shekullit të kaluar në vitet '30 (Depresioni i Madh). Kriza, që si fillim ishte vetem financiare, u trasformua në një krizë të rëndë ekonomike, së cilës ende nuk i dihet fundi; madje edhe po te mendosh me shumë optimizem është sërish e vështirë të japësh një përgjigje per fundin dhe pasojat e kesaj krize. Kjo krizë ishte pergjithesisht⁷⁶ e paparashikuar nga ekonomistet që të arrinte dimensione kaq globale. Kjo krizë është ndryshe, nga kriza të tjera si ajo e fillimit të shekullit (Fluska Internet), ndryshe edhe nga ajo e viteve '70 (Kriza e Naftës).

Për të kuptuar më mirë dimensionet e kësaj krize le të shohim grafikun e mëposhtem i cili paraqet humbjet financiare dhe ekonomike të shkaktuara nga kriza e fundit.

Grafiku nr 1



76 Minsky. H, Potrebbe ripetersi?, Torino, Einaudi, 1985a

Edhe pse është folur dhe shkruar shumë për shkaqet që e sollën këtë krizë, për te patur një ide të qartë të fenomenit, mjafton të mendosh që në Kaliforni një mbledhës luleshtrydhesh meksikan me një page vjetore prej \$14.000 i cili fliste shumë pak anglisht kishte marrë nga Washington Mutual një kredi prej \$720.000 për të blerë një shtëpi. Kur nuk arriti dot të paguante keshtet e kredise atëherë banka u detyrua ti sekuestronte shtëpine e cila tashme vllente vetëm 500.000\$⁷⁷. Po të mendosh gjithashtu që në periudhën e arte të *subprime* jepeshin edhe kredi që quheshin ndryshe “NINJA”, nga inicialet e anglishtes të karakterisitikave të kredimarresve: “No Income, No Job, No Asset” (si mund të paguanin kredite këta persona, në mungesë të një rritjeje të vazhdueshme të cmimit të shtëpive?) Drejtuesit e bankave kryesore në Amerikë që presupozohet të jenë shkaktaret e kësaj krize shfaqesohen me faktin që në momentin e fillimit të këtij rrethi vicioz se dhenies së kredive, ata nuk mundeshin të benin ndryshe se bankat të cilat filluan të jepnin këto lloj kredish po risnin kapitalin bankar cdo ditë e me teper, ndërsa drejtuesit e bankave të tjera që ishin skeptik ndaj këtij mekanizmi riskionin që të ngeleshin pa punë për arsye të mosarritjes së performancave të bera nga konkurentet e tyre.

Kjo krizë, fillimisht financiare, u trasmetua me vone në ekonomine reale nepermjet një sere mekanizmash “klasike” të trasmetimit si :

1) *Credit crunch* – për me teper paradoksale në një situatë në të cilën normat e interesit ishin shumë të ulta dhe kishte një ofertë të lartë për treg.

2) Efekte pasurie (imobiliare dhe mobiliare): Një rënie në cmimet e shtëpive dhe të bursës shkaktoi një rënie të konsumit të familjeve, por edhe volumit të aktivitetit ndertimor.

3) Efektet e pritshmerisë së bizneseve dhe familjeve (rënie të besimit dhe kursimit, investimeve dhe konsumit).

Të gjitha këto në kompleks shkaktojnë një rënie për të parën herë të tregëtisë botërore që nga viti 1982ë shoqëruar kjo me rënien për të parën herë që nga Lufta e Dytë Botërore të GDP botërore. Kjo krizë, fillimisht e limituar vetëm në vendet e zhvilluara, ka prekur tashme gjithë vendet e botes duke mos kursyer asnjë edhe vendet në zhvillim (ku bëjme pjesë edhe ne), të cilat fillimisht dukeshin me imunitet nga kjo krizë.

77 Histori e trajtuan nga Herald Tribune, 27-11-2008

1.1 EFEKTET E KRIZES EKONOMIKO - FINANCIARE GLOBALE NE SHQIPERI

Ne vitet e fundit ekonomia e Shqipërisë ka pasur një zhvillim të pa kontestueshem me ritme shumë të larta zhvillimi. Kosto shumë e ulet e forces punetore, taksat e uleta dhe pozicioni shumë i mirë gjeografik e bëri Shqipërinë një vend shumë tërheqës për të huajt, ku IHD kaluan vlerën e 1 miliardë dollarë në vitin 2010. Por kjo rritje mbas 2010 filloi të zvenitet çdo ditë e më tepër. Përpara se të ndalemi në këto zvenitje le të vërejmë pak bilancin tregtar të Shqipërisë. Në një veshtrim të shpejtë dallojmë që raportet tregtare të Shqipërisë me Italinë kapin vlerën e 1 miliardë euro⁷⁸ me një bilanc shumë pozitiv për Italinë (pasi importon më tepër Shqipëria), i cili është edhe partneri i parë tregtar i Shqipërisë, me një kuotë rreth 34% të gjithë biznesit të jashtëm të Shqipërisë.

Duke marrë në konsideratë shkëmbimin tregtar të Shqipërisë me vendet e Bashkimit Europian vëmë re që përqindja e eksportimit drejtë Italisë ishte e barabartë me 77,94% ndërsa importi ishte i barabartë me 43,76%⁷⁹.

Partneret kryesore si përsa i përket importit po ashtu edhe eksportit janë dy shtetet fqinje, Italia dhe Greqia. Të dyja këto vende gjenden në një situatë shumë të vështirë ekonomike. E para edhe me ardhjen në pushtet të qeverisë teknike të drejtuar nga M.Monti nuk ka arritur akoma të rimekëmbet, për më tepër kjo rimekëmbje duket akoma shumë larg për të. Italia në këto momente presupozohet të mos jetë më në prag *defaulti*, po gjithshësi borxhi i saj publik tashmë ka kapur vlerën e 126% në raport me GDP papunesia po rritet çdo ditë e më tepër, sidomos papunesia në moshat e reja ku po kap vlerën e 34% përqind për moshat deri në 25 vjeç. Kjo situatë po bëhet edhe më dramatike për të huajt që jetojnë në të, ku gjenden rreth 500 000 Shqiptarë të dokumentuar. Ndërsa në Greqi situata është edhe më dramatike, papunesia në këtë vend ka kapur vlerën e 24.7% ndërsa prodhimi i përgjithshëm bruto i saj ka kaluar nga 180 miliardë që ishte në 2008 në 147 miliardë në 2012.

Sipas vlerësimeve zyrtare⁸⁰ tregojnë se pas vitit 1990 rreth 1/5 e popullsisë aktuale shqiptare ose rreth 0,75 milionë individë, jetojnë jashtë saj si emigrantë. Nderkohe vlerësime të tjera⁸¹ e llogarisin numrin emigrantëve nga 0.8 në deri 1 milionë. Pavarësisht se cila shifer i afrohet më shumë realitetit, një fluks kaq

78 ICE (Istituti comercial i Italisë), raporti i 2010

79 Banka e Shqipërisë raporti vjetor i balancave tregtare, 2011

80 INSTAT Albania

81 Barjaba 2004; INSTAT Albania raporti vjetor i 2002

i larte emigracioni e rendit Shqiperine si nje nder vendet me nivel më të larte migrator ku pjesa me e madhe e ketyre emigrantëve jetojnë pikerisht ne Greqi dhe Itali.

Ne keto 20 vjet, ne Shqiperi nje pjese e mire e te ardhurave kombetare vijne pikerisht nga dergesat e emigrantëve, të njohura gjerësisht me termin "remitanca". Shifra zyrtare tregojne se remitancat perbejne nje burim të madh të dergesave nga jashtë ku ne 2007 remitancat kishin vleren 951.7 milione euro⁸² dhe përfaqsonin rreth 12 % të GDP⁸³. Nje studimi i vitit 2005 i IOM⁸⁴ tregoi së 68% e emigrantëve dergonin remitanca ne familjet e tyre.

Kriza financiare ka bere qe emigrantet ne vitet e fundit te sjellin me pak te ardhura per familjet e tyre, ku keto te ardhura jane nje faktor shume i rendesishem per buxhetet familjare dhe per zhvillimin e ekonomise. Dergesat e emigrantëve ne vitin 2008 kane qene rreth 800 milione euro⁸⁵ nje shifer kjo e barabarte me 9,2 % te GDP. Kontributi i ketyre dergesave, ne zbutjen e deficitit tregtar, llogaritet rreth 33 %, me një renie prej 12 pikësh perqindjeje, kundrejt vitit të kaluar", - theksoi raporti i Bankes se Shqiperise⁸⁶.

Edhe per vitin 2009 emigrantet Shqiptare kane derguar rreth 53 milion euro me pak në shtepite e tyre krahasuar me vitin 2008. Po keshtu ka ecur edhe 2010⁸⁷, emigrantet shqiptare kane derguar rreth 690 milione euro (514 milione euro nga Greqia)⁸⁸. Pra rreth 11% me pak ne krahasim me vitin 2009. Sipas nje raporti te EUROSTAT, kriza financiare dhe ekonomike greke beri qe emigrantet shqiptare që punonin dhe jetonin ne Greqi te humbisnin besimin ne sistemin bankar grek dhe kane pare si me te sigurt Shqiperine per te mbajtur kursimet e tyre. Po ashtu vihet re qe edhe viti 2011 ka pasur renie te remitancave edhe pse kjo renie duket shume e vogel ne krahasim me ato te vitit 2010 sikunder vihet re edhe nga grafiku i meposhtem:

82 Banka e Shqiperise raporti vjetor i 2007

83 World Bank, Albania, Urban growth , Migration and Poverty Reduction, June 2007

84 International Organization for Migration


85 Banka e Shqiperise, 2010

86 Raporti perfundimtar i Bankes se Shqiperise per vitin 2008

87 Banka e Shqiperise raporti i 2010

88 Banka e Shqiperise raporti i 2011

Grafiku nr 2, Remitancat ne Shqiperi ne milione euro



Burimi: Banka e Shqiperise

Kriza financiare qe ka prekur tashme pjesen me te madhe te ekonomive boterore por sidomos vendet ku kane emigruar shumica e shqiptareve ne Greqi dhe Itali eshte pasqyruar me humbjen e vendeve te punes nga ana e emigranteve e cila reflektohet me se miri me kete tregues, edhe pse duhet te pranojme se krahas krizes, ulja e nivelit te dergesave ka te beje dhe me stabilizimin social te tyre ne vendet ku kane emigruar. Shume emigrante pasi kane kaluar me rreth 20 vjet ne emigracion, stabilizohen ne ate vend, dhe fillojne te investojne te ardhurat e tyre ne po ate vend (permendim ketu rreth 4500 biznese te vogla te Shqiptareve qe jetojne ne Itali).

Remitancat kane nje efekt te larte ne luften kunder varferise me ane te dergesave qe u behet familjeve. Nje pjese e mire e familjeve shqiptare kane si burim te vetem te ardhurash pikerisht keto remitanca, kjo gje vihet re edhe nga nje studim i fundit i bere nga banka boterore ne Shqiperi. Sipas ketij raporti perqindja e personave qe konsuminin me pak nga sa duhet per te permbushur nevojat baze u zvogelua nga 25.4% qe ka qene ne 2002 ne 12.4% ne 2008 nga ana tjetere duke ju referuar te dhenave te ISTAT, veme re qe remitancat nga 2002 deri ne 2007 ka qene gjithmone ne rritje. Veme re gjithashtu qe perqindja e atyre qe s'mbushnin nevojat baze ushqimore ne 2002 ishte 5% ne 2008 ra ne 1.2%. Tashme veme re qe ne 2012 niveli i varferise po shkon gjithmone duke u rritur. Ne keto momente vendi jone renditet i parafundit ne Europe per sa i perket nivelit te varferise duke lene mbas vetem Bosnje Hercegovinen. Sipas te dhenave te publikuara nga EUROSTAT veme re qe vendi yne ka kosto te

jeteses sa gjysma sa gjysma e nivelit mesatar te vendeve te Europiane, arrin rreth 51%. Te ardhurat per fryme jane sa 1/3 e te ardhurave mesatare e vendeve te BE-se.

Remitancat ne Shqiperi kane stimuluar edhe zhvillimit, duke rritur konsumin e vendit dhe duke mbeshtetur kerkesen agregate te vendit. Kane sherbyer gjithashtu ne rritjen e investimeve, kane ndikuar shume pozitivisht edhe ne zhvillimin e sektorit te ndertimeve pasi nje pjese e mire e emigranteve kane investuar nje pjese te mire te te ardhurave ne kete sektor. Nje efekt pozitiv rrjedhoje e emigracionit shqiptar ka qene ulja e papunesise ne Shqiperi pasi vendet qe lihen vakante nga ata qe emigrojne, zihen nga ata qe ishin me status te papuni⁸⁹. Kthimi i emigranteve sic e permendem me lart duke cituar raportin e EUROSTAT do ndikojne ne menyre indirekte ne rritjen e papunesise si ne rang lokal edhe ne ate nacional. Dhe ne fund por jo nga rendesia remitancat kane sherbyer per te mbeshtetur financiarisht zhvillimin e rajoneve ne gjithe territorin e Shqiperise, pasi nje pjese e mire e tyre familjaret e emigranteve i investojne keto ne hapjen e vendeve te reja te punes e permiresimin e aktiviteve te ndryshme qe ata kryejne ne territorin shqiptar. Te gjitha keto qe lartpermendem ne momentin qe remitancat po shkojne gjithmone e me teper ne renie do ndikojne negativisht ne ekonomine e vendit tone si ne rang lokal edhe ne ate nacional.

2. IMPAKTI I KRIZES EKONOMIKE NE NIVEL LOKAL (RRETHI GJIROKASTER)

Duke qene se kriza aktuale ishte nje krize financiare me epiqender ne sistemin bankar, shqiptaret per te paren here u ndjene te sigurt, pasi nje pjese e mire e bankave qe operojne ne tregun shqiptar nuk kishin lidhje me bankat nderkombetare te prekura direkt nga *subprime*. Ne shume emisione televizive e ne komente te bera nga ekonomistet optimiste te vendit tone thuhej se Shqiperia nuk do te prekej nga kriza ekonomike aktuale, qetesohet opinioni publik duke thene se ne kemi imunitet ndaj krizes fale ekonomise sone e cila eshte pak e "hapur" me ekonomine nderkombetare. Pra ky lloj izolimi financiar per te paren here u trasformua si nje avantazh per vendin tone. Guvernatori i Bankes se Shqiperise qetesonte qytetaret duke thene se sistemi bankar shqiptar nuk ka sektor spekulativ sikunder edhe permendem ne fillim te ketij punimi.


Ne te vertete veme re qe ne Shqiperi rreth 29% e sistemit bankar Shqiptar

89 Rasti i Portugalise, Fuà. G, I problemi dello sviluppo tardivo in Europa, Mulino, 1985,

eshte i perbere nga banka me kapital grek⁹⁰, sidomos ne qarkun e Gjirokastrës nje pjese e mire e bankave jane pikerisht filiale te bankave greke, ose banka me kapital grek. Sic e permendem me lart nje pjese e mire e emigranteve shqiptare kishin depozituar te ardhurat pikerisht ne keto banka, por kriza qe kapi vendin fqinj shkaktoi pasiguri tek emigrantet tane, te cilet terhoqen ne menyre masive kursimet e tyre nga keto banka duke u shkaktuar jo pak probleme ketyre te fundit. Perfitimet e ketyre bankave qe nga 2009 e ne vazhdim kane pasur rnie te theksuar⁹¹, duke shkaktuar keshtu nje ulje te kredidhenies nga ana e tyre. Ulja e nivelit te kredidhenies do te thote pakesim i oksigjenit per zhvillimin e biznesit lokal.

Gjirokastra eshte qyteti me i madh ne jug te Shqiperise. Qender qarku, qytet universitar, qender historike me site te rendesishme kulturore e historike listuar qe ne vitin 2005 ne listen e treshegimise kulturore boterore mbrojtur nga UNESCO. Qyteti me rreth 43000 banore zhvillimin e tij ekonomik e ka kryesisht te bazuar tek tregetia, ka pak biznese prodhuese shumica prej tyre me 1-4 punetore. Sipas te dhenave te marra ne zyren e INSTAT Gjirokaster verejme qe ne vitin 2011 nga 1769 biznese aktive 1448 jane persona fizike dhe 304 jane SHPK.

Grafiku nr 3. Perberja e bizneseve aktive ne Gjirokaster, viti 2011



Burimi: INSTAT, Gjirokaster

90 <http://www.aab.al>, Bankat ne Shqiperi

91 <http://www.aab.al/al/statistics.php>, Te dhenat statistikore te sistemit bankar shqiptar

Nese bejme analizen e ndermarjeve aktive prej vitit 2006 e deri ne vitin 2011 situata paraqitet si ne tabelen me poshte:

Tabela nr. 1: Numri dhe perberja e bizneseve te reja gjate viteve 2006-2011 ne Gjirokaster.

	Gjithsej	Person Fizik	Person Juridik
2006	917	714	203
2007	124	84	40
2008	180	157	23
2009	163	126	37
2010	232	209	23
2011	187	158	29

Burimi: INSTAT, Gjirokaster.

Sikunder verehet numri i bizneseve te hapura ne dy vitet e fundit eshte rritur si pasoje e kthimit te emigranteve ne atdhe, nderkohe qe nga te dhenat e marra nga Bashkia Gjirokaster 200 biznese jane mbyllur perfundimisht gjate vitit 2011 dhe nje pjese relativisht e madhe e tyre nuk kane permbushur detyrimet e tyre fiskale. Edhe struktura e bizneseve te reja te licensuara ne dy vitet e fundit paraqitet shume ne favor te biznesit te vogel kryesisht atij me karakter familjar, ku presupozohet se nje pjese e ketyre familjeve jane ato te kthyer nga vendet fqinje. Duke vendosur qe te shfrytetojne *know-how* e perfituar ne emigracion.

Tabela nr. 2: Perberja e bizneseve te reja prodhuese 2007-2011, Gjirokaster.

	Totale	Agrikulture	Industri	Ndertim
2007	12	2	9	1
2008	38	8	27	3
2009	41	8	24	9
2010	44	16	26	2
2011	24	5	16	3

Burimi: INSTAT, Gjirokaster.

Prodhuesit e te mirave paraqiten ne strukturen e mesiperme me peshe kryesore ne industri. Gjate vitit 2010 kemi hapjen e 44 njesive te reja prodhuese nga te cilat 16 ne agrikulture.

Tabela nr. 3: Perberja e bizneseve te reja te ofrimit te sherbimeve 2007-2011, Gjirokaster.

	Tregeti	Kafe, Hotele	Transport	Te tjera
2007	59	16	8	29
2008	66	38	16	22
2009	64	25	12	21
2010	77	52	29	30
2011	86	41	11	25

Burimi: INSTAT, Gjirokaster

Ofruesit e sherbimeve paraqiten sipas struktures me siper ne te cilen peshen me te madhe e zene bizneset qe merren me tregeti e me pas kafe, restorante dhe hotele, pra vihet re qe pjesa me e madhe e bizneseve lokale eshte e fokusuar ne sektorin e sherbimeve.

Tabela nr. 4: Struktura e bizneve bazuar ne numrin e punonjesve te deklaruar, Gjirokaster.

	Gjithsej	1-4 punetore	5-9 punetore	10-49 punetore	50+ punetore
2007	124	100	15	7	2
2008	180	172	7	1	0
2009	163	153	2	6	2
2010	232	224	4	4	0
2011	187	180	5	2	0

Burimi: INSTAT, Gjirokaster.

Struktura e bizneseve sipas numrit te punetoreve tregon se peshen dermuese e zene bizneset me 1-4 punetore nderkohe qe biznese me me shume se 50 punetore jo vetem qe nuk eshte hapur asnje ne dy vitet e fundit por jane mbyllur edhe ato biznese me me shume se 50 punonjes te cilat ishin hapur vite me pare.

Bizneset te cilat kane ndier me teper krizen, jane fabrikat e fasonit qe operojne ne jug te vendit sidomos ato ne Gjirokaster. Kjo per arsye se pjesa me e madhe e shoqerive fason punojne ekskluzivisht vetem me porosi te ardhura nga vendi fqinj, Greqia. Kompanite greke nga ana e tyre marrin pjese neper

tendera te organizuara nga qeveria e tyre dhe me vone trasferojne prodhimin ne shoqerite qe gjenden ne qarkun e Gjirokastrës duke shfrytezuar koston e ulet te forces punetore dhe distancen jo shume te larget qe ka Gjirokastra me Greqine.

Ne nje bashkebisedim te bere ne qershorin e ketij viti me kryetarin e dhomes se tregëtise dhe industrise se Gjirokastrës z. Mustafa Devolli i cili disponon nje rrobaqepsi me rreth 40 makina qepese ne kete qytet tregonte se dhe ai vete punonte vetem me porosi veshjesh ushtarake te ardhura nga Greqia, qe nga 2010 e ne vazhdim keto porosi beheshin gjithmone e me te rralla per me teper nje pjese e kontraktoreve greke ikin duke mos likuiduar edhe mallin qe kishin porositur.

Nga pese rrobaqepsi qe operonin ne qarkun e Gjirokastrës tashme vetem njera prej tyre funksionon, vetem gjate vitit 2011 rreth 300 punojes kane humbur vendet e punes nga rrobaqepsite dhe magazinat e konfeksionimit ku ata punonin duke qendruar ne pritje.

Te njejten gje me ka konfirmuar edhe z. Bardhi Sejdarasi⁹², qe sektori fason ne Shqiperi eshte ne nje krize te thelle. Kemi nje renie te vazhdueshme te eksportit te fasonit ne Shqiperi, qe nga viti 2008, pothuajse eshte pergjysmuar eksporti ne raport me vitet e meparshem, me konkretisht ai konfirmon se ne Gjirokaster nje pjese e mire e fasonit edhe pse nuk ka deklaruar falimentin, nuk punojne realisht, gjithe punetoret e tyre jane pa pune ose ne pritje te ndonje kontrate te mundshme nga jashte.

Veshtiresite nga kriza nuk i ka ndier vetem fasoni por edhe bizneset e tjera qe merren me import- export apo nxjerrje te gureve dekorative qe me vone eksportohen kryesisht ne Greqi, kane pesuar renie te xhiros vjetore. Sipas te dhenave te marra nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, dega e Gjirokastrës⁹³ ne periudhen 2011 dhe 9 mujorin e 2012 vihet re se shoqerite qe merren me nxjerrjen e gureve dekorative kane renie te theksuar te xhiros se tyre vjetore. Gjithashtu duke ju referuar te njejtut burim veme re qe 5 shoqeri te sektorit te fasoneve kane ndalur prodhimin dhe nuk kane punetore te punesuar neper fabrikat e tyre.

Duke ju referuar serisht te njejtut burim veme re se numri i ndermarrjeve aktive ne vitin 2011 qe operonin vetem ne qytetin e Gjirokastrës ka rene ne 326 kur ne vitin 2010 ky numer arrinte ne 390. Edhe pse ky tregues nuk mund te merret si tregues krize, ai nuk shfaq "optimizem". Nje tregues tjetër i rendesishem i marre nga po i njejtut burim eshte xhirua vjetore, ku per 9mujorin

92 Drejtor i pergjithshem i Biznes Albania

93 Xhiro vjetore e vitit 2011, xhiro vjetore per 9 mujorin e 2012.

e viti 2012 vihet re nje tkurrje e ketij te fundit, nje ndryshim prej vetem 2 milione leke. Sipas te dhenave te INSTAT vetem ne 6 mujorin e pare te 2012 kemi nje renie pre 8% te vellimit tregtar me Greqine (sic e lartpermendem Greqia eshte partneri i jone i dyte tregtar per nga rendesia mbas Italise, por per sa i perktet Gjirokastres me teper se gjysma e shkembimeve tregtare behet pikerisht me kompanite greke).

Sipas disa intervistave *face to face* me bizneset lokale ne Gjirokaster, konfirmojne qe sektori fason eshte paralizuar pothuajse plotesisht, pra ka vetem shkembime sporadike me Greqine. Sipas te dhenave te INSTAT sektori fason ne Gjirokaster ka rene me rreth 60% ndersa sipas nje pjese dermuese te bizneseve qe operojne ne kete sektor, deshmojne se kane nje renie prej gati 90%. Ne sektorin fason ne rajonin e Gjirokastres ne 2008 kishte rreth 2000 te punesuar aktualisht numerohen rreth 200 te punesuar nga keta nje pjese e mire e tyre jane me kontrata mujore⁹⁴.

Nje sektor tjeter ne veshtiresi ekonomike ne qarkun e Gjirokastres eshte edhe ai i ndertimeve, edhe pse duhet thene se ky sektor ka nje frenim edhe ne rang nacional. Sipas te dhenave te INSTAT⁹⁵ veme re ne tabelat permbledhese, se vetem ne 2010 ne qarkun e Gjirokastres ky sektor ka pasur nje renie prej 27%. Sipas te dhenave te marra nga nje grup investitoresh qe perfaqesojne gati 80% te sektorit te ndertimit ne qark konfirmojne se ka nje frenim te shitjeve te apartamenteve te reja dhe ateherë kur ka shitje ata deshmojne se ka shume probleme likuiditeti, bleresit nuk arrijne te paguajne vleren e plote te apartamenteve. Nje pjese e klienteve ne sektorin e ndertimeve ishin pikerisht emigrantet shqiptare qe punonin ne Greqi. Tashme numri i emigrianteve qe blejne shtepi ne qytetin e Gjirokastres po behet gjithmone e me i ulet duke shkaktuar nje frenim te sektorit te ndertimeve dhe ne menyre indirekte edhe nje rritje te papunesise pasi nje pjese te punetoreve nuk i therrasin me ne pune ne momentin qe nuk fillojne kantiere pune te reja. Nje problem tjeter qe po verehet ne qytetin tone eshte edhe problemi i shtepive te lena me qira. Vihet re nje paralizim gati total i ketij procesi. Nga nje ane kemi nje stok te ndertimeve te hapësirave me qellime banimi qe nuk shiten po edhe ne momentin qe ndertusit lokal vendosin qe keto hapësira ti lena me qira per ti dhene sado pak oksigjen sektorit te ndertimit, duke qene se nga nje ane kemi nje shtim te ndertimeve nga ana tjeter edhe universiteti i qytetit po humbet nga viti ne vit nje numer te konsiderueshem studentesh ku vetem ne vitin e fundit akademik ka kaluar nga rreth 800 qe ishte numri i studenteve te rinj qe u rregjistruan vitin e kaluar

94 Informacione te marra nga bisedat me biznesmene lokale jo te konfirmuara zyrtarisht.

95 Raporti i INSTAT per rajone, f. 42, 2010

ne 430 te rregjistruar ne vitin akademik 2012-2013. Nje pjese e mire e ketyre studenteve jetonin ne shtepi me qira, ne momentin qe ky numer po ulet cdo vit e me teper shkakton nje renie te konsiderueshme si ne numrin e shtepive te lena me qira po ashtu edhe ne lokalet bizneset rreth e rrotull strukturave universitare qe operojne ne treg pothuajse vetem me studentet universitare.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Si perfundim mund te themi se sistemi i biznesit ne Gjirokaster e ka ndier shume krizen ekonomiko- financiare aktuale, me renie te xhiros vjetore, prodhimit dhe te porosive per prodhim qe reflektohet negativisht edhe ne tregun e punes me nje rritje te papunesise, me heqje nga puna ne menyre te vazhdueshme duke cuar ne zero diferencat ndermjet biznesit te vogel dhe atij te madh. Jane kryesisht bizneset ne sektorin fason ato qe kane ndjere me teper krizen, por nuk ngelet pas edhe sektori i ndertimeve apo bizneset e vogla familjare, te cilat ankohen per nje ulje te konsumit nga ana e konsumatoreve lokale. Bizneset qe kane operuar ne rajonin e Gjirokastrës dhe qe operojne aktualisht, mundohen ti rezistojë kesaj krize edhe pse kjo krize po zgjatet, por nga ana tjetër prishmeria e nje rimekembjeje po zvenitet cdo ditë e me teper. Megjithate shpirti sipermarrës i qytetareve ne rajonin tone nuk është “dobesuar”, edhe pse me shume veshtiresi, deshira per te punuar dhe per te ecur para ekziston akoma. Duhet thene gjithashtu qe bizneset lokale jane edhe nen presionin e vazhdueshem, jo vetem te krizes qe po i paralizon ato por edhe nen presionin e vazhdueshem te qeverise qe cdo dite e me teper i mbush me gjoba te pakuptimta, per te mbushur arkat e veta, pa harruar ketu bizneset lokale te cilat jane angazhuar ne tendera shteterore qe presin ne agoni likuidimin nga ana e qeverise. Bizneset lokale duhet ti pershtaten ambjentit duke marre ne konsiderate strategjite e reja te zhvillimit, duke rritur reputacionin e tyre ne raport me klientet aktuale. Kjo do ti ndihmoje ato te pozicionohen per performanca pozitive ne te ardhmen. Eshte esenciale per biznesmenet te identifikojne qe tani sfidat dhe oportunitetet qe do te sjelle 2013. Nga ana tjetër eshte e nevojshme qe qeveria te ndihmoje bizneset ne veshtiresi duke pezulluar taksat per nje fare kohe e duke i nxitur ato te punesojne individe te rinj. Eshte gjithashtu detyre e qeverise te marre masa dhe te hartojë plane te zhvillimit afatmesem dhe afatgjate per te ndaluar varesine e vet nga ekonomite e vendeve fqinje⁹⁶.

96 Hirschman. A, *Ascesa e declino dell'economia dello sviluppo : e altri saggi*, Torino, 1983

Biblografia

1. Banka e Shqiperise, Raporti vjetor i 2007
2. Banka e Shqiperise, Raporti vjetor i 2008
3. Bankes se Shqiperise, Raporti perfundimtar i 2008
4. Banka e Shqiperise, Raporti vjetor i 2010
5. DPT e Qarkut Gjirokaster, Raportet e xhiros vjetore per 2009, 2010, 2011, 9-mujorin e 2012
6. Fuà. G, I problemi dello sviluppo tardivo in Europa, Mulino, 1985,
7. Hirschman. A, Ascesa e declino dell'economia dello sviluppo : e altri saggi, Torino, 1983
8. ICE, Raporti vjetor i 2010
9. INSTAT, Raporti vjetor i 2002
10. INSTAT, Raporti per rajone, 2010
11. International Organization for Migration
12. Minsky. H, Potrebbe ripetersi?, Torino, Einaudi, 1985
13. World Bank, Albania, Urban growth , Migration and Poverty Reduction, June 2007

GJIROKASTRA DHE ZHVILLIMI I TURIZMIT TE QENDRUESHEM

Daniela Qiqi

Universiteti Eqerem Cabej
daniela_qiqi@yahoo.com

Alketa Bejko

Universiteti Eqerem Cabej
alketabejko@yahoo.com

ABSTRACT

Tourism statistical data of different countries show that the trend of tourism is, to turn it into a promising branch for the economy. Gjirokastra has numerous potentials for cultural tourism development, which is a type of tourism that has experienced growth and stability and is rapidly becoming an activity of great economic interest, not only because it operates at any season of the year, but also as a result of the increased interest that people have to recognize the specific cultural-historical values of other peoples. The implementation of strategic objectives requires the implementation of concrete actions, for setting the target market, the priority areas that need an intervention, continuous monitoring and evaluation, but mostly it requires the coordination of work between the central and local institutions and all other stakeholders involved in this phenomenon. The drafting of strategies and all the activities that support the development of cultural tourism in Gjirokastra, should be welcomed and appreciated, but at the same time never be forgotten that, only the development of tourism in a sustainable way, enables real growth of local economy and improves the standard of living for local residents.

Keywords: Cultural Tourism, touristic potentials, development strategy, collaboration, sustainable tourism.

Hyrje

Turizmi sot është ndër prirjet themelore të zhvillimit botëror. Ai është një fenomen social, kulturor dhe ekonomik, si dhe një përbërës i kulturës së kombeve i destinuar të ketë një rëndësi të madhe në ekonominë e vendeve. Tashmë turizmi është konsideruar një përbërës i kulturës dhe i mënyrës së të qenit të njeriut modern, duke përbërë kështu një fenomen të pandashëm, që ka një rol dhe një logjike të tijën, pikërisht për funksionet sociale, kulturore dhe ekonomike, që e dallojnë dhe e lidhin me dinjitetin njerëzor dhe me një cilësi të re të evoluar të jetës. Intensifikimi i kërkesës për të mira dhe shërbime turistike ka nevojë për një politikë të kujdesshme programimi e aftë kjo për të zhvilluar turizmin në mënyrën e duhur. Në këtë epokë të një konkurrence të lartë në tregun turistik dhe të një rritje të shpejtë të tij në rang ndërkombëtar, cdo lloj punimi në këtë fushë do të përbente një kontribut për këdo që beson se profesionalizmi së bashku me impenjimimin e duhur do të sillnin rezultatet e dëshiruara.

1. Turizmi dhe funksioni i tij ekonomik

Turizmi konsiderohet kudo si veprimtari me zhvillim intensiv dhe me rentabilitet të lartë ekonomik. Nga analizat e bëra në shumë vende rezulton që, ekzistojnë shumë forma dhe modele zhvillimi me avantazhet dhe disavantazhet e veta, të cilat lidhen me drejtimin e kësaj dege të rëndësishme ekonomike. Komponentet bazë të tregut turistik janë kërkesa dhe oferta turistike të cilat dallohen kryesisht nga elasticiteti i kërkesës dhe joelasticiteti i ofertës. Funksioni ekonomik i turizmit luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të rajonit apo vendit. Ndër funksionet më kryesore ekonomike të turizmit identifikohen:

- Transformon shumë elementë joekonomikë si (mali, klima, monumentet, traditat etj.) në veprimtari ekonomike
- Rrit investimet & ndikon në strukturën e tyre. Në procesin e zhvillimit turistik të zonës, shpenzimet turistike janë të mëdha, por disa shpenzime mund të rikuperohen nëpërmjet rritjes së të ardhurave nga taksat. Kur turizmi zhvillohet gradualisht, për disa vjet, ka një periudhë të gjatë për ndryshime ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe pjesëmarrja lokale rritet edhe nga pikëpamja e kapitaleve. Kur ndodh një zhvillim i shpejtë, komuniteti pritës

nuk u pergjigjet dot këtyre kërkesave duke zvogëluar kështu përfitimet e komunitetit.

- Hap vende pune dhe rrit standartin e jetesës sepse rrit pjesmarrjen, sidomos të gruas në punë dhe lind domosdoshmëria e aplikimit të teknikave të trajnimit të rezidentëve.

- Krijon një treg të ri për produktet e sektorëve të tjerë të ekonomisë si bujqësia (frenon eksodin rural), industria etj. Ai konsiderohet si “eksport i padukshëm”

- Sjell kalimin e të ardhurave nga një krahinë e zhvilluar në një të pazhvilluar dhe nxit zhvillimin e tyre

- Ushtron efekt edhe mbi organizata që plotësojnë nevojat turistike si shoqëri sigurimi, banka, mjekë, avokatë etj

- Rrit fitimet nga shkëmbimi i monedhës

Zhvillimi i suksesshëm i turizmit nuk kërkon domosdoshmërisht një vend të zhvilluar ekonomikisht. Pavarësisht se proceset e zhvillimit mund të jenë të ngjashme, ndikimet që mund të sjellë turizmi, mund të jenë të ndryshme kur ndryshon përmbajtja e tyre.

Sipas të dhënave të OBT (Organizata Botërore e Turizmit)për 9-mujorin e vitit 2012 ekonomitë në zhvillim kanë rimarrë kryesimin. Kështu ekonomitë në zhvillim (+5%) kanë rifituar qartë epërsinë në krahasim me ato të avancuara (4%).

Sipas rajoneve, rritja ishte më e fortë në Azi, Paqësor dhe në Afrikë, pasuar nga Amerika dhe Evropa. Lindja e Mesme vazhdon të tregojë shenja të rimëkëmbjes, me rezultate premtuese veçanërisht në Egjipt.

- Evropa (+3%) ka konsoliduar rritjen e saj rekord të vitit 2011, pavarësisht paqëndrueshmëri ekonomike në Eurozonë. Rezultatet ishin mbi mesataren në Evropën Qëndrore dhe Lindore (9%), në përputhje me mesataren në Evropën Perëndimore (3%), por relativisht e dobët në pjesen jugore të Mesdheut dhe Evropë (1%) - një nga rajonet më të mira evropiane - në 2011 - si dhe në pjesën veriore të Evropës (0,2%).
- Në Azinë Jug-Lindore dhe Azinë e Jugut (të dyja në 8%), të udhëhequra nga Azia dhe Paqësori (7%), pasuar nga Azia Veri-Lindore (7%), duke pasqyruar qartë rimëkëmbjen e Japonisë. Rritja ishte pozitive në Oqeani (+5%) në krahasim me vitin 2011 (1%).
- Në Amerikë (4%), Qëndrore (+7%) dhe Amerika e Jugut (6%) ,në Karaibe (+5%) gjithashtu rritje e rëndësishme. Lëvizja ndërkombëtare turistike u rrit 3% në Amerikën e Veriut.
- Në Afrikë (6%), rimëkëmbja e Tunizisë është reflektuar qartë në rezultatet

e Afrikës së Veriut (+10%), siç është Egjipti në Lindjen e Mesme (-1% në krahasim me një rënie 7% në 2011). Destinacionet në Afrikën Sub-Sahariane (4%) vazhdojnë të kenë rezultate shumë pozitive, kjo tregon konsolidimin e treguesve të rritjes në krahasim me vitet e mëparshme.


Duke analizuar të dhenat për turizmin sot në botë vihet re që, tendenca është për ta kthyer atë në një degë të re dhe premtuese për ekonominë. Pavarësisht se ekonomia botërore ndodhet në kushtet e një krize të përgjithshme globale, të dhënat për turizmin janë premtuese. Kështu:

Gjate periudhës janar-gusht 2012, numri i turistëve ndërkombëtarë në mbarë botën u rrit me 4%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2011 (28 milionë më shumë). Me një rekord prej 705,000,000 turistësh deri në gusht 2012, OBT parashikon se një miliardë turistë ndërkombëtarë do të kenë udhëtuar në botë deri në fund të vitit, pra pritet një rritje prej 3-4% për vitin në tërësi. Megjithëse për vitin 2013 ka parashikuar një ngadalësim të lehtë të kërkesës, përsëri OBT parashikon një rritje në masën (2-4%).(Burimi OBT)

Parashikimet, po sipas OBT-së janë që në një periudhë afatgjatë deri në vitin 2020, numri i udhëtarëve të arrijë deri në 1.6 miliardë deri në vitin 2020, ku pjesa më e madhe e të cilëve rreth (717 milionë) do të vizitojë Evropën.

2. Gjirokastra dhe zhvillimi i turizmit kulturor

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë në afërsi me tregjet më të mëdha të jashtme dhe të brendshme të Evropës, krijon premisa për të përfituar edhe ajo nga prirjet drejt udhëtimeve më të rregullta, në distanca të shkurtra dhe të mesme. Sipas të dhënave të MTKRS gjatë vitit 2011, kanë hyrë në Shqipëri 2.733.650 vizitorë të huaj. Ndërsa statistikatat për vitet 2007-2011 paraqiten si më poshtë:



(Burimi: MTKRS)

Këto të dhëna ripohojnë se turizmi është një nga industritë më premtuese në vend duke rritur përherë e më tepër vëmendjen nga ana e gjithë aktorëve të përfshirë në të.

Sipas të dhënave statistikore të vendeve të ndryshme për turizmin, rezulton se turizmi kulturor, është një lloj turizmi që ka njohur rritje dhe stabilitet dhe po transformohet me shpejtësi në një aktivitet me interes të madh ekonomik, kjo mbi të gjitha, për arsye të funksionimit në çdo stinë të vitit, por edhe interesit gjithnjë në rritje që njerëzit kanë për të njohur vlerat e veçanta historike-kulturore të popujve të tjerë.

Në kohën e sotme të globalizmit, shumë karakteristika dhe krenari ekonomike të vendeve të veçanta, po falimentojnë. Pra, procesit të ndërkombëtarizimit me shpejtësi të gjithçkaje por edhe të perspektives tonë të zhvillimit mund t'i bëjmë ballë vetëm me valorizimin dhe perfeksionimin e të veçantave ekonomiko-kulturore. Për këtë, puna dhe sfidat për produktet turistike kulturore janë shumë më të mëdha, pasi duhet punuar shumë për arritje standartesh dhe krijimin e një destinacioni të qëndrueshëm.

Rritja e turizmit kulturor në fillim mund të jetë e ngadaltë, por nëse sektori është i suksesshëm, ai do të rritet me shpejtësi menjëherë sapo të ketë fituar një reputacion ndërkombëtar pozitiv. Progresi dhe përfitimet e tij në të gjitha fushat do të vrojtohen në periudhat afatmesme.

Padyshim që Gjirokastra e ka tashmë të qartë, që Turizmi dhe zhvillimi i tij i qëndrueshëm janë e ardhmja e saj. Turizmi do të sillte zhvillime në keto fusha:

- Në mjetet e transportit (autobuzë, automobila, forma të tjera transporti etj.)
- Në objektet për strehim dhe ushqim (hotele, motele, restorante etj.) nëpërmjet restaurimit të ndërtesave të pabanuara dhe të degraduara, duke u dhënë atyre një funksion.
 - Në krijimin e agjensive për udhëtarët
 - Në formimin e guidave turistike profesioniste
 - Në shtimin e dyqaneve për suvenire (prodhimet artizanale si objekte në dru, qeramikë, hekur etj. kanë forcë të madhe tërheqëse për turistët)
 - Në format e ndryshme organizative për veprimtari argëtuese (kinema, parqe, lokale, kazino etj.)
 - Në përgatitjen e specialistëve të rinj në fushën e konservimit. Tashmë mjeshtërit e vjetër të Gjirokastrës nuk janë më.
 - Në menaxhimin e ri të objekteve që janë të vizitueshme, duke rritur të ardhurat nëpërmjet shitjes së biletave dhe përdorimin e këtyre fondeve për mirëmbajtjen e vetë objekteve.

- Në krijimin e strukturave kontrolluese lokale për shmangjen e sjelljeve abuzive me klientët-turistë si p.sh rritja artificiale e çmimeve, mungesa e cilësisë së shërbimit etj.
- Në krijimin e një klime lehtësuese për të gjitha sipërmarrjet e reja private që kërkojnë të operojnë në fushën e turizmit nëpërmjet lehtësirave fiskale apo kreditimin e tyre me kushte lehtësuese.

3. Potencialet turistike të Gjirokastrës dhe strategjitë e zhvillimit

Gjirokastra pas viteve 1990 dhe kryesisht pas pranimit në 15 korrik 2005 si "Pasuri e Trashëgimisë Kulturore Botërore" në UNESCO është shndërruar në atraksionin kryesor turistik për vizitorët vendas e të huaj, sidomos për studiuesit, të pasionuarit pas turizmit kulturor, kureshtarët e historisë së Ballkanit etj. Kombësitë e vizitorëve janë thuajse nga cdo kontinent. Edhe vetë shqiptarët kanë filluar ta vizitojnë Gjirokastrën, përveç vizitorëve nga Kosova, Maqedonia, Mali i zi, Italia e Greqia, Gjirokastrën kanë nisur ta vizitojnë edhe vizitorë nga Kanadaja, Australia e largët, nga Japonia, Kina, SHBA.

Gjirokastra ka potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit sepse ka vlera, të papërsëritshme arkitekturore, ka një pasuri të madhe kulturore e historike. Gjirokastra është një qendër e rëndësishme për rajonin Jugor sepse në Gjirokastrë zhvillohen veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike dhe social- kulturore, në të janë përqëndruar institucionet më të rëndësishme administrative, ajo është një portë komunikimi me shtetin fqinjë Greqinë anëtare tashmë e Komunitetit European.

Gjirokastra është një nga qytetet më të vecantë të Shqipërisë dhe arkitektët thonë se ka thyer gjithë ligjet e arkitekturës. Historia, vlerat e papërsëritshme arkitekturore, urbanistike, vlerat e trashëgimisë kulturore janë ndërthurur e gërshetohen bukur me elementin gjeografik.

Gjirokastra, një qytet i veçantë nga pikëpamja arkitekturore në krahasim me gjithë qytetet e tjerë të Shqipërisë, është e ndarë qartësisht në dy zona të dallueshme banimi:- në qendrën historike dhe në zonën e re të banimit, zonë e cila u zhvillua shumë gjatë periudhës 1990- 2000. Ky zhvillim i shpejtë urban, pati impakte pozitive por u shoqërua edhe me probleme të shumta e komplekse social-ekonomike, të fazës së tranzicionit ndër të cilat mund të përmendim :

- mungesa e respektimit të fortë të ligjeve të shtetit si dhe e ligjeve specifike për një qytet të veçantë si Gjirokastra, në ruajtje të vlerave arkitekturore dhe urbanistike sidomos në zonën historike.
- indiferenca e shoqërisë civile në reagimin e në presionin e zgjidhjes së

problemeve

Specialistët vlerësojnë se Gjirokastra ekspozon dëshmi të jashtëzakonshme të llojeve të ndryshme të monumenteve dhe të banesave urbane të zonës gjatë periudhës klasike otomane, si vazhdimësi të kulturave të ndryshme që e paraprinë atë.

Qendra Muzeale e Historike e Gjirokastrës përbëhet nga 56 ngrehina monument kulture Kateg. I, rreth 500-të Kateg. II, Kalaja, Pazari karakteristik, objekte religjioze të kultit dhe pjesë të lagjeve Pazar i vjetër, Palorto, Varosh, Meçite, Dunavat, Manalat, Cfake, Pllakë.

Kalaja, shtrihet përgjatë një kodre të gjatë zotëron gjithë qytetin dhe luginën e Drinos. Ndërtimi i saj ka nisur që në shekujt e parë para Krishtit. Në 1336 kronikat Bizantine e emërtonin Argyropolihne.


Kalaja e qytetit i është nënshtruar disa ndërhyrjeve arkitekturore në kohë, por formën përfundimtare, e cila ruhet edhe sot deri diku, e mori gjatë viteve 1810 - 1820, kur Ali Pashë Tepelena përfundoi gjithë punimet fortifikuese e ndërtimore. Kalaja e Gjirokastrës është një nga kështjellat më të mëdha të Ballkanit juglindor, por gjithashtu është një dëshmi për një larmi stilesh dhe kontributesh të epokave të ndryshme: romako-bizantine, shqiptare dhe osmane. Kalaja përmban në brendësi të saj një numër të madh objektesh e ndërtimesh si Burgu, Ujësjiellësi, Kisha, Episkopati, Katakombet, Dyqanet, Magazinat e Zaireve, Depot e mëdha të Barutit, etj, etj. Gjithsesi, kalaja ende ka nevojë për më shumë angazhim që të jetë një produkt turistik i mirëfilltë që do të gjenerojë të ardhura përmes shfrytëzimit të saj. Pazari, karakteristik, daton në fund të shek XVII -të. Ai është ndërtuar sipas modelit ndërtimor otoman. Në përshkrimet e kronikanit turk Elvia Çelebia, në vitin 1672, Kalasë i është shtuar administrata turke, garnizoni dhe xhamia. Jashtë mureve sipas skemës së qyteteve evropiane ndodhej Varoshi, Pazari i Vjeter dhe dhjetë Lagje të tjera. Ky përshkrim mund të merret si moment i dokumentuar i formimit të qendrës historike dhe i Pazarit Karakteristik.

Elvia Çelebia, në këtë periudhë, evidenton edhe kishat dhe xhamitë. Nga objektet e kultit me interes mund të përmendim xhaminë në qafën e pazarit, xhaminë në kala, kishën e Shën Mihal Kryeëngjëllit në lagjen Varosh, kishën ortodokse e Shën Sotirit në lagjen Pazar i Vjetër etj. Gjithashtu "Pazari i Vjeter", "Teqe", "Meçite", "Hazmurat", "Cfake", "Manalat" janë lagjet që kur i pa Çelebiu i përmendi me emrat e kohës. Lagjet e vjetra të qytetit, janë zona të ruajtura mirë dhe kanë ndërtesa me arkitekturë karakteristike me shumë dritare, të ndërtuara me gur, rrugina të ngushta me kalldrëm dhe objekte fetare. Këto lagje janë të lidhura me Pazarin Karakteristik dhe Kalanë e qytetit

dhe vizitorët mund t'i shetisin ato.

Gjirokastra është njëkohësisht edhe qyteti muzeumeve, qyteti i gjuhëtarit themelues të gjuhës letrare e standarte shqipe Eqrem Cabej, qyteti ku ndodhet shtëpia e lindjes së udhëheqësit komunist Enver Hoxha apo shkrimtarit me përmasa botërore Ismail Kadare, qyteti ku një herë në katër vjet zhvillohen aktivitetet e mrekullueshme artistike të Festivalit Folklorik Kombëtar, qyteti ku vizitori mund të gjejë produkte të artizanatit e zejtarisë, etj. Këtyre vlerave të jashtëzakonshme arkitekturore, kulturore e historike që Gjirokastra u ofron vizitorëve të huaj, u bashkëgjitet edhe Isopolifonia labe (një vlerë e çertifikuar si “Pasuri e Trashëgimisë Kulturore Botërore” në UNESCO). Gjithashtu, në Gjirokastrë, vizitorët do të gjejnë mikpritjen, shoqërimin dhe mjedisin e kulturuar, pastërtinë karakteristike dhe mundësinë për të shijuar kuzhinën tradicionale të kombinuar me atë bashkëkohore karakteristike të rajonit, dhe gjithë prodhimet BIO të rajonit të jugut.

Ky potencial përbën jo vetëm një detyrim institucional për ta mbrojtur e ruajtur të paprekur qytetin, por edhe shpirtëror e kombëtar për ta ekspozuar e promovuar kudo në botë. Sipas statistikave edhe në Gjirokastrë numri i turistëve ka njohur vazhdimisht një tendencë rritjeje. Kjo duket qartë në grafikun e mëposhtëm:



(Burimi: Bashkia Gjirokastrë)

Natyrishtëm këto zhvillime çuan në domosdoshmerinë e krijimit të një Plani Veprimi për Zhvillimin e Turizmit (PVZHT), i cili u hartua nga Bashkia Gjirokastrë. Ky plan është një dokument zyrtar i hartuar me mbështetjen e asistencën teknike të grupeve të interesit, specialistëve, OJF-ve, institucioneve të

specializuara, biznesit privat, shoqëri civile, që së bashku shpehin qartë vizionin e përbashkët për ta kthyer Gjirokastrën në një destinacion të rëndësishëm e cilësor turistik. Ky proces u parapri nga disa iniciativa të tjera të cilat janë:

Bashkia Gjirokastrë, në partneritet me rajonin e Markeve në Itali hartoi, Planin e Rekuperimit të Qendrës Historike, një dokument shumë i rëndësishëm që përcaktoi modelin dhe metodikën institucionale të ndërhyrjeve restaruese në qendrën Historike, pasuri e Trashëgimisë Kulturore botërore në UNESCO. (viti 2006). Plani i Rekuperimit të Qendrës historike, natyrisht u ndërtua mbi konceptet moderne të zhvilluara sot në nivel evropian e ndërkombëtar mbi qendrat historike të lashta e të reja, si dhe duke harmonizuar e ndërthurur ndërgjegjësimin e komunitetit për vlerat e padiskutueshme arkitektonike, historike, kulturore, morale, estetike etj me mundësitë e përfitimit ekonomik që ato sjellin për këtë komunitet. Ky plan, së bashku me një projekt tjetër po kaq të rëndësishëm e të sukseshëm: Projekti Transizmik - Analiza Eksperimentale për Vlerësimin dhe Reduktimin e Riskut në qendrat historike, jo vetëm përcaktoi kufijtë e qendrës historike, por bën të mundur një sërë ndërhyrjesh të planifikuara, duke ulur ndjeshëm rreziqet që kërcënojnë Qendrën Historike të qytetit. Gjithashtu, në bashkëpunim me Rajonin e Pulias është realizuar projekti "Strategji të integruara për zhvillimin e turizmit familjar", projekt ky me një impakt të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit Gjirokastrë si dhe Projekti për administrimin dhe menazhimin e tokës (LAMP)

Objektiv i gjithë këtyre aktiviteteve të rëndësishme ka qenë:- Përvijimi i një profili të qartë turistik të qytetit, jo vetëm për vizitorët vendas, por edhe ata të huaj. Por është e kuptueshme që vetëm kjo nuk mjafton, pra është i domosdoshëm edhe ndërgjegjësimi për prodhimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore turistike, gjë që do ta plotësonte më së miri këtë imazh.

Hartimi i Politikave strategjike sjell si domosdoshmëri harmonizimin e tyre në nivele të ndryshme hierarkike, sepse vetëm kështu mund të japin rezultatin më të mirë të pritshëm.

Kështu për realizimin e planit të "Zhvillimit Strategjik të Turizmit", Bashkia Gjirokastrë u është referuar një sërë dokumentave të ngjashme si:

"Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim" (SKZHI) 2007-2013" e cila bazohet në:

- Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm .
- Krijimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të turizmit kulturor me plane afatgjata me qëllim shtimin e numrit të turistëve
- Nevojën për njohje dhe investim të hapsirave të turizmit kulturor .

Dokumenti i dytë referues në këtë proces është "Strategjia e Zhvillimit të

Qarkut Gjirokastrë 2005-2015. "Ky dokument e sheh turizmin si një shtyllë dytësore për zhvillimin e ekonomisë së Qarkut, pas bujqësisë dhe blegtorisë, dhe vecanërisht e sheh drejtimin kryesor ekonomik për Bashkinë e Gjirokastrës. Në këtë dokument identifikohet zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit si një objektiv me përparësi për rritjen e ekonomisë lokale.

Dokument tjetër me rëndësi në hartimin e PVZHT-it është edhe "Strategjia Lokale e Zhvillimit të Qëndrueshëm të "Qytetit të Gjirokastrës".

Plani i Veprimit për Zhvillimin e Turizmit është një dokument zyrtar, i detajuar, gjatë hartimit të të cilit u evidentuan disa vështirësi të cilat lidhen me:

- infrastrukturën e dobët turistike
- kufizimet në legjislacionin për pronat dhe pronarët sidomos në një qytet të vecantë si Gjirokastra
- sistem i dobët për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit
- përfshirjen e aseteve natyrore dhe kulturore të rajonit në turizëm,
- kulturë dhe mentalitet të munguar në drejtim të promovimit dhe marketingut të turizmit
- mungesa e traditës në kulturën e shërbimit turistik.
- mungesë eksperience në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore

Fushat e veprimit u përcaktuan pas një procesi të gjatë dhe bashkërendues të të gjithë faktorëve, te cilët kryen :

- Analizën e aseteve turistike egzistuese dhe nevojat për t'u plotësuar
- Analizën e detajuar të tregut turistik
- Përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave strategjike
- Kalendarin e aktiviteteve të domosdoshme për realizimin e objektivave strategjike

Plani i Veprimit që lindi si detyrim i këtij dokumenti (SKZHI-së) përcakton qartë hapat konkrete të përfshirë sipas prioriteve. Elementet specifike të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Turizmit përcaktohen në fushat e poshtëshënuara:

- Ndërgjegjësimi dhe marketingu
- Zhvillimi i produktit të qëndrueshëm
- Investimet në zonat natyrore për të forcuar sektorin e turizmit
- Investime në burimet njerëzore
- Infrastruktura
- Biznesi

Në deklaratën e Vizionit të përcaktuar në “Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2011-2021” thuhet se: “..Në 2021 Bashkia e Gjirokastrës do të jetë një qendër e rëndësishme për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin social-ekonomik; një qytet ku komuniteti gëzon të gjitha mundësitë me një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm...”

Strategjia qartëson se Gjirokastra është e listuar në Trashëgiminë Kulturore Botërore, ka një komunitet që gëzon zhvillim në harmoni dhe mundësi e shanse të barabarta, duke ofruar atraksione të një qendre të turizmit ndërkombëtar. Rëndësia e zhvillimit të turizmit në harmoni me cilësitë unike të qytetit është përfshirë në objektivat strategjike të Planit.

Objektivat strategjike të Planit janë:

Objektivi Strategjik 1 Zhvillim i ekuilibruar i territorit urban dhe ruajtja e vlerave arkitekturore e muzeale të Gjirokastrës “Pasuri e Trashëgimisë Kulturore Botërore” në UNESCO. Zhvillim i detajuar i infrastrukturës turistike me synim shndërimin e saj në prioritet të zhvillimit ekonomik të qytetit.

Objektivi Strategjik 2 Zhvillimi i harmonizuar i ekonomisë së qytetit, si pikë nukël në jug të Shqipërisë, duke shfrytëzuar afërsinë me pikëkalimet kufitare më të rëndësishme të vendit që sjellin prurje të vazhdueshme turistike, me synim zhvillimin e industrisë së turizmit duke u mbështetur në traditën vendase.

Objektivi Strategjik 3 Gjirokastra një qendër atraktive kulturore e turistike ku strukturat pritëse ofrojnë mikpritje, guzhinë tradicionale, trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore të qytetit.

Objektivi Strategjik 4 Bashkejetesë kulturash, brezash dhe traditash në një shoqëri të harmonizuar e të hapur.

Realizimi i këtyre objektivave strategjike sigurisht që kërkon realizimin e disa hapave konkrete, por njëkohësisht kërkon edhe bashkërendim të punës midis institucioneve qendrore dhe lokale që mbajnë përgjegjësi për zhvillimin e turizmit.

Çështja kryesore gjatë hartimit të këtyre strategjive është mbështetja buxhetore e tyre. Për fat të keq përshtypja aktuale është se këto strategji zhvillimi janë kthyer tashmë në dokumenta formale, të cilat nuk kontribuojnë

për një zhvillim të qëndrueshëm të rajoneve nga njëra anë dhe të gjithë vendit në përgjithësi. Për ta përmirësuar këtë situatë, lind domosdoshmëria e unifikimit të strukturave dhe dokumenteve të planifikimit në nivel kombëtar. Gjithashtu këto strategji do të jenë më efikase nëse kanë një përmbajtje detyruese, dhe metodologjia e hartimit të tyre të jetë e studjuar dhe e përshtatshme.

Nëse i hedhim një sy të kujdesshëm, një dokumenti tjetër të rëndësishëm për qytetin : *“Strategjia e zhvillimit të Qëndrueshëm për Gjirokastrën”*, do të shohim se *“...nëse në një periudhë afatgjatë deri në vitin 2030 degë të ekonomisë si ndërtimi do të kenë një rritje negative, Turizmi rezulton të ketë një rritje pozitive, pra të gjenerojë të ardhura për komunitetin duke ruajtur mjedisin dhe burimet natyrore...”* Pra: Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, është një koncept esencial i pranuar sot kudo në botë për zhvillimin e tij. Ky është parimi bazë nga i cili çdo autoritet apo grup interesi duhet të udhëhiqet në punën e tij për hartimin e Strategjisë për Turizmin, Objektivave dhe Planeve të ndryshme të aktiviteteve të domosdoshme.

Por, manaxhimi i qëndrueshëm përbën një domosdoshmëri. Termi “qëndrueshmëri” përbën termin më të diskutuar dekadat e fundit në konferencat ndërkombëtare si dhe nga autorët më të njohur. Cështjet e turizmit të qëndrueshëm janë kaq të rëndësishme edhe për faktin se vetë turizmi sjell efekte të shumefishta jo vetëm mbi ekonominë e një vendi por edhe në industritë dhe degët e tjera.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një ide e re. Autorë të ndryshëm përmendin perandorinë romake si referimet e para të qëndrueshmërisë, sepse romakët fokusuan zhvillimin e qyteteve dhe vendbanimet e tyre në mënyrë të planifikuar dhe të mirëpërcaktuar, me një vizion drejt zgjerimit të ardhshëm të tyre.

Revolucioni industrial ndryshoi mjaft ide dhe koncepte të qëndrueshmërisë koncept i cili u shoqërua me urbanizimin e zonave të mëdha si dhe me rritjen e presionit ndaj ambientit, duke synuar vetëm periudhat afatshkurtra si vizion kryesor. Nga vitet 1980 dolën në pah edhe problemet ambientale globale. Për të korrigjuar këto probleme dhe për të parandaluar pasojat përkatëse kërkohet një rikonceptim i situatës apo një ndryshim në stil dhe mënyrë të jetuari.

Pikërisht në këto kohë, nga Kombet e Bashkuara krijohet një organizëm ndërkombëtar i përbërë nga shkencëtarë, ekonomistë apo edhe politikanë, Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit (1983), i kryesuar nga Gro Harlem Brundtland, Kryeministre e Norvegjisë, komision i cili kishte si qëllim eksplorimin urgjent të problemeve si dhe dhënien e rekomandimeve për veprime dhe ndryshime në të ardhmen. Në këtë moment vjen edhe koncepti

i qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si një përpjekje e vazhduar për të bashkërenduar konfliktet e dukshme midis mbrojtjes ambientale, cilësisë së jetës dhe zhvillimit ekonomik. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm ka lindur në fillim të 1970 si një përgjigje ndaj zhvillimit ekonomik i cili nuk kishte në konsideratë mbrojtjen e burimeve natyrore ose mjedisit. Qëndrueshmëria përbën qëllimin final në kohën e sotme të pasigurisë dhe të ndryshimeve të vazhdueshme, duke përcaktuar gjendjen e ekuilibrit për identifikimin e strategjive të duhura. Kështu, qëndrueshmëria si një synim i zhvillimit ekonomik është më shumë një gjykim social, sesa një funksion i analizave teknike.

“Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat aktuale, pa kompromentuar mundësitë e brezave të ardhshëm për të bërë të njëjtën gjë” (WCED, 1987, *Raporti i Brundlandit*)

“Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit përmbush nevojat e turizmit dhe të komuniteteve, destinacioneve dhe rajoneve të ndryshme, duke ruajtur dhe mbrojtur ndërkohë, mundësitë për të ardhmen” (OBT, 1989)

Aktualisht ekziston një debat mbi turizmin e qëndrueshëm, i cili duket se mbështetet më shumë mbi faktin se ky koncept bazohet shumë mbi gjykimin e vlerave se sa mbi kërkimet empirike apo evidenca të tjera faktike. Megjithatë, sipas literaturës bashkëkohore Turizmi i qëndrueshëm ka disa karakteristika që e dallojnë nga Turizmi i paqëndrueshëm. Kështu në lidhje me strategjitë e zhvillimit, studjuesit thonë se një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit bazohet në planifikim, në skema të udhëhequra nga konceptet, ku duken qartë shqetësime mjedisore, investitorët janë lokal, të punësuarit janë lokal si dhe arkitektura që ndiqet është e kontrolluar dhe uniforme. Ndërsa një zhvillim i paqëndrueshëm ka si karakteristika zhvillimin pa planifikim, i cili bazohet në skema të udhëhequra nga projektet, investitorët janë kryesisht të huaj, të punësuarit jo lokale dhe arkitektura është jouniforme dhe e pa kontrolluar.

Nga hapat konkrete të ndermarra për zhvillimin e turizmit në Gjirokastrë vihet re tendenca e zhvillimit të një turizmi i cili është më pranë formës së paqëndrueshme të zhvillimit.

Menaxhimi i mirë i turizmit të qëndrueshëm është i lidhur me mjedisin, me mirëqenien sociale dhe me zhvillimin ekonomik. Është e nevojshme që të përcaktohet qartë ajo që ne kërkojmë të arrijmë, dhe me pas si duhet realizuar kjo gjë.

- Qëndrueshmëria bazohet në inovacione dhe imagjinatë
- Qëndrueshmëria është menaxhimi i ndryshimit dhe jo frenimi i tij.
- Turizmi i qëndrueshëm do të jetë i dobishëm në qoftë se, sistemi i standardeve zyrtare të tij, do të jetë i aftë të ndihmojë ata konsumatorë

të cilët dëshirojnë të blejnë produkte më të qëndrueshme të turizmit.

- Kjo mund të arrihet në rast se do të kihet parasysh që:
- Krahasueshmëria e impakteve të zhvillimit të turizmit, na ndihmon për të përcaktuar standarde zhvillimi në përputhje me këto ndikime.
- Hulumtimet e vazhdueshme për menaxhimin e industrisë turistike, mundësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara.
- Studimet për sjelljen e turistëve, japin informacionin e duhur për të kuptuar më mirë motivet e tyre dhe proceset nëpër të cilat ata marrin vendime.
- Studimet afatgjata specifike për destinacione të veçanta turistike, dhe përcaktimi i segmenteve të tregut, janë mjaft të rëndësishme.

Hartimi i Strategjive dhe i të gjithë veprimtarive që mbeshtesin zhvillimin e turizmit kulturor në Gjirokastër duhen përshëndetur dhe vlerësuar, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë që, vetëm zhvillimi i turizmit në mënyrë të qëndrueshme, sjell rritjen e ekonomisë lokale dhe përmirësimin e nivelit të jetesës për banorët vendas.

Është e domosdoshme të tregohemi më shumë objektiv në debatin e turizmit të qëndrueshëm. Është e rëndësishme të dihet se turizmi i qëndrueshëm është një çështje politike, pasi ka të bëjë pikërisht me shpërndarjen e burimeve në të ardhmen. Natyra politike e debatit të turizmit të qëndrueshëm ka të bëjë me faktin se kush e ka pushtetin dhe se si përdoret ky pushtet – komuniteti pritës & pushteti lokal, pushteti qendror & institucionet e tij, apo bizneset turistike dhe turistët.

Turizmi i qëndrueshëm është balancimi i interesave të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë dukuri.

“Të ecim së bashku është një fillim. Të ruajmë së bashku është progres. Të punojmë së bashku është suksesi. (Henry Ford)

Konkluzione & Rekomandime

➤ Mbështetja buxhetore e strategjive të hartuara si dhe unifikimi i domosdoshëm i strukturave dhe dokumenteve të planifikimit në nivel kombëtar.

➤ Hartimi i strategjive me përmbajtje detyruese dhe metodologjia e hartimit të tyre të jetë e studjuar dhe e përshtatshme.

➤ Koncepti i turizmit të qëndrueshëm është më kompleks se sa duket, kështu që kërkuesit duhet të analizojnë në mënyrë të vazhdueshme konceptet dhe teknikat e turizmit të qëndrueshëm

➤ Zhvillimi i formave më të qëndrueshme të turizmit dhe përshtatja e vazhdueshme e formave të menaxhimit të turizmit të qëndrueshëm

➤ Bashkërendim i punës dhe bashkëpunim efikas midis grupeve të interesit duke realizuar një zhvillim të turizmit me ndikime pozitive mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Bibliografia:

1. "Strategjia e Zhvillimit të Qarkut Gjirokastrë 2005-2015".
2. "Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim" (SKZHI) 2007-2013".
3. Plani Përgjithshëm Urbanistik i qytetit Gjirokastrë Konsorciumi -kompani izraelite, greke e shqiptare.
4. Studimi I riskut sizmik në zonën muzeale. Gjirokastrë : s.n., 2008, Vol. 3. a cura di F.Torresi.
5. Service Guide- ZIT, Office of the Municipality of Gjirokastrë. 2008. . Support to Italy - Albania partnership on tourism.
6. GJIROKASTER, citta museo- Patrimonio dell' Umanita UNESCO. Gjirokastra - Galatina : Catalogo SIVATUR, 2007.
